



# **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Raporti përfundimtar i auditimit i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes (MM)

## **RAPORT PËRFUNDIMTAR**

**“AUDITIM FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRIE  
MBI VEPRIMTARINË E MINISTRISË SË  
MBROJTJES”**

**MAJ 2024**

## **PËRMBLEDHJE**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.....	3
I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.....	10
I. Hyrja.....	13
3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	13
4) Identifikimi i çështjes: .....	15
6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH: .....	15
7) Kriteret e vlerësimit: .....	16
8) Standardet e Auditimit.....	17
9) Metodatat e auditimit.....	17
10) Dokumentimi i auditimit .....	18
II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT.....	19
2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:.....	19
2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit. ....	19
2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.....	31
2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.....	44
2.4 Auditimi i llogarive vjetore.....	56
2.5 Prokurimet me fonde publike.....	79
2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.....	173
2.7 Vlerësimi i komponentëve të Auditit të brendshëm. ....	178
2.8 Probleme të ndryshme që mund të dalim gjatë auditimit. ....	186
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET .....	223

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Ministrinë e Mbrojtjes, më poshtë e emërtuar “MM”, për periudhën nga data 01.07.2021 deri në datën 30.06.2023, me objekt “Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërisë”.

Auditimi kishte në fokus shtatë drejtime kryesore, sipas programit të miratuar me nr. 555/1, datë 17.07.2023 i ndryshuar, dhe në të u angazhuan 5 (pesë) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi u përqendrua kryesisht në aktivitetin e MM mbi planifikimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm të njësisë, procedurat e prokurimit publik, zbatimin e kontratave, mbajtjen e evidencës kontabël dhe menaxhimin e aktiveve.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilin prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë dhe financiar të KLSH, Rregullorja e funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Bazuar në rezultatet e auditimit të MM për periudhën nga data nga data 01.07.2021 deri në datën 30.06.2023, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar të përputhshmërisë dhe opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare.

Grupi i auditimit ka hartuar këtë Raport Përfundimtar auditimi, duke reflektuar edhe komentet e subjektit, sa i takon projektraportit të auditimit. Rezultatet dhe çështjet kryesore të këtij auditimi janë trajtuar në vijim të raportit përfundimtar, së bashku me konkluzionin e përgjithshëm dhe opinionin e auditimit.

## I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA NË RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
A/1	<p>Nga auditimi i Prokurimeve Ushtarake, konstatohet se Ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit shqiptar me legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC. Prokurimet e fushës së mbrojtjes dhe sigurisë, janë zhvilluar sipas Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Nga shqyrtimi i bazës ligjore me të cilën janë zhvilluar procedurat ushtarake vërehen disa mospërputhje mes Ligjit 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020.</p> <p>a) Referuar ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, në nenin 53, pika 2 dhe 3 parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 79-174, të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim korrigjimin dhe ndryshimin e vlerës së kufijitë monetarë sipas përcaktimeve të Direktivës 2009/81/EC.</p> <p>- Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë masat e nevojshme për rregullimet e mospërputhshmërinë ligjore të afateve të ankesave për dokumentet e procedurave prokuruese.</p>

	<p>brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. Ndërsa në VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, në nenin 62, pika 4 dhe 5 parashikohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>b) Referuar VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, neni 5 “Kufijtë monetarë”, në nenin 1/a) parashikohet: Në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së, kufijtë monetarë janë: a) kufiri për procedurat ndërkombëtare: pika i. për kontratat e furnizimit dhe shërbimit me vlerë jo më të ulët se 50,964,400 lekë; pika ii. për kontratat e punëve me vlerë jo më të ulët se 6,371,787 lekë.</p> <p>Duke pasur parasysh që ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit Shqiptar me Legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC, rezulton se vlera e përcaktuar e kufirit për procedurat ndërkombëtare për kontratat e punëve (me vlerë jo më të ulët se 6,371,787 lekë), është një lapsus (Lapsus) në përkthimin e vlerës së Direktivës 2009/81/EC, ku parashikohet se për kontratat e punëve kufiri i përcaktuar është 5,150,000 Euro.</p> <p>c) Një tjetër mangësi që konstatohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) është edhe mos parashikimi i afateve të ankimit pas përzgjedhjes së kandidatëve në fazën e parë të procedurës së kufizuar.</p>			<p>- Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim përmbushjen e parashikimit të afatit të paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomikë pas përfundimit të fazës së parë të procedurës së kufizuar.</p>
<p><b>B/8</b></p>	<p>Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Alpha Web” rezultoi se në llogarinë 31 “Materiale”, rezulton se janë regjistruar padrejtësisht si materiale zëra të aktiveve afatgjata në vlerë totale 780,229 leke.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se gjendja e materialeve në magazinë sipas të dhënave nga “Alpha Web” është në vlerën 11,266,591 lekë, ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 1,193,936 lekë me një diferencë prej 10,072,655 lekë.</p> <p>Inventari i imët është në vlerën 16,515,515 lekë ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 3,876,403 lekë me një diferencë në vlerën prej 12,639,112 lekë.</p> <p>Llogaria 35 “Mallra” është pasqyruar në kontabilitet në vlerën 13,129,191 lekë, ndërsa në “Alpha web” është zero.</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 56-79, të Raportit të Auditimit</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin e vlerave të kontabilizuar në llogarinë 31 “Materiale”, duke kredituar këtë llogari për vlerat të cilat nuk i përkasin dhe debituar llogarinë 21 “Aktive Afatgjata”.</p> <p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që përpara mbylljes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet një rakordim të vlerave të regjistruara në “Alpha Web” dhe atyre që do të raportohet në pasqyra financiare, duke mbajtur një procesverbal midis punonjësit të ngarkuar për kontabilizimin e hyrje</p>

	Diferenca totale "Gjendje inventari qarkullues" e pasqyruara në pasqyrën financiar të institucionit krahasuar me regjistrimin e tyre në programin "Alpha Web" është në vlerën 9,582,577 lekë, e cila është e paargumentuar në shënimet shpjeguese të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Klasa 2 "Aktivet Afatgjata".			daljeve të vlerave materiale dhe Përgjegjësit të Sektorit.
<b>B/15</b>	<p>Nga rakordimi i gjendjes së aktiveve të evidentuar nga Komisioni i inventarizimit me gjendjen e aktiveve të pasqyruara në formatin 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" ka rezultuar një diferencë në shumën prej 50,206,736.90 lekë, për të cilën nga subjekti i audituar nuk janë dhënë shpjegime mbi burimin e krijimit të kësaj difference.</p> <p>- Nga rakordimi i lëvizjeve të aktiveve të realizuara gjatë vitit 2021 dhe pasqyrimi i tyre në formatin 7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" ka rezultuar se:</p> <p>Vlera e aktiveve të dala nga institucioni shoqëruar me dokumentacion është në shumën 17,493,024 lekë, si dhe vlera 6,830,594 lekë që janë aktiveve të dërguara në ASNI për asgjësimin e tyre, bazuar në urdhrin me nr. 1, datë 12.01.2017 "Për trajtimin e mbetjeve nga pajisjet elektronike, pas heqjes nga përdorimi të Forcave të Armatosura", në total në shumën prej 24,323,618 lekë. Nga institucioni është pasqyruar vlera prej 85,231,318 lekë në kolonën "Pakësime të tjera", me një diferencë më shumë në vlerën 60,907,700 lekë, vlerë për të cilën nga subjekti i audituar nuk janë dhënë shpjegime dhe nuk ka dokumentacion bashkëlidhur të daljes ose transferimit të këtyre aktiveve. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 56-79, të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	<p>Ministria e Mbrojtjes të marrë masat të menjëhershme për ngritjen e një grupi punë, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit dhe bazuar në rezultatet e dala të marrë masat rast pas rasti, për të analizuar diferencat dhe të nxjerre përgjegjësitë disiplinore, të marre masa të shpërblimit të dëmeve apo të drejtohet organeve të tjera shtetërore për diferencat e pa justifikuar, si dhe të kryhen sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve.</p> <p>- Ministria e Mbrojtjes të marrë masat në vijimësi, që çdo vit përpara mbylljes së pasqyrave financiare, Përfaqësuesit/Atashetë Ushtarak duhet të paraqesin inventarizimin e aktiveve nën administrim, duke e rakorduar me vlerat e pasqyruara në kontabilitetin e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me qëllim sigurimin e plotësisë, paanësisë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.</p>
<b>B/16</b>	<p>Nga auditimi i 8 (tetë) procedurave të prokurimit "Punë Mallra dhe shërbime", në Ministrinë e Mbrojtjes me objekt: "Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)"; " Rikostruksion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)", "Ndërtim hangari për mirëmbajtje dhe strehim helikopterësh UH60 Black Hawk", "Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë", "Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike", "Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje,</p>	<i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 79-174, të Raportit të Auditimit</i>	E lartë	<p>Ministria e Mbrojtjes, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.</p> <p>- AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe</p>

	<p>Berat”, “Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”, “Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër”, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësisve të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter. Janë konstatuar mangësi në kategori licencash nga QKL dhe kërkesa për operatorët ekonomik që të kenë të punësuar në stafin e tyre “Auditues energjie”, i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjetik në ndërtesa”, në kundërshtim nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4. Kriteret kualifikuese kanë kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk është stimuluar pjesëmarrjen e tyre.</p>			<p>llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.</p>
<p><b>B/18</b></p>	<p>Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të “Shërbime”, në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe kriteret kualifikuese me objekt: “Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA”; “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”; “Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar është përzgjedhur lloji i procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” dhe jo “Konkurs Projektimit” në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të hartimit të projekteve. Janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësisve të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë në përputhje me LPP. Afati i realizimit të projekteve është përcaktuar në kohë shumë të shkurtër, cka tregon veprime të paargumentuara dhe të pa llogjikshme në përcaktimin e afatit për hartimin e projekt preventivit, ku nuk mund të zbatohen as fazat e shërbimit apo dorëzimit të projektit sipas VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”. Afati shumë i shkurtër i dorëzimit të projekt- preventivit ngushton konkurrencën, duke mos stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik. Gjithashtu konstatohet se në DT,</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 79-174, të Raportit të Auditimit</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë në procedurat e prokurimit të projekteve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që të përzgjedh projekte me propozime teknike (apo vlerësime me pike), në funksion të kërkesave të AK, duke propozuar oferta me kosto më të ulëta.</p>

	<p>procedura është trajtuar si kontratë shërbimi mbikëqyrje apo kolaudimi, ku është përcaktuar se të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354, do të skualifikohen, duke moskrijuar mundësi operatorëve ekonomik për propozime teknike dhe ekonomike të projektit.</p>			
C/1	<p>Nga auditimi i Kontratës së shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, nuk janë përmbushur parashikimet ligjore të VKM-së me nr. 354, datë 11.05.2016 “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Me raportin nr. 423/10 prot. Datë 25.05.2023, miratohet procedura e prokurimit nga titullari i IGJIU dhe kontrata nënshkruhet me OE fitues “A.E E.” shpk me nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 me vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, ku nuk është përcaktuar asnjë kalendar pagesash e ndarë në faza. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim nr. 423/8 prot., datë 25.08.2023 nga grupi i marrjes në dorëzim, konstatohet se janë realizuar shërbimet: Analiza e detyrës projektimit dhe termat e referencës; Projekt Idea paraprake; Projekt Idea Përfundimtare; Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; Projekt Zbatimi; Preventivi përfundimtar; Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi. Fatura tatimore e operatorit ekonomik mban nr. 38/2023 datë 04.09.2023, me vlerë total 15,884,200 pa TVSH ose 19,061,040 lekë me TVSH dhe kërkesa për likuidim nr. 423/19 prot., datë 04.09.2023, e cila është e likuiduar plotësisht gjithë vlera e kontratës nga financa e IGJIU. Në lidhje me dorëzimin e projektit konstatohet se në zbatim të VKM-së me nr. 354, datë 11.05.2016 “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, neni 7, “Përcaktimi i Tarifave” pika 5, dhe pika 8, nga AK, nuk është marrë asnjë masë për rillogaritjen e vlerave të projektimit. Referuar Projekt – Preventivit të dorëzuar nga projektuesi “A.E.E.” shpk, konstatohet se vlera e Investimit për objektin “Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, rezulton në vlerën 345,647,428 lekë me TVSH. Pra kjo është kostoja përfundimtare e cila do të rillogaritet vlera e shërbimit të projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit. Në bazë të kostove të objektit, është llogaritur tarifa e projektimit, nga grupi i auditimit dhe</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 79-174, të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>- Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrë masa të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mos llogaritjeve të kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej 10,189,231 lekë me TVSH e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “A.E. E.”.</p>

	<p>specialistë të IGJIU, si më poshtë: I. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira shuma 258,106,339 lekë me TVSH, II. Rruga taxiway parkimet shuma 90,209,677 lekë me TVSH, III. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira + Rruga taxiway parkimet shuma 345,647,428 lekë me TVSH. Në bazë të vlerave sa më sipër rezultojnë tarifat e projektimit si më poshtë: Totali Min 7,393,174 lekë dhe Max 9,010,110 lekë. Mos llogaritja e kostove përfundimtare të ndërtimit dhe rrjedhimisht edhe kostove të shërbimit të projektimit, kanë sjellë përfitim të padrejtë në favor të projektuesit. Kontrata e shërbimit nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 midis OE “A.E.E.”, dhe Titullarit të IGJIU, u nënshkrua me çmimin e ofertuar nga kontraktuesi dhe i miratuar nga AK, në vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, pra me diferencë <math>(15,884,200 - 7,393,174) = 8,491,026</math> lekë pa TVSH ose 10,189,231 lekë me TVSH, e cila përbën Dëm Ekonomik për Buxhetin e Shtetit, e përfituar padrejtësisht nga projektuesi “A.E.E.” shpk.</p>			
C/2	<p>Nga auditimi i Kontratës së shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA”, nuk ka përbushur parashikimet ligjore të VKM-së me nr. 354 datë 11.05.2016 “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Me raportin përmbledhës nr. 200/8 prot., datë 27.06.2022, miratohet procedura e prokurimit nga titullari i IGJIU. Formulari i njoftimit të fituesit është realizuar me nr. 200/9 prot., datë 01.07.2022 dhe kontrata e shërbimit realizohet me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me vlerën 5,698,405 lekë me TVSH me OE fitues “I.D.-A.” shpk. Me shkresën e OE “I.D.-A.” shpk, nr. 468 prot., datë 20.09.2022, dorëzohet dokumentacioni i kontratës së shërbimit që bashkëngjijt vetëm Analizën e Detyrës së projektimit dhe Projekt idenë paraprake. Inventari i dosjes përmban vetëm 13 relacione të godinave për gjendjen ekzistuese dhe një planimetri IDE të tyre. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 200/23 prot., datë 13.10.2022 për objektin “Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë të AFA”, konstatohet se është dorëzuar detyra e projektimit dhe termave të referencës dhe projekt ideja paraprake për kampusin. Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga marrja në dorëzim e projekt idesë hartuar nga OE “I.D.-A.”</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 79-174, të Raportit të Auditimit</i></p>	<p>E lartë</p>	<p>Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, me specialist të fushës për vlerësimin e dokumentacionit shtesë të shërbimit të projektidesë në vlerën <b>5,698,405 lekë me TVSH</b>, e cila nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit rezultonte si shërbim i papërfunduar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse shërbimi projektidesë pas vlerësimit të grupit me ekspertë rezulton i paplotësuar bazuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të merren masa ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga operatori ekonomik “I.D.A.” shpk.</p>



	<p>shpk, Analiza e Detyrës së projektimit dhe Projekt idea paraprake, ka ngjashmëri me Detyrën e projektimit realizuar në Mars 2022 nga IGJIU, çka tregon mbivendosje të idesë apo shërbimit të projekt idesë. Projekt Idea e përgatitur nga OE “I.D.-A..” shpk nuk paraqet situatë të saktë dhe nevojat reale për ndërhyrje, pasi kryesisht përshkruan gjendjen ekzistuese të godinave dhe nevojën për rikonstrukcion, gjë e cila është hartuar ose konstatuar nga vetë IGJU dhe nuk ka hartuar asnjë kosto paraprake të Investimeve. Referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim” Nenit 25 dhe Nenit 49 “Shërbimet për planifikimin e strukturave mbajtëse” nga operatori ekonomik fitues, nuk është përcaktuar asnjë kosto apo ide paraprake e investimeve apo variante të ndryshme të projekt idesë. Gjithashtu nuk është realizuar asnjë relacion statiko-konstruktive mbi problemet e qëndrueshmërisë së godinave dhe në përfundim projekti përfundimtar i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU. Projekti i zbatimit përfundimtar është zbatuar nga vetë IGJIU, fillimisht për 3 objekte më datë 26.06.2022 në vlerën e investimit prej 1,438,894,719 lekë me TVSH dhe në përfundim për 2 objekte (Akademia, Menza) datë 17.07.2022 në vlerën e Investimit prej 741,534,842 lekë me TVSH. Pra nuk ka argumentim se për çfarë shkaku duhet të prokurohej shërbimi i hartimit të projekt idesë kur projekt - preventivi i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU, ç’ka tregon keqmenaxhim të fondeve publike në vlerën 5,698,405 lekë me TVSH, e përfituar padrejtësisht nga OE “I.D.-A.” shpk. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5.</p>			
C/14	<p>Nga auditimi i rimbursimeve në lidhje me programin Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020” të projektit “TO BE READY” rezultoi se nga projekti është rimbursuar vlerat prej 401,126 Euro. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga AKMC citohet se është kërkuar për tu “Certifikuar nga FLC dhe Komisioni Evropian” shuma prej 824,422.88 Euro, por të miratuar për tu rimbursuar është vlera prej 806,422.88 Euro, me një diferencë më pak në shumën prej 18,000 euro, për të cilën nuk është dhënë sqarime dhe argumentime, se për cilën nga paketat nuk është bërë certifikimi i shumës.</p> <p>- Buxheti total i projektit për Shqipërinë ku përfshihen institucionet si Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është 1,479,049.95 euro, ku nga informacioni i dhënë nga</p>	<p><i>Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 179-217, të Raportit të Auditimit</i></p>	E lartë	<p>Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune, që të vlerësojnë e të analizojnë vlerën prej 67,455.68 Euro të përlogaritur më tepër si detyrim për tu paguar nga shtetit Shqiptar dhe shumën e shpenzimeve prej 18,000 Euro e paargumentuar dhe justifikuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga përfituesit.</p>

<p>menaxherja e projektit dhe AKMC është cituar se, fondi ka pësuar shkurtime për shkak të situatës pandemike Covid 19 në vlerën 129,936.37 euro, nga ku rezulton se buxheti total i projektit është në vlerën 1,349,113.58 euro, nga të cilat 1,079,290.86 euro janë financim nga IPA dhe 269,822.7 euro janë bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total). Vlera e bashkëfinancimit nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total) ka një mospërputhje në llogaritje pasi në fazën e parë, pa u shkurtuar fondet vlera e bashkëfinancimit ka qenë në shumën 221,857.50 euro. Me shkurtime e fondeve edhe vlera e bashkëfinancimit ulet në mënyrë proporcionale dhe nuk mund të pësojë rritje me shumën 47,965.22 euro.</p> <p>Nga sa më sipër buxheti total i projektit në vlerën 1,349,113.58 euro, ndahet në 1,146,746.5 euro financim nga IPA dhe 202,367 euro bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total). Në këto kushte shuma e ngarkuar më tepër, si detyrim i Buxhetit të Shtetit në vlerën 67,455.68 Euro (269,822.716 - 202,367), duke rënduar buxhetin e shtetit me vlera të pajustificuara.</p>			
---	--	--	--

### **I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.**

Në përfundim të auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, të ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.07.2021 deri në datën 30.06.2023, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 555/1, datë 17.07.2023 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin, si më poshtë:

Sa i përket auditimit të përputhshmërisë, subjekti i audituar, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, duke u evidentuar mangësi në përcaktimin e kritereve të vendosura në procedurat e prokurimit, në monitorimin dhe zbatimin e kontratave, të cilat për nga rëndësia kanë rezultuar të jenë materiale, por jo të përhapura, duke mbështetur dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Sa i përket auditimit financiar, gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të MM, duke mbështetur dhënien e një opinioni të modifikuar.

#### **I. Opinioni për auditimin financiar<sup>1</sup>: i kualifikuar<sup>2</sup>:**

Ne kemi audituar hartimin dhe konsolidimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mbrojtjes, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i zbatimit të parimeve kontabël si dhe i paraqitjes së

1 - Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

2 -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 "Për miratimin e manualit të auditimit financiar " të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3.5 (faqe 54 dhe 60-61), "Një "Opinion i Kualifikuar", jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*"

përgjithshme të pasqyrave financiare.

### **Opinionit:**

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të institucionit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadrit rregullator në fuqi:

Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi kornizën e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, etj.

### **Baza për opinionin:**

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t. Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti dhe në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, kemi përmbushur përgjegjësitë etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 406,878 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “*Opinionit të Kualifikuar*” të auditimit.

Nga auditimi i kryer nga ana e KLSH-së, mbi vlerësimin integral të sistemit të mbajtjes së kontabilitetit dhe raportimit financiar në institucionin e qeverisjes qendrore Ministria e Mbrojtjes dhe subjektet e varësisë së saj, sipas kërkesave të legjislacionit mbi buxhetin dhe kontabilitetin, kanë rezultuar disa mangësi dhe parregullsi, të identifikuar si më poshtë vijon:

- Nga auditimi i shpenzimeve të konstatuara në “*Pasqyra e Performancës*” rezultoi mospërputhje të shpenzimeve të pasqyruara në pasqyrën e performancës financiare me rakordimin me degën e thesarit, për Llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime”; Llogarinë 605 “Transferime për Organizatat Ndërkombëtare”; Llogarinë 606 “Transferta Paguara nga Institucione tjera e Organizata e Pushtetit Vendor”.

- Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer janë në shumën prej 8,442 mijë lekë.

- Nga auditimi i kartelave të detyrimeve të Përfaqësuesve/Atasheve Ushtarak deri në 31.12.2022 për shpenzimet financiare, të cilat mbulohen nga Ministria e Mbrojtjes. rezultoi se kishte mospërputhje në vlerat e deklaruara në Llogarinë 437-438437-438 “Organizma të tjera shtetërore”, me një diferencë në 156,624 mijë lekë me pak se vlera reale prej 915,753,741 lekë.

- Llogari 215 “*Mjete transporti*” është në vlerën 26,413,260 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është në vlerën 29,910,461 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën prej 3,497,200 lekë.

- Llogari 218 “*Inventar ekonomik*” është në vlerën 274,356,666 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është në vlerën 279,091,542 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën prej 4,734,876 lekë.

- Strukturat përgjegjëse në Mbrojtjes kanë hartuar Pasqyrat Financiare Përmbledhëse Vjetore për 2022, por ato përmbajnë parregullsi, mangësi e mospërputhje, ndaj nuk është e mundur që të ofrohet siguri e plotë mbi saktësinë dhe cilësinë e informacionit të përmbledhur në nivel grupi (ministrie).

- Nga rakordimi i gjendjes së aktiveve të evidentuar nga Komisioni i inventarizimit me gjendjen e aktiveve të pasqyruara në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

historike)” ka rezultuar një diferencë në shumën prej 50,206,736.90 lekë, për të cilën nga subjekti i audituar nuk janë dhënë shpjegime mbi burimin e krijimit të kësaj difference.

Bazuar në konkluzionet kryesore të raportit të auditimit, KLSH nënvizon domosdoshmërinë, për një vëmendje të shtuar të drejtuesve të MM, nga njëra anë, por edhe të titullarëve të subjekteve publike të varësisë së kësaj ministrie, nga ana tjetër, për forcimin e masave dhe përmirësimin e proceseve në fushat e identifikuara. E nevojshme është që të instalohen mekanizma, të cilët sigurojnë zbatimin e parimeve, rregullave dhe standardeve të kontabilitetit të sektorit publik, por edhe rishikimit e forcimit të strukturave organike, sanksioneve e masave ndëshkuese, pasi një numër i gjetjeve mbi parregullsitë e fushës së kontabilitetit dhe raportimit financiar, vijnë të përsëriten nga viti në vit, siç prezantohen në raportet e auditimit të KLSH në subjektin e audituar.

#### **Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit:**

Strukturat menaxheriale të Ministrisë së Mbrojtjes janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar. Stafit drejtues është përgjegjës për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **Përgjegjësia e audituesve të KLSH për auditimin financiar:**

Në bazën për opinionin keni cituar se Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare.

#### ***Opinion për auditimin e përputhshmërisë (Kualifikuar<sup>3</sup>).***

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë në auditim përputhshmërisë e veprimtarisë së institucionit Ministria e Mbrojtjes me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

*“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e MM, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë”.*

#### **Baza për opinionin e përputhshmërisë.**

Në kemi audituar veprimtarinë e subjektit Ministria e Mbrojtjes (MM) në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” , ISSAI 4000 dhe ISSAI 100, paragrafi 42. Auditimi u krye në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së si dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAI-s); me parimet INTOSAI-PI, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20 dhe INTOSAI P-50, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Në i kemi përmblusur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet publike, KLSH është e pavarur nga MM dhe përgjegjësitë janë përmblusur në pajtim me këto kërkesa.

<sup>3</sup> **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura”.

Në besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për përgatitjen e *opinionit të kualifikuar* mbështetur në konstatimet në vijim:

- Nga auditimi u konstatua se 16 projekte investimi, sipas PBA 2021-2023 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2022-2024 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2021-2023 janë parashikuar me një vlerë totale prej 18,571,645 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 janë parashikuar në vlerën totale prej 28,664,854 mijë lekë, me një diferencë prej 10,093,209 mijë lekë.

- Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2021-2022, janë realizuar projekte të paplanifikuara në PBA-të respektive dhe konkretisht: 10 projekte në shumën 1,089,925 mijë lekë gjatë vitit 2021; 13 projekte investimi në shumën 1,175,011 mijë lekë, gjatë vitit 2022. Nga auditimi i procedurave të prokurimit rezultoi se:

a) Kriteret e vendosura dhe të kërkuara nga AK, në 10 raste, nga 45 procedura prokurimi të audituara nuk janë të argumentuara, veprime në kundërshtim të VKM-së me nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” pika 2 e nenit 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

b) KVO ka kualifikuar OE, të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

c) Nga auditimi i zbatimit të kontratave rezultuan pasaktësi për punime të pakryera, por të likuiduara dhe mbivendosje të zërave të punimeve në vlerën **4,268,613 lekë**.

d) Nga auditimi i Kontratës së shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë” dhe ‘Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA” nuk janë përmbushur parashikimet ligjore të VKM-së nr. 354, datë 11.05.2016 “Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën **15,887,636 lekë**.

e) Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të prokurimit “Shërbime”, në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së, në për zgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe kriteret kualifikuese.

f) Nga auditimi i programit Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020” të projektit “TO BE READY” u konstatua dëm ekonomik në vlerën **18,396,391 lekë**.

## **I. Hyrja.**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit me nr. 555/1, datë 17.07.2023 i ndryshuar, në Ministrinë e Mbrojtjes, nga data 17.07.2023 deri më datën 31.01.2024, për periudhën e auditimit 01.07.2021-30.06.2023, u krye auditim Financiar dhe Përputhshmërie, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. J. G., (përgjegjës grupi)
2. A. K., anëtar
3. A. Gj., anëtar
4. S. Z., anëtar
5. M. N., anëtar

### **3) Objektivat dhe qëllimi i auditimit:**

*Objektivat specifike të auditimit* është përputhshmëria e veprimitarisë së subjektit, Ministria e Mbrojtjes me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë këtu procedurat e prokurimit dhe shpenzimet vjetore të institucionit.

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në nenin 3 të tij ka përcaktuar se, “Auditim i përputhshmërisë nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord”. Në nenin 12 “Auditimi i përputhshmërisë” të po këtij ligji është shprehur se: “Në auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë: nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin; nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik”. Në pikën 2 të po këtij neni ka përcaktuar se “Auditim financiar” nënkupton një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.

ISSAI 4000, paragrafi 23: Objektivi kryesor i auditimit të përputhshmërisë është t’i sigurojë përdoruesit të synuar informacione nëse entitetet publike të audituara ndjekin vendimet parlamentare, ligjet, aktet legjislativë, politikat, kode të përcaktuara dhe terma të dakordësuar. ISSAI 1700, paragrafi 4: Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

Objektivat e auditimit synojnë:

**a.** Dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

**b.** njehërësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik).

**c.** promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve:

-nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

- verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

**Qëllimi i auditimit** është vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e raportuara janë në çdo aspekt material, në përputhje me ligjshmërinë dhe menaxhimin financiar, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë Ministria e Mbrojtjes, në mënyrë për të bërë të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, me synim të mirë përdorimit të

fondeve të financuara nga Buxheti i Shtetit.

#### **4) Identifikimi i çështjes:**

Projekt Raporti synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të institucionit të Ministria e Mbrojtjes, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat nënligjore në fuqi, Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së “Ministrisë së Mbrojtjes”, për periudhën objekt auditimi nga 01.07.2021 deri në 30.06.2023, në përputhje me aktet ligjore të cilat rregullojnë veprimtarinë e këtij institucioni. Përputhshmëria dhe rregullshmëria në procedurat e ndjekura nga ana e drejtorive përkatëse të MM, të cilat realizojnë koordinimin dhe zbatimin e strategjive që orientojnë në hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme të institucionit.

Në funksion të këtij angazhimi, janë vlerësuar aktivitetet që kanë të bëjnë me respektimin e kriterëve mbi administrimin e shpenzimeve, buxhetimin dhe menaxhimin financiar, prokurimet publike, respektimin e organigramës dhe të strukturës organike, etj. Në fokusin e angazhimit janë përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare Vjetore nga ana e këtij institucionit në mbështetje të dispozitave ligjore dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi nënligjore në fuqi në fushën e kontabilitetit të sektorit publik dhe pasqyrave financiare, si dhe aspektet e zbatimit të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”, i ndryshuar.

Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit me nr. 555/1, datë 17.07.2023 i ndryshuar.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Niveli menaxherial i Ministrisë së Mbrojtjes është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

#### **6) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:**

Audituesit e KLSH<sup>së</sup> kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinionit.

Audituesit e KLSH<sup>së</sup> kanë përgjegjësi të respektojnë kërkesat etike dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim që të arrijnë nivelin e sigurisë të arsyeshme për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, pra pasqyrat në tërësi nuk përmbajnë gabime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

Audituesit e KLSH<sup>së</sup> kanë përgjegjësi që nëpërmjet auditimit të realizuar, të krijojnë bindjet për të shprehur një opinionin mbi çështjet që janë nën auditim.

Audituesit e KLSH<sup>së</sup> kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;

- njëherësh aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet opinioni i grupit të auditimit mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

a) nëse shpenzimet janë ekzekutuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;

c) nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji Organik i Buxhetit apo Ligji i Prokurimit Publik etj.

b) nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e kaluara;

c) Interesin publik ose pritshmëritë publike (p.sh. shkelje të identifikuara nga media, etj.)

d) Fusha specifike që janë objekt i fokusit ligjvënës etj;

Në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, përkatësisht ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit në Sektorin Publik” (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 41 “Materialiteti” dhe ISSAI 400 “Parimet e auditimit të përputhshmërisë”, (*rishikimi i vitit 2019*), paragrafi 47, ku nënvizohet se:

*“Audituesit duhet të marrin në konsideratë materialitetin gjatë gjithë procesit të auditimit. Përcaktimi i materialitetit është çështje gjykimi profesional dhe varet në interpretimin e auditorit të nevojave të përdoruesve. Një çështje mund të gjykohet material nëse njohuritë për të do të kishin të ngjarë të ndikonin në vendimet e përdoruesit e synuar. Ky gjykim mund të ketë të bëjë me një çështje individual ose me një grup të çështjeve të marra së bashku. Materialiteti shpesh konsiderohet në kuptim të vlerës, por gjithashtu ka aspekte të tjera sasiore si dhe cilësore. Karakteristikat e qenësishme një çështjeje ose grupi të çështjeve mund të jenë materiale nga vetë natyra e saj. Një çështje mund të jetë gjithashtu materiale për shkak të kontekstit në të cilin ndodh”.*

Sa më sipër, audituesit aplikojnë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

## **7) Kriteret e vlerësimit:**

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 57, datë 02.06.2016;
- Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabinetëve, në kryeministri,



aparartet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” i ndryshuar;

- Udhëzimi MF nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”; i ndryshuar me Udhëzimin MF nr. 5, datë 21.02.2022.

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

- Urdhër i MFE nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”;

- Udhëzimi MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”;

- Udhëzimet standard të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.

- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 7, datë 17.01.2024 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup>.

### **8) Standardet e Auditimit**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- INTOSAI – P - 1 “Deklarata e Limës”;

- INTOSAI – P – 10 - 99 “Parimet themelore të INTOSAP”;

- INTOSAI – P - 10 “Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAP”;

- INTOSAI – P - 12 “Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve”;

- INTOSAI – P - 20 “Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies”;

- INTOSAI – P - 50 “Parimet e juridiksionit të SAP”;

- ISSAI 100 - 129 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;

- ISSAI 2000 - 2899 “Standardet e Auditimit Financiar”;

- ISSAI 400 “Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë”;

- ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”;

- ISSAI 2705 “Modifikimet e opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur”;

- Manualin e Auditimit Financiar, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 246, datë 29.12.2022;

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022.

### **9) Medodat e auditimit**

Mbështetur në **ISSAI 1315**, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 07-2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet. Nga përllogaritjet që grupi i auditimit kreu, për institucionin Ministrisë së Mbrojtjes, niveli i materialitetit për vitin 2022 rezultoi në vlerën 406,878 mijë lekë.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

*funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm është bazuar në kryerjen e testeve të kontrolleve. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të ulët deri në të moderuar.*

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara, metodat dhe teknikat e mëposhtme:

a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;

b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;

c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifiku drejtimit të auditimit;

d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;

g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;

h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të veçanta të auditimit, sipas drejtimit të auditimit;

g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

Auditimi ynë ka përfshirë përputhshmërinë e aktivitetit të MM, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi lidhur me zbatimin e kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit, identifikimin, zbatimin e kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimin e planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar, parashikimin dhe realizimin e të ardhurave dytësore, planifikimin mbi identifikimin vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga institucioni, ruajtjen, arkivimin e informacioneve dokumenteve , procedurat për qarkullim e dokumentacionit, prokurimet duke filluar nga buxheti i fondit, hartuesi i specifikeve, komisionet e vlerësimit, kontraktuesi, zbatuesi i kontratës, procedurat për pagesat etj.

## **10) Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar në Akt Konstatimet, Projekt Raporti i auditimit, si dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar.

## **II. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:**

Ministria e Mbrojtjes ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikës së Shqipërisë. Ajo përbëhet nga administrata e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA.

- Ministria e Mbrojtjes ndihmon Ministrin e Mbrojtjes për përmbushjen e veprimtarive të mëposhtme:

a) përfaqësimin në organet e lartë përmendura dhe në Këshillin e Sigurimit Kombëtar, duke dhënë mendim të specializuar për problemet e mbrojtjes dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura;

b) pasqyrimin në programin e zhvillimit perspektiv të FA, të politikave dhe direktivave të Këshillit të Ministrave në fushën e mbrojtjes, në fushën sociale, në atë të integrimit, zhvillimit e modernizimit të FA në përputhje me standardet e NATO-s;

c) sigurimin e marrëdhënieve të qëndrueshme e me bazë mirëbesimi në fushën ushtarake, ndërmjet shteteve, duke ndërtuar politika e praktika që favorizojnë bashkëpunimin;

ç) përcaktimin e përparësive dhe synimeve të cilat krijojnë hapësira bashkëpunimi në interes të rritjes së sigurisë së përbashkët dhe plotësimin e interesave të vendit;

d) ndërtimin e politikave të përshtatshme arsimimi për të gjithë personelin e FA duke synuar shkallë të lartë motivimi, standardizim të veprimtarisë së brendshme në FA dhe integrim normal në shoqëri;

dh) sigurimin e mbarëvajtjes së zhvillimeve të brendshme në FA, në përputhje me zhvillimet e tjera shoqërore duke siguruar mirëkujdesje sa më të mirë të burimeve njerëzore, financiare e materiale, me qëllim që zhvillimi e modernizimi i FA të jetë kurdoherë dhe në çdo rrethanë në përputhje me zhvillimet politike e ushtarake të NATO-s;

e) hartimin e programeve të bashkëpunimit me të gjithë institucionet e tjera shtetërore në funksion të detyrimeve të tyre ligjore për zbatimin e kërkesave të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare dhe Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë, si për sigurinë e mbrojtjen e vendit;

ë) pjesëmarrje në operacionet/misionet ushtarake dhe humanitare të drejtuara dhe të organizuara nga NATO, OKB, BE;

f) hartimin e programeve të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore qendrore ose vendore dhe me shoqërinë civile në funksion të plotësimin të misionit të Ministrisë së Mbrojtjes.

- Ministri i Mbrojtjes është përgjegjës gjatë veprimtarisë së tij përpara Parlamentit, presidentit të Republikës dhe Këshillit të Ministrave.

### **2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

#### **2.1 Hartimi dhe zbatimin i buxhetit të shtetit.**

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni, si më poshtë:

- 1) Programet Buxhetore Afatmesëm 2022-2024 dhe PBA-në 2023-2025;
- 2) Projektbuxheti për vitin 2021 dhe vitin 2022, si dhe shkresat e ndryshimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor;
- 3) Raportet e monitorimit të 4, 8 dhe 12-mujore të realizimit të buxhetit.

***a. Zbatimi i kriterëve në planifikimin e buxhetit, mbështetur në ligjet vjetore të buxhetit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit.***

Financimi i Ministrisë së Mbrojtjes kryhet si më poshtë:

- Për shpenzimet për paga, sigurime, mallra dhe shërbime (llog. 600, llog. 601, llog. 602, 606 dhe 230-231) me financim të brendshëm nga fondet buxhetore;
- Për shpenzimet për investime (llog. 230 & llog. 231), të cilat financohen nga fondet buxhetore dhe financim i huaj.

Ministria e Mbrojtjes ka për mision ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të veta në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Politikën e Mbrojtjes, Strategjinë Ushtarake, ligjet e tjera të Republikës së Shqipërisë për hartimin dhe zbatimin e politikave shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e vendit. Struktura buxhetore e Ministrisë së Mbrojtjes për hartimin e PBA-së paraqitet në 7 programe, si më poshtë:

1. Programi “Planifikim, menaxhim dhe administrimi”;
2. Programi “Forcat e luftimit”;
3. Programi “Mbështetja e luftimit”;
4. Programi “Arsimi ushtarak”;
5. Programi “Mbështetje për shëndetësinë”;
6. Programi “Mbështetje sociale për ushtarakët”;
7. Programi “Emergjencat civile”.

Nën administrimin e Ministrisë së Mbrojtjes përfshihen:

- 6 ndërmarrjet ushtarake, (Kantieri i Ndërtimit Riparimit të Anijeve-Pashaliman, Vlore, Uzina Mekanike Gramsh, Uzina e Lendeve Plasëse, Mjekes Elbasan, Kombinati Mekanik Poliçan, Shtëpia Qendrore e Ushtarakeve Tirane dhe Ndërmarrja MEICO-Tirane), të cilat funksionojnë në zbatim të Ligjit nr.7582 datë 13.07.1992 “Për ndërmarrjet shtetërore”, kanë autonomi dhe drejtohen me bord drejtues. Me Ministrinë e Mbrojtjes kanë vetëm marrëdhënie kontraktuale dhe nuk përfitojnë fonde buxhetore.

- 26 njësi shpenzuese, financohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes sipas programeve buxhetore sipas *Aneksi nr. 1/1* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Programimi i PBA-së 2022-2024 dhe i buxhetit i shpenzimeve të vitit 2022**

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent i Sistemit të Planifikimit të Integruar. Ky dokument përdoret për të informuar Kuvendin e Shqipërisë dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të qeverisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të qeverisë. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të buxhetit vjetor. Kërkesat buxhetore të institucionit hartohen në bazë të programit buxhetor afatmesëm, në mënyrë që shpërndarjet e fondeve buxhetore të reflektojnë qëllimet e politikës dhe iniciativat e përcaktuara në programin e qeverisë gjatë një periudhe 3-vjeçare, në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MFE nr.7 datë 28.02.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm” dhe udhëzimit plotësues nr. 19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”. Planifikimi i zërave të shpenzimeve për “Fondin e pagave & sigurimeve shoqërore” (llog 600 dhe 601), është bazuar në nivelin aktual të punonjësve dhe strukturës së miratuar për secilin program buxhetor të pagave sipas kategorive të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Llogaritja për shpenzime të tjera korrente (llog 602-606) është bazuar në kërkesat e institucioneve të varësisë së këtij institucioni, limiteve të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, limiteve të shpenzimeve të periudhave paraardhëse dhe realizimi i pritshëm të vitit.

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II<sup>të</sup> të PBA 2022-2024**

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 janë miratuar me VKM nr. 440 datë 22.07.2021 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024”.

Me shkresën nr. 4110 prot., datë 30.08.2021 të Ministrit të MM-së, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2022 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit të MM-së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.19, datë 09.07.2021 “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”.

Tabela nr./1 - Planifikimi i fondeve sipas programeve në PBA 2022-2024 të hartuar nga Ministria e Mbrojtjes, krahasuar me realizimin faktik të buxhetit të vitit paraardhës (viti 2021), paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Në mijë  
lekë

Programi	Emërtimi i programit	Fakti 2021	Plan 2022	Plan 2023	Plan 2024
01110	Planifikim Menaxhimi	1,403,358	1,357,912	1,357,912	1,599,373
02120	Forca e Luftimit	9,972,729	13,109,700	16,123,700	19,403,000
02150	Mbështetja e Luftimit	6,088,879	8,363,953	9,570,030	10,709,370
09430	Arsimi Ushtarak	844,728	644,800	644,800	666,500
07340	Mbështetje për Shëndetësinë	1,465,452	1,090,240	1,090,240	1,320,200
10270	Mbështetje për Ushtaraket	5,367,000	5,408,000	5,408,000	5,590,000
10910	Emergjencat Civile	1,713,293	1,632,000	1,232,000	1,654,550
<b>Totali</b>		<b>26,855,439</b>	<b>31,606,605</b>	<b>35,426,682</b>	<b>40,942,993</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM

Nga të dhënat e paraqitura më sipër rezulton se shuma e planifikuar prej **31,606,605** mijë lekë për vitin 2022 në PBA është më e lartë krahasuar me buxhetin faktik të vitit 2021 në shumën **26,855,439** mijë lekë, ose me një rritje në masën prej **15%**.

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I<sup>rë</sup> të PBA 2023-2025**

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”, Ministria e Mbrojtjes ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025. Bazuar në VKM nr. 130 datë 02.03.2022 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, u miratuan tavanet përgatitore për ministritë dhe institucionet buxhetore.

Për secilin program buxhetor janë ngritur e Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MM nga struktura përkatëse dhe me Urdhrin e Ministrit nr.963 datë 22.07.2014 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, u ngrit GMS në Ministrinë e Mbrojtjes, veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”.

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së II<sup>të</sup> të PBA 2023-2025**

Tavanet përfundimtare të shpenzimeve buxhetore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 janë miratuar me VKM nr. 535 datë 29.07.2022 “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”.

Me shkresën nr. 4354 prot., datë 31.08.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në MM, janë përcjellë në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE, kërkesat buxhetore, pasqyrat plotësuese të projektbuxhetit të vitit 2023 dhe relacioni shoqërues (në përputhje me pikën 8.6, kapitulli 1 i udhëzimit standard për përgatitjen e PBA-së) për institucionet e varësisë dhe aparatit të MM-

së në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, pra brenda afatit dhe sipas formatit të përcaktuar në Udhëzimin plotësues nr.22, datë 08.07.2022 “Për përgatitjen e PBA 2023-2025”.

### **Procedurat e planifikimit në kuadër të hartimit të fazës së I<sup>re</sup> të PBA 2024-2026**

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Udhëzimin e MFE nr.5, datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e PBA 2024-2026”, Ministria e Mbrojtjes ka hartuar dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, i cili është dërguar me shkresën nr. 2490 prot., datë 27.04.2023.

Bazuar në VKM nr. 195 datë 05.04.2023 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026”, u miratuan tavanet përgatitore për ministritë dhe institucionet buxhetore.

Për secilin program buxhetor janë ngritur e Ekipet e Menaxhimit të Programeve në Sistemin e MM nga struktura përkatëse dhe me Urdhrit nr. 963 datë 22.07.2014 “Për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik”, u ngrit GMS në Ministrinë e Mbrojtjes, veprime këto në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”. Secili nga institucionet e varësisë ka dërguar kërkesat buxhetore dhe ,e shkresën nr. 2490 prot., datë 27.04.2023, MM ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit në MFE “Program Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, faza strategjike.

Ministria e Mbrojtjes ka implementuar fazat e PBA-së përmes sistemit AFMIS, Mbledhjet në kuadër të planifikimit të buxhetit janë zhvilluar me Grupin e Menaxhimit Strategjik të ngritur pranë Ministrisë së Mbrojtjes me anë të urdhrit nr. 963, datë 22.07.2014 “Për ngritjen e GMS në Ministrinë e Mbrojtjes”, i cili nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës. Sipas këtij urdhri, përbërja përcaktohet:

- Ministri i Mbrojtjes, Kryetar;
- Zv. Ministri i Mbrojtjes, Nën Kryetar;
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Anëtar;
- Drejtuesit e ekipeve të Menaxhimit të Programeve, Anëtarë;
- Drejtuesit e Njësive Shpenzuese të MM, Anëtarë;
- Drejtuesit e Drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm, Anëtarë;
- Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Financave, Sekretar teknik.

### **Ndryshimet midis PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024**

Nga auditimi i buxhetit të alokuar për vitin 2022 për institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes, grupi i auditimit konstatoi se në PBA 2021-2023 janë planifikuar në total 32,238,639 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 janë planifikuar 27,432,805 mijë lekë, pra me një diferencë prej 4,805,834 mijë lekë. Konkretisht, programet buxhetore që kanë patur rritje dhe ulje për vitin 2022 paraqiten si vijon:

Në mijë

lekë

Nr	Kodi i programit	Programi buxhetor	Diferenca në buxhetin e vitit 2022
1	10910	Emergjencat Civile	2,602,000
2	09430	Arsimi Ushtarak	618,380
3	02120	Forcat e Luftimit	(2,523,465)
4	02150	Mbështetja e Luftimit	(724,028)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes

Sa më sipër, rritje në planifikim rezulton për programin Emergjencat Civile në shumën 2,602,000 mijë lekë dhe programin Arsimi Ushtarak në shumën 618,380 mijë lekë , si dhe ulje në planifikim për programin Forcat e Luftimit në shumën 2,523,465 mijë lekë dhe programin

Mbështetja e Luftimit në shumën 724,028 mijë lekë.

Nga auditimi i projekteve të investimit të planifikuara për vitin 2022 duke krahasuar PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024, u konstatuan diferencat sipas *Aneksi nr. 1/2* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2021-2023 me PBA 2022-2024, u konstatuan se 16 projekte investimi, sipas PBA 2021-2023 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2022-2024 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2021-2023 janë parashikuar me një vlerë totale prej 18,571,645 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 janë parashikuar në vlerën totale prej 28,664,854 mijë lekë, me një diferencë prej 10,093,209 mijë lekë.

Nga auditimi i planifikimit për vitin 2022, u konstatua se 30 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2022 në 30 projekte investimi, në PBA 2021-2023 parashikohen në shumën 6,576,315 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 1,700,000 mijë lekë, me një diferencë prej 4,876,315 mijë lekë, sipas *Aneksi nr. 1/3* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Sa më sipër, nga ana Ministrisë së Mbrojtjes evidentohet një parashikim i dobët sa i takon planifikimit të investimeve.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Ndryshime të vlerave të investimeve kapitale ndërmjet PBA 2021-2023 dhe PBA 2022-2024.
<b>Situata</b>	Nga auditimi i ndryshimeve midis PBA 2021-2023 me PBA 2022-2024, u konstatuan se 16 projekte investimi, sipas PBA 2021-2023 janë parashikuar si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, e më pas në PBA 2022-2024 rriten me një vlerë të konsiderueshme. Konkretisht, në PBA 2021-2023 janë parashikuar me një vlerë totale prej 18,571,645 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 janë parashikuar në vlerën totale prej 28,664,854 mijë lekë, me një diferencë prej 10,093,209 mijë lekë. Nga auditimi i planifikimit për vitin 2022, u konstatua se 30 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2022 në 30 projekte investimi, në PBA 2021-2023 parashikohen në shumën 6,576,315 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 1,700,000 mijë lekë, me një diferencë prej 4,876,315 mijë lekë.
<b>Kriteri:</b>	<i>Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</i>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Pasqyrim jo i saktë i projekteve të investimit të parashikuara në buxhetet vjetore me ato në PBA.
<b>Shkaku:</b>	Ndryshimet e vlerave të projekteve të investimeve kapitale ndër vite.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandim:</b>	Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes të merren masa në vijimësi për krahasimin e kërkesave buxhetore në vitin aktual me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

**b. Zbatimi i kriterëve në çeljen e buxhetit sipas viteve, detajimi i planit fillestar, transferimet dhe rialokimet e fondeve buxhetore gjatë viteve ushtrimore, si dhe planin përfundimtar.**

**Viti 2021**

Në zbatim të Ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr. 5662/1, prot datë 31.12.2020 të Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën nr.23724/131, datë 190.01.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është miratuar detajimi i fondeve buxhetore për shpenzimet korrente.

**Buxheti i vitit 2021 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2021-2023**

*Në mijë lekë*

Nr.	Emërtimi i Programit	Kërkesa PBA 2021-2023	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2021	Buxheti i Rishikuar i vitit 2021	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,310,300	1,310,300	1,458,761	-148,461
2	Forca e Luftimit	8,727,500	8,727,500	9,326,850	-599,350
3	Mbështetja e Luftimit	6,497,375	6,497,375	5,904,052	593,323
4	Arsimi Usharak	871,625	871,625	708,661	162,964
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1,216,000	1,216,000	1,384,834	-168,834
6	Mbështetje për Usharakët	5,200,000	5,200,000	5,308,200	-108,200
7	Emergjencat Civile	1,116,000	1,116,000	476,439	639,561
	<b>Totali</b>	<b>24,938,800</b>	<b>24,938,800</b>	<b>24,567,796</b>	<b>371,003</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM*

**Për vitin 2021**, janë planifikuar në PBA 2021-2023, shuma prej 24,938,800 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2021, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 24,567,796 mijë nga MM, pra 371,003 mijë lekë më pak se plani në PBA.

**Viti 2022**

Në zbatim të Ligjit nr.115, datë 16.11.2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe Udhëzimit të MFE-së, nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe në përgjigje të shkresës nr.6246 prot., datë 28.12.2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, ku është dërguar detajimi i buxhetit për shpenzimet korrente dhe shpenzime kapitale të vitit 2022 për MM dhe të gjitha institucionet e varësisë, miratimi i detajimit sipas strukturave respektive është përcjellë nga Ministri i Financave me shkresën nr. 22922/143, prot., datë 29.12.2021.

**Buxheti i vitit 2022 krahasuar me kërkesat sipas PBA 2022-2024**

*Në mijë lekë*

Nr.	Emërtimi i Programit	Kërkesa PBA 2022-2024	Buxheti Vjetor Plani fillestar Viti 2022	Buxheti i Rishikuar i vitit 2022	Diferenca (Kërkesa-Plani i rishikuar)
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,652,503	1,652,503	1,403,358	249,145
2	Forca e Luftimit	11,343,035	11,343,035	9,972,729	1,370,306
3	Mbështetja e Luftimit	7,941,811	7,941,811	6,088,879	1,852,932
4	Arsimi Usharak	1,238,380	1,238,380	844,728	393,652
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1,135,076	1,135,076	1,465,452	-330,376
6	Mbështetje për Usharakët	5,200,000	5,200,000	5,367,000	-167,000
7	Emergjencat Civile	4,122,000	4,122,000	1,713,293	2,408,707
	<b>Totali</b>	<b>32,632,805</b>	<b>32,632,805</b>	<b>26,855,438</b>	<b>5,777,367</b>

*Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM*

**Për vitin 2022**, janë planifikuar në PBA 2022-2024, shuma prej 26,855,438 mijë lekë dhe, deri në fund të vitit 2022, pas rishikimit të buxhetit, janë alokuar 25,847,592 mijë nga MM, pra 5,759,013 mijë lekë më pak se plani në PBA.



## Analizë nga ana e Grupit të Auditimit në lidhje me Investimet

### **Investimet viti 2021**

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2021, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në tabelën e mëposhtme paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2021 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm.

Në lekë

Nr	Program	Kodi i Projektit	Përshkrimi	Vlera
1	Komanda e Forcës Tokësore	18AY913	Blerje projektesh te KFT /AN	9,592,526
2	Komanda e Forcës Tokësore	18AY914	Kompletim me Armatim dhe pajisje për B2K	903,416,000
3	Komanda e Forcës Tokësore	M170411	TVSH për projektet e KFT/ 01	2,500,000
4	Komanda e Forcës Tokësore	M170411	TVSH për projektet e KFT/ 04	8,500,000
5	Komanda e Forcës Ajrore	18AZ106	Ndërtim i perimetrit te sigurisë Baza Ajrore Kuçovë/ AN	110,040,000
6	Komanda e Forcës Ajrore	M170511	Infrastruktura për venddislokimin e radarit ne Majën e Midës	3,600,000
7	Komanda e Forcës Ajrore	M170510	Blerje dylbi te shikimit natën helmetave te fluturimit dhe jelekëve të mbijetesës për pilotet AS 532 AL dhe ec-135	23,320,000
8	Komanda mbështetëse	M18CI301	Dizenjimi I uniformave	7,700,000
9	Komanda mbështetëse	M170411	TVSH për projektet e KM /SIFQ 18,606,437 LEK	18,606,437
10	Komanda e doktrinës dhe stërvitjes	M170225	Studime projektive	2,650,000
				<b>1,089,924,963</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të Ministrisë së Mbrojtjes

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2021 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2021-2023, nga ku u konstatua se për 10 projekte (të listuara në tabelën më sipër) në shumën **1,089,925 mijë** lekë, janë realizuar gjatë vitit 2021 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2021-2023.

Gjithashtu, nga ana e MM, janë planifikuar në PBA 2021-2023 për investimet me financim të brendshëm, të cilat nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2022. Sipas Aneksit 1/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, u konstatua se për 21 projekte (të listuara në tabelën më sipër) në shumën **575,915 mijë** lekë, ka qenë të planifikuara në PBA 2021-2023, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2021.

### **Investimet viti 2022**

Referuar planit të investimeve të miratuar në projekt buxhet për vitin 2022, grupi i auditimit krahasoi këto projekte me projektet e çelura në vijim të miratimit të ligjit vjetor. Më hollësisht, në *Aneksin 1/5* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, paraqiten ndryshimet mes fondit të çelur me ligjin e buxhetit për vitin 2022 dhe planit sipas projekt buxhetit për projektet me financim të brendshëm.

Nga ana e grupit të auditimit është kryer analiza dhe kryqëzimi i të dhënave përse i përket projekteve të investimeve të realizuara gjatë vitit 2022 në raport me projektet e planifikuara në PBA 2022-2024, nga ku u konstatua se për 13 projekte, të listuara *Aneksin 1/6* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, në shumën **1,175,011 mijë** lekë, janë realizuar gjatë vitit 2022 por nuk ka qenë të planifikuara në PBA 2022-2024.

Gjithashtu, nga ana e MM, janë planifikuar në PBA 2022-2024 për investimet me financim të brendshëm, të cilat nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2022.

Sa më sipër, u konstatua se për 14 projektet e listuara në tabelë në shumën **1,014,387 mijë** lekë, ka qenë të planifikuara në PBA 2022-2024, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Projekte të çelura për Ministrinë e Mbrojtjes pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Programit Buxhetor Afatmesëm.
<b>Situata</b>	Nga auditimi u konstatua se për 10 projekte në shumën 1,089,925

	<p>mijë lekë të cilat janë realizuar gjatë vitit 2021, rezultoi se nuk kanë qenë të planifikuara në PBA 2021-2023 , si dhe 13 projekte investimi në shumën 1,175,011 mijë lekë, të cilat janë realizuar gjatë vitit 2022, rezultoi se nuk kanë qenë të planifikuara në PBA 2022-2024. Sa më sipër, këto projekte janë çelur, pa kaluar në procedurat e ciklit të miratimit në kuadër të mirëmenaxhimit të investimeve publike sikundër përcakton VKM nr.185, datë 29.03.2018, “Për menaxhimin e investimeve publike” aneksi 1, pasi, këto projekte, <b>nuk kanë kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm</b>, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimin nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, pika 21 ku përcaktohet se projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore.</p> <p>Gjithashtu, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se: Për vitin 2021, janë planifikuar në PBA 2021-2023, 21 projekte investimi në shumën 575,915 mijë lekë, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2021. Për vitin 2022, , janë planifikuar në PBA 2022-2024, 14 projekte investimi në shumën 1,014,387 mijë lekë, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2022.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Veprime në kundërshtim me: -<b>Ligjin nr.9936</b>, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni nr.40 ku citohet “e drejta për të kryer shpenzime”; -<b>Udhëzimin nr.9</b>, datë 20.03.2018, i MFE-së “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika nr.64; -<b>Ligjin nr. 137</b>, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, VKM 185, datë 29.03.2018 “Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike”. -<b>VKM nr.185</b>, datë 29.03.2018 “Për menaxhimin e investimeve publike”, Aneksi 1- “Procedurat e Menaxhimit të Investimeve Publike” ku citohet se: <i>Diagrama e mëposhtme përshkruan fazat e Ciklit të Menaxhimit të Investimeve Publike. Identifikimi i projektit është procesi i identifikimit e shqyrtimit të ideve për projekte investimi të bazuara në analizën e nevojave publike, ndërhyrjeve të qeverisë dhe përshtatjes me strategjitë kombëtare dhe sektoriale.</i> <i>Hapi 5–Paraqitja e projekt-propozimit të investimit nga Institucionet Buxhetor Ministrisë përgjegjëse për Financat : Projekt-propozimet e investimeve përcillen në Ministrinë përgjegjëse për financat: - nëpërmjet paraqitjes normale të kërkesave për shpenzime sipas afateve të PBA-së/Buxhetit Vjetor; Hapi 7 Miratimi përfundimtar: Pas miratimit në KM të projekteve të investimeve në kuadër të PBA/buxhetit vjetor, lista e projekteve të investimeve paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë vetëm si tabelë shoqëruese e paketës së PBA/Buxhetit vjetor, por që nuk miratohet nga Kuvendi.</i></p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Mos respektim i disiplinës buxhetore për t’u dhënë prioritet projekteve të planifikuara në PBA.</p>

<b>Shkaku:</b>	Detajimi i projekteve të reja të investimit publik gjatë vitit buxhetor pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike në hartimin e PBA-së.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandim:</b>	Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikrat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

### Rishikimet e buxhetit

Nga auditimi i rishikimeve të buxhetit konstatohet se për vitin 2021 dhe vitin 2022, plani i buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes në shpenzimet korrente dhe kapitale ka pësuar ndryshime (shtesa/pakësime). Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se për periudhën objekt auditimi nga Ministria e Mbrojtjes janë kryer një numër i konsiderueshëm rishikimesh, duke kërkuar lëvizje fondesh në projektet ekzistuese, si dhe duke shtuar projekte të reja gjatë vitit, të cilat nuk janë çelur pa kaluar në procesin ligjor të miratimit të Planit Buxhetor Afatmesëm. Këto ndryshime kanë ardhur jo vetëm si rezultat i akteve normative të miratuara gjatë vitit, por edhe si pasojë e vendimmarrjes për kryerjen e rishpërndarjes së fondeve me impakt në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, e cila konsiderohet me impakt negativ në treguesit e monitorimit të buxhetit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 75 ku citohet... “Numri i rishpërndarjeve të fondeve buxhetore për çdo njësi të qeverisjes qendrore mund të përbëjë një nga treguesit për vlerësimin e performancës gjatë zbatimit të buxhetit.”

### Realizimi i planit të buxhetit

#### Viti 2021

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2021 rezulton si vijon:

Në lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	6,294,400	5,937,700	5,841,636	98%
601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	1,063,500	1,018,200	975,871	96%
602. Mallra dhe shërbime	6,437,900	6,443,489	5,607,083	87%
603.Subvencion	0	0	0	0%
604. Transferta të brendshme	5,315,000	5,423,200	5,387,263	99%
605. Transferta të jashtme	190,000	446,325	446,218	100%
606. Transferta për familjet dhe individët	327,500	538,383	492,262	91%
231.Investim me financim të brendshëm	5,010,500	4,760,500	4,321,778	91%
231.Investim me financim të huaj	0	0	0	0%
<b>TOTALI</b>	<b>24,938,800</b>	<b>24,567,797</b>	<b>23,072,111</b>	<b>94%</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM

Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në masën 94% ndaj buxhetit me ndryshime. Plani fillestar paraqitet në shumën 24,639 milionë lekë, ndërsa buxheti me ndryshime paraqitet në shumën 24,567 milionë lekë, i cili është realizuar në shumën prej 23,072 milionë lekë dhe detajuar sipas programeve buxhetore si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programit	Buxheti Vjetor Viti 2021	Buxheti i rishikuar	Realizimi 2021	Realizimi në %
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,310,300	1,458,761	1,431,535	98
2	Forca e Luftimit	8,727,500	9,326,850	8,329,971	89
3	Mbështetja e Luftimit	6,497,375	5,904,052	5,698,733	97
4	Arsimi Ushtarak	871,625	708,661	669,554	94
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1,216,000	1,384,834	1,305,350	94
6	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,308,200	5,308,200	100

7	Emergjencat Civile	1,116,000	476,439	328,769	69
	<b>Totali</b>	<b>24,938,800</b>	<b>24,567,796</b>	<b>23,072,112</b>	<b>94</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM

Sa më sipër, rezulton se në Ministrinë e Mbrojtjes janë realizuar shpenzimet buxhetore në nivelin 94% dhe referuar programeve buxhetore paraqitet si vijon:

Referuar programeve buxhetore rezulton se fondet e akorduara për programin buxhetor **“Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”** përbëjnë 5 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në, për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 3 produkteve në zërat *“Shpenzime Korrente”* të realizuar në shumën 1,431,535 mijë lekë dhe 2 Projekte Investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* të cilët rezultojnë te porealizuara.

Fondet e akorduara për programin **“Forca e Luftimit”** përbëjnë rreth 38% të buxhetit për vitin 2021, të cilat janë përdorur për financimin e 6 produkteve me vlerë 4,672,604 mijë lekë, në zërat *“Shpenzime Korrente”* dhe 19 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 3,657,367 mijë lekë. Në Projektbuxhetin e vitit 2021 janë planifikuar 19 projekte investimi, nga të cilat janë realizuar 12 projekte investimi.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetja e Luftimit”** përbëjnë rreth 25 % të buxhetit, të cilat janë përdorur për 12 produkte në zërat *“Shpenzime Korrente”* dhe 13 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 5,698,733 mijë lekë ose 83% të gjithë buxhetit të planifikuar të vitit 2021.

Fondet e akorduara për programin **“Arsimi Ushtarak”** përbëjnë rreth 4% të buxhetit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithë përfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Realizimi i fondeve buxhetore paraqitet në shumën 646,756 mijë lekë ose 95%, ku sa i takon shpenzimeve kapitale fondet janë akorduar për 5 projekte investimi me vlerë 22,798 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 4 projekte investimi.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetje Sociale për Ushtarakët”** përbëjnë rreth 21.6 % të buxhetit me ndryshime të vitit 2021 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe shpenzohen për trajtimin e veçantë të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim. Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikullit 604, për vitin 2021 paraqitet në shumën 5,308,200 mijë lekë, pra 100%.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetje për shëndetësinë”** përbëjnë 5.6 % të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat janë shpenzuar për realizimin e objektivave për ofrimin e një Shërbimi sa më të Specializuar Mjekësor dhe Spitalor në nivel Universitar, në trajtim në rang Kombëtar të Poli traumave që përben angazhimin e këtij programi. Këto fonde janë përdorur në zërat *“Shpenzime Korrente”* në vlerën 1,144,531 mijë lekë dhe për 4 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 160,819 mijë lekë të cilat janë realizuar 94%.

Fondet e akorduara për programin **“Emergjencat Civile”** përbëjnë rreth 2 % të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes të cilat janë shpenzuar për realizimin e objektivave për zvogëlimin e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis, si dhe rritjen e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore. Ky program paraqitet me përqindjen më të ulët të realizimit krahasuar me programet e tjera buxhetore. Këto fonde janë përdorur në zërat *“Shpenzime Korrente”* në vlerën 272,491 mijë lekë ose 80.9% dhe për 12 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 56,278 mijë lekë, të cilat janë realizuar në masën 40.3%.

### Viti 2022

Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikujve për 12-mujorin e vitit 2022 rezulton si vijon:

Në mijë lekë

Llogaria ekonomike	Plani fillestar	Plani me ndryshime	Realizimi faktik 12 mujor	% e realizimit
600.Paga	6,757,319	6,208,502	6,206,936	100

601. Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	1,019,751	1,059,533	1,059,501	<b>100</b>
602. Mallra dhe shërbime	7,653,900	6,546,955	6,111,547	<b>93</b>
603.Subvencion	-	-	-	-
604. Transferta të brendshme	6,331,000	6,003,222	5,806,309	<b>97</b>
605. Transferta të jashtme	190,000	399,000	369,070	<b>92</b>
606. Transferta për familjet dhe individët	441,335	603,726	565,161	<b>94</b>
231.Investim me financim të brendshëm	8,339,500	6,034,500	5,729,069	<b>95</b>
231.Investim me financim të huaj	1,900,000	-	-	<b>0</b>
<b>TOTALI</b>	<b>32,632,805</b>	<b>26,855,438</b>	<b>25,847,593</b>	<b>96.2</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 në Ministrinë e Mbrojtjes është realizuar në masën 96.2% ndaj buxhetit me ndryshime. Buxheti vjetor Plani fillestar paraqitet në shumën 32,633 milionë lekë, ndërsa buxheti me ndryshime paraqitet në shumën 26,855 milionë lekë, i cili është realizuar në shumën prej 25,848 milionë lekë dhe detajuar sipas programeve buxhetore si vijon:

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi i Programit	Buxheti Vjetor 2022	Buxheti i rishikuar	Realizimi 2022	Realizimi në %
1	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,652,503	1,403,358	1,396,015	99
2	Forca e Luftimit	11,343,035	9,972,729	9,652,717	97
3	Mbështetja e Luftimit	7,941,811	6,088,879	5,870,292	96
4	Arsimi Ushtarak	1,238,380	844,728	826,772	98
5	Mbështetje për Shëndetësinë	1,135,076	1,465,452	1,441,535	98
6	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,367,000	5,367,000	100
7	Emergencat Civile	4,122,000	1,713,293	1,293,261	75
	<b>Totali</b>	<b>32,632,805</b>	<b>26,855,438</b>	<b>25,847,592</b>	<b>96.2</b>

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të MM

Sa më sipër, rezulton se në Ministrinë e Mbrojtjes janë realizuar shpenzimet buxhetore në nivelin 96,2% dhe referuar programeve buxhetore paraqitet si vijon:

Referuar programeve buxhetore rezulton se fondet e akorduara për programin buxhetor **“Planifikim, Menaxhim dhe Administrimi”** përbëjnë 5 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në, për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin e 3 produkteve në zërat *“Shpenzime Korrente”* të realizuar në shumën 1,384,670 mijë lekë dhe 5 Projekte Investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* të realizuar në shumën prej 11,345 mijë lekë.

Fondet e akorduara për programin **“Forca e Luftimit”** përbëjnë rreth 35 % të buxhetit për vitin 2022, të cilat janë përdorur për financimin 4 produkteve me vlerë 5,218,822 mijë lekë, në zërat *“Shpenzime Korrente”* dhe 11 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 4,433,901 mijë lekë. Në Projektbuxhetin e vitit 2022 janë planifikuar 23 projekte investimi, nga të cilat janë realizuar 11 projekte investimi, ku 4 projekte kanë përfunduar plotësisht.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetja e Luftimit”** përbëjnë rreth 24.3 % të buxhetit, të cilat janë përdorur për 12 produkte në zërat *“Shpenzime Korrente”* me vlerë 5,407,219 mijë lekë dhe 19 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 463,001 mijë lekë ose 97% të gjithë buxhetit të planifikuar të vitit 2022.

Fondet e akorduara për programin **“Arsimi Ushtarak”** përbëjnë rreth 4% të buxhetit, me qëllim rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithë përfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Realizimi i fondeve buxhetore paraqitet në shumën 826,772 mijë lekë ose 98%, ku sa i takon shpenzimeve korrente paraqiten në shumën 760,787 leke dhe shpenzimeve kapitale fondet janë akorduar për 7 projekte investimi me vlerë 65,985 mijë lekë, nga të cilat janë realizuar 4 projekte investimi.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetje Sociale për Ushtarakët”** përbëjnë rreth 20.8 % të buxhetit me ndryshime të vitit 2022 për Ministrinë e Mbrojtjes dhe shpenzohen për trajtimin e veçantë të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim. Realizimi i fondeve buxhetore sipas artikullit 604, për vitin 2022 paraqitet në shumën 5,367,000 mijë lekë, pra 100%.

Fondet e akorduara për programin **“Mbështetje për shëndetësinë”** përbëjnë 5.5 % të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat janë shpenzuar për realizimin e objektivave për ofrimin e një Shërbimi sa më të Specializuar Mjekësor dhe Spitalor në nivel Universitar, në trajtim në rang Kombëtar të Poli traumave që përbën angazhimin e këtij programi. Këto fonde janë përdorur në zërat *“Shpenzime Korrente”* në vlerën 1,192,573 mijë lekë dhe për 4 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 248,962 mijë lekë të cilat janë realizuar 100%.

Fondet e akorduara për programin **“Emergjencia Civile”** përbëjnë rreth 5.5 % të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes të cilat janë shpenzuar për realizimin e objektivave për zvogëlimin e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis, si dhe rritjen e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore. Ky program paraqitet me përqindjen më të ulët të realizimit krahasuar me programet e tjera buxhetore. Këto fonde janë përdorur në zërat *“Shpenzime Korrente”* në vlerën 787,387 mijë lekë dhe për 10 projekte investimi në zërin *“Shpenzime Kapitale”* me vlerë 505,874 mijë lekë, të cilat janë realizuar në masën 75.5%.

### **Raportet e monitorimit**

Nga auditimi u konstatua se nga ana institucioneve të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Mbrojtjes, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar relacionet shpjeguese të raporteve të monitorimit 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për të gjithë programet e MM pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. Nga Ministria e Mbrojtjes nuk është hartuar një udhëzues, për përcaktimin e procedurave apo rregullave specifike që duhet të ndjekin njësitë e varësisë së qeverisjes qendrore për procesin e monitorimit të buxhetit si dhe përcaktimi i afateve për paraqitjen e dërgimin e tyre pranë institucioneve eprore, në zbatim të Udhëzimit të MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016, pika 49.

Me anë të shkresës nr.1314, datë 28.02.2023, Ministria e Mbrojtjes ka dërguar Raportin e konsoliduar të monitorimit në MFE.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mungesa e raporteve të monitorimit për buxhetin e administruar nga aparati i Ministrisë së Mbrojtjes si njësi shpenzuese.
<b>Situata</b>	Nga auditimi u konstatua se nga ana institucioneve të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Mbrojtjes, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për të gjithë programet e MM pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në

	NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar të nenit 65. Nga Ministria e Mbrojtjes nuk është hartuar një udhëzues, për përcaktimin e procedurave apo rregullave specifike që duhet të ndjekin njësitë e varësisë së qeverisjes qendrore për procesin e monitorimit të buxhetit si dhe përcaktimi i afateve për paraqitjen e dërgimin e tyre pranë institucioneve eprore, në zbatim të Udhëzimit të MFE-se nr. 22, datë 17.11.2016, pika 49.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 19; Udhëzimi nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ”; Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si rezultat i mungesës së raporteve të monitorimit të buxhetit për aparatit e MM-së dhe institucionet e varësisë: ✓ nuk bëhet e mundur ndjekja e arritjes së qëllimit dhe objektivave të synuar, sipas deklaratës së politikës së programit, për shkak të mos krahasimit të treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. ✓ nuk bëhet e mundur evidentimi nëse realizimi i produkteve të aparatit është në përputhje me planin, në mënyrë që të kryhen propozime/rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese nëpërmjet alokimit të burimeve. ✓ nuk kryhet analiza krahasimore e realizimit të fondeve me periudhat e mëparshme. ✓ nuk sigurohet informacion për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit.
<b>Shkaku:</b>	Mungesa e raporteve të monitorimit të buxhetit për programet e menaxhuara nga aparati i MM dhe njësitë e varësisë si njësi shpenzuese, por përfshirja e tyre në raportin përmbledhës për të gjitha programet e MM-së.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandim:</b>	Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marrë masat, për hartimin e raporteve të monitorimit të buxhetit 4-8-12 mujore për aparatit e MM dhe njësitë e varësisë si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit dhe monitorimit të buxhetit.

## 2.2 Zbatimi i dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Në zbatim të pikës II/2 “*Auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës, i cili përfshin:*

- Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin,
- Baza ligjore e nënligjore që specifikon trajtimin e punonjësve të Ministrisë së Mbrojtjes, të ndara në kategori të veçanta, si civilë, ushtarakë, atashe e përfaqësues ushtarakë;
- Listëpagesat dhe libri i pagave;
- Dosjet e personelit;
- Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Baza e të dhënave/data baza mbi personelin.
- Baza e të dhënave/Data baza e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar.
- Urdhër shpenzimet e realizuara nga MM për likuidimin e këtyre detyrimeve.

Auditimi iu referua akteve ligjore e nënligjore në vijim:

- Ligji nr.152/2013“Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar;
- VKM nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”;
- VKM nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar,
- Urdhri i Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”,
- Rregullore e brendshme, miratuar nga ministri me Urdhrin nr. 2159, datë 16.11.2017 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.
- VKM nr. 125, datë 17.2.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

**Ministria e Mbrojtjes** ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit në përputhje me Kushtetutën, Strategjinë e Sigurisë, Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Strategjinë Ushtarake dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo përbehet nga administrata e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i FA.

### **1. Respektimi i strukturave organike të miratuara dhe krahasimi me faktin.**

Në drejtim të objektivave të institucionit, struktura organizative e Ministrisë së Mbrojtjes ka funksionuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar. Ministria e Mbrojtjes e ka ndryshuar strukturën organike të saj, me urdhrin e Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit 63 të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar” dhe numri total i punonjësve në aparatit MM është **142**.

Gjithashtu, është bërë edhe ndryshimi i kategorisë së pagave të pozicioneve “Përgjegjës Sektor” dhe “Specialist” për dy sektorë të Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhim Financiar, “Sektori i Financës” dhe “Sektori i Pagave”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mosrespektim i Ligjit të Nëpunësit Civil.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes, u konstatua se përgjegjësi i sektorit të financës është i punësuar si anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 për nëpunësin civil, neni 37, pika 3 ku citon se: “Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra”.
<b>Kriteri:</b>	Ligjin Nr. 152/2013 për nëpunësin civil, neni 37, pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Realizim i detyrës në kushtet e konfliktit të interesit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i ligjit te nëpunësin civil.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrë masa për informimin e nëpunësit, i cili ndodhet në kushtet e



konfliktit të interesit, si dhe të ndërmarre hapat e menjëhershme për ndërprerjen e veprimtarisë si anëtare e Këshillit Bashkiak.
---

Titullari i Institucionit me Urdhrin nr. 2159, datë 16.11.2017, ka miratuar Rregulloren e Brendshme "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura".

Nga auditimi rezultoi se rregullorja përmban qëllimin, misionin dhe veprimtarinë e saj, si dhe ka të detajuar organizimin dhe funksionimin e strukturave të MM dhe FA.

Strukturat përbërëse të Ministrisë së Mbrojtjes janë: Ministri, Zëvendësministrat, Kabineti i Ministrit, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme, Drejtoria, Sektori dhe Zyra. Ministri është person civil dhe organi më i lartë i drejtimit politik të Ministrisë së Mbrojtjes. Ministri ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara nga Kushtetuta, nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe nga ligjet e tjera të veçanta.

**Zëvendësministri** është person civil dhe bashkëpunëtori më i afërt i Ministrit në ushtrimin e funksionit të drejtimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të përmbushjes së misionit kushtetues, ligjor dhe politik të kësaj ministrie.

**Sekretari i Përgjithshëm** është nëpunësi më i lartë civil dhe drejtuesi më i lartë administrativ në Ministri, i cili kryen detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në këtë Rregullore, VKM nr. 325, datë 21.05.2003 "Për pozicionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministri" VKM nr. 142, datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", si dhe detyra të tjera të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi apo Ministri i Mbrojtjes. Ai është gjithashtu Nëpunësi i Parë Autorizues i Ministrisë së Mbrojtjes.

**Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura** përbën strukturën organizative më të lartë ushtarake në Forcat e Armatosura. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura organizohet dhe funksionon si shtab i bashkuar me përfaqësues të forcave tokësore, detare dhe ajrore. Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura në kohe lufte, vepron si shtab për Presidentin e Republikës dhe Komandantin e Forcave të Armatosura.

Strukturat përbërëse të Shtabit të Përgjithshëm të FA janë: Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Kabineti i SHSHP, Drejtoria dhe Sektori.

**Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA**, është person ushtarak dhe drejtuesi më i lartë ushtarak i Forcave të Armatosura, i cili ushtron detyrat dhe funksionet të përcaktuara nga Kushtetuta dhe nga ligjet e tjera të veçanta.

**Zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm** është person ushtarak dhe ndihmës i drejtpërdrejtë i SHSHPFA, i cili kryen detyra të ngarkuara nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, sipas ndarjes së detyrave specifike përkatësisht, për planifikimin e kryerjen e operacioneve dhe planifikimin e sigurimit e mbështetjes. Funksionet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FA janë politike, ushtarake dhe civile.

#### **Funksionet politike:**

- Ministri i Mbrojtjes
- Zëvendësministri i Mbrojtjes
- Kabineti i Ministrit

**-Funksionet ushtarake:** Funksionet të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me organizimin dhe drejtimin dhe komandimin operacionale të Forcave të Armatosura, si dhe funksione të tjera që janë në përbërje të strukturës analitike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm. Funksionet civile: Funksionet të cilat rregullohen me anë të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin

civil", i ndryshuar dhe ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

## **2. Respektimi i dispozitave ligjore për pagat e punonjësve. Realizimi i fondit të pagave.**

Pagat e punonjësve në Aparatin e Ministrisë janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar VKM nr. 187, datë 03.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", i ndryshuar me VKM-në nr.696, datë 22.11.2017; VKM-në me nr.1, date 4.1.2018; dhe me VKM-në me nr.116, datë 23.2.2018, Vendim Nr. 610, datë 24.7.2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore", i ndryshuar.

Nga auditimi me përzgjedhje i listë pagesave, për punonjësit e Aparatit të Ministrisë, rezultoi se pagesat janë kryer në përputhje me bazën ligjore në fuqi.

Pagat e ushtarakëve të MM janë përcaktuar sipas funksionit dhe kategorisë referuar VKM nr. 839 datë 11.12.2003 "Për pagat e ushtarakëve aktiv të FA të Republikës së Shqipërisë, VKM nr. 549 datë 11.08.2011 dhe nr. 502, datë 01.08.2012 "Për disa ndryshime në VKM nr. 839 datë 11.12.2003 "Për pagat e ushtarakëve aktiv të FA të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, me VKM nr. 224 datë 21.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", në të cilën janë përcaktuar rolet si grada, paga bazë për gradë, vitet e shërbimit shtesa për natyrë të veçantë, i ndryshuar me Vendimin 426 datë 22.06.2022. Udhëzimin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 8, datë 18.12.2018 "Për zbatimin e VKM nr. 305, datë 12.03.2008", i ndryshuar me udhëzimin nr. 7 datë 22.12.2022 "Për zbatimin e VKM nr. 600, datë 14.09.2022.

Nga auditimi me përzgjedhje u konstatua se pagesat e ushtarakëve të MM janë kryer sipas gradave e viteve të shërbimit, në përputhje me bazën ligjore në fuqi. Pagat e Atasheve dhe Përfaqësuesit Ushtarakë janë përcaktuar referuar VKM nr. 546 datë 11.08.2011 "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi paga të punonjësve të përfaqësuesit diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarakë të FA të RSH-së dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes që shërbejnë në Përfaqësitë Ushtarake të RSH në NATO, në organizatat ndërkombëtare dhe në Shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI".

-Sipas VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për miratimin e strukturës së pagave niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike.

-Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Administratën e Kuvendit, administratën e Komisionit Qendror të zgjedhjeve.

-Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, Qendra Kombëtare Biznesit, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Drejtoria Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, Drejtoria e Përgjithshme Akreditimit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Shtabi Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Shifrës Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra Kombëtare e Kërkim- Shpëtimit, Qendra e Ekselencës së NATO-s. Qendra e Kulturës Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeu i Forcave të Armatosura, Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake.

-Në Drejtorinë e Shifrës, nëpunësit në pozicionet "përgjegjës sektori" dhe "specialist", në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, 7 500 (shtatë mijë e pesëqind) lekë në muaj,

për nëpunësit e strukturave TIK, të institucioneve të përcaktuara në shkronjat "a" deri në "d", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi; 5 000 (pesë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit e strukturave të TIK, të institucioneve të përcaktuara në shkronjën "dh", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi.

Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhim ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat. Përfundimisht, nëpunësit në pozicione IT të institucioneve të përcaktuara në shkronja "b", "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, që deri në datën e hyrjes në fuq të këtij vendimi kanë përfituar shtesën në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj sipas përcaktimit të pikës 4/1, të vendimit nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, ti ndryshuar, do të vijojnë të përfitojnë shtesën në të njëjtën masë deri në kalimin e këtyre pozicioneve pranë Agjencisë Kombëtare të Shqipërisë së Informacionit.

Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, institucionet e sistemit të drejtësisë dhe drejtorisë përgjegjëse për fushën TIK në aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes, në masën përkatësisht: - 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Specialist";

- 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Përgjegjës sektori";  
70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për nëpunësit në pozicionet "Drejtor drejtorie" apo "Drejtor i Përgjithshëm".

Në rast se për institucionet ku janë të punësuar nëpunësit në pozicionet e sipërpërmendura parashikohen shtesa të tjera, nëpunësit e strukturave TIK do të zgjedhin ndërmjet shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të gjitha shtesat.

-Klasa dhe shtesat për kushte pune (natyrë të veçante punë) të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "specialist" deri në "titullar institucioni" (punonjës civilë) në shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Akademinë e Forcave të Armatosura, si dhe Qendrën Kombëtare të Kërkim Shpëtimit.

- Përgjegjës/Shef sektori për sigurinë Kibernetikë klasa e pagës III-2, shtesa 40.000 lekë
- Specialistë në sektorin special të sigurisë Kibernetikë, në Njësinë Kibernetikë, klasa e pagës IV-2, shtesa 100.000 lekë.

Specialistë për sigurinë Specialistë në klasa e pagës IV-2, shtesa 40.000 lekë.

### **3. Respektimi i dispozitave ligjore për rekrutimin dhe largimin e punonjësve nga puna. Plotësimi i vendeve të lira me kontrata të përkohshme pune.**

Sistemi i rekrutimit, përdorimit dhe mbështetjes së punonjësve civilë është i decentralizuar. Ligji 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i ka decentralizuar kompetencat e punësimit, përdorimit dhe mbështetjes së punonjësve civilë në FA. Referuar këtij ligji, si dhe Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1090, datë 02.06.2016 "Për miratimin e politikës dhe procedurës së menaxhimit të personelit civil në forcat e armatosura, që nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, autoritetet vendimmarrëse për personelin civil në FA janë:

- a) Ministri i Mbrojtjes
- b) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm
- c) Komandantët e Forcave dhe Strukturave Mbështetëse
- d) Autoritete të tjera të njohura me ligje specifike (AISM).

**1. Ministri i Mbrojtjes** emëron, liron ose shkarkon nga detyra:

- përfaqësuesit ushtarakë të Republikës së Shqipërisë në shtabet dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë, si dhe atashetë ushtarakë pranë përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë;

- personelin civil në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil apo që janë në funksione ushtari ose nënoficeri;

- personelin civil në strukturat civile të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, përveç atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së emëron, liron ose shkarkon nga detyra ushtarët dhe nënoficerët aktivë, si dhe personelin civil të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura e të strukturave të varësisë së tij, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficeri.

3. Komandanti i Forcës ose strukturës mbështetëse emëron, liron ose shkarkon nga detyra ushtarët dhe nënoficerët aktivë, si dhe personelin civil të forcës apo strukturës mbështetëse që drejton, me përjashtim të atyre që gëzojnë statusin e nëpunësit civil ose që janë në funksione oficeri.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes emëron, liron ose shkarkon nga detyra, komandon punonjësin ushtarak nënoficer dhe ushtar dhe punonjësin civil, ekuivalent me punonjësin ushtarak, nënoficer dhe ushtar, sipas tabelës së organizimit dhe pajisjeve të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

#### **-Planifikimi i rekrutimeve dhe procedurat e ndjekura për rekrutimin e punonjësve në shërbimin civil.**

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 108, datë 26.2.2014 “Për planin vjetor të pranimin në shërbimin civil”, përgatitet plani vjetor i pranimin në shërbimin civil për pozicionet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, si dhe për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

-Me shkresën nr.5679/1 prot, datë 25.11.2021 është dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil të sistemit të MM-së për vitin 2022:

*Gjithsej parashikohen 79 pozicione, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:*

- a) për kategorinë ekzekutive, 43 pozicione;
- b) për kategorinë e ulët drejtuese, 30 pozicione;
- c) për kategorinë e mesme drejtues, 6 pozicione.

-Me shkresën nr.6826/1 prot, datë 28.12.2022 është dërguar pranë Departamentit të Administratës Publike (DAP), planifikimin e nevojave për pranim në shërbimin civil të sistemit të MM-së për vitin 2023:

*Gjithsej parashikohen 67 pozicione, të ndara sipas kategorive të mëposhtme:*

- d) për kategorinë ekzekutive, 46 pozicione;
- e) për kategorinë e ulët drejtuese, 17 pozicione;
- f) për kategorinë e mesme drejtues, 3 pozicione;
- g) për Trupë e Nivelit të Lartë Drejtues (TND), 1 pozicion.

Spektori i Burimeve Njerëzore në zbatim të detyrimit ligjor të parashikuar në VKM Nr. 242, datë 18.03.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” i ndryshuar, pika 3, 5 dhe 8, Kreu II, bën shpalljet për plotësimin e vendeve të lira/vakante për punonjës në shërbimin civil në sistemin e HRMIS (Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore) dhe më pas në sistemin on line të rekrutimit, në platformën administrata.al, veprime r të cilën janë realizuar nga Burimet Njerëzore.

#### **4.Zbatimi i vendimeve gjyqësore mbi punonjësit e larguar nga puna dhe ekzekutimi i tyre.**

Komisioni i Posaçëm i Ekzekutimit të Vendimeve Gjyqësore Urdhri i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr. 5151, datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil” ka si qëllim përcaktimin e rregullave mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, për rikthimin e nëpunësve civilë gjyqfitues në një pozicion të rregullt të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore. Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është i mbikëqyrur nga Departamenti i Administratës Publike.

Referuar këtij urdhri, pranë çdo institucioni të administratës shtetërore krijohet Komisioni i Posaçëm, organ kolegjal, me përbërje si vijon:

- Sekretari i Përgjithshëm, kryetar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet juridike, anëtar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet financiare – buxhetore, anëtar;
- Përfaqësues që mbulon çështjet e burimeve njerëzore, anëtar.

Komisioni i Posaçëm thirret nga kryetari, brenda 2 ditëve punë nga depozitimi i kërkesës/ lajmërimit me shkrim të kreditorit, të përfaqësuesit ligjor të tij, ose të përmbaruesit gjyqësor, për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke vënë në dijeni DAP-in. Komisioni ngarkohet me këto detyra:

- a) Shqyrtimin e fakteve dhe rrethanave të reja të lindura pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë, në favor të kreditorit gjyq fitues;
- b) Shqyrtimin e rasteve kur urdhërimet e gjykatës përcaktojnë zbatimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nëpërmjet zgjidhjeve alternative për njësitë debitorë, sipas diapozitivit të vendimit gjyqësor të formës së prerë;
- c) Shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të gjyq fituesit në një pozicion të rregullt në shërbimin civil, sipas kriterëve të pozicionit të punës dhe kategorisë përkatëse, brenda institucionit nga ku është larguar, apo në një institucion të varësisë së tij.

**-Sa i përket aktivitetit të këtij Komisioni**, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, gjyq fituesit e sistemuar, rezultojnë si më poshtë:

1. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **R. B.** me nr. 3769/2 prot., datë 02.09.2020, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.4471, datë 14.12.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
2. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **G. K.** me nr. 3766/2 prot., datë 02.09.2020, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.2995, datë 30.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
3. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **E. L.** me nr. 3771/2 prot., datë 02.09.2020, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.2171, datë 15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
4. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **A. B.** me nr. 3768/2 prot., datë 02.09.2020, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.3848, datë 20.10.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
5. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **A. H.** me nr. 3770/2 prot., datë 02.09.2020, rezulton se Komisioni ka propozuar

sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.344 datë 07.02.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.

6. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **E. G.** me nr. 1873/4 prot., datë 22.04.2022, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.327, datë 11.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.

7. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **H. N.** me nr. 3366/1 prot., datë 01.07.2022, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.2278, datë 29.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.

8. Nga procesverbali i mbledhjes së Komisionit të Posaçëm, mbi shqyrtimin e dosjes së gjyq fituesit **Sh. S.** me nr. 2495/1 prot., datë 12.05.2022, rezulton se Komisioni ka propozuar sistemimin në një pozicion, në të cilin gjyq fituesi përmbush kriteret. Me vendimin nr.2515, datë 14.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.

- Nënpunësit civil gjyqfitues për rikthimin në një pozicion të rregullt të shërbimit civil, të cilët aktualisht janë në listën e pritjes:

1. B. K., me Vendimin nr.430, datë 04.03.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
2. A. S. me Vendimin nr.678, datë 25.03.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
3. Sh. B. me Vendimin nr.2165, datë 14.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
4. I. K. me Vendimin nr.501, datë, 10.03.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
5. M. O. me Vendimin nr.2017, datë 27.06.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
6. R. B. me Vendimin nr.130, datë 25.01.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë.
7. A. S. me Vendimin nr.2171, datë 15.10.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë *(në proces në Gjykatën e Lartë)*.
8. S. M. me Vendimin nr.744, datë 22.02.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë *(në proces në Gjykatën e Lartë)*.

Komisionit të Posaçëm për këta gjyqëfitues nuk është mbledhur për të bërë sistemimin e tyre bazuar në vendimin e Gjykatës, të cilët paguhen nga MM si punonjës, ku nga auditimi rezultoi se janë paguar për këta gjyqëfitues si më poshtë:

- **Në vitin 2021** për 6 mujorin e dytë janë likuiduar 7, gjyqfitues në Shumën totale 4,568,760 lekë.

- **Në vitin 2022** janë likuiduar 7 gjyqfitues në shumën totale 9,137,520 lekë.

- **Në vitin 2023** për 6 mujorin e parë janë likuiduar 7 gjyqfitues në Shumën totale 5,573,169 lekë.

-A. Gj. me Vendimin nr.2667, datë 20.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë, ku është vendosur ti paguajë palës paditëse pagën për muajt nëntor-dhjetor 2013 dhe pagën për muajin janar 2015- deri datë 25.06.2016.

Shuma e paguar ndaj gjyqfitusit është si me poshtë:

- Për vitin 2022 është paguar në shumën 1,301,025 lekë

- Për vitin 2023 është paguar në shumën 860,171 lekë

*Sa me sipër rezulton se, për një pozicion pune paguhen dy persona, i punësuari aktual dhe personi që ka fituar gjyqin për tu rikthyer në atë pozicion ose ekuivalente me pozicionet e mëparshëm.*

- Nga MM është paguar me urdhër shpenzimin nr.522, datë 20.09.2022 në shumën 1,185,500 për vendimin gjyqësore të:

S. N. ish zëvendës/Drejtor në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të MM bazuar në Vendimin nr.4088/4297, datë 03.10.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ku është vendosur ti paguajë palës paditëse 7 paga mujore si dhe dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës në vlerën 2 paga mujore, si dhe 2 paga mujore mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, 1.5 pagë mujore për shpërblim për vjetërsinë e punës.

- Nga MM është paguar për muajin mars 2023 në shumën 334,803 lekë dhe në muajin Maj në shumën 669,606 lekë për vendimin gjyqësore të:

D. C. ish Drejtore te CIMIC-UT Mond Belgjike me Vendimin nr. 3214, datë 16.06.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë, ku është vendosur ti paguajë palës paditëse 17.5 paga mujore sipas trajtimit financiar të pozicionit, për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

- Nga MM është paguar për muajin Mars 2023 në shumën 334,803 lekë dhe në muajin Maj në shumën 669,606 lekë për vendimin gjyqësore të:

V. B. me detyrë ish Këshilltar për Politikën e Mbrojtjes në përfaqësinë ushtarake të përfaqësisë së përhershme të Republikës së Shqipërisë në Nato, Bruksel, me Vendimin nr. 849, datë 06.03.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë i formës së prerë, ku është vendosur ti paguajë palës paditëse paga për periudhën 16.07.2016-14.07.2017, si dhe shpërblim për vjetërsinë e punës në masën 3 muaj e 15 ditë page.

Nga sa më sipër për vendimet të cilat nuk kanë rikthim në punë u konstatua se nga MM nuk është, mbajtur database për vendimet gjyqësore të formës së prerë që parashikojnë detyrime monetare, si dhe për shumat e detyrimeve për secilin gjyqëfitues të përcaktuar sipas vendimit të Gjykatës, të cilat nuk janë përfshirë as në procesin e programimit buxhetor të vitit të ardhshëm, sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore përkatës.

**Gjithashtu nga auditimi rezultoi se:** Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbarimore dhe detyrimet ndaj gjyqëfituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë risku e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyqëfituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbarimore.

Nga grupi i auditimit bazuar në urdhër shpenzimet e audituara mbi likuidimin e gjyqëfituesve bëri ndarjen e detyrimeve që në detyrime ndaj gjyqëfituesve dhe shpenzimeve përmbarimore, nga ku rezultoi se shpenzimet përmbarimore janë si më poshtë:

- Për 6 mujorin e vitit 2021 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 681,670 lekë.
- Për vitin 2022 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 1,254,362 lekë.
- Për 6 mujorin e vitit 2023 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 226,879 lekë.

Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Drejtësisë, nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” pika 5 ku citon se:

*“Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore që janë parashikuar të shlyhen nga buxheti përkatës, bëhet sipas radhës së paraqitjes zyrtare të tyre në vitin paraardhës dhe **grafiku i shlyerjes bëhet publik nëpërmjet publikimit në faqen on-line të njësisë shpenzuese, apo në forma të tjera të publikimit, që ju bëhen të ditura publikut. Përmbaruesi i përmbahet grafikut të shlyerjes së detyrimit të publikuar**”.*

Në respekt të këtij detyrimi ligjor MM rezultoi se nuk ka publikimin on line në faqen zyrtare

të saj, grafikun e shlyerjes së detyrimeve sipas përcaktimit të bërë në këtë udhëzim, e cila fillon me likuidimin e detyrimeve duke njoftuar menjëherë gjyqëfituesin, ku sipas përcaktimit të pikës 2: “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Nuk është bërë ende sistemi për ish punonjësit e larguar padrejtësisht nga puna.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë për punonjës /zyrtarë civil është konstatuar se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Për 6 mujorin e dytë të vitit 2021 është paguar shuma prej 4,568,760 lekë;</li> <li>- Për vitin 2022 është paguar shuma prej 9,137,520 lekë;</li> <li>- Për 6 mujorin e parë të vitit 2023 është paguar shuma prej 5,573,169 lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 7 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi nuk rezulton të ketë komunikim me Departamentin e Administratës Publike për këta gjyq fituesit, ku të jetë kërkuar sistemimi i tyre në institucione të tjera të administratës publike.</li> <li>- Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbarimore dhe detyrimet ndaj gjyqëfituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë risku e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyqëfituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbarimore. Nga grupi i auditimit bazuar në urdhër shpenzimet e audituara mbi likuidimin e gjyqëfituesve bëri ndarjen e detyrimeve që në detyrime ndaj gjyqëfituesëve dhe shpenzimeve përmbarimore, nga ku rezultoi se shpenzimet përmbarimore janë si më poshtë:</li> <li>- Për 6 mujorin e vitit 2021 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 681,670 lekë;</li> <li>- Për vitin 2022 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 1,254,362 lekë;</li> <li>- Për 6 mujorin e vitit 2023 janë paguar shpenzime përmbarimore në shumën 226,879 lekë, vlerë e cila konsiderohet si <b>shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit</b>.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	Urdhri nr. 5151 datë 28.10.2015 “Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”. Ligji Nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 ”Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”; Ligji nr152/2013 “Për nëpunësin civil”.
<b>Ndikimi:</b>	Rritje e kostove të buxhetit të shtetit me shlyerje pagash (likuidim vendimesh gjyqësore). Sa me sipër rezulton se, për një pozicion pune paguhen dy persona, i punësuar aktual dhe personi që ka fituar gjyqin për tu rikthyer në atë pozicion ose ekuivalente me pozicionet e mëparshëm.
<b>Shkaku:</b>	Mosveprim i strukturave përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.



<b>Rekomandimi:</b>	Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Mbrojtjes, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.
---------------------	--

### **Funksionin dhe strukturën e Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë.**

Nisur nga fushat e përgjegjësive shtetërore që aktualisht ka *Ministria e Mbrojtjes*, e cila ka detyrimin Kushtetues dhe detyrime që rrjedhin nga aktet ligjore për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të mbrojtjes kolektive, ku për shkak të angazhimeve të shumta të Republikës së Shqipërisë në Misionet dhe operacione ushtarake ndërkombëtare dhe misionet apo operacionet humanitare dhe emergjencash civile, *lind nevoja për miratimin e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.*

Në kuadër të angazhimit ndërkombëtar me Forcat Aleate, prej vitit të kaluar NATO ka shtuar gjithashtu, edhe tre fusha të reja bashkëveprimi me vendet aleate që lidhet me:

- NATO SPACE
- Sigurinë Kibernetike
- Sigurinë nëndetare

Për të gjithë këto fusha përgjegjësie është nevoja për hartimin e akteve ligjore e nënligjore, harmonizimin me aktet ligjore të vendeve anëtare, dhe hartimin e rregullave standarde të veprimit, bashkëveprimi me organet e tjera të strukturave shtetërore.

Bazuar sa më sipër grupi i auditimit, auditoi funksionin dhe strukturën e **Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë** në Ministrinë e Mbrojtjes, ku kjo drejtori përbëhej nga dy Sektorë:

1. Sektori i Programimit, Hartimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë, i cili ka në strukturë dhe të punësuar dy specialiste dhe një përgjegjës sektori të komanduar.
2. Sektori i Këshillimit Ligjor dhe Monitorimit të Impaktit të Akteve Rregullatorë, i cili ka në strukturë të punësuar dy specialist, ndërsa funksioni i përgjegjës të Sektorit është vend vakant. *Gjithashtu edhe funksioni i Drejtorit është vend vacant deri në momentin e auditimit në terren.*

Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë ka për mision:

- a) harmonizimin e legjislacionit vendas në fushën e mbrojtjes sipas standardeve të kërkuara nga NATO-ja, në përputhje edhe me planet dhe programet e miratuara në këto fusha;
- b) përgatitjen dhe ndjekjen e veprimtarive që lidhen me hartimin e studimeve në fushën e legjislacionit për mbrojtjen, kryerjen dhe përfundimin e analizave tekniko-ligjore të vlerësimit, të efektivitetit të legjislacionit, të procesit legjislativ, si dhe metodologjisë dhe teknikës së hartimit të legjislacionit, harmonizimin tekniko-ligjor të brendshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes;
- c) bashkërendon dhe jep ndihme të drejtpërdrejtë, drejtorive në Ministri dhe strukturave të varësisë dhe pranë SHPFA në hartimin e projekt akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e mbrojtjes ose në kompetencë të ministrit të Mbrojtjes të tilla, si: projektligje, projektvendime, urdhra apo udhëzime, duke përafëruar legjislacionin në fushën e mbrojtjes me atë ndërkombëtar të NATO-s dhe *acquis communautaire* të BE-së;
- ç) përgatitjen e mendimeve juridike për projektligjet dhe projekt aktet e tjera normative të propozuara nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore;
- d) dhënien e mbështetjes dhe këshillimit ligjor, për strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të tyre, si dhe strukturat e Forcave të Armatosura;

- e) shqyrton ankimimet administrative të personelit civil dhe ushtarak të MM-së.
- f) përfaqëson dhe mbron interesat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në të gjitha proceset gjyqësore, ku MM-ja dhe SHP-ja janë palë
- g) Ofron mbështetje dhe këshillim ligjor të nivelit profesional për strukturat e MM-së dhe SHPFA-së, për çështje që lidhen me pozicionin e punës.
- dh) Garantimin e përputhshmërisë ligjore të akteve me karakter normativ, që dërgohen për nënshkrim te ministri i Mbrojtjes.

Përveç miratimit të akteve rregullatorë, e rëndësishme është edhe monitorimi i impaktit të tyre në strukturat e varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm.

### **Konstatim:**

Grupi i auditimit bazuar në detyrat funksionale që ka kjo drejtori si dhe strukturës organike të miratuar rekomandohet:

- Të rishikohen detyrat dhe përgjegjësitë e “*Drejtorisë Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore*”;
- Shtimi dhe plotësim të numrit të punonjësve për çdo sektor, me jo më pak se tre specialist
- Plotësimin e vendeve vakante të sektorëve siç janë funksionet “*Përgjegjës sektori*”.

### **2. Drejtoria e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve**

Aktualisht DIKM ka në strukturën e saj 4 pozicione Specialist dhe një Drejtor, pozicioni i cili deri në momentin e auditimit në terren ishte vakant.

Nga auditimi i strukturës së kësaj drejtorie u konstatua se, kjo drejtori nuk është e ndarë në sektorë por vetëm në nivel specialist, duke u bërë një drejtori e sheshte.

Drejtoria e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve ka për mision realizimin e detyrave, si më poshtë:

- përafrimin e legjislacionit për sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, në përputhje me aktet ligjore/nënligjore dhe STANAG-NATO, në fushën e mbrojtjes ose në kompetencë të ministrit të Mbrojtjes;
- studimin dhe analizimin e gjendjes së akteve ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe në fushën e mbrojtjes;
- hartimin e memorandumeve, marrëveshjeve, traktateve dhe protokolleve ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave, duke përafruar legjislacionin në fushën e mbrojtjes me atë ndërkombëtar të NATO-s dhe *acquis communautaire* të BE-së;
- hartimin e memorandumeve, marrëveshjeve, traktateve dhe protokolleve ndërinstitucionale dy ose shumëpalëshe që lidhen në emër të ministrisë së Mbrojtjes, Strukturave të SHPFA apo Institucioneve të varësisë dhe strukturave të tjera, duke përafruar legjislacionin në fushën e mbrojtjes;
- përfaqësimin dhe negocimin për Ministrinë e Mbrojtjes, gjatë takimeve të punës të organizuara për përgatitjen e akteve ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe;
- ndjekjen dhe përgatitjen e plotfuqive për nënshkrimin e akteve ndërkombëtare dypalëshe apo shumëpalëshe;
- ndjekjen e të gjitha procedurave ligjore të nevojshme për miratimin në parim, miratimin, aderimin apo ratifikimin e akteve ndërkombëtare të mësipërme në fushën e mbrojtjes;
- njoftimi, sipas parashikimit të marrëveshjes për hyrjen në fuqi, pezullimin, denoncimin dhe shfuqizimin e marrëveshjes, institucionet, ministritë apo strukturat e brendshme të Ministrisë së Mbrojtjes të përcaktuara në marrëveshje, të cilat janë kompetente për fushën e marrëveshjes;

- monitorimin e implementimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës së mbrojtjes, nëpërmjet kontrollit dhe mbikëqyrjes së kontratave apo të çdo akti tjetër nënligjor, të dalë në zbatim/implementim të këtyre marrëveshjeve;
- përgatitjen e rekomandimeve për ministrin e Mbrojtjes, për marrjen e masave konkrete për mos implementimin e marrëveshjeve ndërkombëtare të fushës së mbrojtjes;
- identifikimin e nevojave për marrëveshje, përcaktimin e procedurave standarde të inicimit të marrëveshjeve, si dhe garantimin që strukturat në varësi të ministrisë i kanë kuptuar dhe i zbatojnë procedurat standarde, modelet standarde në rregullimin e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve;
- përgatitjen e mendimeve juridike për marrëveshjet ndërkombëtare, që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe të Këshillit të Ministrave, të propozuara nga ministritë e linjës dhe institucionet qendrore.

Përveç fushave dhe përgjegjësiave shtetërore që aktualisht ka **Ministria e Mbrojtjes** në kuadër të angazhimit ndërkombëtar me Forcat Aleate, prej vitit të kaluar, vendi ynë ka marrë angazhimin për parashikimin e fondit 2% të GDP, në buxhetin e vitit 2024 dhe për rrjedhojë lind nevoja e përfshirjes së Forcave të Armatosura në shume angazhime dy dhe shume paleshe me vendet e tjera Aleate. Në këtë kuadër është planifikuar që nga kjo drejtori të ketë vëllim të shtuar të marrëveshjeve dhe ndryshimeve përkatëse të legjislacionit në këtë fushë pasi angazhimet janë në nivel qeveritar dhe duhet të përafrohen me të gjitha normativat e Vendeve Aleate, por edhe me Bashkimin Evropian.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Ristrukturimi dhe plotesimi i vendeve vakante të Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë.
<b>Situata:</b>	<p>Nisur nga fushat e përgjegjësiave shtetërore që aktualisht ka <b>Ministria e Mbrojtjes</b>, e cila ka detyrimin Kushtetues dhe detyrime që rrjedhin nga aktet ligjore për mbrojtjen dhe sigurinë kombëtare, përfshirë këtu edhe bashkëpunimin ndërkombëtar në kuadër të mbrojtjes kolektive, ku për shkak të angazhimeve të shumta të Republikës së Shqipërisë në Misionet dhe operacione ushtarake ndërkombëtare dhe misionet apo operacioneve humanitare dhe emergjencash civile, <b><i>lind nevoja për miratimin e akteve ligjore e nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.</i></b></p> <p>Në kuadër të angazhimit ndërkombëtar me Forcat Aleate, prej vitit të kaluar NATO ka shtuar gjithashtu, edhe tre fusha të reja bashkëveprimi me vendet aleate që lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- NATO SPACE</li> <li>- Sigurinë Kibernetike</li> <li>- Sigurinë nëndetare</li> </ul> <p>Për të gjithë këto fusha përgjegjësie është nevoja për hartimin e akteve ligjore e nënligjore, harmonizimin me aktet ligjore të vendeve anëtare, dhe hartimin e rregullave standarde të veprimit, bashkëveprimi me organet e tjera të strukturave shtetërore.</p> <p>Nga auditimi rezultoi se kjo strukturë nuk ishte e plotësuar me stafin e nevojshëm sipas organikës së miratuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në emërtimin e kësaj drejtorie është dhe Integrimi, por në funksionin e saj nuk e ka integrimin pasi detyrat kryesore lidhen vetëm me koordinim e marrëveshjeve, punë për të cilën ndiqet e gjithë praktika sipas marrëveshjeve përkatëse duke u përkthyer dhe duke u bashkërenduar me strukturat përkatëse dhe Institucionet e linjës sipas llojit dhe specifikës që ka marrëveshja. Nisur nga fakti që detyrat kryesore të cilat kërkojnë plotësimin e praktikave përkatëse për lidhjen e marrëveshjeve, ndër te</li> </ul>

	tjera kërkojnë edhe negocimin e tyre përveç koordinimit, (pjesë që duhet ti përkiste Integritit) rezultoi se këtë proces e kryen një nga sektorët e Drejtorisë së Politikave të NATO-Be (Sektori i Politikave me Jashtë).
<b>Kriteri:</b>	Urdhrit të Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 94, datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Përpunimi dhe finalizimi i praktikave të marrëveshjes nga dy drejtori të ndryshme pa lidhje funksionale në strukturë me njëra tjetrën, <b>mund të ndikojë në vonesa në përcjelljen e praktikave, rekomandimeve apo edhe raporteve dhe negocimeve gjatë grupeve të punës në fazën fillestare.</b> Për të vijuar në një proces me të plotë dhe pa vonesa të punës, rekomandojmë se bazuar dhe në emërtimin “ <i>Drejtoria e Integritit, Koordinimit dhe Marrëveshjeve</i> ” të realizojë dhe procesin e negocimit të marrëveshjeve, bazuar dhe në fushat e saj të përgjegjësisë.
<b>Shkaku:</b>	Mungesë e stafi.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marrin masa, që të kërkohej ristrukturim i kësaj drejtorie duke e ndarë në sektor, me funksionet organike “Përgjegjës sektori”, si dhe të plotësohet me numrin e nevojshëm të specialistëve për çdo sektor, bazuar në përgjegjësitë dhe funksionet, me qëllim realizimin në kohë të marrëveshjeve, si dhe ndryshimeve përkatëse të legjislacionit në këtë fushë, duke qenë se angazhimet janë në nivel qeveritar dhe duhet të përafrohen me të gjitha normativat e Vendeve Alete, por edhe me ato të Bashkimit Evropian.

### 2.3 Zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

Në zbatim të pikës nr. 3 të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Dokumentet bazë të kontabilitetit si: fletëhyrje, fletëdalje, faturë, mandatarkëtim, mandatpagesë, urdhër-shpenzim;
- Transaksionet e llogarive bankare;
- Pagesa për shërbime e blerje të vogla, të ndara në disa kontrata me disa grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme.

Nga auditimi me zgjedhje i transaksioneve të kryera përgjatë 6 mujorin e dytë të vitit 2021, vitit 2022 dhe 6 mujorit të parë të 2023 mbi ligjshmërinë dhe saktësinë e plotësimit të dokumentacionit bazë të kontabilitetit (fletëhyrje, fletëdalje, faturë, urdhër shpenzim, etj.) të realizuara në Ministrinë e Mbrojtjes, veprimet janë kryer bazuar në Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.

Dokumentacioni i bankës është mbajtur dhe kontabilizuar konform rregullave të kontabilitetit si dhe udhëzimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Urdhër-shpenzimet janë bazuar në dokumentacionin justifikues (si faturat, kontratat e lidhura për blerjet e shërbimet, proces verbalet dhe aktet e marrjes në dorëzim të mallrave apo shërbimeve) konform pikës 35, të

Udhëzimit të Ministrisë Financave dhe Ekonomisë nr. 30, date 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*".

Urdhër-shpenzimet e përzgjedhura u audituan në funksion të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik*", veçanërisht sa i takon regjistrimit të veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazuar në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim si dokumente autorizues, dokumente vërtetues, dokumente të kontabilitetit etj.

#### **a. Auditimi me zgjedhje i urdhër shpenzimeve**

Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, duke i analizuar dhe me regjistrimin në sistemin SIFQ, për vitet 2021, 2022 deri me 30.06.2023 nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkalluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika 184 "*Nëpunësit zbatues të njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik*", si dhe Ligji nr.48/2014 "*Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare*", neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit."

Tejkalimi i këtij afati ka krijuar detyrime të prapambetura për institucionin, ku sipas VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 "*Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit*" dhe UMF nr. 37, datë 06.10.2020 "*Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme*", detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet e përcaktuara në një ligj/ marrëveshje/ vendim gjykatë të formës së prerë, që mbeten të papaguara 60 ditë, pas datës së lëshimit të faturës nga operatori ekonomik.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ndikon në riskun e realizimit të investimeve të reja, si dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve të planifikuara, për t'u realizuar në periudhat e ardhshme, pasi një pjesë e konsiderueshme e buxhetit vjetor shkon për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të krijuara nga institucioni.

Krijimi i detyrimeve të prapambetura ka ardhur, ndër të tjera, edhe si rrjedhojë e si më poshtë:

- Mosidentifikimit të risqeve që pengojnë reduktimin, shlyerjen dhe parandalimin e detyrimeve të prapambetura;
- Mungesës së kontabilizimit të plotë dhe të saktë të të gjitha detyrimeve, që nga koha e krijimit të tyre, si dhe regjistrimit të faturave në kohë në sistemin SIFQ;
- Mungesës së Planeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe planifikimit të fondeve të dedikuara për pagesat;
- Mosrespektimit të qasjes FIFO në radhën e shlyerjes së detyrimeve.

Nga auditimi i faturave të likuiduara nga ana e MM, me datën e faturës tatimore, nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se:

Për vitin 2021, janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor 20 fatura;

Për vitin 2022, janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor 17 fatura.

Për periudhën 30.06.2023, janë kryer likuidime në tejkallim të afatit ligjor 30 ditor 38 fatura.

Sa më lart MM ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për "*Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*", i ndryshuar, neni 52 ku citohet... : "*specifikohet se Nëpunësi zbatues i njësisë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, Brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE-së*", UMF nr. 9, datë 20.03.2018 "*Për procedurat*

standarde të zbatimit të buxhetit", pika 184: Ligji nr. 48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mbi tejkalimin e afatit 30 ditor të likuidimit të faturave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, duke tejkeluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse. të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”.
<b>Kriteri:</b>	UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 184: Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit” dhe UMFE nr. 37, datë 06.10.2020 ‘Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Mundësia e krijimit të detyrimeve të prapambetura.
<b>Shkaku:</b>	Shkelje e disiplinës buxhetore.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

#### **b. Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.**

Auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, të kryera nga MM, në cilësinë e AK u ushtrua bazuar në aktet ligjore/ nënligjore të prokurimit publik, si dhe në aktet ligjore/ nënligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit.

Në zbatim të kësaj pike, grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin, si më poshtë:

- Vlerësimin e hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar;
- Argumentimin dhe përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime;
- Realizimin e procedurave të prokurimit, që nga momenti i nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, deri në lidhjen e kontratës;
- Lidhjen dhe zbatimin e kontratave, deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve.

Grupi i auditimit ka përzgjedhur për të audituar procedurat për blerje mallra/ shërbime, sipas Aneksit 2/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se:

**1. Për procedurën: “Riparim i pajisjeve shumë funksionale të printimit”**

- Me Urdhrin e Prokurimit nr. 128, datë 20.10.2021, është iniciuar procedura e prokurimit me vlerë 181,555 lekë pa TVSh me objekt “Riparim i pajisjeve shumë funksionale të printimit”, publikuar me REF-09005-10-21-2021, realizuar në vlerën 134,000 lekë pa TVSH”.

Nga komisioni nuk është bërë skualifikimi i tre operatorëve të renditur të parët pasi ofertat e tyre rezultojnë të jenë më të vogla se 50% e fondit të limit prej **181,555** lekë pa TVSH, siç parashikon edhe pika 6 e nenit 56 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të kontratës vetëm operatorët ekonomikë, oferta e të cilëve, nuk është ulur më shumë se 50% e fondit limit të përlogaritur.*

Më pas komisioni ka vazhduar me njoftimin e operatorit fitues ku ka rezultuar se 5 operatorët e renditur të parët janë tërhequr nga procedura dhe kanë kaluar te operatori ekonomik i renditur i gjashti. Komisioni ka njoftuar operatorin S. C., i cili ka sjell dokumentet e nevojshme dhe ka nënshkruar kontratën e më pas janë kryer shërbimet e kërkuara, bazuar në procesverbalin e datës 03.11.2021 firmosur nga operatori dhe përfaqësuesit e AK. Operatori ekonomik është likuiduar me anë të faturës elektronike me nr. 79169998/2021 datë 03.11.2021.

Në përgjithësi dosjet e audituara kanë rezultuar të dokumentuar sipas përcaktimit të VKM nr. 285 datë 19.05.2021.

**Nga auditimi me zgjedhje i procedurave dhe marrjen në dorëzim te mallrave/shërbimeve /punëve për të tre vitet 2021;2022 dhe 2023 u konstatua se:**

Komisioni i marrjes në dorëzim mallrave/shërbimeve /punëve në çdo rast ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim, duke ju referuar faturës, kontratës dhe specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë, sipas përcaktimeve të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

**c. Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”**

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021 ”Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”. Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 4 të Udhëzimit ka nxjerrë Urdhrat e Prokurimit përkatës.

**c. Auditimi i procedurave të prokurimit “Blerje e biletave të transportit ajror ndërkombëtar”**

Autoriteti Kontraktor, në fillim të vitit buxhetor, ka ngritur Komisionin e Sistemit Dinamik (SD) për blerjen e biletave i përbërë prej 3 anëtarë, bazuar në pikën 3 të Udhëzimit të APP nr. 3, datë 18.06.2021 ”Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”. Pas nxjerrjes së autorizimit për pjesëmarrje nga titullari/ ministri, titullari i AK/ personi i autorizuar prej tij, referuar pikës 4 të Udhëzimit ka nxjerrë Urdhrat e Prokurimit përkatës. Procedurat e përzgjedhura dhe të auditura janë në Aneksin 2/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Komisioni, në zbatim të pikës 5-6 të Udhëzimit, ka realizuar procedurën e prokurimit nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE).

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mungesë dokumentacioni në urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i blerjes së biletave të transportit ajror ndërkombëtar është si dhe urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve të të likuiduara nëpërmjet arkës u konstatua: Mungesa e boarding pass, e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, pika 4 dhe me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm”, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, nenin 8, pika 1, nenin 9, pika 1 dhe nenin 12, pika 3, germa a. nenin 4, pika 26, nenin 2, pika 16. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos dokumentimi i gjurmëve të auditimit.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Të merren masa nga titullari i institucionit, që menjëherë pas dërgimit të ftesës për pjesëmarrje në takime/evente jashtë vendit, të përgatitet dokumentacioni ligjor në kohë optimale duke respektuar afatet për qarkullimin e shkresave administrative, në mënyrë që blerja e biletave të transportit ajror ndërkombëtar me sistem dinamik blerje të kryhet jo në datë të përfaqërt (apo brenda ditës) me datën e nisjes.

### 2.3. Mbi auditimin pronave dhe asetëve në Ministrinë e Mbrojtjes

Me anë të VKM nr. 515, datë 18.7.2003 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes” është miratuar lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes. Referuar VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata



të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, pronat publike trajtohen në dy kategori, në varësi të sipërfaqes.

Për pronat me sipërfaqe mbi 200m<sup>2</sup>, pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose emfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

Nga auditimi rezultoi se, të gjitha objektet e dhëna me qira ose me emfiteozë janë në përgjegjësi administrimi të njësisë të varësisë dhe asnjë drejtpërdrejtë në përgjegjësi administrimi të aparatit të Ministrisë së Mbrojtjes, pra procedura nuk kryhet nga aparati i Ministrisë së Mbrojtjes, por nga vetë njësitë e varësisë që kanë nën administrim objektet.

#### **1.a Kontratat për dhënie me qira ose emfiteozë të objekteve me sipërfaqe nën 200m<sup>2</sup>**

Referuar VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar:

“5. Përjashtohen nga konkurrimi: a) dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200m<sup>2</sup>, të cilat jepen me afat deri në 1 vit”.

“6. Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve të dhënies me qira e kanë: a) institucioni shtetëror, ndërmarrja ose shoqëria shtetërore, që jep me qira, për një afat deri në 1 (një) vit: i) objekte që ka në administrim, me sipërfaqe deri në 200m<sup>2</sup> (ku të jetë përfshirë dhe sipërfaqja funksionale)”.

Pra sa më sipër, referuar VKM-së, dhënia me qira e sipërfaqeve deri në 200 m<sup>2</sup> bëhet pa konkurrim dhe të drejtën e lidhjes së kontratës e ka struktura administruese.

#### **1.b Kontratat për sipërfaqe mbi 200m<sup>2</sup>**

Pasuritë shtetërore u jepen të tretëve, duke u transferuar të drejtën e përdorimit me qira ose emfiteozë, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, referuar VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

Pas ardhjes së kërkesës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me anë të së cilës paraqet kërkesën për qiradhënien e një pasurie të paluajtshme shtetërore, merret miratimi i Ministrit të Mbrojtjes për fillimin e procedurave. Pas marrjes së miratimit nga Ministri i Mbrojtje, kërkohet prononcimi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura (SHPFA) dhe strukturës administruese të pronës për kërkesën e paraqitur nga MFE për dhënien me qira të pronës në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes. Në rast dakordësie për dhënien me qira të pronës, struktura administruese e pronës përgatit dokumentacionin sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, emfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore.”

Struktura administruese dërgon prononcimin mbi kërkesën e paraqitur, planvendosjen e sipërfaqes që do jepet me qira, konfirmimin nga Agjencia e Trajtimit të Pronës (ATP), konfirmimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës mbi gjendjen juridike të pronës, cakton çmimin dysHEME sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 54/2014 i ndryshuar, afatin kohor që do të jepet me qira dhe përcaktimin e kushteve shtesë për përdorimin e pronës në rast se nevojitet.

Dokumentacioni i përgatitur nga struktura administruese e pronës së kërkuar për qiradhënie, së bashku me prononcimin e SHPFA-së, i dërgohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vijim procedurash qiradhënie. Pas përfundimit të procedurave të konkurrimit dhe lidhjes së kontratës nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me subjektin fitues, Ministria e Mbrojtjes nxjerr urdhrin për zbatimin e kontratës së qirasë.

Ndërmarrja që ka në administrim objektin që do të jepet me qira ose emfiteozë përgatit dokumentacionin, bën shpalljen e njoftimit, konkurrimit dhe, më pas, Komisioni i dhënies me qira ose emfiteozë bën vlerësimin e ofertave.

Neni 6 i VKM-së specifikon se:

- Të drejtën e lidhjes së kontratës së qirasë dhe të përcaktimit të afateve e ka organi që ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore të ndërmarrjes që jep me qira deri në 20 vjet.

- Të drejtën e lidhjes së *kontratës së emfiteozë* me afat deri në 20 vjet e ka ministria përgjegjëse për ekonominë.  
Sa më sipër, sa i takon pronave mbi 200 m<sup>2</sup>, ndërmarrjet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes kanë në fuqi kontratat, sipas *Aneksit 2/3* bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Monitorimi i kontratave**

Monitorimi i kontratave të qirasë dhe të emfiteozë drejtohet nga organi që ka lidhur kontratën e qirasë ose të emfiteozë. Monitorimi bëhet nga njësitë monitoruese, që janë institucionet shtetërore, shoqëritë tregtare dhe ish-ndërmarrjet shtetërore që kanë në administrim objektet e dhëna me qira ose emfiteozë. Neni 2, kreu VI i VKM nr. 54, datë 05.02.2014, specifikon se njësitë monitoruese e kontratave të qirasë ose të emfiteozë kryen, ndër të tjera, këto detyra:

- Ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të emfiteozë;
- Për çdo kontratë të lidhur njësitë monitoruese dërgon një raport të hollësishëm për ecurinë e tyre, të konfirmuar për arkëtimet dhe nga degët e thesarit të rrethit përkatës;
- Për kontratat e lidhura për sipërfaqe mbi 200m<sup>2</sup>, çdo tre muaj dërgon në organin që ka lidhur kontratën e qirasë ose të emfiteozë, raportin përkatës për realizimin e derdhjes së detyrimeve të qirasë mujore dhe treguesve të tjerë të kontratës, shoqëruar me dokumentin e derdhjes dhe çdo dokumentacion tjetër të vlefshëm.

### **- Objekte dhe sipërfaqe funksionale të Repartit Ushtarak ne.3362 (Ish Komanda e vjetër e Bazës Ajrore, Kuçovë)**

Për Objektin dhe sipërfaqen funksionale të Repartit Ushtarak ne.3362 (Ish Komanda e vjetër e Bazës Ajrore, Kuçovë)” në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes me VKM nr.562, datë 29.07.2016 “*Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet MZHETS, si qiradhënës, dhe shoqërisë “B.” shpk, si qiramarrës, për pasurinë “truall dhe objekt (rrënoja)”, pjesë e pronës nr. 1018, ish-venddislokimi i shtabit të vjetër të bazës ajrore Kuçovë, Berat, të Ministrisë së Mbrojtjes*” ku është vendosur dhënia me qira me tarifën 1 euro/kontrata me sipërfaqe 42 000 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 2,115.41 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 39,893.59 m<sup>2</sup>.

Midis MZHETS dhe shoqërisë “B.” shpk, me objekt “Truall dhe Objekt ” është lidhur kontrata e qirasë me nr.1685, datë 24.08.2016, me afat 20 vjet, e cila është pjesë e pronës nr.1018, ish-venddislokimi i Shtabit të Vjetër të Bazës Ajrore Kuçovë, Berat, me sipërfaqe 42,000 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqe ndërtimi 2,115.41 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 39,893.59 m<sup>2</sup>. Qëllimi i lidhjes së kontratës është që gjatë zhvillimit të aktivitetit nga Qiramarrësi do të investohet në sistemimin e ambienteve ekzistuese, në ndërtimin e një qendre multi-funksionale, për grumbullimin, seleksionimin, ambalazhimin, ruajtjen dhe tregtimin e frutave dhe perimeve të freskëta, një vlerë totale 210,000 mijë lekë, i cili duhet të realizohet brenda vitit 2018, sipas planbiznesit.

#### ***Investim duhet të realizohet si vijon:***

- do të investojë për ndërtimin e qendrës së integruar të grumbullimit (Vendosja e qendrës logjistike), Vjelja-Selektimi-Paketimi-Ruajtja-Marketingu-Shitja;

- do të realizohet ngritja e qendrës së shërbimit për fermerët, laborator dhe qendër trajnimi.

Sipas parashikimit në planbiznesin e paraqitur, dhe pikës 5.5 të kontratës, qiramarrësi detyrohet që në objektin e marrë me qira deri në fund të vitit 2017 do të ketë të punësuar 20 punonjës dhe në fund të vitit 2018 do të ketë të punësuar 50 punonjës.

Qiramarrësi detyrohet që të paraqesin në fillim të çdo viti relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve shoqëruar me dokumentacionin përkatës, si dhe vërtetimin nga tatimet për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

Me vendimin e Ministrit të Mbrojtjes me nr.1837, datë 09.09.2016 është përcaktuar se Komanda e Forcave Ajrore ngarkohet që të monitorojë dhe raportojë në vazhdimësi lidhur me

zbatimin e kësaj kontrate.

### **Monitorimi**

Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me monitorimin e dhënies me qira të këtij objekti, me përfitues “B.” shpk u konstatua se:

Me Aktmonitorimin me nr. 744/1 prot., datë 02.04.2019 “Mbi realizimin e tregueseve të punësimit, investimeve të kryera dhe zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë 1685 rep, nr.566/4 Kol., datë 24.08.2016 nga shoqëria B. shpk”, Komisioni i Monitorimit në FA i përbërë nga: z. P. S., z. E. F., z. M. J. dhe z. S. H., si dhe administratorit të shoqërisë “B.” Shpk, z. Y. A. ka kryer monitorimin mbi numrin e punonjësve, investimet e kryera, si dhe mbi zbatimin e kushteve të kontratës. Sa më sipër, grupi i monitorimit citon se subjekti nuk ka kryer asnjë investim të parashikuar në pikat 5.4 dhe 5.5 të kontratës së qirasë. Nga grupi i monitorimit është konstatuar se realizimi i tregueseve si numri i të punësuarve dhe investimit të realizuar është 0.

Me anë të Urdhrit të Komandës së Forcës Ajrore me nr. 305, datë 19.07.2022 “Për krijimin e grupit të punës mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë nr.1685 Rep., nr. 566/4 Kol, të datës 24.08.2016”, Reparti Ushtarak nr.3005”, u ngrit komisioni i marrjes në dorëzim të pronës në Repartin Ushtarak nr.3005, Kuçovë i përbërë nga z. L. K., z. P. B., z. L. T., z. L. Z., znj. S. I., z. M. J., z.S. I. dhe z.V. K. dhe administratorit të shoqërisë “B.” Shpk, z. Y. A.

Me shkresën nr.2831 prot., datë 16.08.2022, me lëndë “Procesverbal për marrje në dorëzim të sipërfaqes dhe objekteve të pronës nr.1018 dhënë me qera me VKM nr.562, datë 29.07.2016”, nga verifikimi në terren i komisionit të marrjes në dorëzim, rezulton se shoqëria “B.” shpk nuk ka kryer asnjë investim apo ndërhyrje në sipërfaqen 42,009m<sup>2</sup>, përkatësisht 2,115.41 m<sup>2</sup> me sipërfaqe funksionale dhe 39,893.59 m<sup>2</sup> të marrë me qira nga ana e saj.

Me shkresën nr. 2831/2, Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i ka dërguar Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore në MFE, Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Sekretarit të Përgjithshëm në MM një informacion për marrjen në dorëzim të pronës, duke kryer verifikimin fizik të sipërfaqes së marrë me qira.

Nga ana e Grupit të Auditimit, konstatohet se nga strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes si edhe Struktura e Komandës së Forcës Ajrore është ngritur ngritur grupi i punës me anë të Urdhrit nr.305, datë 19.07.2022 “Për krijimin e grupit të punës mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë nr.1685 Rep., nr.566/4 Kol, të datës 24.08.2016.” Gjithashtu, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, konkretisht Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse e cila i ka kërkuar Komandës së Forcave Ajrore me shkresën nr.8234/2, datë 26.11.2018, argumentimin mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë me shoqërinë “B.” shpk. Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr.8655/2, datë 07.01.2019, i ka dërguar MFE-së, kërkesën për zgjidhjen e kontratës me shoqërinë “B.” si edhe propozon penalitetet sipas nenit nr.7 dhe zgjidhjen e kontratës.

MFE me shkresën nr.4602/2, datë 14.07.2022, ka njoftuar shoqërisë “B.” shpk, si dhe ka vënë në dijeni Ministrinë e Mbrojtjes edhe Komandën e Forcave Ajrore, mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë si edhe penalizimin e shoqërisë “B.” shpk me vlerën e ngurtësuar në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë.

Sa më sipër referuar VKM-së nr.562, datë 29.07.2016 “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë “B.” shpk, si qiramarrës, për pasurinë “truall dhe objekt (rrënoja)”, pjesë e pronës nr. 1018, ish-venddislokimi i Shtabit të vjetër të bazës ajrore Kuçovë, Berat, të Ministrisë së Mbrojtjes”, ku specifikisht në nenin nr.6 “Pagesa e qirasë”, pika nr.6.2 përcaktohet se: “Para nënshkrimit të kontratës Qiramarrësi ka paguar garancinë e kontratës, në vlerën 4,200,000 (katër milionë e dyqind mijë) lekë, sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit të shprehur në nenin 5.4 të kësaj kontrate”.

Gjithashtu në nenin nr.7, **“Penalitetet”**, pika nr.7.1., përcaktohet se: *“Në rastin kur Qiramarrësi, në përfundim të vitit 2018, nuk ka realizuar investimet e përcaktuara në pikën 5.4 të kësaj kontrate, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe gjobit Qiramarrësin, me vlerën e garancisë së ngurtësuar në atë moment”*, rezulton se nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, Srukturave përkatëse për Administrimin e Pronave dhe Aseteve, Komandës së Forcës Ajrore dhe MFE-së është proceduar me zgjidhjen e kontratës si edhe mbajtjen e garancisë për shoqërinë “B.” shpk.

Nëpërmjet shkresës nr.8234/2, datë 26.11.2018, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse i ka dërguar Komandës së Forcave Ajrore, kërkesën për argumentim mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë me shoqërinë “B.” shpk.

Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes me shkresën nr.8655/2, datë 07.01.2019, i është drejtuar MFE-së, me kërkesën për zgjidhjen e kontratës nr.1685 Rep, nr.566/4 Kol, të datës 24.08.2016 *“Kontratë qiraje me tarifën simbolike 1 euro/kontrata”*.

Gjithashtu nëpërmjet shkresës nr.1298/8, datë 23.05.2022, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, i është kthyer përgjigje shkresës së MFE-së me nr.4602, datë 09.03.2022, ku e informon se Komanda e Forcave Ajrore me aktmonitorimin 809/1, datë 24.03.2022, vërteton se subjekti qiramarrës nuk ka kryer asnjë investim të parashikuar, si edhe Ministria e Mbrojtjes propozon anulimin e kontratës së qirasë pasi nuk janë plotësuar detyrimet kontraktuale nga qiramarrësi si edhe vendosjen e penaliteteve për subjektin.

Nga ana e MFE-së, nëpërmjet shkresës nr.4602/2, datë 14.07.2022, njofton shoqërinë “B.” shpk, për dijeni Ministrinë e Mbrojtjes dhe Komandën e Forcave Ajrore, mbi zgjidhjen e kontratës së qirasë me çmimin simbolik 1 Euro/kontrata lidhur ndërmjet MFE-së dhe shoqërisë “B.” shpk. Në pikën nr.2 të kësaj shkrese Shoqëria qiramarrëse “B.” shpk penalizohet me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kontratës së qirasë në zbatim të nenit nr.7 të kontratës së qirasë.

Veprimet e mësipërme janë në përputhje me VKM nr.54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kriteve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enftëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”* i ndryshuar, Kreu V *“Kontrata me tarifën simbolike 1 Euro Kontrata”*, pika nr.5 ku përcaktohet se *“Në kontratat me tarifë 1 euro/kontrata vendosen sanksione për rastet kur qiramarrësi nuk realizon kushtet e saj. **Për çdo vend pune të pahapur subjekti qiramarrës do të ndëshkohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë në vit. Për mosrealizim të investimit në përfundim të fazës përkatëse ndëshkohet me 10 për qind të vlerës së investimit të përcaktuar në atë fazë dhe nëse pas 6 muajve investimi nuk realizohet, kontrata zgjidhet nga institucioni shtetëror që e ka lidhur atë, duke marrë gjobë, në masën e garancisë së depozituar në atë periudhë. Pas këtyre veprimeve, në marrëveshje midis palëve, kontrata e qirasë mund të rilidhet me tarifa qiraje sipas përcaktimeve në kreun III, të këtij vendimi, pasi të jenë përmbushur të gjitha kushtet e parashikuara në kontratën bazë.”***, si edhe VKM nr.562, datë 29.07.2016 *“Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënësi, dhe shoqërisë “B.” shpk, si qiramarrës, për pasurinë “truall dhe objekt (rrënoja)”, pjesë e pronës nr. 1018, ish-venddislokimi i Shtabit të vjetër të bazës ajrore Kuçovë, Berat, të Ministrisë së Mbrojtjes”, nenin nr.7, “Penalitetet”, pika nr.7.1.*

Gjatë vitit 2023, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes, janë kryer monitorimet sipas institucioneve të varësisë si vijon:

#### Komanda e Forcës Ajrore

Me anë të shkresës nr. 999 prot., datë 11.04.2023, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore në MFE, për dijeni të Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe të Shërbimeve në MM, Komanda e Forcave Ajrore ka dërguar informacion për objektet me qira

për vitin 2022. Sa i takon kontratave të qirasë, nga ana e KFA është paraqitur një përmbledhje për të gjitha kontratat e lidhura para vitit 2022 dhe kanë vazhduar zbatimin gjatë vitit 2022, ku është kryer monitorimi për 3 kontrata mbi 200m<sup>2</sup>, nga komisioni përkatës, janë kryer monitorimet si vijon:

- Me Aktmonitorimin nr.992/2 prot., datë 30.03.2023 *“Mbi realizimin e tregueseve të punësimit, investimeve të kryera dhe zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë 8378 rep, nr.3241 Kol., datë 28.12.2020 nga shoqëria “Sh.” shpk*, Komisioni i Monitorimit në FA i përbërë nga: z.L. K., z. A. F., z. M. J., znj. L. A. dhe z. S. H., si dhe administratorit të shoqërisë *“Sh.” Shpk*, z.Sh. Sh., ka kryer monitorimin mbi numrin e punonjësve, investimet e kryera, si dhe kushtet e kontratës. Sa më sipër, grupi i monitorimit citon se bazuar në informacionin e datës 10.03.2023 nga ana e shoqërisë *“Sh.” shpk*, prot. në KFA me nr.670/2, datë 20.03.2023, ka informuar se nuk është pajisur ende me Leje Zhvillimi dhe për këtë arsye dhe numri i të punësuarve është 0.

- Me Aktmonitorimin nr.966/1 prot., datë 31.03.2023 *“Mbi realizimin e tregueseve të punësimit, investimeve të kryera dhe zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë nr.931 Rep, 182 Kol, datë 06.05.2020 nga shoqëria C. I. Sh.”*, Komisioni i Monitorimit në FA i përbërë nga: z. L. K., z.A. F., z.M. J., znj.L. A. dhe z. S. H., si dhe administratorit të shoqërisë *“C.I. Sh.”*, z. I. Sh. është kryer monitorimi mbi numrin e punonjësve, investimeve të kryera, si dhe kushteve të kontratës. Sa më sipër, grupi i monitorimit citon se bazuar në informacionin e datës 20.03.2023 nga ana e shoqërisë *“C.I.Sh.”*, prot. në KFA me nr.1058, datë 20.03.2023, ka informuar se për realizimin e përmbushjes së kërkesave të kontratës, ka filluar punimet në muajin dhjetor 2020, ku sipas planit të investimeve të detajuara në plan biznesi, janë përgatitur situacionet përkatëse në vlerën 132,672,023 lekë dhe vlera e pajisjeve sipas projektit në shumën 44,971,553 lekë, ku treguesit janë realizuar në masën 100%.

- Me Aktmonitorimin nr.999/1 prot., datë 29.03.2023 *“Mbi realizimin e tregueseve të punësimit, investimeve të kryera dhe zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë nr. 3039 rep, nr.1115 kol, datë 2.10.2019 nga shoqëria A. B.”*, Komisioni i Monitorimit në FA i përbërë nga: z. L. K., z.A. F., z.M. J., znj.L. A. dhe z. S. H., si dhe administratorit të shoqërisë *“A.B.”*, është kryer monitorimi mbi numrin e punonjësve, investimeve të kryera, si dhe kushteve të kontratës. Sa më sipër, grupi i monitorimit citon se bazuar në informacionin e datës 21.03.2023 nga ana e shoqërisë *“A.B.”*, prot. në KFA me nr.1133, datë 21.03.2023, ka informuar se për realizimin e përmbushjes së kërkesave të kontratës treguesit janë realizuar në masën 100%.

#### Komanda e Forcave Detare

Me anë të shkresës nr. 100/1 prot., datë 20.01.2023, drejtuar Drejtorisë së Administrimit të Pronës Shtetërore në MFE dhe Drejtorisë së Mirëadministrimit të Pronave dhe Aseteve në MM Komanda e Forcave Detare ka dërguar informacion për objektet e dhëna me qira gjatë vitit 2022. Sa i takon kontratave të qirasë, nga ana e KFD është paraqitur një përmbledhje për të gjitha kontratat e lidhura para vitit 2022 dhe kanë vazhduar zbatimin gjatë vitit 2022, ku 7 kontrata janë deri në 200 m<sup>2</sup> dhe 2 kontrata mbi 200m<sup>2</sup>. Sa i takon monitorimit të kontratave mbi 200 m<sup>2</sup>, nga komisioni përkatës, janë kryer monitorimet si vijon:

- Me Aktmonitorimin nr.1 *“Mbi numrin e punonjësve, investimeve të kryera dhe zbatimi i kushteve të kontratës së qirasë nr.821 rep.nr.166 kol, datë 17.04.2020 nga shoqëria A.O.”*, të datës 11.01.2023, Komisioni i Monitorimit në FD i përbërë nga Kryetari, z. A. K. dhe anëtarë: z. E. G., z. A. B., z. D. M., z. Xh. B., si dhe administratorit të shoqërisë *“A.O.”*, z. Sh. K. është kryer monitorimi mbi numrin e punonjësve, investimeve të kryera, si dhe kushteve të kontratës. Në zbatim të pikës 5.7 të kontratës, shoqëria A.O., ka detyrimin e kryerjes së investimeve në vlerën totale prej 22,389,800 lekë pa TVSh, për të cilat, nga grupi i monitorimit citohet se gjatë vitit 2020-2021, investimi i kryer paraqitet në shumën 26,949,892 lekë. Gjithashtu, kjo shoqëri ka 49 punonjës, bazuar në kushtet e kontratës.

- Me Aktmonitorimin nr.2 "Për zbatimin e kushteve të kontratës së qirasë nr.982 rep.nr.445 kol, datë 16.07.2020 lidhur midis MFE dhe shoqërisë M. B.S., për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e turizmit.", të datës 11.01.2023, Komisioni i Monitorimit në FD i përbërë nga Kryetari, z. A. K. dhe anëtarë z. E. G., z. A. B., z. D. M., z. Xh. B., si dhe administratorit të shoqërisë "M.B.S.", z. G. K. ka kryer monitorimin e kontratës nr.982 rep.nr.445 kol, datë 16.07.2020. Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë në fushën e turizmit, ku investimi do të konsistojë në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës "Pro turizëm" duke investuar rreth 6.2 miliard lekë pa TVSh dhe duke punësuar minimalisht 35 punonjës.

Bazuar në kontratën e mësipërme dhe Akt-Marrveshjen nr.4389, date 10.12.2021 dhe nr. 06.10.2021 të lidhur ndërmjet Komandantit të Forces Detare dhe shoqërisë "M.B.S." shpk ndërtimi i objekteve do të përfundojë 6 (gjashtë) muaj nga dita e zbardhjes së lejeve të ndërtimit. Bazuar në informacionin e administratorit të shoqërisë "M.B.S." shpk, z.G. K., dhe monitorimi në terren të kushteve të kontratës nga grupi i monitorimit rezulton se nuk ka filluar puna në asnjë prej objekteve të parashikuara për tu ndërtuar në interes të KFD, për shkak, se nuk ka dal ende VKM për prishjen e objekteve në interes të zhvillimit të projektit për të cilat shoqëria "M.B.S." sh.p.k, ka aplikuar, pranë MFE.

#### Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura

Me anë të shkresës nr.13110 prot., datë 17.07.2023 me lëndë "Lidhur me monitorimin e kontratës së qirasë nr.1034 rep., nr.306/3 kol", SP në MM ka kërkuar informacion mbi monitorimin e kontratës së qirasë me palët MZHETS dhe Shoqëria "U..", me afat 20 vite.

Me shkresën nr. 2161/2 prot., datë 21.08.2023, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në MM, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura ka dërguar informacionin dhe monitorimin e kryer gjatë vitit 2023.

- Me Aktmonitorimin nr.1 "Mbi monitorimin e kontratës së qirasë nr.1034 rep.nr.166 kol, datë 23.02.2016 nga OJF "Qendra U.", të datës 11.01.2023, Komisioni i Monitorimit në Repartin Ushtarak nr.6630 i përbërë nga z. B. K., znj. A. B. dhe z. J. L., si dhe Drejtori Ekzekutiv i OJF "Qendra U.", znj. A. A. është kryer monitorimi mbi numrin e punonjësve, investimeve të kryera, si dhe kushteve të kontratës. Në zbatim të pikës 5.4 të kontratës, OJF "Qendra U.", ka kryer investime në vlerën totale prej 22,651,435 lekë pa TVSh nga momenti i marrjes për shfrytëzimin e objektit, për të cilat. Gjithashtu, kjo shoqëri ka 10 punonjës, bazuar në kushtet e kontratës.

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit rezultoi se për kontratat me sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>, për institucionin e Ministrisë së Mbrojtjes, monitorimi është detyrë e Institucioneve të varësisë (*Komanda Mbështetëse; Komanda e Forcës Ajrore; Komanda e Forcave Detare; Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura*), të cilat referuar VKM-së nr.54, datë 05.02.2014, i ndryshuar, kanë detyrimin ligjor të kryerjes së monitorimit të vazhdueshëm për të gjitha objektet dhe pasuritë që kanë në pronësi dhe rezultojnë me statusin të dhëna me qira ose enfiletozë.

Nga verifikimi i të dhënave, Grupi i Auditimit konstaton se, Njësitë Monitoruese në Ministrinë e Mbrojtjes të cilat kanë në administrim pasuritë shtetërore duhet të kishin hartuar për secilën objekt/pasuri një kartelë të veçantë e cila duhet të jetë e inventarizuar me të dhënat përkatëse që nga momenti i lidhjes së kontratës ose VKM-të për kontratat të tipit me qira simbolike 1 euro, me ndryshimet e ndodhura gjatë periudhave.

Në këto kartela të shoqëruara për secilën kontratë të jenë të pasqyruara dhe të inventarizuara me procesverbalet përkatëse me dorëzimet e objekteve/pasurive shtetërore ku të përshkruhen gjendja fizike e pronës si dhe vlera kontabël përkatëse e raportuar në pasqyrat financiare.

Gjithashtu në rend kronologjik duhet të jenë të përshkruara qartë dhe të hartuara sipas afateve

(6-mujore) të përfshira në kartelat përkatëse të pronës së dhënë me qira akt-monitorimet detyruese, bashkë me raportet e hollësishme për ecurinë e tyre, referuar VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VI, pika “c” ku citohet se: “ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse”.

Për rrjedhojë krijimi i kartelave të veçanta dhe të inventarizuara për çdo pasuri shtetërore të dhënë me qira nga ana e Njësive të Monitorimit të pronës në Ministrinë e Mbrojtjes, përbën detyrim ligjor si edhe është e shoqëruar me rritjen e efektivitetit në monitorimin e tyre në vijueshmëri.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mbi krijimin e kartelave të veçanta për secilën kontratë qiraje për pronat dhe asetet e Ministrisë së Mbrojtjes me shoqëritë private.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kontratave të qirasë për pronat me sipërfaqe mbi 200 m2, u konstatua se nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Pronave dhe Njësitet Monitoruese në Ministrinë e Mbrojtjes të cilat kanë në administrim pasuritë shtetërore nuk janë marrë masat e nevojshme për krijimin e kartelave të veçanta për secilën pronë të dhënë me qira, e cila duhet të jetë e inventarizuar me të dhënat përkatëse që nga momenti i lidhjes së kontratës me ndryshimet e ndodhura gjatë periudhave. Gjithashtu, grupi i auditimit konstatoi mangësi në dokumentacionin përkatës në rend kronologjik si akt-monitorimet, sëbashku me raportet e hollësishme për ecurinë e tyre, procesverbalet përkatëse me dorëzimet e objekteve/pasurive shtetërore ku përshkruhet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël përkatëse e raportuar në pasqyrat financiare, duke shkaktuar mungesë të gjurmës së auditimit. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VI, pika “c” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19.
<b>Kriteri:</b>	VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VI, pika “c” ku citohet se: “ndjek në vijueshmëri respektimin e kushteve të kontratave të qirasë ose të enfiteozës dhe çdo 6 (gjashtë) muaj harton akte rakordimi me subjektet qiramarrëse ose enfiteozëmarrëse”. Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19.
<b>Efektí/Ndikimi:</b>	Mangësi në dokumentacionet për çdo pronë dhe aset të dhënë me qira, si edhe mungesë e gjurmës së auditimit.
<b>Shkaku:</b>	Nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Pronave nuk janë marrë masat e nevojshme për të krijuar kartela të veçanta për secilën pronë të dhënë me qira.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga ana e Drejtorisë së Mirëadministrimit të Pronave në bashkëpunim me Strukturat Përgjegjëse, të merren masat e nevojshme për krijimin e kartelave të veçanta për secilën pronë ose aset të dhënë me qira, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit në funksion të rritjes së efektivitetit në

## 2.4 Auditimi i llogarive vjetore.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë

1. Formati 1: Pasqyra e pozicionit financiar;
2. Formati 2: Pasqyra e performancës financiare, ose pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve;
3. Formati 3: Pasqyra e flukseve monetare;
4. Formati 4: Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto;
5. Formati 5: Shënimet shpjeguese për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;
6. Formati 6: Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit të tyre;
7. Formati 7: Pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike dhe me vlerën neto (si dhe regjistri i aktiveve);
8. Formati 8: Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondi i pagave.

### a. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit.

Struktura e llogarive është hartuar mbi bazën e Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022.

Auditimi në drejtim të mbajtjes së kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare u përqendrua në vlerësimin e saktësisë dhe përputhshmërisë ligjore të veprimeve ekonomiko-financiare dhe të dokumentimit të transaksioneve financiare të realizuara gjatë periudhës objekt auditimi, si dhe në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi, përjashtuar disa mangësi të trajtuara në vijimësi.

Auditimi u krye në lidhje me dy drejtimet e mëposhtme: mbi afatin ligjor të përcaktuar për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe në vlerësimin e rregullshmërisë dhe saktësisë së llogarive dhe të pozicioneve të bilancit për çdo vit, si dhe kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve në ditarin e përgjithshëm (ku janë regjistruar dhe veprimet e bankës), konform udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Për çdo vit të veçantë të periudhës objekt auditimi, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kërkesave të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, me Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022, pasqyrat financiare janë përpiluar dhe dërguar në afat për miratim në Degën e Thesarit Tiranë.

Rezulton se, veprimet kontabël janë azhurnuar periodikisht, janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e dispozitave në fuqi. Llogaritë vjetore, si dhe pasqyrat financiare janë të shoqëruara me situacionin e shpenzimeve të programit dhe ato të realizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, situacione këto të rakorduara me degën e Thesarit.

PF është shoqëruar me relacionin shpjegues, sipas udhëzimit të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE), me situacionin përfundimtar të shpenzimeve si dhe llogaridhënien vjetore.

Në bazë të të dhënave kontabël përkatëse janë përpiluar Pasqyrat e llogaridhënies vjetore mbi llogaritë e vitit ushtrimor që janë raportuar.



- për vitin 2021 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën me shkresën nr.1563/1, datë 28.03.2022 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2021”  
 - për vitin 2022 janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit Tiranë me shkresën nr. 1985, datë 03.04.2023 “Dërgimi i pasqyrave financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022” duke respektuar afatet ligjore.

Sa sipër ka gjetur zbatim paragrafi 117, i Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, që përcakton se:

“Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit, një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë, dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikave të rrethit”.

Nga ana tjetër, situacionet progresive vjetore janë rakorduar dhe kundër-firmuar rregullisht nga përfaqësuesi i Degës së Thesarit. Realizimi i buxhetit i është raportuar rregullisht Degës së Thesarit.

**b. Saktësia dhe rregullshmëria e pasqyrave financiare vjetore individuale dhe të konsoliduara.**

**Auditimi i llogarive performancës financiare**

Nga auditimi i gjendjes së llogarive rezultoi se, evidentimi, kontabilizimi dhe dokumentimi i tyre është kryer konfirmo rregullave. Rakordimi dhe kuadrimi është bërë si për llogaritë sintetike dhe ato analitike.

Totali i ardhurave të funksionimit në “Pasqyrën e Përformancës” është i barabartë me totalin e shpenzimeve vjetore plus rezultatin e ushtrimit (formati nr.2).

Për vitin 2022 paraqiten si më poshtë vijon:

i. Të ardhurat (grupi A, pasqyra F2) = 1,454,427 milionë lekë

ii. Shpenzimet (grupi B, kolona 74 e F2) = 1,469,261 milionë lekë

iii. Rezultati i ushtrimit (llog.85) = 14,834 milionë lekë

Totali ii + iii = 0 lekë

Nga auditimi i zërave të shpenzimeve rezulton se në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës” është pasqyruar dhe reflektuar ndryshimi i gjendjes së inventarit në vlerën prej 14,834,076 lekë, veprime në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika “Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit”. Llogaria 63 ”Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Shpenzimeve të konstatuara në “Pasqyra e Performancës” për vitin 2022.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i shpenzimeve të konstatuara në “Pasqyra e Performancës” rezultoi: - Mospërputhje të shpenzimeve të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare me rakordimin me degën e thesarit përkatësisht për: - Llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime” për Llogarinë 6024 “Shpenzime udhëtimi”, ku në “Pasqyrën e Përformancës” është pasqyruar në vlerën 52,095,925 lekë, ndërsa me rakordimin me degën e

	<p>thesarit është vlera 50,095,925 lekë me një diferencë më shumë prej 2,000,000 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni.</p> <p>- Llogarinë 605 “Transferime për Organizatat Ndërkombëtare” është pasqyruar në vlerën 418,649,981 lekë, ndërsa me rakordimin me degën e thesarit është vlera 365,999,981 lekë me një diferencë më shumë prej 52,650,000 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni.</p> <p>- Llogarinë 606 “Transferta Paguara nga Institucione tjera e Org. Pushtetit Vendor” është pasqyruar në vlerën 62,070,197 lekë ndërsa me rakordimin me degën e thesarit është vlera 51,309,887 lekë me një diferencë më shumë prej 10,760,310 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni.</p> <p>Shuma e diferencave të konstatuara sa më sipër është në vlerën 65,410,310 lekë.</p> <p>- Nga analiza e zërit 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” pasqyruara në vlerën 118,402,440 lekë, e cila përfaqëson detyrimet që ka MM ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhet në janar 2023, të kryer nga grupi i auditimit konstatohet:</p> <p>Nga MM në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm” pasqyruar në vlerën 57,181,681 lekë janë kredituar vlera prej 1,204,644 lekë, që ka të bëjë me shpenzime të periudhave paraardhëse dhe shpenzime të tjera të konstatuara dhe të cilat do të paguhet në janar të 2023.</p> <p>Diferenca rezultuar mes shpenzimeve të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare me rakordimin me degën e thesarit në shumë prej 65,410,310 lekë, duke i zbritur vlerën e kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm” konstatohet një diferencë në shpenzime me një vlerë prej 9,433,273 lekë, për të cilën ska asnjë informacion në shënimet shpjeguese dhe asnjë informacion se si është bërë verpimet kontabël të mbylljes nga MM.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.1. Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim i saktë i shpenzimeve në “Pasqyra e Performancës”, ka ndikuar në paraqitjen jo të saktë të zërave dhe me gabime materiale në “Pasqyrën e pozicionit financiar” të institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Mospasqyrimi i drejte i llogarive në pasqyrën e “Pasqyra e Performancës”.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	- Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të analizojë diferencat e konstatuara dhe në vijimësi të marrë masat për të argumentuar arsyet e mos akordimit të shpenzimeve të realizuara në një vit ushtrimor me degën e thesarit, me qëllim reflektimin e drejtë të tyre në “Pasqyrën e Performancës”.

### **Analiza e posteve kryesore të pasqyrës së “Pozicionit Financiar”.**

Nga auditimi dhe verifikimi i llogarive të pasqyrës rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit

kuadrojnë me pasqyrat financiare dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar vjetore rezulton se:

- “Aktivet afatgjata” zënë 10% të vlerës totale të aktivitetit, ndërsa “Aktivet Afatshkurtra” zënë 90% të totalit.

### Aktivet qarkulluese

Aktivet Afatshkurtra përbëhet nga shuma e nën rubrikave që përfaqësojnë: mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre, gjendje inventari qarkullues, llogari të arkëtueshme dhe të tjera aktive afatshkurtra.

- Llogaria 520 “Disponibilitete në Thesar”: Sipas UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, Pika 49:

Njësitë të cilat trashëgojnë të ardhura nga një vit ushtrimor në tjetrin, sipas kuadrit ligjor në fuqi, nuk do të kryejnë mbylljen e llogarisë së disponibiliteteve në thesar dhe kjo llogari do të pasqyrohet për tepricën debitorë të saj në aktivet e Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Gjithashtu, llogaria 520 nuk mbyllet edhe për gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466), si dhe për sponsorizimet e tjera të trashëgueshme.

Pasqyrimi në vlerën në vlerën 3,150,920 lekë përfaqëson gjendjen e mjeteve në ruajtje (të evidentuara si të tilla në llogaritë e grupit 466).

Pika 50 e udhëzimit. Tepricat e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të vërtetohen me akt rakordim me thesarin, një kopje e të cilit i bashkëlidhet llogarisë vjetore. Në akt rakordim tepricat duhet të paraqiten të strukturuar sipas natyrës së të ardhurave të trashëguara (të ardhurat e papërdorura, si të çelura ashtu edhe ato të pa çelura, mjetet në ruajtje, sponsorizimet dhe pjesën e grandit që trashëgohet). Në llogaritë vjetore të vitit 2022 ka një akt rakordim me thesarin për “Kreditorët për mjete në ruajtje”, llogari e cila në pozicionin financiar të datës 31.12.2022 reflekton me ulje prej vitit 2021 në vlerën 9,736,855 lekë.

Klasa 3 “Gjendja e inventarit”, në fund të vitit 2022, rezulton në vlerën 18,199,530 lekë. Në krahasim me vitin 2021 është ulur në vlerën 14,834,076 lekë, ku peshën më të madhe e zë ulja e zërit “Materiale”, diferenca e cila është pasqyruar në llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në Formatit nr. 2 “Pasqyra e Performancës”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Regjistrime të gabuara në llogarinë “Materiale”.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Alpha Web” rezultoi se në llogarinë 31 “Materiale”, rezulton se janë regjistruar padrejtësisht si materiale zëra të aktiveve afatgjata materiale në <b>vlerë totale 780,229 leke</b> të tillë si:</p> <p>D.V.D; Mbajtëse muri TV; Grirëse letre 13 flete ( Shredder ) ; Grirëse letre 30 flete ( Shredder ); Elektrogurë (fresibël) 230V /2200w,; Matrapik për thyerje me daltë heksagonale me fuqi 1600 W dhe fuqi goditje 43 J; Matrapik SDS Plus me fuqi 900 W dhe fuqi goditje 3 J; Grirëse letre 5 flete; Trapan elektrik 600w; Bateri 12 II 100AH 16800, Trapan elektrik, Fuqia: 1050 W, Shpejtësia maksimale:3000 RPM: Shkallë alumin me kombinim3 x11me gjatesi7.5 m leke.</p> <p>Gjithashtu rezulton se në llogarinë 32 “Inventari i imët” janë regjistrua si materiale aktiveve afatgjata të tillë si: Pjekëse Buke; Antene satelitore TV; Makine kafe Nespresso (2011); Trapan elektrik (2011); Shkallë alumin me kombinim3 x11me gjatesi7.5 m lek 15600; Hekur hekurosje; Bateri (UPS) për sigurimin e ushqimin për kompjuter; Padijsje ngrohëse zyre; Karrige zyre; Mikrovale etj.</p> <p>Sa më sipër veprime në kundërshtim të Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë</p>

	<p>09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.</p> <p>Gjithashtu konstatohet se gjendja e materialeve në magazinë sipas të dhënave nga “Alpha Web” është në vlerën 11,266,591 lekë ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 1,193,936 lekë me një diferencë prej 10,072,655 lekë.</p> <p>Inventari i imët është në vlerën 16,515,515 lekë ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 3,876,403 lekë me një diferencë në vlerën prej 12,639,112 lekë.</p> <p>Llogaria 35 “Mallra” është pasqyruar në kontabilitet në vlerën 13,129,191 lekë, ndërsa në “Alpha web” është zero.</p> <p>Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Alpha Web” rezultoi se llogari 214, rezulton se janë regjistruar si aktive blerjet për ujë, sheqer, llampa dhe starte <b>në vlerën totale 115,516 lekë</b>, të cilat kanë të bëjnë me mall konsumi dhe duhet të ishin regjistruar në llogarinë 3 “Gjendje Inventari qarkullues”, duke kredituar llogarinë 602 “Mallra e shërbime” dhe debituar llogarinë 31.</p> <p>Diferenca totale “Gjendje inventari qarkullues” e pasqyruara në pasqyrën financiar të MM krahasuar me regjistrimin e tyre në “Alpha Web” është në vlerën 9,582,577 lekë, e cila është e paargumentuar në shënimet shpjeguese të institucionit.</p> <p>Diferenca e konstatuar ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit me ndikim material në rezultatin e vitit ushtrimor, pasi Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është pasqyruar saktë duke sjellë mospasqyrim të saktë të fondeve bazë të institucioneve.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Diferenca e konstatuar ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit me ndikim material në rezultatin e vitit ushtrimor, pasi Llogaria 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” nuk është pasqyruar saktë duke sjellë mospasqyrim të saktë të fondeve bazë të institucioneve.
<b>Shkaku:</b>	Mos kontabilizim i sakte i llogarisë “Materiale”, të trashëguara.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin e vlerave të kontabilizuar në llogarinë 31 “Materiale”, duke kredituar këtë llogari për vlerat të cilat nuk i përkasin dhe debituar llogarinë 21 “Aktive Afatgjata”.</p> <p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që përpara mbylljes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet një rakordim të vlerave të regjistruara në “Alpha Web” dhe atyre që do të raportohet në pasqyra financiare, duke mbajtur një procesverbal midis punonjësit të ngarkuar për kontabilizimin e hyrje daljeve të vlerave materiale dhe Përgjegjësit të Sektorit.</p>

**Pasqyrimi në pozicionin financiar i të drejtave dhe detyrimeve.**

**\* Llogari të arkëtueshme:**

- Llogaritë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” në vlerën 127,844,833 lekë, përbëhet nga detyrimi të personelit, për të cilën nga MM nuk ka asnjë informacion të detajuar.

**\* Situata e Detyrimeve të Prapambetura:**

Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm” është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën 15,991,255 lekë, shifër kjo e njëjtë me atë të një viti më parë. Ajo përbëhet nga:

*Në mijë lekë*

Detyrimet	Punonjës	Vlera e detyrimit
Vendime të MM përpara vitit 2000	38	2,107
Vendime të KLSH 1998	138	4,810
Vendime të KLSH 2005	62	2,412
Vendime të MM 19 99-2003	6	3,261
Vendime të MM nga vitet 1995-1999	5	90
Vendime të KLSH 1995-1998	13	3,104
Vendime të KLSH 1998 ne euro te konv	5	207
<b>Total</b>	<b>267</b>	<b>15,991</b>

- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, në vlerën 1,204,644 lekë për shpenzime:

*Lekë*

Subjekti	31.12.2022
A.T. A. T.	108,580
F. SHPK	112,320
X. S.	864,000
2S.	119,744
<b>Totali</b>	<b>1,204,644</b>

Nga bilanci i printuar nga Sistemi i thesarit konstatohet se kjo llogari është në shumën prej 1,374,960 lekë me një diferencë më shumë në vlerën 170,916 lekë e paargumentuar në shënimet shpjeguese.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.
<b>Situata:</b>	<p>- Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre ne kontabilitet rezultoi se shumica e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Kjo ka sjellë mospasqyrim të drejtë të llogarive ne pasqyrën e “Pozicionit financiar”.</p> <p>- Nga Pasqyrat financiare të printuar nga Sistemi i thesarit konstatohet se Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në shumën prej 1,374,960 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën 170,916 lekë e paargumentuar në shënimet shpjeguese.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 61, Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42.

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos njohja e detyrimeve në momentin e konstatimit të tyre, po në momentin që likuidohen.
<b>Shkaku:</b>	Mospasqyrimi i drejte i llogarive ne pasqyrën e “ <i>Pozicionit financiar</i> ”.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	- Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të merren masa në vijimësi për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin. - Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësore të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

- Llogaria 437-438 “*Organizma të tjere shtetërorë*” paraqitet në vlerën 759,129,156 lekë dhe përfaqëson detyrimet e Përfaqësuesve Ushtarak.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Shpenzimeve financiare për Atashetë Ushtarak & Përfaqësuesit Ushtarak (AU & PU).
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i kartelave të detyrimeve të Përfaqësuesve Ushtarak në 31.12.2022 rezulton në vlerën 915,753,741 lekë, ndërsa në llogarinë 437-438 “ <i>Organizma të tjera shtetërorë</i> ” paraqitet në vlerën 759,129,156 lekë me një diferencë prej 156,624 mijë lekë. - Nga auditimi i kartelave të detyrimeve në lidhje me “Përfaqësuesit/Atashetë Ushtarak” rezultoi se ka detyrime te pa mbyllura që nga viti 2020. - Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me mbylljen e shpenzimeve të rakorduar nga sektori i financës me Atashetë Ushtarak & Përfaqësuesit Ushtarak (AU & PU) u konstatua se, mbyllja e shpenzimeve bëhej sipas rastit, pa i nënshtruara asnjë lloj rregulli apo kriteri. - Në disa raste rezultoi se mbyllja e shpenzimeve nga AU & PU ishte kryer pas 2 deri ne 3 vjet. - Nga MM, Sektori i Financës pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në rastet kur janë mbajtur procesverbalet e mbylljes dhe dorëzimit të dokumentacionit të shpenzimeve me përfaqësuesit ushtarak nuk është bërë kontabilizimi i mbylljes së detyrimeve në kontabilitet dhe mbyllja e kartelave të detyrimeve.
<b>Kriteri:</b>	Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”; VKM nr. 600, datë 14.09.2022 për “Për trajtimin dhe mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit ushtarak dhe civil të ministrisë së mbrojtjes dhe forcave të armatosura të republikës së Shqipërisë, gjatë kohës që emërohen me detyrë jashtë vendit”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosparaqitja e reale e shpenzimeve të AU & PU të shpenzuara për një periudhë ushtrimore buxhetore, duke ndikuar në paraqitjen jo me vërtetësi të pasqyrave financiare.
<b>Shkaku:</b>	Mosrakordim të fondeve buxhetor të akorduara për AU&PU.

<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Ministria e Mbrojtjes të marrë masat të menjëhershme për nxjerrjen e një urdhri të brendshme në lidhje me mbylljen e shpenzimeve financiare të AU &amp; PU, që çdo vit përpara mbylljes së pasqyrave financiare Atashetë Ushtarak &amp; Përfaqësuesit Ushtarak duhet të paraqesin një deklaratë për shpenzimet e realizuara gjatë vitit ushtrimor të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e skanuar të justifikimit të shpenzimeve, të cilat më pas të dërgohen në rrugë elektronike, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për të reflektuar të gjitha transaksionet dhe ngjarjet në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.</p> <p>- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin e llogarisë 437-438 “Organizma të tjera shtetërorë” në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim përfshirjen e të gjithë shpenzimeve financiare të kryera dhe të rakorduara mes përfaqësueseve/atasheve dhe përfaqësuesit të ministrisë.</p>

Nga auditimi i kartelave dhe disa dosjeve të marra nga grupi i auditimit rezultoi:

Përfaqësuesi Ushtarak në Izmir, A. Xh. ka bërë mbylljet e shpenzimeve në gusht të 2023, për tre vitet 2019 deri me 15.07.2022.

Atsheu Ushtarak në Gjermani, L. Sh. rezultoi se ka shpenzimet e pa mbyllura sipas kartelës në kontabilitet, që nga viti 2021. Ndërsa nga auditimi i dosjes rezulton se, nga përfaqësuesi është mbajtur procesverbali me datë 24.01.2022 për mbylljen e shpenzimeve për periudhën nga data 16.09.2020 deri me 31.12.2021, me një gjendje në llogari prej 27,931 euro.

Procesverbali me datë 03.02.2023 për mbylljen e shpenzimeve për periudhën nga data 01.01.2022 deri me 31.12.2022, me një gjendje në llogari prej 4,137 euro.

Përfaqësues Ushtarak në Spanje, A. M., me procesverbalin e datës 12.09.2023 ka bërë mbylljet në Shtator të 2023 për tre vitet nga data 01.08.2021 deri me 13.07.2023. Sipas kartelës në kontabilitet rezulton me detyrime.

Përfaqësuesi Ushtarak në SHBA, A. B., me procesverbalin e mbajtur me datën 12.02.2021 ka bërë mbylljet e shpenzimeve nga data 01.01.2020 deri me 31.12.2020. Nga auditimi i kartelës rezulton se është i pa mbyllur, me një detyrim prej 98,156 USD.

Përfaqësues Ushtarak në Tampa, J. M. me procesverbali e datës 12.10.2021 ka bërë mbylljet e shpenzimeve nga data 24.08.2020 deri me 08.08.2021, ku në procesverbal është cituar se gjendja është zero. Në kartelën e nxjerrë nga kontabiliteti rezulton me vlerë të pambyllur në shumën prej 241,391 USD.

- Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” paraqitet në vlerën 118,402,440 lekë dhe përfaqëson detyrimet që ka MM ndaj punonjësve për muajin dhjetor 2022, përkatësisht për pagat, për tatim taksa, për sigurime shoqërore dhe sigurime shëndetësore, si dhe vlera e faturave të shpenzimeve të konstatuara në dhjetor, të cilat paguhen në janar 2023. Kjo llogari ka si kundërparti llogaritë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 dhe 467.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i zërave të pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është regjistruar vlera e plotë e llogarisë 467 “Kreditore të ndryshëm” prej 57,181,681 lekë. Duke zbritur vlerën 1,204,644 të Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila ka të bëjë me detyrime të dhjetorit që likuidohen nga “Financim i pritshëm nga buxheti”, diferenca prej 55,977,037 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin

	<p>(<i>të drejta</i>)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.2.</p> <p>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (<i>të drejta</i>)” përfaqëson burime financimi për detyrimet afatshkurtër gjendje (kryesisht të muajit Dhjetor), që sipas Ligjit të Buxhetit mbulohen nga buxheti i vitit pasardhës.</p> <p>Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (<i>të drejta</i>)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit), nga ku debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (<i>të drejta</i>)” dhe kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.</p> <p>Sa më sipër vlera prej 55,977,037 lekë e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (<i>të drejta</i>)”, duhet të ishte debituar në llogarinë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”.</p> <p>Nga pikëpamja e kontabilitetit, regjistrimet për detyrimet e prapambetura duhet të ishte:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Debitohet llogaria përkatëse 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrimet e prapambetura” dhe</li> <li>• Kreditohet llogaria përkatëse 467 “Kreditorë të ndryshëm”.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.1 pika 42 dhe paragrafi 3.2.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrimi i saktë i llogarive në pasqyrën financiare jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, por pa ndikim material në rezultatin e institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Mos pasqyrimi i drejtë i llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.
<b>Rëndësia:</b>	E ulët.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që për detyrimet e krijuara të bëjë veprimin kontabël në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

### ***Aktivet afatgjata***

Në formatin nr. 1 “*Aktivet e Afatgjata*” në vlerën neto prej 117 milionë lekë, janë të pasqyruara sipas zërave më poshtë, “*Aktive Afatgjata jo materiale*” në vlerën neto 0 lekë dhe “*Aktive Afatgjata materiale*” në vlerën neto 105.6 milion lekë dhe “*Investime*” në vlerën 11.3 milion lekë.

- Llogaria 214 “Instalime, Teknike makineri, pajisje”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 427,874 lekë, e cila krahasuar me vitin 2021 nuk ka pësuar ndryshime.

### **Konstatim:**

Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin Alpha Web rezultoi se llogari 214 janë regjistrua si aktive blerjet për ujë, sheqer, llampa dhe starte në vlerën totale 115,516 lekë, të cilat kanë të bëjnë me mall konsumi dhe duhet të ishin regjistruar në llogarinë 3 “Gjendje



Inventari qarkullues” duke kredituar llogarinë 602 “Mallra e shërbime” dhe debituar llogarinë 3, trajtuar më hollësisht 3 “Gjendje Inventari qarkullues”.

- Llogaria 215 “Mjete Transporti” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 8,538,299 lekë.

**Gjatë vitit ka pësuar ndryshime nga “Kalimit kapital pa pagesë”:**

- Rritje në vlerën 1,157,349 lekë të automjetit tip “Toyota” në vlerën 866,671 lekë dhe “Minibus Sprinter” në vlerën 290,677 lekë kalim nga shoqëria “T.A.P.” në MM.

Me Urdhrin me nr. 2154, datë 20.12.2022 prot. me nr. 6599/2 të ministrit është ngritur grupi i marrjes në dorëzim të mjeteve të transportit.

Me datë 20.12.2022 është mbajtur proces-verbal nr. 1, midis përfaqësuesve të MM dhe T..., mbi dorëzimin e automjeteve, me personin e autorizuar nga MM me Urdhrin me nr. 2154, datë 20.12.2022 prot. me nr. 6599/2.

Nga MM është bërë hyrje me FH nr. 1, datë 15.12.2022.

Bashkëlidhur është dhe akt dorëzimi i mjeteve i cili mban datën 29.12.2022.

**Zvogëlimi në vlerën 1,157,349 lekë** të dy automjeteve kaluar tek Presidenca e Republikës.

Me datë 29.12.2022 është mbajtur Akt dorëzimi i mjeteve, midis përfaqësuesve të MM dhe Presidencës së Republikës, mbi dorëzimin e automjetit. Nga MM është bërë dalja me FD 1, datë 29.12.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi në pronësi i automjeteve nga MM në PRSH nuk ka të bashkëngjitur Urdhri për transferimin e aktiveve; Akti i konfirmimit i cili përcillet brenda datës 20 të muajit pas ardhës dhe fletë hyrja.*

- Llogaria 218 “Inventar ekonomik”, paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 96,721,050 lekë. Ky zë ka pësuar ndryshime gjatë vitit si rezultat:

- Blerjeve të realizuara gjatë vitit në vlerën 1,015,992 lekë.

- Kalimit kapital pa pagesë në vlerën prej 21,624,032 lekë.

- Zvogëlim në vlerën në vlerën 6,090,000 lekë.

FH	Data	Subjekti nga ka ardhë aseti	Vlera e mallit
1	28.03.2022	Akshi	4,422,600
10	09.05.2022	AKSHI	13,979,892
18	30.06.2022	Rezervat e Shtetit	24,860
24	22.08.2022	reparti 6630	93,600
25	31.08.2022	AKMC	19,080
35	11.11.2022	AKMC	2,791,200
106	21.12.2022	AKMC	100,800
107	27.12.2022	Reparti 6670	33,000
33	11.10.2022	Ndërrmrrje dekori	156,000
<b>Totali</b>			<b>21,465,012</b>

### **Konstatim:**

Nga kryqëzimi i të dhënave të regjistruar në kontabilitet dhe fletë hyrjeve të mbajtura nga MM rezulton një hyrje në vlerën **159,000 lekë** e pa justifikuar me dokumentacion.

### ***Lëvizja e aktiveve kapitale pa pagesë në 2022, të cilat rezultuan me mungesë dokumentacioni:***

#### **\* Rritja:**

1. Kalim kapitali pa pagesë nga Rezervat e Shtetit më MM të një pajisje frigorifer.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr. 18, datë 30.06.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur asnjë dokumentacion bashkëngjitur, siç janë procesverbali i marrjes në dorëzim, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga Rezervat e shtetit deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

2. Kalim kapitali pa pagesë nga Reparti 6630 në MM të një kasaforte.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr. 24, datë 22.08.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur asnjë dokumentacion, siç janë autorizimi për kalimin kapitali, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga Reparti 6630 deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit si dhe fletë dalja e asietit nga Reparti 6630.*

3. Kalim kapitali pa pagesë nga AKMC në MM të një kompjuter dell.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr. 106, datë 21.12.2022.

*Bashkëngjitur praktikës është urdhri për transferimin pa pagesë të pajisjes si dhe fletë dalja nga subjekti transferues.*

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur procesverbalin e marrjes në dorëzim të mallit, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga AKMC deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

4. Kalim kapitali pa pagesë nga Reparti ushtarak 6670 në MM të rafteve metalike.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr. 107, datë 27.12.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur asnjë dokumentacion, siç janë autorizimi për kalimin kapitali, procesverbalin e marrjes në dorësim të mallit, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga Reparti 6670 deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

5. Kalim kapitali pa pagesë nga AKSHI në MM të një gjeneratori.

Pajisja është bërë hyrje me FH nr. 10, datë 09.05.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur Urdhrin e përbashkët mes MM dhe Akshit, Aktin e dorëzimit, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga AKSHI deri në momentin e daljes nga pronësia. Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

### **Zvogëlimi:**

1. Kalim kapitali pa pagesë nga MM në Reparti ushtarak 6012 të “Tableta Lenov” në vlerën 4,422,600 lekë.

Pajisjet janë bërë hyrje me FH datë 30.03.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion sic është i procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

2. Kalim kapitali pa pagesë nga MM në Reparti ushtarak 6630 të një kasaforte në vlerën 93,600 lekë.

Pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 19, datë 14.10.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion sic është i procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, Autorizimi për tërheqje malli, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MMI deri në momentin e daljes nga pronësia., Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së aseteve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit.*

3. Kalim kapitali pa pagesë nga MM në Reparti ushtarak 5001 të pajisjeve zyre në vlerën 984,600lekë

Pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 22, datë 25.11.2022.

*Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion siç është i*

procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MMI deri në momentin e daljes nga pronësia., Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së asetëve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit dhe fletë hyrja e mallrave në magazinë.

5. Kalim kapitali pa pagesë nga MM në Reparti ushtarak 6680 të pajisjeve zyre në vlerën 589,200 lekë.

Pajisjet janë bërë dalje me FD nr. 23, datë 25.11.2022.

Nga auditimi u konstatua se kalimi nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion siç është i procesverbali i marrjes në dorësim të mallit, kartelën shoqëruese të llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga MMI deri në momentin e daljes nga pronësia., Gjithashtu mungon Akt konfirmimi i njësisë pritëse të marrjes së asetëve dhe të regjistrimit të tyre si kapital të institucionit dhe fletë hyrja e mallrave në magazinë.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Rakordimi i aktiveve afatgjata të raportuara në pasqyrën financiare me ato të regjistruara në programin “Alpha Web”. Kalim kapitali pa pagesë i aktiveve gjatë viteve në nëntë raste.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin Alpha Web rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llogari 215 “Mjete transporti” rezulton në vlerën 26,413,260 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” është në vlerën 29,910,461 lekë me një diferencë më shumë në vlerën prej 3,497,200 lekë.</li> </ul> <p>Sa më sipër nga MM është bërë dalje të mjeteve të transportit për të cilën nuk figuron asnjë dokumentacion mbështetës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre”.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Llogari 218 “Inventar ekonomik” rezulton në vlerën 274,356,666 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” është në vlerën 279,091,542 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën prej 4,734,876 lekë.</li> <li>- Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “Kalim kapitali pa pagesë” u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MM është regjistruar në kontabilitet vlera e kosto historike të tyre; Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivitetit. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin.</li> </ul>
<b>Kriteri:</b>	<p>Udhëzimi i MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.1 pika 42 dhe paragrafi 3.2.</p> <p>Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011, Kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrimi i saktë i llogarive në pasqyrën financiare jep një pamje jo të drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit, ku mungesa e rakordimit të aktiveve të regjistruara në programin “Alfa

	web” me ato të pasqyruara në kontabilitet, ka efekt material në fondet neto të institucionit. Mos llogaritje e vlerës së mbetur të aktivitetit, çon në regjistrimin e vlerës jo reale të aktivitetit. Mos paraqitja e flete hyrjeve ose fletë daljeve si dhe aktit të konfirmimit, lë të hapur ciklin e transferimit të kapitali.
<b>Shkaku:</b>	Mos plotësimi i dokumentacionit shoqërues sipas përcaktimeve ligjore, si dhe mos rakordimi i të dhënave të regjistruara në kontabilitet me ato që pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për verifikimin e diferencave të konstatuara nga rakordimi i të dhënëve të sistemit “Alpha web” dhe atyre të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe më pas të bëjnë korrigjimet dhe sistemimin e domosdoshme, duke bërë që llogaria e aktiveve afatgjata materiale të paraqitet vlera e drejtë dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël. - Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose daljeve, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

- Llogaria 231 “Për Aktive Afatgjata materiale” paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën neto prej 11,345,000 lekë.

Subjekti	Përshkrim	Vlera në lekë
X. S. SHPK	Shpenzime për rritjen e AAM - mjete dhe pajisje të tjera teknik	864,000
A. SH.P.K	Shpenzime për rritjen e AAM - ndërtesa administrative	10,481,000
		<b>11,345,000</b>

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Llogaria 231 “Për Aktive Afatgjata materiale”.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i analitikë i llogarive të “Investimeve”, si dhe nga rakordimi i zërit “Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)” në pasqyrën e flukseve monetare (cash flow) me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” rezultoi se: Akordimi i fondeve buxhetore për llogarinë 231 “Investime” është në vlerën 11,345,000 lekë, vlerë e cila është debituar në llogarinë 231 “Për Aktive Afatgjata materiale”. Ndërsa, vlera prej 1,015,992 lekë, e cila është debituar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” si blerje të krijuara gjatë vitit nuk përputhet me fondet e akorduara për shpenzime kapitale, për të cilën nga MM nuk ka asnjë sqarim në shënimet shpjeguese se nga është marrë ky fond. Kjo vlerë e kontabilizuar ndikon dhe në pasqyrimin jo të drejtë të “Pasqyrës së ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto”. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Udhëzimin e MFE me nr. 5, datë 21.02.2022. duke

	ndikuar në paraqitjen jo të drejtë të pasqyrave financiare të institucionit me ndikim material.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim të saktë të zërave dhe nënzërave në pasqyrën financiare të institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Mos rakordim të fondeve buxhetore.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

### **Pasivet Afatshkurtra**

Nga llogaritë e pasivit për vitin 2022, konstatohet se pasivi përbëhet 100% nga pasive afatshkurtra në vlerën 1,025,725 mijë lekë.

- Llogaria 42 “Personeli dhe llogari të lidhur me to“ në vlerën 45,214,254 lekë, përfaqëson pagat e muajit Dhjetor 2022, që paguhen në janar të vitit 2023.
- Llogaria 431 “Personeli dhe llogari të lidhur me to” në vlerën 4,499,749 lekë përfaqëson tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në janar të vitit 2021.
- Llogaria 435 & 436 “Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore“ përfaqëson kontributin e sigurimit shoqëror në shumën prej 11,215,901 lekë dhe e sigurimit shëndetësor në shumën 1,495,499 lekë të muajit Dhjetor 2022, të cilat paguhen në muajin janar 2023.
- Llogaria 4341 “Te tjera operacione me shtetin (kreditor)” në shumën prej 143,836,088 lekë përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa-arkëtuara nga vitet e mëparshme. Kjo llogari përbëhet nga saldo debitorë të llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” dhe të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.
- Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në shumën prej 3,150,920 lekë përfaqëson 5% e garancisë së mbajtur.

#### ➤ **Pasqyrat financiare të konsoliduara të MM**

Nga auditimi i pasqyrave individuale të njërive shpenzuese rezultoi:

##### • **Forca Tokësore “Reparti 1001”**

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” pasqyruar në vlerën 216,767,673 lekë me një diferencë më pak për shumën 98,199 lekë të paargumentuar.

Nga auditimi i pasqyrës së “Ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto” rezultoi se rritja e e fondit neto për blerje të aktiveve të krijuara me pagesë është pasqyruar në vlerën 452,675,552 lekë, ndërsa në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” është pasqyruar në një vlerë prej **452,773,671 lekë me një diferencë prej 98,199, vlerë e cila për të barazuar aktivin dhe pasivin është zbritur dy herë tek** Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor”.

Gjithashtu në pasqyrën e “Ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto” në llogarinë 109 “Diferenca nga Rivlerësimi i AAGJ(+,-)” në çelje është pasqyruar vlera 20,821,670,939 lekë ndërsa në pasqyrën e “Pozicionit financiar” vlera e periudhës paraardhëse është në vlerën 20,821,567,938 lekë me një diferencë më pak në vlerën prej 103,000 lekë, diferencë e paargumentuar nga institucioni, me ndikim material në pasqyrat financiare të institucionit.

- **Forca Detare “Reparti 2001”**

Nga auditimi i pasqyrës së “Flukseve monetare (cash flow)” rezultoi se pasqyrimi i “Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)” është pasqyruar në vlerën 80,931,733 lekë, e cila nuk përputhet me shumën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit dhe të fondeve të akorduara.

Nga analiza e shpenzimeve për shpenzime kapitale dhe atyre për investime rezulton se kjo shumë rezulton në vlerën:

Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+) 1,056,083,975 lekë

Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente - 960,895,092 lekë

Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+) 71,683,564 lekë

Për detyrime e Investime të viti ushtrimor (-) -60,584,838 lekë

**Totali 106,287,609 lekë**

Ky pasqyrim jo i saktë i llogarive në pasqyrën “Pasqyrën e flukseve monetare (cash flow)” ka ndikim në pasqyrat e konsoliduara të institucionit.

- **Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes “Reparti 5001”**

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor” pasqyruar në vlerën 61,779,830 lekë nga analiza rezulton se shuma e kundërpartive të llogarisë e pasivit 401,421, 431, 435, 436 është në vlerën 64,986,803 lekë. Vlera e llogarisë 467 është në shumën prej 3,621,396 lekë.

Në llogarinë 468 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është debituar për shumën 6,828,369 lekë, për të cilën është kredituar llogaria 467 në shumë 3,621,396 lekë, ndërsa diferenca prej 3,206,973 lekë është debituar po në llogarinë 4342 “Të tjera operacione me shtetit debitor”, veprime në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, duke sjellë ndikim me gabim material në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën prej 3.206,973 lekë si dhe pasqyrim jo të drejtë të llogarisë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

- **Komanda Mbështetëse “Reparti 4001”**

Nga auditimi i “Pasqyrës së flukseve monetare (cash flow)” rezultoi se për vitin 2022 janë likuiduar për investime shuma prej 222,600,924 lekë dhe 2,206,200 lekë nga “Pjesëmarrje në kapitalin e vet(-)” në total 224,807,124 lekë.

Shuma e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, blerjet e krijuara me pagesë janë pasqyruar në vlerën 234,778,280 lekë dhe llogaria 231 “Investime” në vlerën 5,128,632 lekë është e pandryshuar nga viti paraardhës.

Sa më sipër diferenca prej **9,971,156 lekë** e pasqyruar më tepër në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është e pargumentuar se me ca fondesh janë blerë, veprim i cili ka sjell pasqyrimin jo të saktë të fondeve neto të institucionit me ndikim material.

Nga auditimi i “Pasqyrës së flukseve monetare (cash flow)” rezultoi se për vitin 2022;

Te hyra nga ardhurat jotatimore (+) është në vlerën 5,038,423 leke dhe “Derdhje e Transferime të te Ardhurave në Buxhet (-)” është në vlerën 4979422 lekë me një diferencë 59,001 lekë.

Ndryshimi i Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në pasqyrën e pozicionit financiar pasqyrohet në vlerën 8,686,119 lekë.

466	Kreditorë për mjete në ruajtje	36,602,647	27,916,528
-----	--------------------------------	------------	------------

Ndërsa në pasqyrën e cash flow ndryshimi është i barabartë:

-Të hyra nga Mjetet në ruajtje (+) në vlerën 9,331,850 lekë

- Pagesat për mjetet në ruajtje (-) -704,732 lekë

**Shtesë 8,627,118 lekë**

Diferenca e pasqyruar gabim në pasqyrën e pozicionit financiar prej 59,001 lekë, e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 520 “Disponibilitete ne Thesar” dhe vlera e 466 me 31.12.2022 duhet të ishte pasqyruar në shumën prej 36,543,646 lekë.

Nga auditimi i pasqyrës së “Pozicionit financiar” në llogarinë 106 “Teprica e Granteve kapitale te Huaja” paraqite me tepricë në fund të vitit në vlerën 1,091,730,717 lekë.

Llogaritë 106 “Teprica e Granteve kapitale te Huaja” mbeten me tepricë në fund të periudhave ushtrimore vetëm në rastet kur këto grante janë burim për investimet në proces për institucionin (të papërfunduara ose të pamarra në dorëzim), të cilat në aktiv të bilancit këto janë investime në proces në grupin e llogarive 23.

**Nga institucioni kjo vlerë nuk është pasqyruar në llogarinë 23 “Investime”, por është pasqyruar si rritje aktive në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”**, si shtesa pa pagesë jashtë sistemi veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, llogaria 23 “Investime” (në proces);

Gjithashtu në pasqyrën e “Ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto” kjo vlerë është pasqyruar gjendje në shumën **1,046,424,196 lekë me një diferencë më pak prej 45,306,521 lekë**, duke sjellë mosrakordim të pasqyrave me njëra tjetrën me ndikimin material në pasurat financiare të institucionit.

- **Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes “Reparti 5001”**

Nga auditimi i “Pasqyrës së flukseve monetare (cash flow)” rezultoi se për vitin 2022 janë likuiduar për investime shuma prej 65,984,858 lekë.

Shuma e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, blerjet e krijuara me pagesë janë pasqyruar në vlerën 79,969,729 lekë.

Llogaria 231 “Investime” është zvogëluar në vlerën 14,887,435 lekë duke debituar në llogarinë 21 “Aktive Afatgjata material”.

Rritja totale e rritjes së aktiveve duhet të ishte në shumën 80,872,293 lekë.

Sa më sipër diferenca prej 902,564 lekë nuk është pasqyruar në “Gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, me ndikim material në pasqyrën e pozicionit financiar.

- **Policia Ushtarake “Reparti 6620”**

Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, blerjet e krijuara me pagesë janë pasqyruar në vlerën **2,139,240 lekë**.

Në “Pasqyrën e flukseve monetare (cash flow)” vlera për investime është zero, gjithashtu dhe ndryshimi i llogarisë 23 “Investime” është zero.

Sa më sipër vlera prej **2,139,240 lekë** e pasqyruar më tepër në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është e paargumentuar se me ca fondesh janë blerë, veprim i cili ka sjell pasqyrimin jo të saktë të fondeve neto të institucionit me ndikim material.

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 58,244,890 lekë, nga institucioni nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- **ASNI “Reparti 6640”**

Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, blerjet e krijuara me pagesë janë pasqyruar në vlerën 97,957,792 lekë.

Në “Pasqyrën e flukseve monetare (cash flow)” vlera për investime është 88,902,480 lekë.

Sa më sipër vlera prej 9,055,312 lekë e pasqyruar më tepër në pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është e paargumentuar se me ca fondesh janë blerë, veprim i cili ka sjellë pasqyrimin jo të saktë të fondeve neto të institucionit me ndikim material.

- **Qendra e Personel Rekrutimit “Reparti 6670”**

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e aktiveve në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 2,014,215 lekë, nga institucioni është llogaritur amortizimi i akumuluar në vlerën 5,812,794 lekë, në një diferencë më tepër 3,798,579 lekë me ndikim material në fondet neto të institucionit.

- **QNOD**

Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, janë pasqyruar transferime pa pagesë të llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 4,014,360 lekë dhe 215 “Mjete transporti” në vlerën 400,000 lekë

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e këtyre aktiveve nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kosto historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

Nga kryqëzimi i të dhënave të pasqyrës së cash flow me pasqyrën e performancës rezultoi se për vitin 2022:

Nga Buxheti për NJQP(Qendrore) është në vlerën 24,238,995 lekë.

Financim i pritshe nga buxheti për mbulimin e shpenzimeve të konstatuara në 2021 që paguhen në janar të 2022 është në shumën 1,992,312 lekë.

Në total në vlerën 26,231,307 lekë.

Sipas pasqyrës së cash flow rezulton se fondet e përdorura nga Institucioni janë:

Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korente (+) 26,471,300 lekë

Pagesa për Detyrime e Shpenzime korente -26,448,953 lekë

Transferime ne buxhet të Fondeve të pa përdorura (-) 22,347 lekë.

Total fonde të akorduara të pasqyruar në pasqyrën e performancës duhet të ishte në vlerën 26,448,953 lekë.

Sa më sipër nga institucioni është pasqyruar më pak për vlerën 217,646 lekë me ndikim material në pasqyrën e pozicionit financiar.

- **DPRMSH**

Në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, janë pasqyruar transferime pa pagesë në vlerën 125,554,212 lekë.

Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezultoi se për pakësimet e këtyre aktiveve nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kosto historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit dhe me ndikim material në fondin neto të institucionit.

**Nga auditimi i pasqyrës “Cash flow” konstatohet se:**

Te hyra nga Mjetet ne ruajtje (+) është në vlerën 953,120 lekë

Pagesat për mjetet ne ruajtje (-) -280,538 lekë

Diferenca është 672,582 lekë.

Ndryshimi i Llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në pozicionin financiar është pasqyruar në vlerën 749,634 lekë dhe jo sa është pasqyruar në pasqyrën e cash flow 672,582 lekë, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë dhe me gabime materiale të pozicionit financiar të institucionit.



Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore (+) janë pasqyruar në vlerën 1,307,075 lekë

Te hyra nga ardhurat jotatimore (+) 5,595,540 lekë

Te tjera, arkëtuar (+) 708,857 lekë

**Në total 7,611,472 lekë**

- Tatime te paguara (-) 1,230,023 lekë

Derdhje e Transferime të të Ardhurave në Buxhet (-) është pasqyruar në vlerën 6,304,397 lekë. Ndërsa vlera që duhet të pasqyrohet duhet të ishte në shumën 6,381,449 lekë, me një diferencë më pak në vlerën 77,652 lekë.

Sa më sipër vlera 77,652 lekë nga subjekti është kredituar në llogarinë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

- **AKMC**

Nga auditimi i pasqyrës së “Ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto” rezultoi se:

Të hyra nga sipas pasqyrës 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga jashtë sistemi janë ne vlerën 68,121,111 lekë dhe pakësime në vlerën 18,712,361 lekë.

Nga institucioni janë pasqyruar në pasqyrës e “Ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto”;

Nga grantet e brendshme kapitale (+) në vlerën 120,908,168 lekë.

“Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)” në vlerën 124,556,034 lekë e cila është ë paargumentuar.

Gjithashtu në zërin “Nga konsumi i AAGJ (-)” nga institucioni është pasqyruar vlera 0 lekë, ku sipas pasqyrës 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” rezulton në vlerën (50,890,250) lekë.

Sipas pasqyrës së pozicionit financiar dhe cash flow vlera “Nga grantet e brendshme kapitale(+)” duhet të ishte pasqyruar në vlerën 85,855,988 lekë.

Nga shtesa dhe pakësime të realizuara gjatë vitit duhet të të ishte pasqyruar në shumën prej 49,408,750 lekë.

Pra sa më sipër “Totali i Fondeve te veta” nuk është pasqyruar saktë, e cila ka gabime material të cilat ndikojnë në pasqyrimin jo të drejte të pozicionit financiar të institucionit me një diferencë prej (42,888,859) lekë.

**Konstatim:**

**Nga lëvizja e aktiveve të institucioneve në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” konstatohet se:**

**Repartin 3001** është bërë nxjerrje jashtë përdorimi të “Ndërtime e Konstruksione” në vlerën 1,875,000 lekë, ku nga subjekti është dhënë vetëm një sqarim që është bërë bazuar në procesverbalin nr. 4 datë 13.04.2011 në repartin 3005 Kuçovë.

Bashkëngjitur nuk na është vënë ndonjë dokumentacion se si është bërë vlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimi i kësaj prone që nga viti 2011 dhe pasqyruar në kontabilitet në 2022.

Sa më sipër veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, përkatësisht:

**Pika 95**

“Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi është një proces që kryhet gjate ose pas procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale”.

**Pika 101**

*“Për vlerësimin dhe nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve afatgjata me rendësi të veçantë për institucionin, komisioni i vlerësimit dhe komisioni i nxjerrjes nga përdorimi përbëhen nga jo më pak se 7 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht dy specialistë të lartë të fushës.. Kur këto specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore”.*

**Pika 118**

*“Nxjerrja nga përdorimi e ndërtesave ekonomike dhe administrative, aktiveve financiare në formën e pjesëmarrjes në kapital, aktiveve afatgjata jomateriale si koncesione, patenta, licenca; rezervat shtetërore; terrenet dhe aktivet natyrore bëhet sipas dispozitave të veçanta ligjore në fuqi”.*

**Në Repartin 5001:**

Me urdhër të MM nr. 194 datë 23.02.2022 është bërë kalimi “Ndërtime e Konstruksione” nga Reparti 6630 në Repartin 5001.

Në pasqyrën e repartit 5001 është pasqyruar vlera 12,356,003 lekë, ndërsa në pasqyrën e “Repartit 6630” është pasqyruar në vlerën 13,455,987 lekë me një diferencë në vlerën 1,099,984 lekë të paargumentuar.

Në “Repartin 5001” është bërë dalje “Ndërtime e Konstruksione” në vlerën 168,423 lekë citon vetëm dalje për sistemim veprimi pa argumentuar se ku është mbështetur kjo lëvizje.

**Repartin 4001 me urdhrin e MM nr. 60 datë 18.11.2021** është bërë dalje brenda sistemit të “Ndërtime e Konstruksione” në vlerën 86,803,250.

**Repartin 6604** bazuar në urdhrin e MM me nr. 60, datë 18.11.2021 është bërë shtesë “Ndërtime e Konstruksione” në vlerën 52,657,246 lekë nga përthithja e aktivitetit, si dhe vlera 1,089,370 lekë shtesë në “Toka, troje, terrene” në total në vlerën 53,746,616 lekë.

Diferenca (86,803,250 - 53,746,616 = **33,056,634 lekë**) e transferimit sipas Urdhrit nr. 60 datë 18.11.2021 bazuar në ristrukturim nuk është sqaruar se nga cila njësi është përthithur.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Pasqyrat financiare të konsoliduara.
<b>Situata:</b>	<p>Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022, u konstatua:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Diferenca të vlerave të pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga blerjet e krijuara dhe me vlerat në llogarinë 231 “Investime” të pasqyruar në pasqyrën e “Pozicionit Financiar”.</li> <li>- Zëri “Transferime në buxhet të Fondeve të pa përdorura(-)” në pasqyrën e “Flukseve monetare (cash flow)” nuk përputhet me shumën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit dhe të fondeve të akorduara.</li> <li>- Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” për pakësimet e aktiveve si rezultat i transferimeve apo nxjerrjes jashtë përdorimi për disa njësi vartësie nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e koston historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit, me ndikim material në fondin neto të institucionit.</li> <li>- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit rezultoi se, në rubrikën D “Fondet e konsoliduara nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” në vlerën 1,091,730,717 lekë, përkatësisht në “Repartin 4001”. Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto rezultoi se, nga institucioni kjo vlerë nuk është pasqyruar në llogarinë 23 “Investime”, por është pasqyruar si rritje aktivesh në</li> </ul>

	<p>pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, si shtesa pa pagesë jashtë sistemi, për të cilat janë njohur në momentin fillestar në llogarinë 21, të aktiveve afatgjata dhe është bërë hyrje në institucion.</p> <p>- Ndryshimi i Llogarisë 466 “Kreditore për mjete në ruajtje” në pozicionin financiar nuk përputhet me të hyrat dhe likuidimet e pasqyruara në pasqyrën e cash flow, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë dhe me gabime materialë të pozicionit financiar të institucionit.</p> <p>- “Totali i Fondeve te veta” për disa njësi vartësie nuk është pasqyruar saktë, e cila ka gabime material, të cilat kane ndikuar në pasqyrimin jo të drejte të pozicionit financiar të institucionit me një diferencë.</p> <p>- Nga lëvizja e aktiveve në institucionet e vartësisë në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përkatësisht në Repartin 3001 rezultoi se është bërë reflektimi i nxjerrje jashtë përdorimi të zërit “Ndërtime e Konstruksione” të një prone të vlerësuar për jashtë përdorimi që nga viti 2011, në shënimet shpjeguese nuk ka asnjë sqarim në lidhje si është bërë vlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimi i kësaj prone që nga viti 2011 dhe pasqyruar në kontabilitet në vitin 2022.</p> <p>Nga auditimi i kalimit pa pagesë të aktiveve nga njëri institucion tek tjetri rezultoi mospërputhje të vlerave të pasqyruara, ku përkatësisht: Për kalimin e “Ndërtime e Konstruksione” nga Reparti 6630 në Repartin 5001, sipas urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 194 datë 23.02.2022, u konstatua se në Repartin 5001 është pasqyruar vlera 12,356,003 lekë, ndërsa në pasqyrën e “Repartit 6630” është pasqyruar në vlerën 13,455,987 lekë, me një diferencë në vlerën 1,099,984 lekë të paargumentuar në shënimet shpjeguese.</p> <p>Për daljen brenda sistemit të “Ndërtime e Konstruksione” në vlerën 86,803,250 nga Repartin 4001 dhe shtesë në Repartin 6604 në vlerën 52,657,246 lekë nga përthithja e aktivitetit, si dhe vlera 1,089,370 lekë shtesë në “Toka, troje, terrene” në total në vlerën 53,746,616 lekë bazuar në urdhrin e MM nr. 60 datë 18.11.2021 “Kalim pronësie të aktivitetit bazuar në ristrukturim” u konstatua se: Diferenca (86,803,250 - 53,746,616 = 33,056,634 lekë) e transferimit nuk është sqaruar se nga cila njësi është përthithur.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”;</p> <p>Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar;</p> <p>Neni 62 “Përgatitja e llogarive vjetore të buxhetit” të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos pasqyrim të saktë të zërave dhe nënzërave në pasqyrën financiare të institucionit.
<b>Shkaku:</b>	Mosrakordim të fondeve buxhetore.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat për analizimin e diferencave të konstatuara, si dhe të nxjerrë përgjegjësitë për zyrtarët për mungesat e rakordimit të llogarive të aktiveve.

	Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Sektori i Financës të marrë masat për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korrigjimin e sistemimin e tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.
--	--

**c) Inventarizimi i pronës shtetërore, nxjerrja e rezultateve të inventarizimit dhe sistemimi i diferencave në përputhje me rregullat kontabël**

Auditimi u fokusua në rregullshmërinë e kryerjes së procesit të inventarizimit sipas Udhëzimit nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave të dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar sa më poshtë vijon:

Nga auditimi u konstatua se Ministria e Mbrojtjes nuk ka të dhëna të plota mbi gjendjen fizike dhe vlerën kontabël të pronave në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, neni 26 ku citohet: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësoj një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike që siguron të ardhur ...” dhe neni 31, citohet “ ...për objektet e dhëna me qira – sipërfaqja e objektit në m<sup>2</sup>, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës...”.

Nisur nga rëndësia dhe materialiteti sasior dhe në natyrë të aspekteve të menaxhimit material dhe mundësisë për veprime të pajustificuara, ky aspekt është audituar shtrirë për periudhën 2021-2022.

Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i praktikave dokumentuara të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, ka rezultuar se, për periudhën objekt auditimi, është realizuar procesi i inventarizimit për vitin 2021-2022, sipas parashikuar në Paragrafi nr. 74, i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar që sanksionin se:

“Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës.”
---

Hyrja e aktiveve në përgjithësi është dokumentuar me fletë hyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre, konform pikës 37, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik". Dalja e aktiveve në përgjithësi është realizuar konform pikës 38, të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

**Më konkretisht:**

**Për vitin 2021:**

**a) Inventarizimi fizik**

Në urdhrin e Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 998 prot., 1121/1, datë 21.07.2021 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve” në pikën 2 të urdhrin citohet se afati i kryerjes së inventarizimit është nga data 01.07.2021 deri me datën 30.11.2022.

Para fillimit të inventarit, me datën 01.11.2021 nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljes nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit.

Nga komisioni është filluar procesi i inventarizimit me datën 03.09.2021, **ndërsa procesverbali**

*të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit është bërë me datën 01.11.2021, veprime në kundërshtim me përcaktimet e paragrafit 82, të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.*

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkuara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Në fund të procesit të inventarizimit, nga komisioni është përgatitur informacion përmbledhës mbi inventarizimin, në të cilën citohet se procesi i inventarizimit ka filluar me datën 03.09.2021 dhe ka përfunduar me datën 27.11.2021, si dhe nga inventarizimi fizik i aktiveve nuk kanë rezultuar diferenca dhe vlera totale e aktive paraqitet në shumën 150,522,254 lekë.

**Konstatim:**

Nga auditimi i pasqyrës 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( kosto historike)” rezulton se vlera e AQT të institucionit është **294,145,210 lekë pra me një diferencë më shumë** në vlerën 143,622,956 lekë, për të cilën nuk ka asnjë argument dhe sqarim në informacionin përmbledhës të komisionit.

Nga auditimi i kartelave të AU&PU u konstatua se vlera totale e aktiveve që kanë në administrim është në shumën 78,274,364.10 lekë, vlerë për të cilën nga komisioni nuk është shprehur në raport.

Nga zbritja e vlerës së aktiveve nga AU&PU rezulton përsëri një diferencë e paargumentuar në shumën prej 65,348,591 lekë.

Gjithashtu në informacionin përmbledhës nga komisioni i inventarizimit nuk është shprehur për gjendjen e aktiveve në përdorimi, si dhe për vlerat materiale, (për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike), ku së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit duhet dorëzuar tek nëpunësi autorizues për veprime të mëtejshme, veprime në kundërshtim me paragrafin 85/c të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

*b) Vlerësimi i aktiveve*

Me Urdhrin nr. 320 datë 05.03.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm është ngritur komisioni “Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve materiale afatgjata”, ku në pikën 1 dhe 2 të urdhrin janë përcaktuar komisionet për vlerësimin e aktiveve në inventar të MM që do të propozohen për jashtë përdorimi dhe në pikën 3 është përcaktuar komision për nxjerrjen jashtë përdorimi.

Me anë të shkresës nr.1212 prot., datë 07.07.2021 komisioni i vlerësimin të aktiveve ka mbajtur relacionin mbi përfundimin e procedurës së vlerësimin për nxjerrjen nga përdorimi ose tjetërsimin e aktiveve të MM, ku kanë evidentuar listën e aktiveve (27) jashtë përdorimi për llogarinë për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 3,906,698 lekë, të cilat kryesisht janë laptop kompjuter, fotokopje, video projektor dhe kamera etj.

Në fund të procesit të vlerësimin, komisioni i vlerësimin për aktivet e institucionit ka mbajtur procesverbalet nga nr. 24-80 të datës 17.06.2021, për secilin aktiv të vlerësuar të dëmtuar dhe jashtë përdorimi, ku janë përcaktuar shkaqet e daljes jashtë përdorimi të këtyre aktiveve, vlera e mbetur e tyre pas amortizimit të akumuluar, si dhe kriterin mbi bazën e të cilit është bërë vlerësimi i aktiveve, veprime në përputhje me paragrafin 102-105 të UMF nr. 30/2011, i ndryshuar.

Pra sa më sipër ka një mospërputhje të listës së aktiveve vlerësuar për jashtë përdorimi me procesverbalet e mbajtura nga komisioni për rreth 56 aktive.

Me shkresën nr. 4276/2 datë 27.07.2021 është dërguar dokumentacioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve në pronësi të Forcave të Armatosura reparti 6001, të cilat janë kontabilizuar dhe pasqyruar si ndryshime në kontabilitetin e kësaj njësie.

Nga komisioni janë evidentuar dhe pajisje zyre të dëmtuara dhe të dala jashtë përdorimi për të

cilat janë mbajtur procesverbalet me nr. 1-19 dhe nr. 81-86 me një vlerë totale 1,719,317 lekë. Totali i AQT-ve vlerësuar për jashtë përdorimi sipas procesverbaleve të mbajtura nga komisioni paraqitet në shumën 6,830,594 lekë.

Me shkresën nr. 4373/1, datë 17.09.2021 është dërguar dokumentacioni për nxjerrjen jashtë përdorimi të aktiveve Repartit Ushtarak 6640 bazuar në urdhrin nr. 1 datë 12.01.2017 “Për trajtimin e mbetjeve nga pajisjet elektronike, pas heqjes nga përdorimi të Forcave të Armatosura”.

Nga auditimi i pasqyrës 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( kosto historike)” të MM për vitin 2021 nuk është vënë asnjë vlerë për nxjerrje jashtë përdorimi.

Gjithashtu tek kolona “Pakësime të tjera” është kontabilizuar vlera **85,231,318 lekë**.

Nga auditimi i fletë daljeve të mbajtura nga institucioni për vitin 2021 vlera e aktiveve të dala nga institucioni shoqëruar me dokumentacion është në shumën 17,493,024 lekë.

Duke shtuar dhe vlerën e aktiveve të dërguara në ASNI për asgjësimin e tyre në vlerën 6,830,594 lekë, në total për vitin 2021 pakësim të AQT-ve është në vlerën 24,323,618 lekë.

Diferenca e pakësimit në **vlerën 60,907,700 lekë**, e cila është pasqyruar në kontabilitet në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( kosto historike)” është e paargumentuar dhe e pa dokumentuar nga institucioni, vlerë e cila ka ndikim material në fondet neto të tij.

### **Për vitin 2022:**

#### *a) Inventarizimi fizik*

Në urdhrin e Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 1032, datë 04.07.2022 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve”.

Para fillimit të inventari, nga komisioni i inventarizimit është mbajtur procesverbal, ku është fiksuar numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit bazuar në përcaktimet e paragrafit 82, të UMFE nr. 30/2011, i ndryshuar.

Komisioni është bazuar në të dhënat e regjistrit kontabël për kryerjen e inventarizimit të pasurisë. Për sa më sipër është vepruar në bazë të përcaktimeve të paragrafit nr. 26, të Udhëzimit të MFE me nr. 30/2011.

Në dosje janë depozituar kartelat/ fletët e inventarit të çdo punonjësi, të nënshkruara rregullisht nga komisioni i inventarizimit dhe persona materialisht përgjegjës.

Nga komisioni i inventarizimit në fund të procesit ka përgatitur informacion mbi inventarizimin, në të cilën shprehen se procesi i inventarizimit ka filluar me datën 04.07.2022 dhe ka përfunduar me datën 30.11.2022, si dhe nga inventarizimi fizik i aktiveve nuk ka rezultuar diferenca dhe vlera totale e aktive është në shumën 182,214,133 lekë.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Diferencat e konstatuara nga rakordimi i vlerave të pasqyruara në pasqyrat financiare me ato të relatuara dhe raportuara nga komisioni i inventarizimit.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i procedurës së inventarizimit u konstatua se Komisioni i inventarizimit i ngritur me Urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 1032, datë 04.07.2022 “Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve” ka kryer procesin e inventarizimit për vitin 2022, ku në procesverbalin e mbajtur është shprehur se në fund të procesit nuk ka rezultuar diferenca dhe vlera totale e aktive është në shumën 182,214,133 lekë. Nga auditimi i pasqyrës 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( kosto historike)” rezulton se vlera e AQT të institucionit është 310,695,234 lekë, ku vetëm “Inventar ekonomik” në fund të vitit 2022 është pasqyruar në vlerën 279,091,542 lekë.

	<p>Nga auditimi i aktiveve në administrim të AU&amp;PU rezultoi se vlera totale e aktiveve që kanë në administrim është në shumën 78,274,364.10 lekë, vlerë për të cilën nga komisioni nuk është shprehur në raport. Nga zbritja e vlerës së aktiveve nga AU&amp;PU rezulton përsëri një diferencë e paargumentuar në shumën prej 50,206,736.90 lekë.</p> <p>- Nga auditimi i lëvizjeve të aktiveve gjatë vitit 2021 rezultoi se: Në pasqyrës 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata( kosto historike)” të MM për vitin 2021 nuk është reflektuar asnjë vlerë për nxjerrje jashtë përdorimi, por vetëm tek kolona “Pakësime të tjera” është pasqyruar vlera <b>prej 85,231,318 lekë</b>.</p> <p>- Nga auditimi i fletë daljeve të mbajtura nga institucioni për vitin 2021 vlera e aktiveve të dala nga institucioni shoqëruar me dokumentacion është në shumën 17,493,024 lekë, si dhe vlera 6,830,594 lekë që janë aktiveve të dërguara në ASNI për asgjësimin e tyre, bazuar në urdhrin me nr. 1, datë 12.01.2017 “Për trajtimin e mbetjeve nga pajisjet elektronike, pas heqjes nga përdorimi të Forcave të Armatosura”, në total në shumën prej 24,323,618 lekë.</p> <p>Diferenca e pakësimit në vlerën 60,907,700 lekë, e cila është pasqyruar në kontabilitet në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është e paargumentuar dhe e pa dokumentuar nga institucioni, vlerë e cila ka ndikim material në fondet neto të institucionit dhe paraqitjen jo të drejtë dhe të saktë të pasqyrave financiare.</p>
<b>Kriteri:</b>	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.
<b>Ndikimi:</b>	Pasqyrat financiare nuk sigurojnë të dhënave të plota dhe nuk paraqesin, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje, në regjistrat kontabël.
<b>Shkaku:</b>	Mungesë veprimesh nga strukturat përgjegjëse.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>- Ministria e Mbrojtjes të marrë masat të menjëhershme për ngritjen e një grupi punë, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit dhe bazuar në rezultatet e dala të marrë masat rast pas rasti, për të kryer sistemimet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korigjimin e sistemimin e tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.</p> <p>- Ministria e Mbrojtjes të marrë masat në vijimësi, që çdo vit përpara mbylljes së pasqyrave financiare, AU &amp; PU duhet të paraqesin inventarizimin e aktiveve nën administrim duke e rakorduar me vlerat e pasqyruara në kontabilitetin e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me qëllim sigurimin e plotësisë, paanësisë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.</p>

## 2.5 Prokurimet me fonde publike.

### Prokurimet e realizuara nga Ministria e Mbrojtjes

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)*”, zhvillimi i procedurës 19.09.2022, në lidhje zhvillimin e procedurës, faza e vlerësimit të ofertave, të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të

fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), si dhe verifikimin e shkresës informuese nr. 1043 prot. Datë 14.11.2022 të Operatorit Ekonomik “N.M.P.” shpk, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)”,2022		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-40512-09-01-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. G. J. 2. E. F. 3. E. T.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. D. K. 3. K. Ll.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 617,945,702 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 500,472,588 lekë Operatori Fitues: BOE “P.G.” sh.p.k & “J.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 117,473,114 lekë ose zbritur 20 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>19/09/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> 243,989,167 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2022, për Akademinë e Forcave të Armatosura dhe vlera prej 373,956,535 lekë pa TVSH, nga fondet e planifikuara/parashikuara në PBA për vitet 2023 – 2025.	<b>9. Operoret Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër <b>14 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>10 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>4 B/</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 15 muaj		

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar në preventivin e përlllogaritur mbështetur në VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”. Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)” Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 19.09.2022 për Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca), Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën 2.3.2/b të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” ( <i>Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta</i> ), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Referuar kërkesës së mësipërme për licensim, konstatohet se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të LPP. Argumentimi nga Njësia e Prokurimit citohet se kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr.



10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*. Nga auditimi në QKB, Aktiviteti i licensimit së **ruajtjes së mbetjeve të ngurta**, ekzistojnë shumë pak operator ekonomik, duke zvogëluar ndjeshëm konkurrencën në procedurë. Ndërkohë, nga auditimi i vlerësimit të ofertave, KVO nuk ka pasqyruar apo cituar se asnjë operator pjesëmarrës nuk e disponon aktivitetin e ruajtjes së mbetjeve të ngurta. Për rrjedhojë të gjithë OE duheshin s’kualifikuar dhe anuluar procedura, për shkak të mospërbushjes të pikës së licensës. Referuar ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, përcakton se Leje mjedisi e tipit “B” është leja e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator. Gjithashtu referuar Vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licensimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, përcakton se Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B, specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme. Pra nga Ak, nuk është argumentuar dhe vendosur jo në përputhje me natyrën e kontratës dhe zërat e punimeve, nënkategoria III.2.B e “ruajtjes së mbetjeve të ngurta”. Në pikën **2.3.2/h** të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të

	pajisjeve sipas relacioneve teknike të punimeve elektrike, mekanike, kondicionimit etj. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. <b>Si konkluzion</b> , për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese.
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 14 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE nga data 19.09.2022 dhe përfunduar datë 01.11.2022, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	BOE “N.M..P.” sh.a., & “Gj.” sh.p.k.	450,502,992	S’Kualifikuar
2	OE A.. K.” sh.p.k	468,790,533	S’Kualifikuar
3	OE “K. C.” sh.p.k	494,051,418	S’ Kualifikuar
4	BOE “P. G.” sh.p.k J.” sh.p.k	<b>500,472,588</b>	Kualifikuar/ Fituesi
5	“A.. K.” sh.p.k	518,961,788	S’Kualifikuar
6	“S.” sh.p.k	519,978,126	S’Kualifikuar
7	BOE “A.-G.” & “N. C.2012”	526,540,501	S’Kualifikuar
8	BOE “A. C.” & “C.” sh.p.k	536,977,910	Kualifikuar
9	BOE “R. C.” & “N.” “U.”	551,545,973	Kualifikuar
10	“D. P.2007” sh.p.k.	567,851,756	S’Kualifikuar
11	“U.” sh.p.k.	607,526,983	Kualifikuar
12	“H..” sh.p.k	615,217,914	S’Kualifikuar
13	“D. J.” sh.p.k	Pa ofertë	S’Kualifikuar
14	“S.” sh.p.k	Pa ofertë	S’Kualifikuar

Referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 4 B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues BOE “P.G.” & “J.” shpk, ka s’kualifikuar 10 B/OE të tjerë me arsyetimin që nuk plotësojnë dokumentacionin e kërkuar sipas DT. Referuar procedurës, informohet se bashkimin e operatorëve ekonomikë “P.G.” sh.p.k., dhe “J.” sh.p.k., me vlerë totale prej 500,472,588 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme. Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja ka kryer veprime të cilat bien ndesh me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 3, pika 1 “*Parime të përgjithshme*”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: <i>“Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)”</i> , mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar operatori i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të tenderit. Konkretisht, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë (BOE) e cila përfundimisht është shpallur fituese <i>“BOE P.G. &amp; J.shpk”</i>, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar, veprime të cilat kanë çuar në shpalljen fitues padrejtësisht të BOE përkatës. Konkretisht mangësitë e BOE fitues janë në lidhje OE <i>“P.G.”</i> shpk, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Operatori Ekonomik <i>“ P.G.”</i> shpk, nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me disponimin në stafin e shoqërisë të punojësit <i>“Auditues energjie”</i>, pajisur me <i>“Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”</i>, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë. Lidhur me plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik <i>“ P. G.”</i> sh.p.k., ka deklaruar në Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit si <i>“Auditues energjie”</i> z. E. XH., i cila rezulton në listën e Audituesve të Energjisë të publikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, <u><i>por nuk është i punësuar në stafin e kompanisë ” P.G.”</i></u>. Në DT përcaktohet saktë që audituesi i energjisë duhet të jetë i punësuar, pra i siguruar me e-sigurime. Operatori ekonomik në përmbushje të kësaj pike, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë <i>“E. S.”</i> shpk, veprim i cili nuk është i specifikuar edhe kërkuar në DT, sic citohet: <p><i>Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Maj - Korrik 2022. Përjashtim nga kjo bëjnë vetëm <u>“Eksperti për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe “Mjeku i përgjithshëm”</u>, të kërkuara sipas gërmave <i>“f” dhe “g”</i>, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë edhe me kontrata pune individuale. Pra rezulton se kjo pikë e kërkuar nuk plotësohet nga BOE. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga BOE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të jetë kërkuar asnjë sqarim nga ofertuesi apo NJP për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre. Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 <b>“Shqyrtimi i ofertave”</b>, pika 1 përcakton se <u><i>“Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”</i></u>. Pika 2. <i>“Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet”</i>. <b>Së dyti</b>, sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 <b>“Shqyrtimi i ofertave”</b>, pika 3 përcakton se <i>“....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të</i></i></p> </li></ul>

	<p>korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”. Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”; pika 4, citohet se “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Referuar ligjit mbi prokurimin publik mbi Kualifikimin e ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, <b>gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.</b></p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.  - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit  - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos arritje e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 92 të LPP për Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandime:</b>	<p>1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.</p>

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstrukcion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)”**, zhvillimi i procedurës është realizuar 26.09.2022.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstrukcion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)”, 2022</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-41662-09-14-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. K. Ll. 2. D. M. 3. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. D. K. 3. J. L.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 7.896.520 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 7,819,400 lekë Operatori Fitues: OE “P.G.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 77,120 lekë ose zbritur 99 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>26/09/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fondet e planifikuara nga buxheti i shtetit për vitin 2022 për DPRMSH, projekti me kod 21AD401.	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>1 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>0 B/OE</b> c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 8 javë ose 2 muaj		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “ <i>Rikonstruksion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)</i> ”, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 26.09.2022 për rikonstruksionin e ambienteve magazinuese Pukë, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën <b>2.3.3/e</b> të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se <u>kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”</u> , i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjetik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “ <i>Rikonstruksion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)</i> ”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike përkatëse. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese.
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	I lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet

	ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik.
--	--

**Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

<b>Titulli i gjetjes</b>	Në procedurën e prokurimit: “ <i>Rikostruksion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)</i> ”, mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar operatori i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të tenderit. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës. Njoftimi i fituesit informon se në procedurë kanë marrë pjesë vetëm 1 Ofertues dhe i shpallur fitues. Operatori ekonomik “P. G.” sh.p.k., me ofertë ekonomike me vlerë 7,819,400 lekë pa TVSH. Operatori Ekonomik “P.G.” shpk, nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit lidhur me disponimin në stafin e shoqërisë të punojësit “Auditues energjie”, pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjitik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë. Lidhur me plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “P. G.” sh.p.k., ka deklaruar në Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit si “Auditues energjie” z. E. XH., i cila rezulton në listën e Audituesve të Energjisë të publikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, <i>por nuk është i punësuar në stafin e kompanisë</i> ” P. G.”. Në DT përcaktohet saktë që duhet të jetë i punësuar, pra i siguruar me e-sigurime. Operatori ekonomik në përmbushje të kësaj pike, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me kompaninë ”E. S.” shpk, veprim i cili nuk është i specifikuar edhe kërkuar në DT.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos arritje e efiçencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 92 të LPP për Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion i ambienteve magazinuese në Drejtorinë e rezervave të Shtetit Korçë*”, zhvillimi i procedurës është realizuar fillimisht 04.08.2022 (e anuluar) dhe më pas 26.09.2022.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “ <i>Rikonstruksion i ambienteve magazinuese në Drejtorinë e rezervave të Shtetit Korçë</i> ”, 2022
--

<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-41655-09-14-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. K. Ll. 2. D. M. 3. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. D. K. 3. J. L.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 8.109.560 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 8,072,778 lekë Operatori Fitues: OE “P.G.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 36,782 lekë ose zbritur 99.5 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>26/09/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fondet e planifikuara nga buxheti i shtetit për vitin 2022 për DPRMSH, projekti me kod 21AD401	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>2 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>1 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 8 javë ose 2 muaj		

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 B/OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës.

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	BOE “Xh.” sh.p.k & “A. K.” sh.p.k	7,646,969	S’Kualifikuar
2	“P. G.” sh.p.k	8,072,778	Kualifikuar

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh.” sh.p.k., dhe “A. K.” sh.p.k., për arsyet e mëposhtme: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Xh.” sh.p.k., dhe “A.K.” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë se plotëson të gjithë kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT. Konkretisht nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/b, të Kapacitetit Teknik të Kriteve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, për punonjësit e specializuar/të kualifikuar, të deklaruar në Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Vlerësimi si më sipër është bërë referuar përcaktimeve të nenit 80, pika 1/a dhe 3 të LPP, ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar. Gjithashtu ky arsyetim/vlerësim mbështetet edhe në dy vendime të Komisionit të Prokurimit Publik, në vendimin nr. 441/2020 dhe nr. 238/2021. Referuar procedurës, informohet se operatori ekonomik “P.G.” sh.p.k., me ofertë të paraqitur me vlerë totale prej 8,072,778 lekë është identifikuar si oferta e suksesshme dhe është nënshkruar kontrata.

**4.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim hangari për mirëmbajtje dhe strehim helikopterësh UH60 Black Hawk”**, në Bazën Ajrore Farkë, Tiranë zhvillimi i procedurës viti 2023.

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim hangari për mirëmbajtje dhe strehim helikopterësh UH60 Black Hawk”, 2023</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-65657-04-11-2023 Urdhri nr. 423 prot., datë 27.03.2023	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. M. J. specialist Infrastruktura dhe mjedisi KFA 2. G. J. përgjegjës sektori DPA, MM 3. E. F. specialist në DPA, MM	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 423/1 prot., datë 27.03.2023 1. Y. I. Drejtor i DPESHM 2. D. K. Drejtor i DPA 3. F. H. zv/drejtor IGJIU (ekspert fushe)

<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 407,623,670 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 384,361,462 lekë Operatori Fitues: BOE "A. C." sh.p.k., dhe "A.-i.G. C."	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 23,262,208 lekë ose zbritur 94 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 28/04/2023 ndryshohet më datë <b>05/05/2023</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> 150,000,000 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2023, 183,333,333 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2024 74,290,337 lekë pa TVSH, vënë në dispozicion për vitin 2025	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>8B/OE</b> b) S'kualifikuar <b>7 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 24 muaj		

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:  
a-Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.**

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: <i>"Ndërtim hangari për mirëmbajtje dhe strehim helikopterësh UH60 Black Hawk"</i> , Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 05.05.2023 për Ndërtimin e hangarit helikopterët UH60 Black Hawk, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, konstatohet se në këtë procedurë prokurimi, natyra e objektit është e ngjashme me procedurat me objekt <i>"Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)"</i> , <i>"Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë"</i> etj, <u>dhe nuk është kërkuar që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) "Auditues energjie", i cili duhet të jetë i pajisur me "Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa"</u> , lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Referuar dokumenteve të ndryshme të procedurave, konstatohet qartazi se kërkesat kualifikuese ndryshojnë nga njëra-tjetra, duke përdorur nga AK standarde të ndryshme në kërkesa për kualifikime. Njoftimi i shkurtuar i kontratës është realizuar mr nr. 1811/2 prot., datë 11.04.2023 dhe dalë në Buletinin e APP nr. 34 datë 18 Prill 2023. Në pikën 2.3.5 të DT kërkohet që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga <i>prodhuesit</i> ose nga <i>distributorët e autorizuar nga prodhuesit</i> , për tregtimin e artikujve/pajisjeve që do të përdoren në funksion të realizimit të zërave përkatës të preventivit të punimeve (sipas listës së përcaktuar në pikën 2.3.6, të DT). Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Kjo kërkesë nuk është kërkuar në asnjë nga procedurat e ngjashme të realizuara nga AK.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik".
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese dhe mos unifikim i kriterëve në procedurat prokuruese.
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe në procedurat e ngjashme.



<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës, duke unifikuar kriteret kualifikuese për kontratat e punëve publike. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “**Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë**”, zhvillimi i procedurës viti 2022.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë”, 2022		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-35039-06-30-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. D. K. 2. D. M. 3. L. L.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. E. M. 3. E. F.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 92,574,706 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 89,000,000 lekë Operatori Fitues: OE “E. K.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 3,574,706 lekë ose zbritur 4 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>18/07/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Buxheti i MM.	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>5 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>4 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 5 muaj		

**Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet që:**

Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK (*specialisti i fushës*), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4. Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë”, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 18.07.2022 për ndërtimin e grup-depove për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën 2.3.2/b të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” ( <i>Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta</i> ), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Referuar

	<p>kërkesës së mësipërme për licensim, konstatohet se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të LPP. Argumentimi nga Njësia e Prokurimit citohet se kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “<i>leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji</i>”. Nga auditimi në QKB, Aktiviteti i licensimit së <i>ruajtjes së mbetjeve të ngurta</i>, ekzistojnë shumë pak operator ekonomik, duke zvogëluar ndjeshëm konkurrencën në procedurë. Në pikën 2.3.3/g të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se <u>kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”</u>, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “<i>Ndërtim i grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit</i>”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar nga IGJIU e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike të punimeve elektrike, mekanike, kondicionimit etj. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. <b>Si konkluzion</b>, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</li> <li>- Termet e referencës dhe dokumentet e tenderit</li> <li>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese.
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese

	të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.
--	--

### ***Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 B/OE, për të cilët referuar procesverbalit përkatës të hapjes së ofertave 18.07.2022, KVO-ja ka kryer në SPE nga data 18.07.2022 dhe përfunduar datë 13.09.2022 dhe rivlerësuar ofertuesit nga data 13.09.2022 deri më 20.09.2022, për vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	OE "2." sh.p.k	68,964,592	S'Kualifikuar
2	BOE "I." sh.p.k., dhe "Xh." sh.p.k	79,576,675	S'Kualifikuar
3	BOE "A. C." sh.p.k., & "C."	81,829,139	S'Kualifikuar
4	OE "E. K." sh.p.k	<b>89,000,000</b>	<b>Kualifikuar/Fituesi</b>
5	"G. C." sh.p.k., dhe "Sh." sh.p.k.	89,203,259	S'Kualifikuar

Referuar procesverbalit nr 3 datë 13.09.2022 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, rezulton se KVO-ja, ka vepruar si më poshtë vijon: 1. Operatori ekonomik "2." sh.p.k, me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT. 2. BOE "I." sh.p.k. dhe "Xh.", nuk arrijnë të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT. 3. BOE "A.C." sh.p.k., dhe "C.P." sh.p.k., me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT. 4. BOE "G.C." sh.p.k. dhe "Sh." sh.p.k., me dokumentacionin ligjor dhe teknik të paraqitur në tender, nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në DT. OE "E. K." shpk, sipas KVO-së konstatohet se plotëson të gjitha kërkesat e kualifikimit sipas DT. KVO citon se në funksion të vlerësimit sa më të drejtë, KVO i kërkoi operatorit "E. K." shpk, informacion dhe dokumentacion që vërteton kualifikim profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certificate /diploma) lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara / akredituara nga autoritet përgjegjëse shtetërore. Kërkesa u dërgua në SPE datë 08.09.2022 dhe u sollën nga OE 09.09.2022. Me procesverbalin nr. 3/1 datë 13.09.2022, dërgohen operatorëve ekonomik OE "2." shpk, BOE "A.C." & "C.P." shpk dhe BOE "I." & "Xh." shpk, arsyet e s'kualifikimit. Me procesverbalin nr. 3/1 datë 20.09.2022, verifikohet përpara publikimit njoftimit fituesit dokumentacioni i paraqitur nga OE "E. K." shpk, ku përcaktohet se dokumentacioni i paraqitur ishte në përputhje me parashikimet e LPP. Formulari i njoftimit të fituesit realizohet me nr. 4749/1 prot., datë 20.09.2022 dhe paraqitet në buletin nr. 131 datë 26 Shtator 2022. Me shkresën e KVO nr. 4749/2 prot. Datë 30.09.2022, drejtuar Titullarit të AK, dërgohet raporti përmbledhës mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe me urdhrin e titullarit nr. 1655 datë 30.09.2022, urdhërohet të lidhet kontrata me operatorin "E.K." shpk me Komandën Mbështetëse, e cila nënshkruar kontratën më datë 10.10.2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: "Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë", mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar operatori i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të

	<p>tenderit. Sipas kërkesës së dërguar në SPE datë 08.09.2022 mbi certifikimet e punonjësve, të cilat u sollën nga OE “E. K.” shpk më datë 09.09.2022, konstatohet:</p> <p>Kontrata individuale midis punëdhënësit E.K. shpk dhe B.B datë 01.02.2022, me detyrë <u>specialist teknike e teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit</u>, disponon certificate nga “S.A.A.” shpk me Nipt K.....</p> <p>Certifikata lëshohet pas përfundimit me sukses të kursit për sigurinë në punë. Pra është certificate për sigurinë në punë dhe jo për teknik IT. Nga verifikimi i kryer në faqen zyrtare www.qkb.gov.al, në seksionin “Kërko për Licencë”, shoqëria si më sipër është licensuar me licensën me nr. LN-..... me Titull “Formim profesional”, për të cilën figurojnë 1 miratim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe nga QKB: Me miratimin e kërkesës për licensim nr. 1572/2 prot., datë: 14.02.2022, citon se: Miratohet kërkesa e subjektit “S.A.A. (Franchise S. A. T. B. Sa G.), për tu pajisur me license për formim profesional dhe ofrim të kurseve në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë për: “Koordinator sigurie në fazën e projektimit dhe zbatimit”, “Përgjegjës i sigurisë dhe shëndetit në punë”, “Punime në hapësira rë kufizuara”, “Punime në lartësi”, “Përgjegjës për menaxhimin e emergjencave”, “Për mbrojtjen nga zjarri”, “Operator piruni”, “Operator Vinc-urë”, “Sigurimi teknik elektrik” dhe “Përdorues i pajisjeve/instalimeve nën presion”. Për sa më sipër rezulton se ky subjekt (S.... A..... A....) referuar Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NUIS K..... dhe Licencë me LN-....., nuk është i licensuar të ofrojë kurse të formimit profesional dhe të lëshojë certifikata/diploma për profesionet “Specialist teknike IT”, “Hidraulikë”, “Saldator”, “Elektricitist”, “Hekurkthyes”, “Karpentier” “Murator”, etj sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” dhe për rrjedhojë, nuk përmbushet kërkesa për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Këtë qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 bashkë me vendimet e cituara nga KVO. <b>Sa më sipër arrihet në përfundim se:</b></p> <p>Sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 përcakton se “....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse <u>ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit</u>”.</p> <p>Gjithashtu bazuar edhe sipas VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave”; pika 4, citohet se “Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Anëtarët e komisionit duhet të zbatojnë detyrat në pavarësi të plotë. <u>Nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit</u>. Referuar ligjit mbi prokurimin publik mbi Kualifikimin e ofertesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet</p>
--	--

	dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, <b><i>gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.</i></b>
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos rritje e efizienzës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 92 të LPP për Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: ***“Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike”***, zhvillimi i procedurës viti 2022.

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike”, 2022</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” UP nr. 451 datë 08.04.2022 REF-26095-04-21-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. E. F. 2. E. T. 3. D. M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. D. K. 2. E. M. 3. G. J.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 29,650,579 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 28,318,809 lekë Operatori Fitues: OE “A.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 1,331,770 lekë ose zbritur 5 % nga F.L
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>11/05/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fondet e vëna në dispozicion për vitin 2022, për Aparatin e MM (Rep. Usht. nr. 6001), në artikullin 231, për projektin me kod M170203	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>3 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>2 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 8 javë		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: <b><i>“Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike”</i></b> , Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 11.05.2022 për rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë e sigurisë kibernetike, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar

vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën **2.3.2/b** të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me license leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim, ruajtje dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “*Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta*”, i ndryshuar. Referuar kërkesës së mësipërme për licensim, konstatohet se nuk është në përputhje me parashikimet ligjore të LPP. Argumentimi nga Njësia e Prokurimit citohet se kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “*leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/B të këtij ligji*”. Nga auditimi në QKB, Aktiviteti i licensimit së **ruajtjes së mbetjeve të ngurta**, ekzistojnë shumë pak operator ekonomik, duke zvogëluar ndjeshëm konkurrencën në procedurë.

- Në pikën **2.3.3/e** të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “*Auditues energjie*”, i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “*Për efikasitetin e energjisë*” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “*Rikonstruktion ambientesh për zyra*”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar nga IGJIU e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike të punimeve elektrike, mekanike, kondicionimit etj. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. Në lidhje me këtë kërkesë AK, i ka kërkuar sqarim Agjencisë për Eficencën e Energjisë dhe me emailin datë 13.04.2022 AEE citon: “*Audituesi i energjisë është i domozdoshëm në fazën e projektimit dhe në fazën e supervizim/kolaudimit, pasi është përgjegjës për hartimin e raportit paraprak të efikasitetit të energjisë shoqëruar nga certifikata paraprake e performancës së energjisë (në*

fazën e projektimit) si dhe për hartimin e raportit përfundimtar të eficensës së energjisë shoqëruar nga certifikata përfundimtare e performancës së energjisë (në fazën e supervizim/kolaudim). Audituesi që ka zhvilluar raportin paraprak të eficensës nuk mund të kryej edhe raportin përfundimtar. Përsa i përket fazës së zbatimit, prezenca e Audituesit të energjisë bëhet e panevojshme në rastet kur raporti paraprak i eficensës së energjisë është hartuar në fazën e projektimit. Nëse kjo nuk ka ndodhur atëherë bëhet i nevojshëm prezenca e Audituesit të energjisë në fazën e zbatimit”. Sa më sipër, konstatohet se përgjigja nga AEE, nuk ka mbështetje ligjore konkrete, mbi domozdoshmërinë e fazave ku është i nevojshëm Audituesi i energjisë. Pra sa më sipër konstatohet se IGJIU, ka hartuar projektin Elektrik, Mekanik së bashku me raportet përkatëse bashkë me specifikimet teknike, të cilat janë detyruese të zbatohet nga zbatuesi i punimeve.

Në lidhje me kapacitetin teknik kërkohet që të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar - Mars 2022. Përrjashtim nga kjo bënë vetëm “Mjeku i përgjithshëm”, i kërkuar sipas shkronjës “d” i cili përveç se si pjesë e stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jetë edhe me kontratë pune individuale. Përcaktimi apo kufizimi i listëpagesave prej Janarit dhe Marsit 2022, ngushton konkurrencën duke mos stimuluar operatorët të cilët sapo mund të kenë punësuar specialistët apo audituesin e energjisë.

**Si konkluzion**, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4. Më datë 29.04.2022 në rubrikën “Kërkesa” në SPE është paraqitur kërkesë për sqarim nga OE “2.” shpk, në lidhje me kriterin e AK, nëse pranohet kontratë shërbimi midis operatorit ekonomik dhe Audituesit të energjisë.

Me procesesverbalin datë 05.05.2022, njësia e prokurimit shprehet se nuk pranohet kontraktimi i audituesit të energjisë dhe se duhet te jetë në listëpagesa Janar – Mars 2022, me arsyetimin e përvojës së duhur për të përmbushur dhe zbatuar kontratën. Veprimet e njësisë së prokurimit vazhdojnë duke mbajtur të ngushtuar konkurrencën, në kundërshtime me LPP, neni 73 “Sistemet e kualifikimit”, ku citohet: “Kur kriteret dhe rregullat për kualifikim përfshijnë kërkesa që kanë lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorit ekonomik, apo kapacitetin teknik dhe/ose profesional, operatori ekonomik, sipas rastit, mund të mbështetet në kapacitetin e subjekteve të tjera, sipas parashikimeve të nenit 84 të këtij ligji.

Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” pika 2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë. Pika 3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim. Pika 4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij.

	Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosija e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

#### ***Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 B/OE, për të cilët referuar procesverbalit përkatës të hapjes së ofertave 11.05.2022, KVO-ja ka kryer në SPE nga data 11.05.2022 dhe përfunduar datë 23.06.2022, për vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	BOE “S.2.” & “F. E.” sh.p.k	21,111,111	S'Kualifikuar
2	OE “I.” sh.p.k.,	26,873,617	S'Kualifikuar
3	OE “A.” sh.p.k	28,318,809	Fituesi

Referuar procesverbalit datë 23.06.2022 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, rezulton se KVO-ja, ka vepruar si më poshtë vijon: 1. Operatori ekonomik “I.” sh.p.k., për arsye se nuk plotëson kërkesa për kualifikim. 2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “S. 2.” sh.p.k., dhe “F. E.” sh.p.k., me për arsye nuk plotëson kërkesa për kualifikim.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “Rikonstrukcion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike”, mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar operatori i shpallur fitues nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të tenderit. Nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas shkronjës a) të pikës 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me disponimin e personelit kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, pasi një nga punonjësit e deklaruar rezulton i punësuar në cilësinë e drejtuesit teknik të shoqërisë në kundërshtim me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë”, pika 2 ku parashikohet që: Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër



*publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohe të disponojë licencë për mbikqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit. Operatori ekonomik "A." sh.p.k., në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, ka deklaruar se ka drejtues teknik zj. B. A., me profesion Inxhinierë Ndërtimi profil transport. Sipas shkresës e sigurimeve shoqërore nr. 3860/1 prot. Datë 08.06.2022, konstatohet se zj. B.A, është e dy punësuar pranë Fakultetit të Inxhinierisë së ndërtimit dhe nuk është përcaktuar koha apo pozicioni i punësimit pranë Fakultetit. Referuar listëpagesës së OE "A." shpk, rezulton se kjo punonjëse është e punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë.*

2. Certifikata për përgjegjësinë e mbrojtjen e shëndetin në punë dhe përgjegjësinë e për mbrojtjen dhe menaxhimin e mjedisit të cilat disponohen nga zj. B. A. ka paraqitur certifikatat nga shoqëria "A." shpk. Shoqëria "A." shpk, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/b, të kritereve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi nuk ka paraqitur dokumente që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, për punonjësit e specializuar/të kualifikuar, të deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë të dërguar nga ofertuesi, konstatohet se për të gjithë punonjësit të specializuar, të lëshuara nga A. me NIPT L....., e cila nuk ka license aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat kualifikuese nga Institucione të licensuara/ akredituara. Punonjësit e specializuar janë Teknike/specialistë, hidraulikë, specialist elektrikist, Saldator, Hekurkthyes, Hidroizolues, Karpentier, Suvatues, Bojaxhi, specialist gipsi, kanë paraqitur certificate nga A. Vendimi mbështetet nga vendimi i KPP nr. 441/2020 dhe nr. 238/2021. Shoqëria A. e cila ka lëshuar certifikatat e trajnimit, nuk është e licensuar nga MFE dhe nuk disponon license për të ofruar kurse trajnimi formimi profesional sipas ligjit Nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në RSH". Referuar Nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik"; Nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar; Ligjin nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R. Sh." dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar, vlerëson/gjykon se ofertuesi referuar Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe Deklaratës (tabela) me të dhënat e Institucionit lëshues të certifikatave/diplomave, të paraqitura në SPE, nuk vërteton se disponon të gjithë punonjësit e specializuar/të kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate. Sa më sipër OE "A." shpk, duhej të ishte s'kualifikuar. Si konkluzion, sipas Nenit 92 të ligjit 162/2020 "Shqyrtimi i ofertave", pika 3 përcakton se "....Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit".

<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos arritje e efijencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 92 të LPP për Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat*”, zhvillimi i procedurës është realizuar 21.07.2022.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”, 2022</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-35383-07-05-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. O. D. 2. L. L. 3. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. K. Ll. 3. G. J.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 82,509,530 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 76,463,757 lekë Operatori Fitues: BOE “B.” shpk, & “LI.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 6,045,773 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 21/07/2022	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Shpenzimet planifikuara për Komandën e Forcës Tokësore	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 8 B/OE b) S’kualifikuar 7 B/OE c) Kualifikuar 1 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 5 muaj		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “ <i>Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ”, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 21.07.2022, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën <b>2.3.3/e</b> të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “ <i>Auditues energjie</i> ”, i cili duhet të jetë i pajisur me “ <i>Certifikatë për Auditues Energjitik në ndertesa</i> ”, lëshuar nga Agjencia per Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efijencës së energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “ <i>Për efijencën e energjisë</i> ” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet

	<p>me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Efikasitetin e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “Ndërtim depo”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike përkatëse. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4. Në pikën 2.3.3/c të DT, citohet se operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklaratë nga (Administratori i shoqërisë), Përgjegjësin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”</li> <li>- Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit</li> <li>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE nga data 21.07.2022 dhe përfunduar datë 14.09.2022, dhe më pas rivlerësohen deri më datë **20.09.2022** sipas vlerësimit dhe klasifikimit përkatës.

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	“A.” sh.p.k	63,645,778	S’Kualifikuar
2	“I.” shpk, & “Xh.”	69,443,090	S’Kualifikuar
3	“A. K.” sh.p.k	73,794,925	S’Kualifikuar

4	“A.C.” sh.p.k	75,524,013	S’Kualifikuar
5	“E. K.” sh.p.k	76,128,925	Tërhequr
6	“B.” shpk, & “Ll.” sh.p.k.	<b>76,463,757</b>	Kualifikuar / Fituesi
7	“G. C.” sh.p.k., “Sh.”	78,479,169	S’Kualifikuar
8	“S.” sh.p.k	Pa ofertë	S’Kualifikuar

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “A. C.” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë se plotëson kërkesat për kualifikim. 2. Operatori ekonomik “A.” sh.p.k. me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesave për kualifikim. 3. Operatori ekonomik “A. K.” sh.p.k., me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim. 4. Operatori ekonomik “E. K.” sh.p.k. Oferta është refuzuar, pasi operatori ekonomik “E. K.” shpk, është tërhequr nga oferta e paraqitur më datë 08.09.2022, në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim depo A-M, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”. E drejta për tu tërhequr nga një procedurë administrative, parashikohet në nenin 64, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, cituar: Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar.

- Me memon e Drejtorit të DPA nr. 5963 prot. Datë 14.11.2022, drejtuar SP, njoftohet tërheqja e OE “E. K.”shpk, ku KVO refuzoi ofertën dhe kërkon konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe raportimin pranë APP rastin e tërheqjes së ofertuesit. 5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “G. C.” sh.p.k., & “Sh.” sh.p.k, krijuar sipas kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar më datë 20.07.2022 dhe përfaqësuar nga shoqëria “G.C.” sh.p.k., nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në DT. 6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “I.” sh.p.k., & “Xh.” sh.p.k., nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim 7. Operatori ekonomik “S.” sh.p.k., nuk ka paraqitur as dokumentacion për të vërtetuar plotësimin e kërkesave për kualifikim dhe as ofertë ekonomike. Referuar procedurës, informohet se bashkimin e operatorëve ekonomikë, të përbërë nga “B.” shpk, & “Ll.” shpk, me vlerë totale prej 76,463,757 lekë pa TVSH identifikohet si oferta e suksesshme dhe nënshkruhet kontrata.

**8.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”**, zhvillimi i procedurës është realizuar 18.08.2022.

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”, 2022</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-36790-07-21-2022.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. J. L. 2. O. D. 3. D. M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. A. G. 2. Y. I. 3. G. J.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 54,270,117 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 76,463,757 lekë Operatori Fitues: BOE “B.” shpk, & “Ll.” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 6,045,773 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 10/08/2022 ndryshohet <b>18.08.2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Shpenzimet planifikuara për Komandën e Forcës Tokësore	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>8 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>7 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>1 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 12 muaj		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat”, Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 18.08.2022, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën <b>2.3.3/e</b> të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se <u>kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”</u> , i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjistik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “Ndërtim objekte”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike përkatëse. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese.
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE nga data 18.08.2022 dhe përfunduar datë 20.10.2022, dhe më pas rivlerësohen deri më datë 26.10.2022 sipas vlerësimit dhe klasifikimin përkatës.

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	"A. C." sh.p.k	45,526,649	S'Kualifikuar
2	"I." sh.p.k.	45,778,216	S'Kualifikuar
3	"J." sh.p.k., & "C." sh.p.k.	48,469,972	S'Kualifikuar
4	"A. K." sh.p.k	48,668,861	S'Kualifikuar
5	"A. K." & "2." & "I."	51,015,300	S'Kualifikuar
6	"G. C...." sh.p.k	51,972,101	S'Kualifikuar
7	"B." sh.p.k., & "Ll." sh.p.k.,	<b>52,714,702</b>	Kualifikuar / Fituesi

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "A.C." sh.p.k., për arsyet se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit. 2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "A.K." sh.p.k., & "2 ." sh.p.k., me & "I." sh.p.k., për arsyet se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit. 3. Operatori ekonomik "A. K." sh.p.k., për arsyet e mëposhtme se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit 4. Operatori ekonomik "G.C." sh.p.k., për arsyet se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit 5. Operatori ekonomik "I." sh.p.k., për arsyet se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit. 6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "J." sh.p.k., & "C." sh.p.k., për arsyet e se nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit. Referuar procedurës, informohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë "B." sh.p.k., dhe "Ll." sh.p.k., me ofertë totale prej 52,714,702 lekë pa TVSH, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit dhe nënshkruhet kontrata.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: " <i>Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ", mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar operatori i shpallur fitues "B." sh.p.k., dhe "Ll." sh.p.k., nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të tenderit. Nga auditimi i dokumenteve të operatorit të shpallur fitues, konstatohet se ky operator ka paraqitur të njëjta dokumente si në procedurën me objekt " <i>Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ", zhvillimi i procedurës është realizuar 21.07.2022. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "B." sh.p.k., dhe "Ll." sh.p.k., nuk plotësojnë asnjë kriter të përgjithshëm dhe të veçantë të kualifikimit lidhur me disponimin në stafin e shoqërisë të punojësit Deklaratat dhe shtojcat e paraqitura nga "B..." sh.p.k., dhe "Ll...." sh.p.k, janë të njëjta me shtojcat e paraqitura në procedurën " <i>Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> " dhe atë aktualen " <i>Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ". Pra, personeli i deklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomik, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se është deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt " <i>Ndërtim depo A-M ne Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ", të realizuar nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Mbrojtjes, për të cilën ky BOE, është shpallur fitues. Pra BOE "B." sh.p.k., dhe "Ll." ka paraqitur identik të njëjtin dokumentacion dhe është shpallur fitues në të dy procedurat prokuruese, <u>cka nuk plotëson në mënyrë kumulative kapacitetet</u>

	<i>teknike</i> . Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/a & b, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi personeli i deklaruar nga BOE, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për procedurën e prokurimit me objekt “ <i>Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat</i> ”, në përbushje të kësaj kërkesë, rezulton se janë deklaruar edhe në dy procedura të tjera prokurimi të realizuara nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Mbrojtjes, për të cilat BOE, është shpallur fitues. Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3/c, të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT, pasi përgjegjësi teknik i kantierit i deklaruar, rezulton të jetë deklaruar dhe për rrjedhojë angazhuar si drejtues teknik i punimeve në dy procedura të tjera prokurimi të realizuara nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Mbrojtjes, për të cilat BOE, është shpallur fitues.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos arritje e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 92 të LPP për Shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër*”, zhvillimi i procedurës është realizuar 13.06.2022.

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “ <i>Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër</i> ”, 2022		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-30639-05-24-2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. G. J. 2. L. L. 3. D. M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> 1. Y. I. 2. D. K. 3. M. M.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 15,864,929 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b>	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b>
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data <b>13/06/2022</b>	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Shpenzimet planifikuara për Repartin Vau i Dejës, Shkodër.	<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>1 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>1 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>0 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 23 javë nga data e fillimit të punimeve		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: “ <i>Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër</i> ”, Njësia e Prokurimit nuk ka
---------------------------	--

	argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 13.06.2022, Dokumentet e tenderit të hartuara dhe miratuara nga AK ( <i>specialisti i fushës</i> ), nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në pikën 2.3.3/e të DST, kërkohet që Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se <u>kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) “Auditues energjie”</u> , i cili duhet të jetë i pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjistik në ndertesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Nga NJP argumentohet se Audituesi i energjisë është i nevojshëm për hartimin e raportit mbi vlerësimin e efikasitetit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit nr. 124/2015 “Për efikasitetin e energjisë” parashikohet se: “2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin: a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik; b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik; c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme; ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse. 3. Audituesi i dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik Agjencisë për Eficencën e Energjisë për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm”. Për sa më sipër, lidhur me kërkesën e audituesit të energjisë, konstatohet se nga auditimi i zërave të punimeve, nuk ka asnjë zë në preventiv që të ketë lidhje për shërbimin e auditimit të energjisë. Gjithashtu, objekti i prokurimit “ <i>Rikonstrukcion objekti</i> ”, do të zbatohet sipas specifikimeve teknike të projektit të realizuar e të miratuar nga AK, ku janë të përcaktuara të gjitha parametrat teknik të pajisjeve sipas relacioneve teknike përkatëse. Rrjedhimisht kjo kërkesë është vendosur jashtë objektit të kontratës, e cila ngushton konkurrencën e operatorëve ekonomik. Si konkluzion, për sa konstatuar më sipër veprimet bie në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” - Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos argumentim i kriterëve kualifikuese
<b>Shkaku:</b>	Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik.

**b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.**



Në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë 1 OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datë 04.07.2022 vlerësimin e procedurës ku ka kryer klasifikimin përkatës.

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	"A." sh.p.k	15,589,910	S'Kualifikuar

Operatori ekonomik "A." sh.p.k. Oferta është refuzuar, pasi operatori ekonomik "A." shpk, është tërhequr nga oferta e paraqitur më datë **13.06.2022**, në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër*". E drejta për tu tërhequr nga një procedurë administrative, parashikohet në nenin 64, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", cituar: Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Në procedurën e prokurimit: " <i>Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër</i> " është tërhequr nga oferta ku vlera prej <b>317,298 lekë</b> nuk është pasqyruar as në pasqyrat financiare të institucionit si detyrim.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar ka marrë pjesë 1 OE, ku referuar procesverbalit përkatës, KVO-ja ka kryer në SPE në datë 04.07.2022 vlerësimin e procedurës ku ka kryer klasifikimin përkatës. Operatori ekonomik "A." shpk, është tërhequr nga oferta e paraqitur më datë 13.06.2022, në procedurën e prokurimit me objekt " <i>Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër</i> ". E drejta për tu tërhequr nga një procedurë administrative, parashikohet në nenin 64, të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", cituar: Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Me raportin përmbledhës të Drejtorit të DPA nr. 3498/2 prot. Datë 27.07.2022, drejtuar SP, njoftohet tërheqja e OE "A." shpk, ku KVO refuzoi ofertën dhe kërkon konfiskimin e sigurimit të ofertës dhe të raportojë pranë APP rastin e tërheqjes së ofertuesit. Me shkresën e titullarit të MM nr. 4065/1 prot. Datë 08.08.2022, kërkohet konfiskimi i ofertës nga shoqëria "A." sh.a, lëshuar në emër të shoqërisë "A." shpk, përfitues Ministria e Mbrojtjes në vlerën <b>317,298 lekë</b> , bazuar në nenin 83 të LPP, ku vlera e sigurimit të ofertës transferohet në llogarinë e MM sipas numrit të llogarisë dhe kodit të institucionit. Me shkresën nr. 4065/2 prot. Datë 08.08.2022, raportohet tek APP mbi tërheqjen e OE. Formulari i sigurimit të ofertës rezulton me datë 13.06.2022 me nr. Serial: 220603613 me afat vlefshmërie 150 ditë. Nga auditimi i të ardhurave të arkëtuar në MM për periudhën 2022 deri në përfundim të auditimit në terren, rezultoi se kjo shumë nuk është arkëtuar nga subjekti si detyrim i lindur nga konfiskimi i sigurimit të ofertës. Gjithashtu, nga MM kjo vlerë prej <b>317,298 lekë</b> nuk është pasqyruar as në pasqyrat financiare të institucionit si detyrim, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të llogarisë 468 "Debitorëve të ndryshëm të institucionit", vlerë e cila përbën të

	ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Pasqyrimin jo i drejte i llogarisë 468 “Debitorëve të ndryshëm të institucionit”.
<b>Shkaku:</b>	Mos mbajta e sigurit të ofertës nga Drejtoria e Buxhetit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, sektori i prokurimeve të marrë masa të menjëhershme për dërgimin e njoftimit të konfiskimit të ofertës nga shoqëria “A.” sh.a, lëshuar në emër të shoqërisë “A.” shpk, përfitues Ministria e Mbrojtjes në vlerën prej <b>317,298 lekë</b> , ku vlera e sigurimit të ofertës transferohet në llogarinë e Ministrisë së Mbrojtjes sipas numrit të llogarisë dhe kodit të institucionit.

10. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt "*Blerje materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme*" konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-64886-04-04-2023 Urdhri nr. 430, datë 28.03.2023	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b>	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> D. L. G. J. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri me nr. 430/1, datë 28.03.2023 D. K. Y. Y. E. N.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 64,418,286 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 49,505,453 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 14,912,833 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 05.05.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>6</b> b) S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 5 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 60 ditë</b>			
<b>10. Ankimime</b> S’ka	<b>11. Përgjigje Ankesës</b>	<b>12. Përgjigje</b> .	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes KM dhe L.... VII” sha me nr. 5131/3, datë 07.08.2023	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi I kontratës është realizuar nga Komanda Mbështetëse		

Nga shqyrtimi i procedurës konstatohet që:

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos dokumentimi i mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të kontratës.
---------------------------	--

<p><b>Situata:</b></p>	<p>1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “<i>Blerje materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme</i>” zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2023 me fond limit në vlerën e 64,418,286 lekë pa TVSH nga e cila, u konstatuan parregullsi përsa i përket dokumentimit të mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit nga Komandën Mbështetëse. Me shkresën nr. 1279/1 datë 26.02.2023 (prot në MM 534, datë 27.02.2023) dërguar nga Shtabi i Përgjithshëm të FA është bërë kërkesë për “<i>Materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme të infrastrukturës për vitin 2023</i>”. Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi sasinë e kërkuar për artikuj, specifikimet teknike, si dhe përlllogaritja e fondit limit nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 9, datë 11.01.2023, “<i>Për ngritjen e grupit të punës për unifikimin e specifikimeve teknike dhe çmimeve për njësi për materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme të infrastrukturës për vitin 2023</i>” Grupi i punës vijoi me testimin e tregut për materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme të infrastrukturës, të cilat nuk janë të përfshira në listën e çmimeve të referencave. Grupi i punës ka realizuar testimin e tregut për materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme të infrastrukturës, si dhe bazuar në nenin 76, të VKM-së, i është drejtuar me shkresë zyrtare Institutit të Statistikave, për çmimet e 3- mujorit të fundit të vitit 2022, për rreth 20 artikuj. Në procesverbalin e mbajtur për përcaktimin e vlerës së fondit limit, cilësohet se komisioni data 18 janar 2023 deri me datën 08.02.2023 ka bërë testimin e tregut dhe në vazhdim tek tabela e paraqitur me çmimet e marra, nuk jepen të dhëna për operatorët ekonomikë nga të cilët është marrë oferta por vetëm përcaktime gjeografike të zonave nga janë marrë çmimet duke <b>cituuar se:</b> Nga testimi në vend i tregjeve sipas llojshmërisë, se subjektet ku kanë shkuar për të marrë çmime, më shume vështirësi të lejonin evidentimin e çmimit të shitjes brenda ambienteve, por nuk pranonin të jepnin me shkrim ofertë apo listë çmimesh për artikuj që tregtojnë, duke krijuar vështirësi në marrjen e listave të çmimeve të sakta, për të cilën janë evidentuar çmimet duke mbajtur shënime të ndryshme në vend, si rrjedhojë është bërë përcaktimin e çmimit për njësi, me çmimin mesatar të dalë nga studimi i kryer. Asnjë e dhënë nuk jepet për operatorët ekonomikë që kanë dhënë oferta tek komisioni për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit.</p> <p>Sa më sipër rezulton se:</p> <p>AK për një pjesë të artikujve që do të prokurojë të ndarë në grupe artikujsh të ngjashëm</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Materiale elektrike</li> <li>- Materiale ndërtimi dhe vegla</li> <li>- Material mekanike dhe hidraulike etj., çmimet e tyre janë të përcaktuara në kontratën me nr. 4012/6, datë 12.09.2022, e cila nuk është marrë në konsideratë nga grupi i punës.</li> </ul> <p>2. Grupi i punës shprehet se ka marrë çmimet për rreth 20 artikuj të dërguar nga INSTAT, për të cilat nuk është bashkëlidhur lista e artikujve dhe nuk është marrë në konsideratë ky çmim nga grupi i punës në përlllogaritjen e fondit limit.</p> <p>3. Llogaritja është bërë duke marrë çmime nga OE të ndryshëm nga ish-Tregu elektrik dhe nga OE të ndryshëm që operojnë në autostradën Tiranë-Vorë, Kinostudio, 21 Dhjetor dhe Kombinati, të cilat nuk janë të</p>
------------------------	---

	dokumentuar, çmimet e marrë nga OE nuk është specifikuar nëse kemi të bëjmë me shitës me pakicë apo me shumicë.
<b>Kriteri:</b>	VKM-së 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos dokumentimi i argumentimit të përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, mund të bëhet shkas për kryerjen e procedurave të prokurimit me fonde limite përtej vlerave reale të tregut.
<b>Shkaku:</b>	Mos respektimi i ligjeve dhe rregullave të prokurimit publik.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandëve në bashkëpunim me Komandën Mbështetëse të marri masat që në të ardhmen, për procedurat e tenderimit në lidhje me blerjen e mallrave për mirëmbajtjen e përgjithshme, të dokumentohet analiza mbi nevojat e njëjësive për mallra, si dhe në përlllogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike.

***Nga auditimi i dosjes fizike rezulton se:***

Bazuar në planin e shpërndarjes dhe artikujve të kërkuar objekt i procedurës së prokurimit kërkesat për *artikuj/sasi* për Repartet janë pothuajse të njëjta me procedurën “*Blerje material për mirëmbajtje të përgjithshme*” finalizuar me kontratën me nr. 4012/6, datë 12.09.2022, e cila si afat furnizim ka pasur 60 ditë.

Në procesverbalin me:

- Nr. 1, datë 18.10.2022 mbajtur nga Komanda Mbështetëse rep usht 4006 mbi marrjen në dorëzim të sasisë në vlerën 37,572,507 lekë shoqëruar me faturën nr. 111/2022, datë 18.10.2022 bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen me nr. 1, datë 18.10.2022.
- Nr. 2, datë 07.11.2022 mbajtur nga Komanda Mbështetëse rep usht 4006 mbi marrjen në dorëzim të sasisë në vlerën 27,645,834 lekë shoqëruar me faturën nr. 116/2022, datë 07.11.2022 bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen me nr. 2, datë 07.11.2022.
- Nr. 3 datë 14.11.2022 mbajtur nga Komanda Mbështetëse rep usht 4006 mbi marrjen në dorëzim të sasisë në vlerën 16,005,792 lekë shoqëruar me faturën nr. 126/2022, datë 12.11.2022 bërë hyrje në magazinë me fletë hyrjen me nr. 3, datë 14.11.2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos argumentim i nevojave për mallra që prokurohen.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi u konstatua se mungon një raport/relacion mbi nevojat për prokurimin e mallrave që do të prokurohet, jo në përputhje me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1 si dhe VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021(i ndryshuar), neni 2, pika 1 dhe pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1, në të cilat përcaktohet qartë se: Neni 21, pika 2: “ <i>Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit.</i> ”; Neni 2, pika 2, germa “a”: “ <i>Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën: a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës</i> ”. Pasi bazuar në dokumentacionin rezulton se: Nga repartet ushtarake nevojat e paraqitura nuk janë të analizuara dhe të argumentuar mbi dokumentacione si: gjendja e mallrave në magazinë bazuar në

	kontratën e ekzekutuara një viti më parë, situacione apo kartela shoqërues të lindjes së nevojave për blerje të këtyre mallrave, si dhe elementëve të tjerë, të cilët nuk janë përjashtues. - Përsëritja e kërkesave, për e mallrat, veglat ndërtimore, hidraulike dhe elektrikë, të cilat shumë herë dublohen, nuk janë analizuar, studiuar në lidhje me konsumin e tyre, pasi ekzistojnë shumë mallrat të cilat kane jetëgjatësi dhe nuk janë produkte konsumi.
<b>Kriteri:</b>	Ligji Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1; -VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2, pika 1 dhe pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Rritja e shpenzimeve të Autoritetit Kontraktor.
<b>Shkaku:</b>	Mos argumentim dhe dokumentim i nevojave për mallra.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandëve në bashkëpunim me Komandën Mbështetëse të marri masat që në të ardhmen, për procedurat e tenderimit në lidhje me blerjen e mallrave për mirëmbajtjen e përgjithshme, të dokumentohet analiza mbi nevojat e njësisë për mallra, si dhe në përlllogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, me qëllim mirëmenaxhimin e fondeve publike.

#### ***b. Mbi vlerësimin e ofertave.***

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali datë 15.05.2023 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE me ofertat si më poshtë:

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, është skualifikuar, operatori ekonomik “E.V.” sh.p.k., me NUIS ....., për shkak se nuk i plotëson kërkesat për kualifikim, pasi ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion në përmbushje të kërkesave për kualifikim, nuk ka paraqitur mostra sipas kërkesës së DT dhe nuk ka paraqitur as ofertë ekonomike.

Nga KVO janë mbajtur procesverbalet me datën 15.05.2023 të pritjes administrative të mostrave për 5 OE sipas përcaktimit të pikës 2.2.3 të DT.

Me datën 14.06.2023 nga KVO është mbajtur procesverbali i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ku është shpallur fitues OE L.VII” sh.a., me NUIS ....., ku i është kërkuar dhe paraqitja e dokumentacionit fizik përpara publikimit të njoftimit dhe nisjes së afateve të ankimimit.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me shkresën nr. 534/4 datë 30.06.2023.

Nga KVO është përpiluar raporti përmbledhës i procedurës me objekt “Blerje materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme” prot. 534/5, datë 11.07.2023.

Me urdhërin nr. 1206 Prot., 534/6, datë 11.07.2023 të titullarit të AK është urdhëruar:

Lidhja e kontratës mes OE L.VII” sh.a dhe Komandës Mbështetëse.

Komandës Mbështetëse përgjigjet për administrimin e marrëdhënieve kontraktuale dhe kryerjen e pagesave.

Komandës Mbështetëse të përcjellë pranë drejtorisë së prokurimeve dhe Ankandëve brenda 3 ditëve nga nënshkrimi planin e zbatimit të kontratës dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i kontratës raportin përfundimtar për ekzekutimin e saj, i cili të përmbajë informacion në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra.

Me shkresën nr. 4264, datë 31.07.2023 është dërguar dokumentacioni për lidhjen dhe zbatimin e kontratës pranë Komandës Mbështetëse.

Komandës Mbështetëse me shkresën nr. 5231/4, datë 07.08.2023 dërgon njoftimin për

publikimin e kontratës së nënshkruar me nr. 5131/3, datë 07.08.2023, si dhe planin e zbatimit të kontratës.

**11.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt "Ndërtim palestre e Regjimentit Operacional Special", në Repartin Ushtarak nr. 1040" konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim palestre e Regjimentit Operacional Special", në Repartin Ushtarak nr. 1040"</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur" REF-07011-10-01-2021 Urdhri nr. 1396, datë 14.09.2021.	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> Urdhri nr. 1396, datë 14.09.2021	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> G. J. E. F. E. M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr 1396/1 datë 14.09.2021 D. K. E. T. N. L.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 36,483,524 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 22,911,619 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 13,571,905 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 19.10.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 21 b) S'kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 19 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 120 ditë</b>			
<b>10. Ankimime</b> S'ka	<b>11. Përgjigje Ankesës</b>	<b>12. Përgjigje</b> .	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes FA dhe "E" shpk datë 14.02.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi është realizuar nga Komanda e Forcave të Armatosura.		

**a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

- Me urdhrin e prokurimit me nr. 1396, prot. 4221/2, datë 14.09.2021 të z. A. C., Sekretar i Përgjithshëm, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 36,483,525 lekë pa TVSH, me objekt "Ndërtim palestre e Regjimentit Operacional Special", në Repartin Ushtarak nr. 1040" dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga G. J., E. F. dhe E. M..

Fondi i prokuruar prej 9,120,834 lekë pa TVSH vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2021 për Komandën e Forcave të Armatosura dhe 27,362,690 lekë pa TVSh vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për vitin 2022.

Me urdhrin nr. 1396/1, prot., 4221/2, datë 14.09.2021, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, D. K., E. T. dhe N. L..

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Me shkresën nr. 4221/4, datë 30.09.2021 është publikuar njoftimi i shkurtuar i kontratës me objekt "Ndërtim palestre në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë".

Nga NJP me datën 01.10.2021 është mbajtur procesverbali i hartimit të dokumenteve të tenderit Nga NJP me datën 01.10.2021 është mbajtur procesverbali i argumentimit dhe miratimit i specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Me datën 10.06.2021 nga APP është dërguar e-maili mbi kriteret e DT përkatësisht për pikën: 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 27001:2013** mbi "Menaxhimin e sigurisë së informacionit", lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Vlerësojnë se kërkesa nuk është lidhur ngushtë me objektin e kontratës, për të cilën

rekomandojmë rishikimin e këtij kriteri në përputhje me nenin 44 pika 3 të VKM-së nr. 285. Sa më sipër AK duhet të mbajë në konsideratë përcaktimet e nenit 78 të VKM-së 285 dhe nenit 76.

AK me procesverbalin e datës 08.10.2021 ka sqaruar arsyen e vendosjes së këtij kriteri i cili është i lidhur me zbatimin e kontratës në vijimësi. Gjithashtu sqarojmë se nga eksperiencia e AK, kjo kërkesë nuk kufizon pjesëmarrjen e ofertuesve, pasi shumë shoqëri që ushtrojnë aktivitetin tregtar në fushën objekt prokurimi, janë të pajisura me certifikatën e kërkuar dhe zbatojnë standardet e menaxhimit të sigurisë së informacionit.

#### ***b. Mbi vlerësimin e ofertave.***

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 19.10.2021 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 21 OE.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 25.11.2021 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ku janë kualifikuar 9 OE dhe nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm :

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "M." shpk., me NUIS J.... dhe "A." shpk., me NUIS L.....

#### **Për arsyet e mëposhtme:**

1. Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "M." shpk. dhe "A." shpk., nuk është plotësuar në përputhje me shtojcën 1 "Formulari i ofertës", shtojcën 2 "Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit" dhe shtojcën 10 "Preventivi i punimeve", të dokumenteve të tenderit, pasi në ofertën e paraqitur nga ofertuesi në seksionin "Shkarkimi i brendshëm i ujerave të zeza të brendshme dhe të jashtëm" është ndryshuar sasia e artikullit/zërit me nr. 13 dhe emërtesë "*F.V. Tubo shkarkimi PVC d160 mm*", nga 25 ml në 15 ml.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson se ashtu si kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi edhe sasi të zërave të punimeve të përcaktuara në preventivin e punimeve, janë të detyrueshme dhe s'mund të ndryshohen nga ofertuesit.

Në rastin konkret, oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "M." shpk. dhe "A." shpk., nuk përmbush kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit, ndaj konsiderohet e pavlefshme.

2. Operatori ekonomik "I." shpk., me NUIS J.....

Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik "I." shpk., nuk është plotësuar në përputhje me shtojcën 2 "Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit", të dokumenteve të tenderit, pasi në ofertën e paraqitur nga ofertuesi nuk janë ofertuar të gjithë zërat e preventivit, konkretisht si më poshtë:

- Në seksionin I "Punime prishje", nuk është ofertuar zëri me numër rendor 2 dhe emërtesë "Transport mbetje ndertimi, me auto deri 5.0 km".
- Në seksionin II "Punime ndërtimore", nuk është ofertuar zëri i rubrikës "F-Punime bojatisje", me emërtesë "Boje hidroplastike importi cilësi e I-rë".

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendosi të refuzojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik "I." shpk.

Nga KVO është kërkuar OE "E." shpk një sqarim për ofertën anomalisht të ulët.

Kjo kërkesë është bërë me datën 17.11.2021. në SPE, ku nga OE është dërguar kthim përgjigje në datën 19.11.2021 në SPE si dhe janë administruar dokumentacioni bashkëngjitur me shkresën nr. 5573, datë 19.11.2021.

Nga KVO shpjegimet e dhënë nga OE "E." shpk si dhe analizën e çmimeve të dërguar e ka gjykuar si ofertë të rregullt me gjithë elementët.

Nga KVO është kërkuar BOE "I.G." shpk dhe "2. K." shpk sqarim për ofertën anomalisht të

ulët. Kjo kërkesë është bërë me datën 17.11.2022. në SPE, ku nga OE është dërguar kthim përgjigje në datën 22.11.2021 në SPE si dhe janë administruar dokumentacioni bashkëngjitur me shkresën nr. 5598, datë 22.11.2021.

Nga KVO shpjegimet e dhënë nga BOE si dhe analizën e çmimeve të dërguar e ka gjykuar si ofertë të rregullt me gjithë elementët.

Nga KVO pas shqyrtimit të Ofertës së paraqitur nga OE/ “E.” shpk ka konstatuar se në **II- “Punime Ndërtimore” në seksionin A- Punime Dheu në Zërin 2,258 “Shtrese çakelli t = 20 cm”** është ndryshuar sasia e artikullit/zërit nga 250 m3 në 250.5 m3.

KVO e ka argumentuar si gabim aritmetik dhe i ka kërkuar OE “Kërkesë për pranimin e korrigjimit të gabimit aritmetik në ofertën e paraqitur dhe shpjegime për elementët të veçantë të ofertës”.

Me datën 31.12.2021 nga KVO është mbajtur procesverbali i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE i kualifikuar.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me shkresën nr. 4221/7 datë 06.12.2021.

Nga KOV është përpiluar raporti përmbledhës i procedurës me objekt "Ndërtim palestre e Regjimentit Operacional Special", në Repartin Ushtarak nr. 1040” me nr. 34, datë 05.01.2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE plotëson kriterin “kapacitetet teknike dhe profesionale”.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditmi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- OE fitues nuk plotëson kriteret e vendosura dhe të kërkuar në DT pika 2.3.3 “Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik” pika; Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj Gusht 2021, ku: “<i>Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listpagesat e shoqërisë për periudhën Maj - Gusht 2021. Përjashtim nga kjo bëjnë vetëm “Punonjësit e kualifikuar si (Eskavatorist, Buldozerist dhe Automakinist)”, të kërkuar sipas shkronjës “e”, të cilët përveç se si pjesë e stafit të ofertuesit (në listpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qira</i>”.</li> </ul> <p>Listëpagesës së dorëzuar për plotësimin e kriterëve të DST, të cilat kanë qenë me kode që <b>NUK</b> përkonin me kodet e profesioneve të kërkuara në DST në pasi punonjësit e deklaruar nga OE në listëpagesë janë me kodin 9312.06, ku sipas VKM-së nr. 514, date 20.9.2017 "<i>Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)</i>", të rishikuar mbi të cilën janë vendosur dhe kriteret kualifikuese janë të gjithë të kategorizuar “Punëtor krahu”.</p> <p><i>Gjithashtu u konstatua se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- F. M., Sp konstruksionesh është punësuar në qershor dhe deklaruar në listëpagesën e qershorit për 10 ditë pune.</li> <li>- M. Q., Hekurkthyes është punësuar në gusht dhe deklaruar në listëpagesën e gushtit për 10 ditë pune.</li> </ul> <p>A. R., Elektracist nuk është në Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj - Gusht 2021. Pra OE fitues nuk plotëson kërkesën e DT.</p> <p>Sa më sipër OE nuk plotëson kriterin e mësipërm të vendosur nga Njësia e Prokurimit.</p> <p>Bazuar në praktikën e <b>Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr. 480/2020 i datës 29.10.2020</b>, i cili parashikon se: “<i>KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve</i></p>



ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumentet duhet të refuzohen si të papranueshme.”, si edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, i cili parashikon listën kombëtare të profesioneve, të cilët identifikohen me anë të kodeve në listëpagesë. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s’kualifikimi.

Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 gërma ë parashikon: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë të dërguar nga ofertuesi, grupi i auditimit konstaton se për punonjës të specializuar, e kërkuar në pikën 2.3.3 “Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik” pika b, ku “për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë: një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (**dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë**), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore” janë lëshuara nga C. C. I. me NIPT L..., e cila nuk ka licence aktive në QKL dhe për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat kualifikuese nga Institucione të licencuara/ akredituara.

C. C. I., e cila ka lëshuar certifikatat e trajnimit, nuk është e licencuar nga MFE dhe nuk disponon licence për të ofruar kurse trajnimi formimi profesional sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori “E.” për punonjësin nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi institucioni lëshues i certifikatave të trajnimit, konkretisht shoqëria C.C.I. nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë". Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me

	Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar nga një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar. Për sa më sipër cituar, në kushtet kur shoqëria C.C.I., nuk është e licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Certifikatat e Trajnimit, lëshuar nga C.C.I. për kurs trajnimi; Teknik Ndërtimi; “Hidraulikë në banesa dhe ujësjellës; Elektricitet në banesa dhe të tjerë të ngjashëm; Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm; Saldator dhe prerës të metaleve;Karpentier; Hekurkthyes; Bojaxhinj ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to; Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to; Suvatues; Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm etj.” nuk mund të konsiderohen se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor për “dëshmi profesionale të punonjësve”, në dokumentet e tenderit.
<b>Kriteri:</b>	- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, - Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 3, neni 92 pika 1 dhe 2; - VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 pika 4: - Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kriterëve të kërkuar në DST.
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Me urdhrin nr. 1 Prot., 34/1, datë 05.01.2022 të titullarit të AK, z. A. C. është urdhëruar:

Lidhja e kontratës mes OE “E.” shpk dhe Komandës së Forcave të Armatosura.

Komanda e Forcave të Armatosura përgjigjet për administrimin e marrëdhënieve kontraktuale dhe kryerjen e pagesave.

Komanda e Forcave të Armatosura të përcjellë pranë drejtorisë së Prokurimeve dhe Ankandëve brenda 3 ditëve nga nënshkrimi planin e zbatimit të kontratës dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i kontratës raportin përfundimtar për ekzekutimin e saj, i cili të përmbajë informacion në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra.

- Komanda e Forcave të Armatosura të zhvillojë procedurën e prokurimit për përcaktimin e mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit gjatë zbatimit të kontratës dhe kolaudatorit të punimeve. Me shkresën nr. 34/2, datë 06.01.2022 është dërguar dokumentacioni për lidhjen dhe zbatimin

e kontratës pranë Komandës së Forcave të Armatosura.

Komanda e Forcave të Armatosura me shkresën nr. 810 datë 14.02.2022 dërgon njoftimin për publikimin e kontratës me nr. 707, datë 14.02.2022, si dhe planin e zbatimit të kontratës me nr. 707/2, datë 22.02.2022.2022.

**12.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim palestre në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë” konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim palestre në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë”.</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-12916-11-24-2021 Urdhri nr. 4221/6, datë 29.10.2021.	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b>	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> M. N. G. J. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr.409/1 datë 21.09.2021 D. K. E. T. N. L.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 36,483,525 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 22,392,300 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 14,091,225 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 10.12.2021	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 14 b) S’kualifikuar 5 OE, c) Kualifikuar 9 OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 120 ditë</b>			
<b>10. Ankimime</b> S’ka	<b>11. Përgjigje Ankesës</b>	<b>12. Përgjigje</b> .	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes KFA dhe “E.” shpk me nr. 775/6 datë 28.03.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi është realizuar nga Komanda e Forcave të Armatosura		

**a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

- Me urdhrin e prokurimit të z. A. C., Sekretar i përgjithshëm, nr. 1623, prot. 4221/6, datë 29.10.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 36,483,525 lekë pa TVSH, me objekt “Ndërtim palestre në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga G. J., M. M. dhe E. Sh..

**Konstatim:**

Urdhri për marrjen e angazhimit ka dalë me datën 29.10.2021, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” pika 83 ku citohet se...“Nëpunësi autorizues i njësisë së qeverisjes së përgjithshme mund të ndër marrë angazhime të reja gjatë vitit buxhetor, por jo më vonë se data 15 tetor e çdo viti buxhetor”. Në lidhje me fondin e prokuruar nuk është cituar nëse ka qenë në dispozicion nga buxheti i shtetit për realizimin e kësaj procedure.

Me urdhrin nr. 1623/1, prot., 4221/6, datë 29.10.2021, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, D. K., E. T. dhe N. L..

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Nga NJP me datën 24.11.2021 është mbajtur procesverbali i argumentimit dhe miratimit i specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

**b. Mbi vlerësimin e ofertave.**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 10.12.2021 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 14 OE

Nga KVO është kërkuar OE "E." shpk një sqarim për ofertën anomalisht të ulët.

Kjo kërkesë është bërë me datën 25.01.2023. me shkresën nr. 466 datë 28.01.2022 është dërguar sqarim nga OE. Ku nga KVO janë dukur të arsyeshme për ta kualifikuar si ofertë.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 31.01.2022 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ku janë kualifikuar 9 OE dhe nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "A. C." shpk, për arsye se:

- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve. Konkretisht ofertuesi nuk plotëson kërkesën në lidhje me disponimin e punonjësve "*Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm*", pasi në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 ka deklaruar si "*përgatitës të konstruksioneve metalike*" z. F. Ll. dhe z. F. H., por nga dokumentacioni i ngarkuar në SPE rezulton se këto punonjës kanë dëshmi kualifikimi si hekurkthyes dhe kontratat e lidhura me to janë përkatësisht, për z. F. Ll. hekurkthyes dhe punues mermeri, ndërsa për z. F. H. specialist ndërtimi.
- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/e, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e punonjësve të kualifikuar "*Buldozerist*".
- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme për realizimin e kontratës, pasi në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 nuk ka deklaruar që disponon mjetet e kërkuara "*Matrapik*", "*Moto gjenerator*", "*Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)*" dhe "*Betoniere kantieri*".

2. Operatori ekonomik "C. R. 2008" shpk., për arsye se:

- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3 dhe 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me paraqitjen e personelit dhe mjeteve të nevojshme për zbatimin dhe realizimin me sukses të punimeve objekt kontrate. Një pjesë e personelit dhe e mjeteve të deklaruara nga operatori ekonomik "C.R.2008" shpk. për përmbushjen e kriterit të mësipërm janë aktualisht të angazhuar në dy kontrata të tjera pranë Autoritetit Kontraktor (Ministria e Mbrojtjes) dhe konkretisht:
  - inxhinier ndërtimi z. I. K., inxhinier markshajder z. A. M., teknik ndërtimi z. H. P., përgatitës konstruksionesh z. K. S., saldator z. B. K., karpentier z. Xh. D., hekurkthyes z. Rr. Gj. dhe z. J. D, ekskavator z. I. K. si dhe automjeti "kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton" me targë A....., janë të angazhuar në kontratën me objekt "Loti nr. II, me objekt "*Riparimi i dëmtimeve të argjinaturës së lumit Buna në Dajç, Shkodër*", zbatimi i të cilës ka filluar më datë 28.12.2021 dhe ka si afat realizimi datën 28.03.2022 dhe;
  - inxhinier ndërtimi z. I. K., inxhinier markshajder z. A. M., përgatitës konstruksionesh z. K. S., saldator z. B. K., karpentier z. A. K., hekurkthyes z. Rr. Gj. dhe z. J. D, buldozerist z. Sh. M. si dhe automjeti "kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton" me targë AB719AE, janë të angazhuar në kontratën me objekt "*Mbrojtja nga lumi i Vjosës, Varibop/Kashisht, Fier*", zbatimi i të cilës ka filluar më datë 28.12.2021 dhe ka si afat realizimi datën 28.03.2022.

3. B.O.E. "I.G." shpk. dhe "2. K." shpk, për arsye se:

- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të

dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve. Konkretisht asnjëri nga anëtarët e BOE nuk plotëson kërkesën në lidhje me disponimin e punonjësve “Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm”, pasi në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 nuk kanë deklaruar se disponojnë punonjës të kualifikuar si më sipër.

4. B.O.E. “J.” shpk. dhe “G. B.” shpk., për arsye se:

- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.3/b, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit, lidhur me disponimin e punonjësve të specializuar/të kualifikuar të nevojshëm për realizimin e punimeve. Konkretisht BOE nuk plotëson kërkesën në lidhje me disponimin e punonjësve “hidraulikë në banesa dhe ujësjellës – 2 (dy)” dhe “karpentier - 2 (dy)”. Në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8, vetëm njëri nga anëtarët ka deklaruar se disponon punonjës si më sipër dhe konkretisht shoqëria “J.” shpk. ka deklaruar se disponon 1 (një) punonjës “karpentier”, z. V. B. dhe 1 (një) punonjës “hidraulik”, z. K. K., ndërsa shoqëria “G.B.” shpk. në formularin e vetdeklarimit sipas shtojcës 8 nuk ka deklaruar se disponon punonjës të kualifikuar si “hidraulik” dhe “karpentier”.
- nuk plotëson kërkesën e pikës 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim, të dokumenteve të tenderit lidhur me disponimin e certifikatave të kërkuara, pasi shoqëria “G. B.” shpk. nuk disponon “Certifikatë **ISO 27001:2013** mbi “Menaxhimin e sigurisë së informacionit”.

5. B.O.E. “O.K.” shpk. dhe “E.K.” shpk., për arsye se oferta e paraqitur nuk është plotësuar në përputhje me shtojcën 1 “Formulari i ofertës ekonomike” dhe shtojcën 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, të dokumenteve të tenderit, pasi në ofertën e paraqitur ka gabim në sasi, konkretisht:

- Në kreun “II-PUNIME NDERTIMORE”, zëri “B-Punime Suvatimi”, nr. rendor 1 “Suva brenda mur tulle h~4m me krah, llaç perzier M 25”, sasia e kërkuar është 1.750 (një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) ndërsa sasia e ofertuar është 314 (treqind e katërmbëdhjetë);
- Në kreun “VI-PUNIMET ELEKTRIKE”, zëri “B-Instalimet Elektrike”, nr. rendor 32 “F.V. Automat 2P/M-10A magnetik termik”, sasia e kërkuar është 1 (një) ndërsa sasia e ofertuar është 10 (dhjetë).

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE plotëson kriterin “kapacitetet teknike dhe profesionale”.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE, rezultoi se - OE fitues nuk plotëson kriteret e vendosura dhe të kërkuar në DT pika <u>2.3.3</u> “Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik” pika; Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Maj Gusht 2021, ku: “ <i>Të gjithë punonjësit e kërkuar sipas pikës 2.3.3, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Maj - Gusht 2021. Përjashtim nga kjo bëjnë vetëm “Punonjësit e kualifikuar si (Eskavatorist, Buldozerist dhe Automakinist)”, të kërkuar sipas shkronjës “e”, të cilët përveç se si pjesë e stafit të ofertuesit (në listëpagesat e tij) mund të jenë të kontraktuar vetëm në rastet kur mjetet/makinëritë disponohen me qira</i> ”. Listëpagesës së dorëzuar për plotësimin e kriterëve të DST, të cilat kanë qenë me kode që <b>NUK</b> përkonin me kodet e profesioneve të kërkuara në DST në pasi punonjësit e deklaruar nga OE në listëpagesë janë me kodin 9312.06, ku sipas VKM-së nr. 514, date 20.9.2017 “ <i>Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)</i> ”, të rishikuar mbi të cilën janë vendosur dhe kriteret kualifikuese janë të gjithë të kategorizuar “Punëtor

	<p>krahu”.</p> <p>Kërkesat e shkronjës "b", pika 2.3.3, të kritereve të veçanta për kualifikim, të DT, sipas se cilës operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të disponojnë punonjës të specializuar/te kualifikuar, ku ndër të tjerë janë kërkuar edhe punonjës të specializuar/te kualifikuar si "Përgatitës të konstruksioneve dhe të ngjashme", "Hidraulike në banesa dhe ujësjellës", "Elektricitete në banesa dhe të tjera të ngjashme" dhe "Bojaxhi ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to", janë bazuar në: - pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23. 12.2020 "Për prokurimin publik",</p> <p>- nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe</p> <p>- në VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar.</p> <p>a) Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë:</p> <p>“Bojaxhi ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to” dhe “Saldator dhe prerës të metaleve”</p> <p>Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- kontratën individuale të punës;</li> <li>- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritete përgjegjëse shtetërore.</li> </ul> <p>Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se asnjë nga punonjësit që do angazhohen nuk e kanë dëshmi kualifikimi profesional “Bojaxhi ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to”.</p> <p>Të gjithë kanë certifikatë kualifikimi “Bojaxhi”, Si dhe “Saldator dhe prerës të metaleve”, të gjithë kanë certifikatë kualifikimi saldator. Etj</p> <p>Bazuar në praktikën e <b><u>Komisionit të Prokurimit Publik vendimi nr. 480/2020 i datës 29.10.2020</u></b>, i cili parashikon se: <i>“KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumentet duhet të refuzohen si të papranueshme.”</i>, si edhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, i cili parashikon listën kombëtare të profesioneve, të cilët identifikohen me anë të kodeve në listëpagesë. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të</p>
--	--

Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 gërma ë parashikon: “Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

- Pas shqyrtimit të dokumentacionit të plotë të dërguar nga ofertuesi, grupi i auditimit konstatoj se për punonjës të specializuar, e kërkuar në pikën 2.3.3 “Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik” pika b, ku “për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë: një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (**dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë**), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore” janë lëshuara nga C.C.I. me NIPT L....., e cila nuk ka licence aktive dhe për rrjedhojë nuk përmbush kërkesat kualifikuese nga Institucione të licencuara/ akredituara.

C.C.I., e cila ka lëshuar certifikatat e trajnimit, nuk është e licencuar nga MFE dhe nuk disponon license për të ofruar kurse trajnimi formimi profesional sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.

Dokumentacioni i paraqitur nga operatori “E.” për punonjësin nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pasi institucioni lëshues i certifikatave të trajnimit, konkretisht shoqëria C.C.I. nuk është licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë". Formimi profesional i personelit përbën domosdoshmëri dhe garanton autoritetin kontraktor për kapacitetet profesionale të ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës, gjë e cila vërtetohet vetëm me Certifikatë/dëshmi/diplomë që është dokument zyrtar dhe i lëshuar nga një organ certifikues, sipas procedurave standarde ligjore dhe që regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit të caktuar. Për sa më sipër cituar, në kushtet kur shoqëria C.C.I., nuk është e licencuar nga ana Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe nuk disponon asnjë licencë për të ofruar kurse trajnimi për formimin profesional në përputhje me ligjin nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Certifikatat e Trajnimit, lëshuar nga C.C. I. për kurs trajnimi; Teknik Ndërtimi; “Hidraulikë në banesa dhe ujësjellës; Elektricitet në banesa dhe të tjerë të ngjashëm; Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm; Saldator dhe prerës të metaleve; Karpentier; Hekurkthyes; Bojaxhinj ndërtesash dhe të tjerë që lidhen me to; Shtgues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to; Suvatues; Muratorë dhe të tjerë të ngjashëm etj” nuk mund të konsiderohen se përmbushin kriterin e përcaktuar nga autoritetit kontraktor për “dëshmi profesionale të punonjësve”, në dokumentet e tenderit.

	2. Nga auditimi i dokumenteve të operatorit të shpallur fitues, konstatohet se ky operator ka paraqitur të njëjta dokumente si në procedurën me objekt “Ndërtim palestres e Regjimentit Operacional Special”, në Repartin Ushtarak nr. 1040” zhvillimi i procedurës është realizuar 19.09.2021. Pra, personeli i deklaruar nga OE, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, rezulton se është deklaruar edhe në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim palestres e Regjimentit Operacional Special”, në Repartin Ushtarak nr. 1040”, të realizuar nga Autoriteti Kontraktor Ministria e Mbrojtjes, për të cilën ky OE, është shpallur fitues. Pra OE ka paraqitur identik të njëjtin dokumentacion dhe është shpallur fitues në të dy procedurat prokuruese, çka nuk plotëson në mënyrë kumulative kërkesat për kapacitetet teknike të pikës 2.3.2 të DT.
<b>Kriteri:</b>	- Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar”, - Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 pika 3, neni 92 pika 1 dhe 2; - Termat e referencës procedurës “Punë Publike” dhe dokumentet e tenderit. - VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 pika 4: - Ligji nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kritereve të kërkuar në DST.
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

13. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për Flotën Luftarake”, për nevoja të Komandës së Forcës Detare”, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> “Blerje materiale për Flotën Luftarake”, për nevoja të Komandës së Forcës Detare.			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-96747-05-28-2021	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> G. J. E. F. A. K.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> G. J. E. F. A. K.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr 396/1 datë 30.03.2021 D. K. A. C. N. L.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 31,608,310 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 24,187,220 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 7,421,090 lekë



7/1 Data e hapjes së tenderit Data 26.06.2021	8. Burimi Financimit Buxheti i Shtetit	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 b) S' kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
7/2 Kohëzgjatja e kontratës, brenda vitit 2021		
10. Ankimime S'ka	11. Përgjigje Ankesës	12. Përgjigje
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>		
13. Lidhja e kontratës Është lidhur kontrata mes KFD dhe "A...A..." me nr. 442/1, datë 08.10.2021.	Zbatimi i kontratës: Zbatimi është realizuar nga Komanda e Forcave Detare.	

### a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:

Me shkresën nr. 924/1, datë 16.03.2021 nga Komanda e forcës Detare është dërguar dokumentacionin pranë MM për zhvillimin e procedurës "Blerje materialesh për Flotën Luftarake", për nevoja të Komandës së Forcës Detare".

Bashkëlidhur kërkesës është informacioni mbi sasinë e kërkuar për artikuj, specififikimet teknike, si dhe përlllogaritja e fondit limit.

Sipas natyrës së objektit të prokurimit bazuar në urdhrin nr. 461, datë 23.12.2020, "Për ngritjen e komisionit për argumentimin e fondit limit për blerjen e materialeve Tekniko Detare për mirëmbajtjen e anijeve për vitin 2021". Fondi është përlllogaritur pas marrjes së ofertave nga tre OE. Komisioni ka mbajtur procesverbalin me nr. 1 me datë 01.03.2021, ku është përlllogaritur fondi limit për njësi.

- Me urdhrin e prokurimit të z. A. C., Sekretar i përgjithshëm, nr. 396, prot. 1607/1, datë 30.03.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 31,608,310 lekë pa TVSH, me objekt "Blerje materialesh për Flotën Luftarake", për nevoja të Komandës së Forcës Detare" dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga G. J., A. K. dhe E. F..

Me urdhrin nr. 396/1, prot., 1607/1, datë 30.03.2021, ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave me anëtar, D. K., A. C. dhe N. L..

*Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Nga NJP me datën 26.05.2021 është mbajtur procesverbali i hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit.

Me shkresën nr. 1607/2, datë 28.05.2021 është publikuar njoftimi i kontratës me objekt "Blerje materialesh për Flotën Luftarake", për nevoja të Komandës së Forcës Detare".

Me datën 07.06.2021 nga APP është dërguar e-maili mbi kriteret e DT përkatësisht për pikën: **2.3.5** Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 27001:2013** mbi "Menaxhimin e sigurisë së informacionit", lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Vlerësojnë se kërkesa nuk është lidhur ngushtë me objektin e kontratës, për të cilën rekomandojmë rishikimin e këtij kriteri në përputhje me nenin 79 pika 4 të LPP-së.

AK me procesverbalin e datës 08.06.2021 sqaron se: Zbatimi i kontratës nga operatori ekonomik që do të rezultojë fitues do të bëhet në ambientet e brendshme të repartëve ushtarak dhe pavarësisht rregullave dhe masave që Forcat e Armatosura zbatojnë për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, personeli i kontraktorit mund të bjerë në kontakt me informacion të kufizuar.

Për sa më sipër, Njësia e Prokurimit e vlerëson rekomandimin e APP, por e konsideron vendosjen e kësaj kërkesë në përputhje dhe të lidhur ngushtë me objektin e kontratës, pasi ISO/IEC 27001:2013) përcakton një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, vlerësohet në përputhje dhe e lidhur me objektin e kontratës.

### ***b. Mbi vlerësimin e ofertave.***

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 25.06.2021 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE me ofertat si më poshtë:

- Operatori ekonomik "A." sh.a., me NUIS K..... dhe ofertë në vlerën 24,187,220 lekë pa TVSH;

- Operatori ekonomik "T." sh.p.k., me NUIS L..... dhe ofertë në vlerën 30,818,100 lekë pa TVSH.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali nr. 3, datë 06.08.2021 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ku është skualifikuar OE "T." shpk për arsyet e mëposhtme:

- Operatori ekonomik "T." sh.p.k., me NUIS L....., me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e kërkesave për kualifikim të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit, pasi ka mangësitë si vijon:

Nuk plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.5 të Kapacitetit Teknik, pasi nga verifikimet e bëra lidhur me mostrat e paraqitura rezultuan mangësitë si më poshtë:

**I.** Mostra e paraqitur për artikullin me numër rendor 42, me emërtesë "Anoda Xingato Alumini Penguen A3Z", nuk përputhet me kërkesat teknike të vendosura në DT.

Konkretisht:

- gjatësia e kërkuar është 260 mm, ndërsa artikulli i ofruar është me gjatësi 400 mm;

- trashësia e kërkuar është 40 mm, ndërsa artikulli i ofruar është me trashësi 60 mm.

**II.** Mostra e paraqitur për artikullin me numër rendor 162, me emërtesë "Vardallak i mbushur me shkumë me cimë  $\Phi = 16$ ", nuk përputhet me kërkesat teknike të vendosura në DT.

Konkretisht, të dhënat e kërkuara janë si më poshtë:

- gjatësia është 110 cm, diametër 30 cm dhe pesha 10-15 kg, ndërsa artikulli i ofruar është me të dhënat gjatësi 60 cm, diametër 15 cm dhe peshë 6 kg.

**III.** Mostra e paraqitur për artikullin me numër rendor 196, me emërtesë "Panel Diellor 20W", nuk përputhet me kërkesat teknike të vendosura në DT. Konkretisht, të dhënat e kërkuara janë si më poshtë:

- gjatësi 550 mm, lartësi 25 mm, gjerësi 360 mm dhe fuqi 20W, ndërsa artikulli i ofruar është me të dhënat: gjatësi 630 mm, lartësi 20 mm dhe fuqi 30Ë.

**IV.** Mostra e paraqitur për artikullin me numër rendor 231, me emërtesë "Fener deti i bardhë", nuk përputhet me kërkesat teknike të vendosura në DT. Konkretisht, artikulli i kërkuar është me përmasat: 11 ½ "hx7" "1x7" w, me peshë 2,5 kg, burimi i llambës LED me fuqi të lartë, materiali polikarbonat Lexan, me ndikim të lartë dhe dukshmëria 1-3 milje. Artikulli i ofruar është me peshë 0,5 kg, materiali plastik i thjeshtë dhe me burim llambe jo LED.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me shkresën nr. 4017/1 datë 23.08.2023.

Nga KOV është përpiluar raporti përmbledhës i procedurës me objekt "Blerje materialesh për Flotën Luftarake", për nevoja të Komandës së Forcës Detare" prot. 1627/3, datë 23.08.2021.

Me urdhrin nr. 1193 Prot., 4012 datë 23.08.2021 të titullarit të AK është urdhëruar:

Lidhja e kontratës mes OE "A." sh.a dhe Komandës së Forcës Detare.

Komanda e Forcës Detare përgjigjet për administrimin e marrëdhënieve kontraktuale dhe kryerjen e pagesave në përputhje me kushtet e kontratës.

Komanda e Forcës Detare të përcjellë pranë drejtorisë së prokurimeve dhe Ankandëve informacionin periodik mbi ecurinë e zbatimit të kontratës, i cili të përmbajë informacion në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre.

Me shkresën nr. 4017/2, datë 08.09.2021 është dërguar dokumentacioni për lidhjen dhe zbatimin e kontratës pranë Komandës së Forcës Detare.

Komanda e Forcës Detare me shkresën nr. 3448/3, datë 08.10.2021 dërgon njoftimin për

publikimin e kontratës së nënshkruar me nr. 442/1, datë 08.10.2021, si dhe me shkresën nr. 3448/7, datë 15.10.2021 dërgon planin e zbatimit të kontratës.

Komanda e Forcës Detare me shkresën nr. 39, datë 07.01.2022 dërgon formularin për raportimin e zbatimit të kontratës.

**14.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje materialesh xheniere (elemente për ura Bailey)*” konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materialesh xheniere (elemente për ura Bailey)”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-40735-09-06-2022 Urdhri nr. 1423, datë 01.09.2022.	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> Urdhri nr. 1423, datë 01.09.2022.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> G. J. Major Sh. Gj. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 1423/1, datë 01.09.2022 D. K. Y. Y. E. N.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 66,666,085 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 63.926.330 lekë	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 2,739,755 lekë	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 10.10.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit	<b>9. Operatoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 b) S’kualifikuar 0 OE,	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës,</b> 60 ditë			
<b>10. Ankimime</b> S’ka	<b>11. Përgjigje Ankesës</b>	<b>12. Përgjigje</b> .	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes KM dhe BOE “T... D..” dhe “3. – P...” me nr. 6705/2, datë 11.11.2022	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi është bërë nga Komanda Mbështetëse.		

**a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

- Me urdhrin e prokurimit të znj. G. P., Sekretar i Përgjithshëm, nr. 1423, prot. 4155/2, datë 01.09.2022, urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 66,666,085 lekë pa TVSH, me objekt “*Blerje materialesh xheniere (elemente për ura Bailey)*” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga G. J., Major Sh. Gj. dhe E. Sh..

Kërkesa për blerjen e materialeve është bërë nga Komanda Mbështetëse me nr. 4547/3, datë 15.08.2022, në të cilën citon nevojat për realizimin e kësaj procedurë, me listën e artikujve dhe sasisë bazuar në kërkesat e Repartit Ushtarak 4040. Nevojat për materiale kanë dalë pas një analize të gjendjes së tyre në depo.

- Rikonicionet e kryera në bashkinë Kukës, Has, Konispol, Berat, Dimal, Tiranë, Gramsh, Bulqizë, Klos, Pukë, Tropojë dhe Dibër për vitin 2022.

*Specifikimet teknike të materialeve bazuar në “Manualin për përdorimin e urave Baaily”*

*Nga komisioni është mbajtur procesverbali nr. 1 datë 05.08.2022.*

Me shkresën nr. 4155/1, datë 01.09.2022 nga z. D. K. drejtuar Znj. G. P. titullarë të AK dhe Z. Y. Y. drejtor i DPSHM, kërkon miratimin e kërkesave dhe fillimin e procedurës së prokurimit. *Nga auditimi i Dokumenteve të Tenderit nëpërmjet dosjes fizike dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE) rezultoi:*

Me shkresën nr. 4155/4, datë 06.09.2022 është publikuar njoftimi i shkurtuar i kontratës me objekt “*Blerje materialesh xheniere (elemente për ura Bailey)*” .

Nga NJP me datën 06.09.2022 është mbajtur procesverbali i argumentimit dhe miratimit i specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim.

Me shkresën nr. 4155/5 datë 12.09.2022 të Titullarit të AK drejtuar Komandës Mbështetëse kërkohet krijimi i kushteve të mostrave nga OE të interesuar dhe administrimin e mostrave të artikujve objekt prokurimi pasi:

Në DT në Shtojcën 5 “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar “*Komanda Mbështetëse, me adresë Vaqarr, Tiranë do të vendosë në dispozicion të subjekteve të interesuar, elementët origjinalë të artikujve të mësipërm si mostra për prodhimin apo tregtimin e tyre (nëse këto kërkohen nga operatorë ekonomikë të interesuar)*”.

Si dhe në pikën 2.2.5. Në zbatim të shkronjës a), pikës 6, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, të ndryshuar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga 1 (një) mostër për të gjithë artikujt objekt prokurimi.

Mostrat duhet të shoqërohen me një inventar të tyre sipas listës së kërkuar. *Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

a) Mostrat do të dorëzohen pranë Repartit Ushtarak nr. 4001, me adresë Vaqarr, Tiranë, jo më vonë se data 10.10.2022, ora 10:00 (afat i përcaktuar për dorëzimin e ofertave) dhe për secilin nga mostrat, në procedurën elektronike të prokurimit duhet të paraqiten:

- Lista e mostrave të paraqitura;
- Çertifikatë/dokument mbi origjinën/prodhuesin për secilin nga detalet, lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi.

#### ***b. Mbi vlerësimin e ofertave.***

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali me datë 10.10.2022 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE me ofertat si më poshtë:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “T.D.” shpk, me NUIS J..... dhe “3. – P.” shpk me NUIS K....., me ofertë ekonomike me vlerë 63.926.330 (gjashtëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëzet e gjashtë mijë e treqind e tridhjetë) lekë pa TVSH.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali me datë 18.10.2022 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ku është kualifikuar BOE, me arsyetimin se plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në DT.

Nga Komanda Mbështetëse, komisioni i ngritur sipas urdhërit me nr. 813, datë 07.10.2022 është mbajtur procesverbali nr. 1, datë 10.10.2022 mbi dorëzimin e 14 mostrave nga BOE sipas kërkesave të DT pika 2.2.5 Në zbatim të shkronjës a), pikës 6, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, të ndryshuar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin nga 1 (një) mostër për të gjithë artikujt objekt prokurimi.

Bashkëlidhur procesverbalit është deklarata e origjinës, ku prodhues janë “T.D.” dhe “3. – P.”. Me datën 21.10.2022 nga KVO është mbajtur procesverbali i verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE i kualifikuar, përpara publikimit të BOE fitues.

Nga KOV është përpiluar raporti përmbledhës i procedurës me shkresën nr. 5224/1, datë 31.10.2022.

Formulari i njoftimit të fituesit është publikuar me shkresën nr. 5224/2 datë 31.10.2022.

Me urdhrin nr. 1903 Prot., 5224/2, datë 31.10.2022 të titullarit të AK z. G. P. është urdhëruar:

- Lidhja e kontratës mes BOE “T.D.” shpk dhe “3.-P.” shpk dhe Komandës Mbështetëse.
- Komanda Mbështetëse përgjigjet për administrimin e marrëdhënieve kontraktuale dhe kryerjen e pagesave.
- Komanda Mbështetëse të përcjellë pranë drejtorisë së prokurimeve dhe Ankandëve brenda 3 ditëve nga nënshkrimi planin e zbatimit të kontratës dhe brenda 15 ditëve nga përfundimi i kontratës raportin përfundimtar për ekzekutimin e saj, i cili të përmbajë informacion në lidhje me korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës, problemet e hasura gjatë zbatimit dhe masat e marra.

Me shkresën nr. 5825, datë 08.11.2022 është dërguar dokumentacioni për lidhjen dhe zbatimin e kontratës pranë Komandës Mbështetëse.

Komanda Mbështetëse me shkresën nr. 5996 datë 15.11.2022 dërgon njoftimin për publikimin e kontratës me nr. 6705/4 datë 11.11.2022. Kontrata e nënshkruar me nr. 6705/2, datë 11.11.2022.

**14.1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për xhenion (elemente për ura Bailey)” për vitin 2023, konstatohet:

A. Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për xhenion (elemente për ura Bailey)”			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-67626-04-28-2023	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> G. J. Major Sh. Gj. E. Sh.	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> G. J. Major Sh. Gj. E. Sh.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> D. K. Y. Y. E. N.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 66,666,441 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 64.342.000 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 2,324,441 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 01.06.2023	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 1 b) S’kualifikuar 0 OE,
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 31.12.2023</b>			
<b>10. Ankimime</b> S’ka	<b>11. Përgjigje Ankesës</b>	<b>12. Përgjigje</b> .	
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes KM dhe BOE “T. D.” dhe “3. – P.”	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi është bërë nga Komanda Mbështetëse.		

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos verifikimi nga KVO nëse OE plotëson kriterin “kapacitetet teknike dhe profesionale” për të dy procedurat me objekt “Blerje materiale për xhenion (elemente për ura Bailey)” te realizuara në vitin 2022 dhe 2023.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i vlerësimit të ofertave për të dy procedurat e vitit 2022 dhe vitit 2023 u konstatua se:</p> <p>Në pikën 2.3.3 të DT është kërkuar “Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për të gjithë artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme</p> <p>Në funksion të përmbushjes së kërkesës si më sipër, ofertuesit duhet të deklarojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve dhe nr. i faqes së katalogëve;</li> <li>- kompaninë prodhuese dhe</li> <li>- letër angazhimi e prodhuesit/distributorit të autorizuar (Në rast se do të paraqitet letër angazhimi nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit); me qëllim verifikimin e origjinës së artikullit dhe të dhënave të tjera të deklaruara. Me anë të kësaj skede teknike ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se artikujt/mallrat e ofruar do të jetë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë.</li> </ul> <p>2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të angazhohet se mallrat objekt i prokurimit në momentin e dorëzimit do të shoqërohen me dokumentacionin si më poshtë:</p> <p><i>çertifikatën e origjinës së mallit;</i></p>

	<p><i>çertifikatën e cilësisë;</i>  <i>fletë analize për çdo detal në veçanti;</i>  <i>deklaratë garancie;</i>  OE fitues si BOE; 3. – P. rezulton se nuk është prodhues, ku në skedën teknike tek <b>“Letër angazhimi e Prodhuesit/Distributorit të autorizuar”</b> të paraqitur ka vënë emrin e tij.  Objekti i aktivitetit të tij është <i>“Import-eksport i pjesëve të këmbimit për mjete transporti dhe makineri të gjitha llojeve. Import eksport, tregtim me shumice e pakice i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit, profile hekuri, llamarine, hekur, çimento, tulla, etj. Projektimi, ndërtimi i veprave civile, industriale, turistike, restaurime, ndërtime rrugore, ndërtime vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime hidroteknike, punime mbrojtëse e sistemim hidraulik, etj. Import dhe tregti artikuj ushqimor me shumice dhe pakice”</i>.  <b>Sa më sipër OE/3. – P. nuk e plotëson këtë kriter.</b>  - Nga auditimi i dokumentacioneve të dorëzuar nga OE “T. D.” ShPK shtojca 8 <i>“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”</i> Kapitullin III, Seksioni II, Shkaqet e përjashtimit pika <b>C, Deklarata</b>, “Mbi Konfliktin e Interesit”, OE ka deklaruar se:  <i>“Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu”</i>.  Sa më sipër OE ka bërë deklaram të rremë pasi ortakët e kompanisë janë R. T.- Ortak- 15% A. T.- Ortak – 15% dhe E. T. – Ortak- 70%.  <u>A. T. është Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, post të cilin e mban që nga muaji Nëntorit 2021.</u>  Sa më sipër jemi në shkelje të nenit 21, paragrafi 1, Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik.</p>
<b>Kriteri:</b>	- Ligjin nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” pika 3 shkronja ë parashikon, neni 92 pika 1 dhe 2; - VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 75 pika 4.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Risku i mos përmbushjes së shërbimit objekt prokurimi nga OE, sipas kriterëve të kërkuar ne DST.
<b>Shkaku:</b>	Mos verifikimi nga KVO i dokumenteve të dorëzuara nga OE, në përputhje me DST.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.

<b>Rekomandime:</b>	<p>AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.</p> <p>- AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave të marrë masa, që në rastet e konstatimit të OE në kushtet e konfliktit të interesit, të ndjekë hapat ligjore për raportimin e tyre në organet kompetente, me qëllim përdorimin me efience dhe efektivitet e fondeve publike.</p>
---------------------	---

**15. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore” konstatohet:**

A. Të dhëna mbi objektin

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore”</b>			
<b>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-08550-10-18-2021 Urdhri nr. 1541, datë 12.10.2021.	<b>1.1 Grupi i hartimit kritereve kualifikuese</b> Grupi i punës pranë AKMC	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> G. J. V. L. D. M.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 1654, datë 12.10.2022 N. L. D. K. L. Q.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 11,016,318 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 9,583,700 lekë		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1,432,618 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit</b> Data 11.11.2022	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Shtetit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 b) S’kualifikuar 0 OE,
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës, 45 ditë</b>			
<b>10. Ankimime</b> Datë 06.12.2021 operatori ekonomik “V.-A.” ShPK	<b>11. Përgjigje Ankesës</b> AK me Vendimin nr. 5855/3, datë 14.12.2021.		<b>12. Përgjigje</b> KPP me vendimin me nr. 1044/2022.
<b>b. Zbatimi i Kontratës Prokurimit</b>			
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Është lidhur kontrata mes AKMC dhe OE/“V.-A.” me nr. 154/2, datë 07.02.2022.	<b>Zbatimi i kontratës:</b> Zbatimi është bërë nga AKMC dhe likuidimi nga MM		

**a-Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit konstatohet:**

- Me urdhrin e prokurimit, nr. 1541, prot. 2588/4, datë 12.10.2021, të z. A. C., Sekretar i Përgjithshëm urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 11,06,318 lekë pa TVSH, me objekt “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore” dhe ngarkohet njësia e prokurimit e përbërë nga G. J., V. L. dhe D. M..

Kërkesa për blerjen e materialeve është bërë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me nr. 298/2, datë 02.04.2021, në të cilën citon nevojat për realizimin e kësaj procedurë, në zbatim të urdhrin të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1336, datë 04.11.2021 dhe Ministrit të Brendshëm me nr. 420, datë 24.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe studimin e tregut për aktivitet e parashikuar në formatin e aplikimit të Projektit "TO BE READY", me anëtarë A. C., Shef i Sektorit në Drejtorinë e MZSH Bashkia Tirane, H. K., specialiste pranë Drejtorisë së MZSH në Ministrinë e Brendshme dhe A. Sh., specialist i punimeve Avaro – Shpëtuese në KM, sipas paketës së Punës T.1.4. “Modeli i funksionimit për rrezikun hidrik dhe zjarret pyjore” përkatësisht blerje të disa prej pajisjeve të parashikuar në projekt për:

- Pompa Portative shpinore të ujit, me kapacitet mbajtës 20 litra.  
-Rezervuar uji të lëvizshëm me karrel. ku bashkëlidhur janë dokumentacioni i termave të referencës, specifikimeve teknike dhe studimi i tregut për përlogaritjen e fondit limit. Nga MM me shkresën nr. 2588/1, datë 02.06.2021, kërkon nga AKMC plotësimin e dokumentacionit në lidhje me përlogaritjen e fondit limit si dhe saktësimin e vlerave për njësi dhe të konvertuar në ALL, për faktin se procedura do të zhvillohet sipas legjislacionit Shqiptar, si dhe disponibilitetin e fondeve për realizimin e kësaj procedure. Me shkresën nr. 1240/1, datë 08.06.2021 është kthyer përgjigje në lidhje me fondin limit si dhe është cituar se fondet për mbulimin e shpenzimeve **janë fonde disponibel në llogarinë e nivelit të dytë në bankën C.**, të cilat janë disbursuar nga Autoriteti Menaxhues "TO BE READY". Shteti Shqiptar dhe përkatësisht AKMC do të mbulojë vetëm TVSH, të cilat janë disponibel në buxhetin e AKMC në llogarinë 231 "Investime".

Sipas shkresës është cituar se

- Pompa Portative shpinore të ujit, me kapacitet mbajtës 20 litra është parashikuar fondi limit prej **74,930 euro pa TVSH.**

- Rezervuar uji të lëvizshëm me karrel është parashikuar fondi limit prej **14,619 euro pa TVSH.**

Në DST është përcaktuar:

**Burimi i financimit:** Shpenzimet për këtë prokurim do të përballohen fondet e disbursuara nga Autoriteti Menaxhues i Programit CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi (BE), për llogari të projektit TO BE READY, **në llogarinë bankare të nivelit të dytë**, në bankën C., si dhe nga fondet e alokuara në buxhetin e shtetit për vitin 2021, në artikullin 231, programi "Emergjencat Civile", ku më e detajuar në lidhje me fondet dhe planifikimin është trajtuar tek materiali i projektit "TO BE READY" pjesë e këtij Projekt raporti.

Me urdhrin me nr. 1654, prot. 5361/1, datë 12.10.2021 të SP z. A. C. ngrihet Komisioni i vlerësimit të ofertave N. L., D. K. dhe L. Q..

Me shkresën nr. 2588/5 datë 18.10.2021 është publikuar njoftimi i shkurtuar i kontratës me objekt "*Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore*".

Nga OE/ "V.A." është bërë kërkesë në SPE në lidhje me saktësimin e specifikimeve teknike të rezervuarit të ujit dhe të karrelit.

Pas shqyrtimit të kërkesës nga AK me shtojcën datë 28.10.2021 "Për ndryshimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit me objekt "*Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore*" për nevoja të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile bën ndryshimet në specifikime.

**Konkretisht:**

**1. Në Aneksin A (specifikimet teknike) bashkëlidhur DT-ve, në specifikimet teknike të rezervuarit të ujit (faqe nr. 2), shtohen specifikimet si më poshtë:**

- Kapaciteti bartës minimal i rezervuarit të jetë 1200 litra dhe ai maksimal 1500 litra ujë.
- Furnizimi me ujë bëhet nga lart në grykën e hapur.
- Dimensionimi i pikës së daljes me një ose dy dalje D25/C52 me bashkues.
- Diametri i bazës së rezervuarit nga 180-190 cm.
- Mënyra e transportimit të rezervuarit bosh me çantë të posaçme.
- Temperatura e operimit -40°+70° C.

**2. Në Aneksin A (specifikimet teknike) bashkëlidhur DT-ve, në specifikimet teknike të karrelit / rimorkios (faqen nr. 3 dhe nr. 4), shtohen specifikimet si më poshtë:**

- Kapaciteti bartës pesha maksimale e karrelit nga 1000-1500 kg.
- Lartësia e tendës 1 metër - 1.2 metër nga spondet e karrelit.
- Nr. i akseve 1 ose 2.



### **b. Mbi vlerësimin e ofertave.**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali datë 11.11.2021 hapjes së ofertave. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE me ofertat si më poshtë:

- Operatori ekonomik "V. – A." shpk, me NUIS K....., me ofertë ekonomike me vlerë **9,583,700** (nëntë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH;

- Operatori ekonomik "Z." shpk, me NUIS J....., me ofertë ekonomike me vlerë **8,074,600** (tetë milionë e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali datë 24.11.2021 mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, nga ku janë kualifikuar 2 OE.

Nga KVO është shpallur fitues "Z." shpk, ku AK me shkresën nr. 5361/2 datë 01.12.2021 ka publikuar "Formulari i njoftimit të fituesit".

Në datën 06.12.2021 operatori ekonomik "V.-A." ShPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Z." SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Në ankesë ngrihen pretendime për mos përmbushje nga ana e operatorit ekonomik "Z." ShPK të kritereve si më poshtë vijon:

- Në ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik operatori ekonomik "V.-A." SHPK në lidhje me këtë kriter pretendon se: "..... Mbështetur në përcaktimet e mësipërme ligjore deklarojmë se operatori ekonomik "Z." ShPK, duke marrë parasysh aktivitetet e deklaruara në Ekstraktin Historik të kësaj shoqërie, ku nuk është parashikuar në **asnjë pike tregtimi i mallrave objekt** i kësaj procedure prokurimi do të rezultonte e pa mundur që nga operatori ekonomik "Z." ShPK të paraqitet dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit në plotësim të kriterit të mësipërm për kualifikim. Konkretisht nga ky operator ekonomik nuk mund të provohet eksperiencë e ngjashme në lidhje me tregtimin e produkteve zjarrfikëse **Pompa portative shpinore të ujit me kapacitet mbajtës 20 litra dhe rezervuarëve të ujit të lëvizshëm**, të cilat mbështetur në specifikime e paraqitura nga autoriteti kontraktor janë produkte që do të përdoren nga ekipet zjarrfikëse dhe për rrjedhojë këto produkte mund të tregtohen vetëm nga kompani të cilat kanë në objektin e tyre të specifikuar shprehimisht tregtimin e produkteve zjarrfikëse. Për pasojë kriteri kualifikues duhet konsideruar si i paplotësuar nga shoqëria "Z." ShPK.

Me urdhër të AK nr. 1786, prot., 5855/2, datë 09.12.2021 bën pezullimin e procedurës, për shqyrtimin e ankesës nga OE. ku vlerësimi i ankesës të bëhet nga z. R. B..

AK me **Vendimin nr. 5855/3, datë 14.12.2021** drejtuar OE/ "V.A." ShPK mbi shqyrtimin e ankesës vendos të refuzojë ankesën e OE me arsyetimet si më poshtë:

**1.** Në funksion të përmbushjes së kërkesës sipas pikës 1, shkronja a, të Kritereve të Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit, të shtojcës nr. 7 të Dokumenteve të Tenderit, ofertuesi i klasifikuar në vend të parë ka paraqitur deklaratën sipas formatit të shtojcës nr. 8 të DT, të nënshkruar nga administratori, ku veç të tjerash ka deklaruar se: OE është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Në funksion të shqyrtimit të ankesës, është verifikuar Ekstraktin e Regjistrit Tregtar për të dhënat e subjektit "Z." ShPK., me NUIS ..... dhe u konstatua se kjo shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: tregtim i mjeteve të transportit dhe makinerive të tonazheve të ndryshme; tregtimi dhe montim pjesë këmbimi mekanike/elektrike; tregtimi, furnizimi dhe shpërndarja e materialeve hidraulike, elektrike, mekanike, elektroshtepiake, elektropompa....etj. Referuar Ekstraktit të Regjistrit Tregtar, ky operator tregon artikuj të **ndryshëm industriale**, kategori

kjo që në vlerësimin KSHA përfshin edhe **artikujt (materiale) objekt prokurimi**. Referuar sa më sipër dhe ne kushtet kur : - objekti i prokurimit është furnizim me mallra (materiale); - operatori ekonomik i klasifikuar ne vend te pare ka plotësuar deklaratën sipas shtojcës përkatëse te DT lidhur me objektin e aktivitetit; ne kërkesat e veçanta për kualifikim nuk është përcaktuar ndonjë licence/leje për tregtimin e artikujve objekt prokurimi; vlerësoj se OE "Z." ShPK. me NUIS J....., e plotëson kërkesën për kualifikim sipas pikës 1, shkronja a, te Kriteve te Përgjithshme te Përzgjedhjes/Kualifikimit, te shtojcës nr. 7 te Dokumenteve te Tenderit dhe pretendimi i ankimuesit për këtë pike nuk qëndron.

**2. Ne funksion të përmbushjes së kërkesës për kualifikim sipas pikës 2.2.1 te Kapacitetit Teknik te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, ofertuesi i klasifikuar ne vend te pare ka paraqitur dy kontrata me autoritete kontraktor te ndryshëm, për te vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme. Artikujt e furnizuar për këto kontrata janë kryesisht *artikuj te ndryshëm industriale* dhe mjete transporti. **Për te dy kontratat, ofertuesi ka paraqitur vërtetim për realizimin me sukses te tyre. Ne këto kushte, me dokumentacionin e paraqitur ofertuesi vërteton se e plotëson kërkesën për kualifikim dhe pretendimi i ankimuesit lidhur me këtë pike nuk qëndron.****

**3. Në funksion te përmbushjes së kërkesës për kualifikim sipas pikës 2.2.3 te Kapacitetit Teknik te Kriteve te Veçanta te Kualifikimit, ofertuesi i klasifikuar ne vend te pare ka paraqitur certifikate ISO 9001:2015, ku evidentohet se sistemi i menaxhimit te shoqërisë është konform kërkesave te standardit ISO 9001:2015 për qëllime tregtimi, furnizimi dhe shpërndarja e automjeteve, makinerive; tregtimi, furnizimi dhe shpërndarja e materialeve hidraulike, metalike, elektrike etj.**

Ne këto kushte dhe referuar argumentimit te paraqitur ne piken 1, vlerësoj se ofertuesi me dokumentacionin e paraqitur vërteton se e plotëson kërkesën për kualifikim lidhur me certifikatën ISO 9001:2015 dhe pretendimi i ankimuesit për këtë pike nuk qëndron.

### **KPP**

Me shkresën nr. 5855/5 prot., datë 04.12.2021 është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues "V.-A." shpk, në të cilin konstatohet se zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës me vendimin nr.5855/3 prot., datë 14.12.2021 ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik "V.-A." shpk.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë për të fituar kontratën publike.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Z." shpk për përmbushjen e kriterit të mësipërm, **Komisioni i Prokurimit Publik** konstaton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar në pikën III.1.2 të këtij vendimi.

Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "V.-A." shpk lidhur me mos përmbushjen nga operatori ekonomik "Z." shpk të kriterit për vërtetimin e shërbimeve të mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit të përcaktuar në "kriteret e veçanta" të kualifikimit, "kapaciteti teknik" pika 2.2.1 të dokumenteve të tenderit si dhe nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Z." shpk në lidhje me kontratat e ngjashme, **KPP konstaton**, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik "Z." shpk nuk ka plotësuar kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, ***për sa i përket vërtetimit të realizimit të shërbimeve të ngjashme.***

Konkretisht, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Z." shpk, për kontratat e cituara në pikën III.1.2 të këtij vendimi të cilat janë paraqitur nga operatori

ekonomik, si dokumentacion për përmbushjen e pikës 2.2.1 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, KPP konstaton se nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjithë elementëve të këtyre kontratave, duke nisur që nga objekti i tyre si dhe përshkrimi i mallit ose shërbimit të faturave tatimore të shitjes ose faturave elektronike si pjesë përbërëse e kontratave, **rezulton se vetëm njëri prej tyre mund të konsiderohet i ngjashëm me objektin e prokurimit, konkretisht kontrata me objekt “Blerje kamionçine”.**

KPP pasi e veçoi këtë kontratë zërat e së cilës mund të konsiderohen të ngjashëm me objektin e prokurimit vëren se vlera e saj sipas faturës tatimore bashkëngjitur kontratës së paraqitur në sistemin nuk arrin të përmbushë e vetme vlerën e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e veçante të kualifikimit në masën prej 40% të fondit limit.

Në këtë kuptim, KPP gjykon se operatori ekonomik “Z.” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit duke mos plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme, pasi kontratat e paraqitura përmbajnë objekt dhe zëra të cilat nuk janë të ngjashëm me objektin e prokurimit si dhe atë kontratë që KPP e konsideroi që përmban zë të ngjashëm (blerje kamionçine) nuk mjafton për të plotësuar vlerën e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër, KPP sqaron, se mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme. Operatori ekonomik “Z.” shpk duhet të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve.

*Sa më sipër KPP shprehet se pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “V.-A.” qëndron.*

Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik “V.-A.” shpk mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Z.” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm qëndron, pasi operatori ekonomik “Z.” ShPK nuk përmbush kriterin e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të operatorit ekonomik “Z.” ShPK, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

#### **Sa më sipër KPP me vendimin me nr. 1044/2022 vendos:**

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “V.-A.” shpk për procedurën e prokurimit “E hapur”, me nr. REF-08550-10-18-2021, me objekt: “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore” për nevoja të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile” me fond limit 11,016,318.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 11.11.2021 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Mbrojtjes.

Me urdhër të AK nr. 4, prot., 19/2 datë 05.01.2022 bën heqjen e pezullimit të procedurës dhe zbatimin e vendimit të **KPP-së me nr. 1044/2022.**

Nga KVO është mbajtur procesverbalin me datë 06.01.2022 për rivlerësimin e procedurës, ku bazuar në vendimin e KPP ka shpallur fitues “V.-A.” shpk.

Nga KVO është mbajtur procesverbalin me datë 12.01.2022 i verifikimit të dokumentacionit përpara njoftimit të fituesit, ku citon se dokumentacioni i dorëzuar është në përputhje me kriteret e DT.

Nga auditimi i procedurës me objekt “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore” u konstatua se:

Operatori ekonomik “V.-A.” ShPK, me datën 06.12.2021 ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur

nga operatori ekonomik "Z." SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushje nga ana e operatorit ekonomik "Z." ShPK të kriterëve. Referuar arsyetimit dhe vendimit të KPP-së me nr. 1044/2022 rezultoi se:

- Vendimi i KVO dhe KSHA, është i drejtë pasi referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar, operatori "Z." shpk tregton artikuj të ndryshëm industriale, kategori kjo që në vlerësimin e tyre përfshin edhe artikujt (materiale) objekt prokurimi. Artikujt e furnizuar për këto kontrata janë kryesisht artikuj të ndryshëm industriale dhe mjete transporti. Për te dy kontratat, ofertuesi ka paraqitur vërtetim për realizimin me sukses të tyre. Në këto kushte, me dokumentacionin e paraqitur ofertuesi vërteton se e plotëson kërkesën për kualifikim dhe pretendimi i ankimuesit lidhur me këtë pikë nuk qëndron, duke mbajtur në konsideratë ofertën më të favorshme ekonomike për AK.

2. Vendimi i KPP-së me nr. 1044/2022, i cili vendos mosmarrjen në konsideratë të kontratave të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me artikuj të ndryshëm industriale dhe mjete transporti duke i konsideruar si jo punë të ngjashme me objektin e prokurimit, duke skualifikuar OE të renditur të parin me ofertë ekonomikisht më të favorshme për AK, grupi i auditimit gjykon se Vendimi i KPP nuk ka mbajtur në konsideratë kriterin kryesor vlerësues (çmimi më i favorshëm), por ka bërë interpretim të mallrave sipas zërave të situacioneve duke skualifikuar ofertën ekonomikisht të favorshme dhe duke vendosur kontraktimin e një ofertë më të lartë.

Sa më sipër jemi në kushtet e moszbatimit të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 2, ku citon se: Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
  - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
  - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
  - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
  - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
  - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik
- Kontraktimi dhe lidhja e kontratës me OE "V.-A." shpk nga vendimi i KPP i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit një pagesë më të lartë për AK në vlerën 1,509,100 lekë (9,583,700 lekë - 8,074,600 lekë), si diferencë midis ofertave ekonomike.

Me shkresën nr. 19/4 datë 13.01.2022 është bërë publikimi i njoftimit të fituesit.

Nga KVO është mbajtur raporti përmbledhës i procedurës me nr. 19/6, datë 24.01.2022

Me urdhrin e SP z. A. C. me nr. 54, prot., 19/7, datë 24.01.2022 është urdhëruar lidhja dhe zbatimi i kontratës nga AKMC me OE fitues "V.-A." shpk, e cila përgjigjet për lidhjen, administrimin dhe zbatimin e kontratës.

Pagesa e kësaj kontrate do të realizohet nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit financiar pranë MM.

Mes AK/AKMC dhe OE/ "V.-A." shpk është lidhur kontrata me nr. 154/2, datë 07.02.2022

MM e ka likuiduar OE me urdhër pagesën me nr. 530, datë 07.09.2022, në vlerën 11,500,440 lekë me TVSh.

### **Prokurimet e realizuara nga Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake**

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: "**Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA**", me Autoritet Kontraktor Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), zhvillimi i procedurës viti 2022.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:</b> "Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA", 2022
--

<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar” REF-31484-06-01-2022 Urdhri nr. 25 prot., datë 17.05.2022	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. K. Ll., specialist për projektimin 2. N. S. specialist në IGJIU 3. A. R. specialist Jurist në IGJIU	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 341/2 prot., datë 17.05.2022 1. A. B. 2. J. L. 3. A. G.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 5,529,634 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 4,748,671 lekë Operatori Fitues: BOE “I. D.-A. & “A. M.”	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 780,963 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 13.06.2022	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fonde vënë në dispozicion për vitin 2022, CPV :22114311-5	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>8 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>3 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>5 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 60 ditë		

**Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë** funksion në bazë të ligjit nr. 8907 “Për funksionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak (IGJU) të Shqipërisë” i datës 06/06/2002, i ndryshuar, i cili është institucioni shtetëror Ushtarak, që realizon veprimtari kërkimore-shkencore dhe projektim e prodhim dhe *jo organ blerës*. Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë (IGJIU), i cili ka si funksion projektimin dhe prodhimin e projekteve bazuar në misionin dhe ligjin e funksionimit të këtij institucioni, sipas strukturës së institucionit ekzistojnë: I. Sektori i projektimit, me numër strukture 7 punonjës dhe aktualisht të punësuar janë 4 punonjës, nga të cilët 3 Arkitekt dhe një Inxhinjer Ndërtimi. II. Sektori i projektimit të rrjeteve inxhinjerike, me numër strukture 7 punonjës dhe aktualisht të punësuar janë 3 punonjës, nga të cilët një Inxhinjer elektrik, një Hidroteknik dhe 1 Mekanik. III. Sektori i preventivit, me numër strukture 4 punonjës dhe aktualisht të punësuar janë 2 punonjës, nga të cilët një Inxhinjer Ndërtimi dhe një Inxhinier Mekanik. IV. Sektori i certifikimit dhe teknologjise, me numër strukture 4 punonjës dhe aktualisht të punësuar është një Arkitekt. Struktura e mësipërme është e vitit 2023, por megjithatë janë realizuar blerje të projekteve si më poshtë vijon. Mbajtja në punë të personelit që ka mbushur moshë për pension, argumentohet për shkak të mungesave të personelit apo stafit teknik IGJIU dhe referuar Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Neni 119 “Kontrata Administrative” citon kushtet dhe kërkesat e kontratës administrative; 1. Organi publik, për realizimin e një interesi publik, të cilit i shërben, por pa cenuar interesat apo të drejtat e palëve të treta, mund të lidhë një kontratë administrative, nëse plotësohen këto kushte:

a) forma kontraktore nuk ndalohet shprehimisht nga ligji ose nuk bie në kundërshtim me vetë natyrën e çështjes administrative; dhe b) organi publik është i autorizuar nga ligji të vendosë *për çështjen me diskrecion*. 2. Kontrata administrative lidhet në formë të shkruar, përveç rasteve kur ligji parashikon një formë tjetër të posaçme. 3. Kontrata nënshkruhet nga palët apo përfaqësuesit në mënyrë manuale apo elektronike, në përputhje me modalitetet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Nënshkrimi në emër të organit publik bazohet mbi një autorizim të lëshuar nga organi përkatës.

#### **Nga shqyrtimi i sipërcituar konstatohet:**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, fillimi i kësaj procedure prokurimi, nuk ka memo të brendshme nga zyrtarët e prokurimi, nuk disponohet kërkesë nga strukturat e varësisë për të iniciuar procedurën e prokurimit. Me urdhrin e prokurimit nr. 25 datë 17.05.2022, protokolluar me nr. 341/1 datë 17.05.2022, të titullarit të IGJIU, urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt “**Hartimi projekt ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe si Sigurisë të AFA**”, ku është përcaktuar me fond limit 5,529,634 lekë pa TVSH, dhe fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022. Nga auditimi konstatohet se në fakt fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i Shtetit për vitin 2022 zëri “*Studime – Projekte*” parashikohej në vlerën 4,905,000 lekë pa TVSH. Detyra e projektimit dhe përcaktimi i vlerës së kontratës së shërbimit për fazën I dhe Fazën II është realizuar në Mars 2022 nga E. T., E. M., E. M., E. B. dhe L. M.. Analiza e fondit limit është mbështetur në VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori*,”

*Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim*”. Analiza është realizuar sipas gjendjes ekzistuese dhe grupet tarifore të objekteve që ndodhen në kampusin e Fakultetit të Mbrojtjes për fazën I dhe II, por në fakt prokurohet vetëm faza II (Projekt idea paraprake), rrjedhimisht edhe përcaktimi i fondit limit të kontratës nuk është i saktë.

- Realizimi i procedurës së prokurimit është bazuar fillimisht në Udhëzimin e Ministrit nr. 3 datë 04.04.2022 me prot. 692/2 datë 04.04.2022 “Për zhvillimin e Procedurave të Prokurimit në mënyrë të Përqëndruar në Ministrinë e Mbrojtjes” Neni 5, pika 5, pika 6 “Përrjashtime” ku përcaktohet:

5. Për vlera investimi (vlerë të realizimit të punimeve) deri 20,000,000 lekë të përlllogaritur mbi bazën e parashikimeve në legjislacionin e fushës, IGJIU duhet të hartojë vetë projektet me kapacitetet profesionale që ka në dispozicion. Për blerjen e projekteve të infrastrukturës, me vlerë investimi mbi 20,000,000 lekë, autorizohet IGJIU, të zhvillojë procedura prokurimi si Autoritet Kontraktor. 6. Në raste të veçanta, për situata të argumentuara dhe të dokumentuara, institucionet në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes mund të zhvillojnë procedura prokurimi si Autoritete Kontraktore, sipas buxhetit të miratuar, pasi kanë informuar Ministrinë e Mbrojtjes mbi situatën respektive dhe pas dakordësisë së kësaj të fundit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion ekziston vetëm një kërkesë nga IGJIU me nr. 683 prot., datë 29.09.2021, drejtuar MM për përfshirje në fondin buxhetor 2022, për shkak të mungesës së personelit dhe kërkon buxhet në vlerën 30,000,000 lekë për artikull 230 “Shpenzime për rritjen aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara”. Pra nuk ekziston asnjë dokument ku të kërkohej prokurimi specifik “*Hartimi projekt ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe si Sigurisë të AFA*”, me fond limit 5,529,634 lekë pa TVSH dhe miratimi i tij nga MM. Me Urdhrin e Ministrit nr. 331 datë 06.03.2023, nr. 243/1 prot., datë 06.03.2023, Urdhërohet IGJIU si Institucioni përgjegjës për hartimin e projekt preventivave të infrastrukturës sipas detyrave të projektimit të paraqitura nga Shtabi i Përgjithshëm FA-së, KFA, njësive dhe reparteve vartësisë të FA-së. IGJIU ngarkohet për hartimin ose blerjen e projekt-preventivave sipas pikës 5 të udhëzimit nr. 3 datë 04.04.2022. IGJIU është përgjegjëse për hartimin dhe kontrollin e përmbushjes së kërkesave projektuese sipas VKM nr. 354 datë 11.05.2016.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Përzgjedhje e gabuar e procedurës së prokurimit me objekt: “ <i>Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA</i> ” dhe kriteret kualifikuese në kundërshtim me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “ <i>Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim</i> ”.
<b>Situata:</b>	Me urdhrin e prokurimit të IGJIU nr. 25 datë 17.05.2022, protokolluar me nr. 341/1 datë 17.05.2022, urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt “ <i>Hartimi projekt ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe si Sigurisë të AFA</i> ”, ku është përcaktuar me fond limit 5,529,634 lekë pa TVSH, dhe fondi i vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2022. Lloji i procedurës i urdhëruar për prokurim do të jetë “ <i>E hapur e thjeshtuar</i> ” bazuar në nenin 49 LPP dhe nenit 55 të RrPP, ku ngrihet njësia e prokurimit e përbërë nga Kujtim Llagami, specialist për projektimin, Nexhjana Serani specialist në IGJIU dhe Amarilda Reci specialist Jurist në IGJIU. Përcaktimi i procedurës së hapur të thjeshtuar, konstatohet shkelje e ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi siç konstatohet nga lloji dhe objekti i shërbimi është “ <i>Hartim projekt ideje</i> ”, ku përcaktohet në nenin Neni 57 “ <i>Konkursi i projektimit</i> ” ku citohet në mënyrë

eksplicide: 1. Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me fazë, sipas nenit 104, të LPP-së, nëpërmjet së cilës, autoriteti/enti kontraktor për zgjedh një studim ose projekt, që ka kryesisht natyrë estetike, duke i mundësuar autoritetit/entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt. 2. Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitim të një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik.

a) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatit fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar. b) Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon konkurs projektimi, si pjesë të një procedure që çon në përzgjedhjen e kontratës fituese për shërbime, mund të përdorë procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit për kryerjen e shërbimit me kandidatit e suksesshëm të dalë në përfundim të konkursit të projektimit, në përputhje me pikën 3, të nenit 47, të LPP-së. 3. Në çdo rast, në dokumentet e tenderit, autoriteti/enti kontraktor duhet të bëjë të njohur qëllimin e tij për të marrë vetëm një projektide apo për të marrë projektide dhe shërbimin në lidhje me këtë projektide. 4. Nuk mund të jenë në cilësinë e kandidatëve në një konkurs projektimi, punonjës të autoritetit/entit kontraktor, i cili zhvillon këtë konkurs. 5. Hapat e procedurës së konkursit të projektimit... a) Titullari i autoritetit/entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit. b) Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me LPP-në dhe me këto rregulla. Me procesverbalin datë 01.06.2022 hartohen argumentimet e specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese. **Sa më sipër**, konstatohet se është përzgjedhur procedurë prokurimi e gabuar në kundërshtim me Legjislacionin e Prokurimit Publik. Referuar Dokumentetve të tenderit, procedura është trajtuar si kontratë shërbimi mbikëqyrje apo kolaudimi (me tarifa shërbimi përfundimtare sipas Investimit), ku është përcaktuar se të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlllogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354 në fjalë, do të skualifikohen, duke krijuar diskriminim dhe trajtim të pabarabartë për propozime teknike dhe ekonomike të Projekt Idesë, pasi edhe vetë vlerat minimale të projektit janë të përafërta dhe jo përfundimtare si në rastin e shërbimit e mbikëqyrjes dhe kolaudimit. Sipas procesverbalit të vlerësimit datë 20.06.2023, vlerësimi sipas KVO ka s'kualifikuar Operatori ekonomik "Gj. & C.", pasi nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3, të kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi vlera e ofertës së paraqitur nga ky ofertues është më e ulët se vlera minimale e lejuar, e përlllogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM nr.354, datë.11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Pra referuar bazës ligjore të shërbimit

	konsulencës dhe konkursit të projektimit ky operator nuk duhet të s'kualifikohej, pasi tarifat nuk janë përfundimtare. Veprimi ka ardhur si pasojë e përzgjedhjes së gabuar të prokurimit publik.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Projekteve” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shmangje të propozime teknike sipas LPP, të cilat do të sillnin oferta më të ulëta se vlera e kontraktuar.
<b>Shkaku:</b>	Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë në procedurat e prokurimit të projekteve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që të përgjedh projekte me propozime teknike (apo vlerësime me pike), në funksion të kërkesave të AK, duke propozuar oferta me kosto më të ulëta.

#### ***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit të hapjes së ofertave datë 13.06.2022. KVO-ja ka kryer në SPE nga data 20.06.2022, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S'kualifikuar/ Kualifikuar
1	A. E.	5,102,000	Kualifikuar
2	I. D.-A. & “A. M.”	4,748,671	<b>Kualifikuar</b> fituesi
3	“E..C.G.”	5,093,800	S' Kualifikuar
4	“I. C. E.” & “S. B&.”	5,060,000	Kualifikuar
5	“S.” & “N.-G.”	4,748,671	S'Kualifikuar
6	“S.-R.”	4,900,000	Kualifikuar
7	“T.”	4,748,671	Kualifikuar
8	“Gj. & C.”	3,957,227	S'Kualifikuar

Sipas procesverbalit të vlerësimit datë 20.06.2023, vlerësimi sipas KVO konsiston si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “E.C.G.”, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha kërkesave për kualifikim dhe konkretisht: Nuk plotëson pasi kërkesën sipas pikës 2.3.2, të kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit, lidhur me disponimin e Urbanistit. Ky ofertues në Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit nuk ka deklaruar se disponon punonjësin Urbanist. 2. Operatori ekonomik “Gj.& C.”, nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.3.3, të kërkesave për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi vlera e ofertës së paraqitur nga ky ofertues është më e ulët se vlera minimale e lejuar, e përlloritur mbi bazën e parashikimeve të VKM nr.354, datë.11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Pra referuar bazës ligjore të shërbimit konsulencës dhe konkursit të projektimit ky operator nuk duhet të s'kualifikohej, **pasi tarifat nuk janë përfundimtare**. Veprimi ka ardhur si pasojë e përzgjedhjes së gabuar të prokurimit publik. 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “S.” sh.p.k., & “N.-G.” sh.p.k, me dokumentacionin e paraqitur nuk arrin të vërtetojë plotësimin e të gjitha



kërkesave për kualifikim dhe konkretisht: Nuk plotëson kërkesën sipas pikës 2.2.2/a, të kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi anëtari i BOE “S.” sh.p.k., nuk ka paraqitur Certifikatë ISO 9001:2015 “Per menaxhimin e cilësisë”. Nëpërmjet rubrikës mesazhe, operatorëve “T.” shpk dhe BOE “I. D.-A. & “A.M.”, është dërguar kërkesë nga IGJIU për pjesëmarrje në procesin e hedhjes së shortit për përcaktimin e fituesit, ku u kërkon të paraqiten më datë 21.06.2022. Nga shorti i hedhur rezultoi fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë, “I.D.-A.” sh.p.k & “A.-M.” shpk, ku citohet se nuk ka ankesa nga OE “T.” shpk.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Kontrata e shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: <i>“Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA”</i> , nuk ka përmbushur parashikimet ligjore të VKM 354 datë 11.05.2016 <i>“Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”</i> .
<b>Situata:</b>	<p>Me raportin përmbledhës nr. 200/8 prot., datë 27.06.2022, miratohet procedura e prokurimit nga titullari i IGJIU. Formulari i njoftimit të fituesit është realizuar me nr. 200/9 prot., datë 01.07.2022 dhe kontrata e shërbimit realizohet me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me vlerën 5,698,405 lekë me TVSH. Me shkresën e OE “I.D.-A.” shpk, nr. 468 prot., datë 20.09.2022, dorëzohet dokumentacioni i kontratës së shërbimit që bashkëngjijt vetëm Analizën e Detyrës së projektimit dhe Projekt idenë paraprake. Inventari i dosjes përmban vetëm 13 relacione të godinave për gjendjen ekzistuese dhe një planimetri IDE të tyre. Pra konstatohet një shërbim shumë i thjeshtë ku vetë IGJIU edhe me pak kapacitete njërezore mund ta realizonte project idenë e prokuruar. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 200/23 prot., datë 13.10.2022 për objektin <i>“Hartim project Ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë të AFA”</i>, i përbërë nga grupi i marrjes në dorëzim F. H., E. M. dhe L. L., konstatohet se është dorëzuar detyra e projektimit dhe termave të references dhe project ideja paraprake për kampusin. <i>Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet:</i></p> <p><u>Së pari:</u> Nga marrja në dorëzim e projekt idesë hartuar nga OE “I.D.-A.” shpk, konstatohet se Analiza e Detyrës së projektimit dhe Projekt idenë paraprake, ka ngjashmëri me Detyrën e projektimit realizuar në mars 2022 nga E. T., E. M., E. M., E. B. dhe L. M., çka tregon mbivendosje të idesë apo shërbimit të projekt idesë.</p> <p><u>Së dyti:</u> Projekt Idea e përgatitur nga OE “I.D.-A.” shpk nuk paraqet situatë të saktë dhe nevojat reale për ndërhyrje, pasi kryesisht përshkruan gjendjen ekzistuese të godinave dhe nevojën për rikonstruksion, gjë e cila është hartuar ose konstatuar nga vetë IGJU <b>dhe nuk ka hartuar asnjë kosto paraprake të Investimeve.</b></p> <p><u>Së treri:</u> Referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 <i>“Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Terriori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”</i> Neni 25 <i>“Ndërtesat dhe ndarjet funksionale të tyre sipas tipologjisë, si dhe strukturat në ambientet e jashtme sipas tipologjisë së shërbimit”</i> ku nuk është parashikuar asnjë kosto dhe nuk është zbatuar asnjë pike e nenit. Neni 49 <i>“Shërbimet për planifikimin e strukturve mbajtëse”</i> citohet:</p> <p><u>1. Faza I e shërbimit:</u> Analiza e detyrës së projektimit/ termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit Shërbimet bazë. Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës, për fushat</p>

specifike të strukturave mbajtëse. E rëndësishme në këtë fazë është konsultimi me inxhinierët dhe arkitektët e projektit.

**2. Faza II e shërbimit:** Projekt idea paraprake (përgatitja e bazave të projektit dhe përgatitja për projektim). i. Shërbimet bazë.

a) Për projekte të veprave inxhinierike, siç përcaktohet në nenin 34, pika 6 dhe 7: ndërthurja e rezultateve sipas fazës I të shërbimit;

b) Këshillim për çështje të projektimit të strukturës mbajtëse, duke marrë parasysh kërkesat mbi stabilitetin, *funksionin dhe koston*;

c) Konsultë në pikëpamjen statiko-konstruktive duke patur parasysh problemet e qëndrueshmërisë, aftësisë për t'u përdorur dhe *rentabilitetin ekonomik*.

ç) Bashkëveprim për përpunimin e një koncepti planifikimi, përfshirë studimin e zgjidhjeve të mundshme alternative të strukturës mbajtëse me kërkesa të njëjta të objektit me paraqitje vizatimore. Sqarimi dhe dhënia përcaktimeve konstruktive kryesore për strukturën mbajtëse p. sh. për materialet e ndërtimit, mënyrat e ndërtimit dhe procedurat e prodhimit, rrjetat e konstruksionit dhe llojin e themelit bazamentit.

d) Negociatat paraprake me autoritetet lokale dhe specialistë të tjerë të përfshirë në projekt në lidhje me pajtueshmërinë dhe kushtet e miratimit.

dh) *Ndihma në llogaritjen e koston paraprake edhe në rastin e ndërtesave dhe objekteve strukturore.*

ii) Shërbime të veçanta

a) Hartimi i llogaritjeve krahasuese për disa mundësi zgjidhjesh nën kushte të ndryshme të objektit.

b) Përpilimi i një plani të ngarkesës, p.sh. si bazë për vlerësimin e truallit të ndërtimit dhe konsultën për bazamentin.

c) Llogaritje paraprake e verifikueshme e pjesëve themelore mbajtëse.

ç) Llogaritje paraprake e verifikueshme e bazamentit.

Referuar nenit 7, “Përcaktimi i Tarifave” pika 5 të VKM 354 datë 11.05.2016 “*Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, citohet: Nëse, gjatë kohës të vlefshmërisë së kontratës, ndryshon projekti me kërkesë të porositesit, duke ndikuar në ndryshimin e koston së llogaritshme, vlerat ose njësitë e llogaritjes, atëherë marrëveshja mbi të cilën është e llogaritur tarifa, duhet të rillogaritet dhe të dokumentohet me shkrim. Referuar grupeve tarifore duke përllogaritur vlerë investimi deri 800 milion, hartimi i projekt idesë në këtë rast, nuk do të shkonte më shumë se 3 milion lekë. Në dorëzimin e Projekt Idesë nuk janë zbatuar kërkesat e mësipërme.

Së katërti: Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”, ku citohet se: “*Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitimin e një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik. Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar. Pra në thelb IGJU ka shpenzuar 5,698,405 lekë me TVSH, duke shmangur propozime teknike (apo vlerësime me pikë) sipas legjislacionit*

	<p>prokurimit publik, të cilat <u>do të sillnin oferta shumë here më të ulëta se vlera e kontraktuar.</u></p> <p>Kontraktimi pa variante teknike apo ide të ndryshme, konstatohet se OE vetëm ka përcaktuar gjendjen ekzistuese të godinave, veprim i cili është realizuar nga vetë IGJIU dhe hartimi i projekt-idesë nga OE "I.D.-A." shpk, nuk është realizuar në përputhje sipas përcaktimeve ligjore të Neni 49 të VKM nr. 354 datë 11.05.2016, <u>ku nuk është përcaktuar asnjë kosto apo ide paraprake e investimeve apo variante të ndryshme të projekt idesë.</u></p> <p>Gjithashtu nuk është realizuar asnjë relacion statiko-konstruktive mbi problemet e qëndrueshmërisë së godinave dhe në përfundim, <u>projekti përfundimtar i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU.</u> Projekti i zbatimit përfundimtar është zbatuar nga vetë IGJIU, fillimisht për 3 objekte më datë 26.06.2022 në vlerën e investimit prej 1,438,894,719 lekë me TVSH dhe në përfundim për 2 objekte (Akademia, Menza) datë 17.07.2022 në vlerën e Investimit prej 741,534,842 lekë me TVSH. Pra nuk ka argumentim se për çfarë shkak duhet të prokurohej shërbimi i hartimit të projekt idesë kur projekt - preventivi i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU, ç'ka tregon keqmenaxhim të fondeve publike <b>në vlerën 5,698,405 lekë me TVSH</b>, e përfituar padrejtësisht nga OE "I.D.A" shpk.</p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.</li> <li>- Termat e referencës procedurës "Projekteve" dhe dokumentet e tenderit</li> <li>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik"</li> <li>- VKM 354 datë 11.05.2016 "Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mos realizim i detyrave të hartimit të project idesë sipas VKM 354 datë 11.05.2016 " <i>Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim</i> ".
<b>Shkaku:</b>	Mos përcaktim i saktë i detyrave të shërbimit të hartimit të projekt idesë.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, me specialist të fushës për vlerësimin e dokumentacionit shtesë të shërbimit të projektidesë në vlerën 5,698,405 lekë me TVSH, e cila nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit rezultonte si shërbim i papërfunduar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse shërbimi projektidesë pas vlerësimit të grupit me ekspertë rezulton i paplotësuar bazuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të merren masa ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga operatori ekonomik "I.D.-A." shpk.

***Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga shoqëria projektuese "I.D.A." është paraqitur observacioni me nr. 66 prot., datë 23.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 555/19 prot., datë 24.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:***

**Pretendimi i Subjektit:** Në përgjigje të shkresës Nr. 382 Prot., datë 19.04.2024 për dergimin e Projekt Raportit të Auditimit kryer nga Kontrolli Lartë i Shtetit për objektin: "*Projekti i Kampusit të Ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA Prona nr.108 me emërtim "Batalioni i Mbështetjes, Rrapi i Treshit Tirane"* sipas kontratës Nr.200/11 Prot., nënshkruar me datë 22.07.2022 midis Autoritetit Kontraktor Institutit Gjeografik Ushtarak dhe Bashkimit të Operatoreve Ekonomik: "I.D.-A." sh.p.k & "A.M.".

Hartimi i Analizes së Detyrës së Projektimit të perbashket me Detyren e Projektimit ka vetëm permbushjen e kërkesave sipas detyrës së projektimit, si psh siperfaqja për secilen godine. Për të hartuar projektin sipas fazave

fillimisht grupi i projektimit ka kryer një rievim topografik të mirëfilltë dhe ka bërë një dokumentim teknik të seciles godine, duke evidentuar në mënyrë të sakte ndërhyrjet e nevojshme për secilen godinë shoqëruar me foto, planimetri dhe pikat kryesore të cilat kanë nevojë për ndërhyrje. Nga rievimi topografik është përfutur Harta Topografike për të gjithë godinat dhe hapsirat e tyre të përfshira në gjurmën e projektit. Kjo ka bërë që dokumentacioni i dorëzuar përmbush kërkesat e detyrës së projektimit të hartuar nga autoriteti kontraktor dhe është konform VKM Nr. 354, datë 11.05.2016. Në përmbushje të Fazës 2 Projekt ideja paraprake, në kemi dorëzuar dokumentacionin teknik konform pikave të mëposhtme. i) Hartimin e zgjedhjeve teknike grafike dhe relacioneve perkatase ii) Parashikimin e kostove iii) Pergatitja e paraqitjeve te vecanta teknike. Pra kemi paraqitur 2 variante të ndryshme arkitektonike për realizimin e objektit të kontrates, preventivin paraprak nisur nga ndërhyrjet e nevojshme për këto godina dhe Raporte Teknike Strukturore për godinat që do i nenshtrohen rikonstruksionit. Dokumentacioni i dorëzuar nga ana jonë është hartuar duke përmbushur kërkesat e detyrës së projektimit nga autoriteti kontraktor Instituti të Gjeografise Ushtrake në baze te VKM Nr. 354, datë 11.05.2016.

Për më tepër, nga Shoqëria jone janë ndjekur edhe procedurat pranë Agjencise së Zhvillimit të Territorit, për paisjen me Leje Zhvillimi për këtë objekt sipas fazës që kemi dorëzuar, pra Projekt Idene Paraprake, e cila është miratuar nga KKT. Pas miratimit te projekt-idesë paraprake pranë Instituti te Gjeografise Ushtrake, është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit Leja e Zhvillimit të objektit me Vendim nr. 09 datë 08.03.2023 e hartuar në përmbushje të plotë të termave të references nga "I.D.A." shpk. Miratimi i Lejes së Zhvillimit vërteton më së miri që kërkesat e kontratës janë përmbushur me sukses dhe Shoqëria jone ka Hartuar një Analizë të Detyrës së Projektimit dhe Projekt Idene paraprake me te gjitha standartet e kërkuara sipas VKM Nr. 354, datë 11.05.2016. Duke qene se grupit të auditimit nuk mund ti jetë venë në dispozicion materiali i plote, po ju ridërgojme dokumentacionin e dërguar për secilen fazë për një rivleresim nga ana juaj.

Faza e pare:

1. Analiza e detyrës së projektimit, 2. Vlerësimi Teknik i godinave, 3. Rievimi Topografik, 4. Raporti Topografik.

Faza e dyte:

1. Relacion Arkitektonik, 2. Raportet Teknike Strukturore, 3. Projekt Ide Varianti I, 4. Projekt Ide Varianti II, 5. Kosto Paraprake Studime. Bashkëngjitur do të gjeni edhe Lejen e Zhvillimit të objektit dhe Vendimi i Keshilit Kombëtar të Territorit mbi Miratimin e Lejes. Për sa me sipër I.D.-A. shpk kundërshton me bindje të plotë gjetjet, pasi shërbimi është përmbushur me përpikmeri sipas detyrës së projektimit dhe legjislacionit ne fuqi duke u kryer edhe sherbime shtesë pa pagese, referuar neni 24, te VKM Nr. 354, datë 11.05.2016 te cilat me marrjen e Lejes nga KKT vërtetojnë që nga ana jone shërbimi është kryer duke u përmbushur edhe fazën e tretë dhe e katërt.

#### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Së pari:* Në lidhje me dokumentacionet shtesë të sjella nga shoqëria "I.D.A." shpk, sqarojmë se dokumentacionet e sjella në observacion nuk janë vënë në dispozicion grupit të auditimit gjatë fazës së terrenit, deri të dorëzimit të Akt Konstatimit datë 31.01.2024 dhe të fazës së hartimit të Projekt Raportit të Auditimit.

*Së dyti:* Bashkëlidhur dokumentacionit shoqëruar të projekt idesë, nuk është bashkëlidhur asnjë dokumentacion në lidhje me dorëzimin e tij në Ministrinë e Mbrojtjes nga grupi i marrjes në dorëzim të projekt idesë (procesverbal, inventari i dorëzimit etj).

*Së treti:* Grupit të auditimit referuar zbatimit të kontratës i është vënë në dispozicion materiali nga IGJIU referuar shkresën së OE "I.D.-A." shpk, nr. 468 prot., datë 20.09.2022, ku dorëzohet dokumentacioni i shërbimit të kontratës që bashkëngjitur ndodhej vetëm Analiza e Detyrës së projektimit dhe Projekt idea paraprake.

*Së katërti:* Inventari i dosjes përmbante vetëm 13 relacione të godinave për gjendjen ekzistuese dhe një planimetri IDE të tyre. Pra referuar dokumentacionit të dorëzuar në MM dhe vënë në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet një shërbim i pa plotësuar referuar VKM Nr. 354, datë 11.05.2016.

*Së pesti:* Procesverbali i marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 200/23 prot., datë 13.10.2022 për objektin "Hartim projekt Ide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë të AFA", i përbërë nga grupi i marrjes në dorëzim F. H., E. M. dhe L. L., rezultoi se është dorëzuar detyra e projektimit, termave të references dhe projekt ideja paraprake për kampusin, ku nuk disponohej asnjë nga dokumentacioni shtesë siç është sjellë në observacion.

*Së gjashti:* Referuar fazave të auditimit nga subjekti IGJIU, është paraqitur observacioni me e-mail datë 09.02.2024, ku nuk kundërshtohet pjesa atakuuese e konstatimit mbi shërbimin e realizuar të hartimit të projekt idesë nga "I.D.A." shpk dhe nuk është vënë asnjë dokumentacion shtesë nga IGJIU në lidhje

me mangësitë e konstatuara për zbatimin e kontratës nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022.

*Së shtati:* Referuar pagesës së bërë ndaj OE nga IGJIU për këtë shërbim, rezultoi se nuk kishte të bashkëlidhur dokumentacionin shtesë të sjellë me observacion, si dhe vendimi i KKT, të cilat konstatohen që janë marrë mbas likuidimit të shërbimit, duke shkaktuar shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore në lidhje me përdorimin e fondeve buxhetore, pasi shërbimi/mallrat/punët likuidohen pas marrjes në dorëzim të tyre më gjithë dokumentacionin shoqërues, i cili është dokument vërtetues ligjor i transaksionit.

Referuar argumentimeve Sa më sipër, observimi nuk merret në konsideratë dhe vlerësimi i situatës trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, ngelet nën juridiksionin e Ministrisë së Mbrojtjes.

**2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, me Autoritet Kontraktor Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), zhvillimi viti 2023.**

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, 2023</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar” REF-64386-03-30-2023 Urdhri nr. 19 prot., datë 29.03.2023	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. B. P., specialist për projektimin 2. M. Sh. specialist në IGJIU 3. N. S. specialist Jurist në IGJIU	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 19/1 prot., datë 29.03.2023 1. J. L. 2. A. G. 3. M. F.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 19,194,717 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 15,884,200 lekë Operatori Fitues: OE “A.E.” shpk	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 3,310,517 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 20.04.2023	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fonde vënë në dispozicion për vitin 2023,	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 4 B/OE b) S’kualifikuar 0 B/OE, c) Kualifikuar 4 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 35 ditë		

- Me urdhin e prokurimit nr. 19 datë 29.03.2023, urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, me fond limit 19,194,717 lekë pa TVSH, ku citohet se fondi është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023, për IGJIU. Përcaktimi i fondit limit prej 19,194,717 lekë pa TVSH, është realizuar nga një llogaritje e përafërt nga IGJIU referuar VKM 354 datë 11.05.2016, për vlerën e Investimit të zbatimit 525,562,000 lekë pa TVSH, duke referuar sipas grupeve tarifore dhe llogaritjeve përkatëse. Vlerat e përafërta të investimit janë referuar i projektit të hangarit të farkës dhe sipërfaqeve respektive, II rrugës lidhjes me taxiway, III nëntokës dhe punimet në themele dhe IV vlerat në ndikimin në mjedis dhe rezultoi tarifa minimale 15,883,735.27 me TVSH dhe tarifa maksimale 19,194,717.19 lekë me TVSH.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Përzgjedhje e gabuar e procedurës së prokurimit me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, dhe kriteret kualifikuese në kundërshtim me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”.
<b>Situata:</b>	Me urdhin e prokurimit nr. 19 datë 29.03.2023, urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë”, me fond limit 19,194,717 lekë pa TVSH, ku citohet se fondi është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023, për IGJIU. Përcaktimi i fondit limit prej <u>19,194,717 lekë pa TVSH</u> , është realizuar nga një

llogaritje e përafërt nga IGJIU referuar VKM 354 datë 11.05.2016, për vlerën e Investimit të zbatimit 525,562,000 lekë pa TVSH, duke referuar sipas grupeve tarifore dhe llogaritjeve përkatëse. Vlerat e përafërta të investimit janë referuar I projektit të hangarit të farkës dhe sipërfaqeve respektive, II rrugës lidhjes me taxiway, III nëntokës dhe punimet në themele dhe IV vlerat në ndikimin në mjedis dhe rezultoi tarifa minimale 15,883,735.27 me TVSH dhe tarifa maksimale 19,194,717.19 lekë me TVSH. Nga Komanda e Forcës Ajrore nr. 873/1 prot. Datë 06.03.2023, miratohet detyra e projektimit, ku përcaktohet infrastruktura e nevojshme, kuhstet dhe kërkesat e projektit, hartuar nga Kolonel A. K., N/kolonel L. K., N/kolonel F. D., N/kolonel M. J., Major A. F. dhe Kapiten S. H.. Me procesverbalin nr. 423/2 prot., datë 30.03.2023 hartohen argumentimet e specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese, ku përcaktohet kapacitetet ekonomike, teknike, licenca, stafi drejtues teknik, stafi mbështetës, numri mesatar punonjësish, certifikata dhe licenca, pajisje topografike. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar **35 ditë**, cka tregon veprime të paargumentuara dhe të pa llogjikshme në përcaktimin e afatit shumë të shkurtër për hartimin e projekt preventivit, ku nuk mund të zbatohen as fazat e shërbimit apo dorëzimit të projektit në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim*”. Afati shumë i shkurtër i dorëzimit të projekt- preventivit menjëherë ngushton shumë konkurrencës, duke mos stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik pasi është e pamundur realizimi i një projekti prej 15,995,597 lekë pa TVSH për 35 ditë kalendarike, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit. Gjithashtu konstatohet se në DT, procedura është trajtuar si kontratë *shërbimi mbikëqyrje apo kolaudimi*, ku është përcaktuar se të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlloritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354 në fjalë, do të skualifikohen, duke krijuar diskriminim dhe trajtim të pabarabartë për propozime teknike dhe ekonomike të Projekt Preventivin. *Pra konkursi i prokurimit nuk ka tarifa përfundimtare të cilët mund të s'kualifikosh OE për shkak të vlerave minimale pasi nuk është përcaktuar ende vlera e investimit përfundimtar.* Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”, ku citohet se: “*Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitimin e një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik. Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar*”. Sipas VKM 285 datë 19.05.2021 Neni 57 “Konkursi i projektimit” citohet: “Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 104, të LPP-së, nëpërmjet së cilës, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka kryesisht natyrë estetike, duke i mundësuar autoritetit/entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe

	inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt. Pika 5. Hapat e procedurës së konkursit të projektimit.... a) Titullari i autoritetit/entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, <i>urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit</i> . Në zbatim të VKM 354 datë 11.05.2016 “ <i>Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim</i> ”, neni 15 “Pagesa” citon se: 1. <i>Pagesa duhet të shlyhet, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kur shërbimi është kryer konform kontratës dhe është paraqitur tek porositësi një <u>faturë e kontrollueshme</u></i> . 2. <i>Këstet mund të paguhen në afatet e përcaktuara në kontratë ose në <u>distanca kohore logjike për shërbime të kryera dhe të vërtetueshme</u></i> . Referuar neni 3 “Shërbimet dhe tipologjitë e shërbimit” pika 5 përcakton fazat e shërbimit 1-9, ashtu si parashikohet pagesa sipas kalendarin e pagesve.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Projekteve” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shmangje të propozime teknike sipas LPP, të cilat do të sillnin oferta më të ulëta se vlera e kontraktuar.
<b>Shkaku:</b>	Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë në procedurat e prokurimit të projekteve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që të përgjedh projekte me propozime teknike (apo vlerësime me pike), në funksion të kërkesave të AK, duke propozuar oferta me kosto më të ulëta.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit të hapjes së ofertave datë 20.04.2023. KVO-ja ka kryer në SPE nga data 04.05.2023, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	A. E.	<b>15,884,200</b>	Kualifikuar fituesi
2	I. D.-A..	16,383,437	Kualifikuar
3	BOE “N.G.” & “D.”	16,421,544	Kualifikuar
4	“I.K. N. I.” & “A. & G. 2000” & “G. Z.”	17,536,166	Kualifikuar

Me procesverbalin e KVO datë 04.05.2023, të katërt ofertuesin kualifikohen. Me shkresën nr. 423/7 datë 05.05.2023 OE ”A.E.” shpk i kërkohet dorëzimi i dokumentacionit sipas nenit 83 të RrPP. Formulari i njoftimit të fituesit realizohet me nr. 423/8 prot., datë 16.05.2023 dhe raporti përmbledhës miratohet nga titullari me nr. 423/10 prot. datë 25.05.2023.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Kontrata e shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “ <i>Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për</i>
---------------------------	---

	<p><i>UAV në Bazën Ajrore Kuçovë</i>”, nuk ka përmbushur parashikimet ligjore të VKM 354 datë 11.05.2016 “Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.</p>
<b>Situata:</b>	<p>Me raportin nr. 423/10 prot. Datë 25.05.2023, miratohet procedura e prokurimit nga titullari dhe kontrata nënshkruhet me IGJIU dhe OE fitues "A.E." shpk me nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 me vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, ku nuk është përcaktuar asnjë kalendar pagesash e ndarë në faza si më poshtë: 1. % e vlerës së kontratës me marrjen në dorëzim të projekt idesë përfundimtare, 2. % e vlerës me dorëzimin e projektit për miratimin e lejes së ndërtimit, 3. % e vlerës me dorëzimin e projektit të zbatimit draft (<i>koordinimi midis komponentëve</i>), 4. % e vlerës me dorëzimin e projektit të zbatimit (final), 5. % e vlerës me dorëzimin e preventivit përfundimtar. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim nr. 423/8 prot., datë 25.08.2023 nga grupi i marrjes në dorëzim sipas urdhrit nr. 23/5 datë 24.07.2023, i përbërë nga B. P., E. M. dhe E. T., konstatohet se janë realizuar shërbimet: Analiza e detyrës projektimit dhe termat e referencës; Projekt Idea paraprake; Projekt idea Përfundimtare; Projektimi për miratimin e lejes së ndërtimit; Projekt Zbatimi; Preventivi përfundimtar; Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi. Fatura tatimore e operatorit ekonomik mban nr. 38/2023 datë 04.09.2023, me vlerë total 15,884,200 pa TVSH ose 19,061,040 lekë me TVSH dhe kërkesa për likuidim nr. 423/19 prot., datë 04.09.2023, e cila është e likuiduar nga financa e IGJIU plotësisht gjithë vlera e kontratës. <u>Sa më sipër në lidhje me dorëzimin e projektit konstatohet se:</u></p> <p><u>Së pari:</u> Në zbatim të VKM 354 datë 11.05.2016 “<i>Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim</i>”, neni 15 “Pagesa” citon se: 1. <i>Pagesa duhet të shlyhet, nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, kur shërbimi është kryer konform kontratës dhe është paraqitur tek porositësi një faturë e kontrollueshme.</i> 2. <i>Këstet mund të paguhen në afatet e përcaktuara në kontratë ose në distanca kohore logjike për shërbime të kryera dhe të vërtetueshme.</i> Referuar neni 3 “Shërbimet dhe tipologjitë e shërbimit” pika 5 përcakton fazat e shërbimit 1-9, ashtu si parashikohet pagesa sipas kalendarin e pagesve.</p> <p><u>Së dyti:</u> Mbështetur në nenin 7, “Përcaktimi i Tarifave” pika 5 të VKM 354 datë 11.05.2016 “<i>Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim</i>”, citohet: <i>Nëse, gjatë kohës të vlefshmërisë së kontratës, ndryshon projekti me kërkesë të porositësit, duke ndikuar në ndryshimin e kostos së llogaritshme, vlerat ose njësitë e llogaritjes, atëherë marrëveshja mbi të cilën është e llogaritur tarifa, duhet të rillogaritet dhe të dokumentohet me shkrim.</i> Pra AK, nuk ka marrë masa për rillogaritjen e vlerave të projektimit. Pika 8 citon:</p> <p>Për lidhjen e kontratës së shërbimit dhe për llogaritjen e tarifës, si bazë merret vlerësimi i përafërt i kostove të llogaritshme, i cili parashtrohet nga investitori (porositësi) ose përgatitet nga ofruesi i shërbimit në kryerjen e fazës së dytë të shërbimit “Projektideja paraprake”. Në rastin, kur vlerësimi i përafërt i kostos llogaritet nga ofruesi i shërbimit, atëherë kjo kosto mbart një tolerancë maksimale prej 30% nga kostoja</p>



	<p>përfundimtare. <i>Kjo kosto shërben si bazë për lidhjen e kontratës.</i> Mbas përfundimit të fazës së shtatë të shërbimit: “Organizimi i procedurës dhe vlerësimi i tenderit” vendoset “<i>Kostoja e llogaritshme e tenderuar</i>” dhe bëhet rillogaritja e tarifës së shërbimit, e cila i shtohet kontratës në formën e një shtojce. Kjo kosto mbart një tolerancë maksimale prej 10% nga kostoja e llogaritshme përfundimtare. Mbas përfundimit të fazës së nëntë të shërbimit: “Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar për kolaudim”, bëhet kontraktimi i “<i>Kostos së llogaritshme përfundimtare të objektit</i>”. <b><i>Kjo kosto është kostoja e llogaritshme përfundimtare dhe reale dhe mbi këtë kosto bëhet rillogaritja e tarifës përfundimtare të shërbimit.</i></b></p> <p>- Referuar Projekt – Preventivit të dorëzuar nga projektuesi “A.E.” shpk, konstatohet se vlera e Investimit për objektin “<i>Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë</i>”, rezulton në vlerën <b>345,647,428 lekë me TVSH</b>. Pra kjo është kostoja përfundimtare e cila do të rillogaritet vlera e shërbimit të projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit. Në bazë të kostove të objektit, është llogaritur tarifa e projektimit, nga grupi i auditimit dhe specialistë të IGJIU, si më poshtë: I. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira shuma 258,106,339 lekë me TVSH, II. Rruga taxiway parkimet shuma 90,209,677 lekë me TVSH, III. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira + Rruga taxiway parkimet shuma 345,647,428 lekë me TVSH. Në bazë të vlerave sa më sipër rezultojnë tarifat e projektimit si më poshtë:</p> <table data-bbox="440 1041 925 1108"> <tr> <td>Totali</td> <td>Min</td> <td>7,393,174 lekë</td> </tr> <tr> <td></td> <td>Max</td> <td>9,010,110 lekë</td> </tr> </table> <p><b>Sa më sipër,</b> konstatohet mos llogaritje të kostove të ndërtimit përfundimtare dhe rrjedhimisht edhe kostove të shërbimit të projektimit, duke u përfituar padrejtësisht pagesa shtesë në favor të projektuesit. Kontrata e shërbimit nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 midis OE “A. E.”, dhe Titullarit të IGJIU, u nënshkrua me çmimin e ofertuar nga kontraktuesi dhe i miratuar nga AK, në vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, pra me diferencë <math>(15,884,200 - 7,393,174) = 8,491,026</math> lekë pa TVSH ose <b>10,189,231 lekë me TVSH, e cila përbën Dëm Ekonomik për Buxhetin e Shtetit</b>, e përfituar padrejtësisht nga projektuesi “A.E.” shpk.</p>	Totali	Min	7,393,174 lekë		Max	9,010,110 lekë
Totali	Min	7,393,174 lekë					
	Max	9,010,110 lekë					
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.</li> <li>- Termat e referencës procedurës “Projekteve” dhe dokumentet e tenderit</li> <li>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”</li> <li>- VKM 354 datë 11.05.2016 “Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.</li> </ul>						
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Përfitim i padrejtë në vlerën 10,189,231 lekë me TVSH, për shërbimin e hartimit të projektit.						
<b>Shkaku:</b>	Mos llogaritje të kostove të ndërtimit përfundimtare dhe rrjedhimisht edhe kostove të shërbimit të projektimit, duke u përfituar padrejtësisht pagesa shtesë në favor të projektuesit.						
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.						
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrotjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mos llogaritjeve të kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej <b>10,189,231 lekë</b>						

	me TVSH e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “A.E.”.
--	--

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”**, me Autoritet Kontraktor Institutit të Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU), zhvillimi i procedurës viti 2023.

Të dhëna mbi objektin e prokurimit:

<b>a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”,2023</b>		
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur e thjeshtuar” REF-60498-02-27-2023 Urdhri nr. 12 prot., datë 15.02.2023	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> 1. B. P., specialist për projektimin 2. M. Sh. specialist në IGJIU 3. N. S. specialist Jurist në IGJIU	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 12 prot., datë 15.02.2023 1. J. L. 2. A. G. 3. M. F.
<b>4. Fondi Limit (pa tvsh)</b> 5,830,600 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa tvsh)</b> 4,756,057 lekë Operatori Fitues: OE “I. D.-A.” shpk	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)</b> 1,074,543 lekë ose
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 15.03.2023 ndryshon 23.03.2023	<b>8. Burimi Financimit, Fondet e MM</b> Fonde vënë në dispozicion për vitin 2023,	<b>9. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 2 B/OE b) S’kualifikuar 1 B/OE, c) Kualifikuar 1 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 30 ditë		

Me urdhnin e prokurimit nr. 12 datë 15.02.2023, të titullarit të IGJIU T. K., urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt **“Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”**, me fond limit 5,830,600 lekë pa TVSH si vlerë max dhe 4,753,691 lekë si vlerë min, ku citohet se fondi është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023, për IGJIU.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Përzgjedhje e gabuar e procedurës së prokurimit me objekt: <b>“Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”</b> , dhe kriteret kualifikuese në kundërshtim me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 <b>“Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim”</b> .
<b>Situata:</b>	Me urdhnin e prokurimit nr. 12 datë 15.02.2023, të titullarit të IGJIU T. K., urdhërohet të zhvillohet procedura e prokurimit me objekt <b>“Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë”</b> , me fond limit 5,830,600 lekë pa TVSH si vlerë max dhe 4,753,691 lekë si vlerë min, ku citohet se fondi është vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për vitin 2023, për IGJIU. Përcaktimi i fondit limit është realizuar nga një llogaritje e përafërt nga IGJIU referuar VKM 354 datë 11.05.2016, për vlerën e Investimit të zbatimit përafërt <u>103,179,114 lekë pa TVSH</u> , duke referuar sipas grupeve tarifore dhe llogaritjeve përkatëse. Nga Komanda e Forcës Ajrore nr. 129/3/1 prot. Datë 03.02.2023, miratohet detyra e projektimit, ku përcaktohet infrastruktura e nevojshme, kushtet dhe kërkesat e projektit, hartuar nga N/Kolonel M. J. dhe Kapiten S. H.. Me

procesverbalin nr. 200/2 prot., datë 27.02.2023 hartohen argumentimet e specifikimeve teknike dhe kriterëve kualifikuese, ku përcaktohet kapacitetet ekonomike, teknike, licenca, stafi drejtues teknik, stafi mbështetës, numri mesatar punonjësish, certifikata dhe licenca, pajisje topografike. Afati i realizimit të kontratës është përcaktuar **30 ditë**, cka tregon veprime të paargumentuara dhe të pa llogjikshme në përcaktimin e afatit shumë të shkurtër për hartimin e projekt preventiv, ku nuk mund të zbatohen as fazat e shërbimit apo dorëzimit të projektit në përputhje me VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim*”. Afati shumë i shkurtër i dorëzimit të projekt-preventivit menjëherë ngushton shumë konkurrencën, duke mos stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik pasi është e pamundur realizimi i një projekti prej 5,830,600 lekë pa TVSH për 30 ditë kalendarike, çka ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit. Gjithashtu konstatohet se në DT, procedura është trajtuar si kontratë shërbimi mbikëqyrje apo kolaudimi, ku është përcaktuar se të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përllogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354 në fjalë, do të skualifikohen, duke krijuar diskriminim dhe trajtim të pabarabartë për propozime teknike dhe ekonomike të Projekt Preventivin, pasi edhe vetë vlerat minimale të projektit janë të përafërta dhe jo përfundimtare si në rastin e shërbimit e mbikëqyrjes dhe kolaudimit. Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”, ku citohet se: *Konkursi i projektimit mund të organizohet si pjesë e një procedure, që shërben për përfitimin e një projekti ose për përcaktimin e një fituesi të një kontrate shërbimi publik. Në rastin kur autoriteti/enti kontraktor organizon një konkurs projektimi, ku objekti është një projektide, në dokumentet e tenderit duhet të përcaktohen qartë kriteret e vlerësimit teknik, çmimi dhe/ose rimbursimet që jepen për kandidatin fitues dhe për kandidatët e tjerë të pranuar.* Sipas VKM 285 datë 19.05.2021 Neni 57 “Konkursi i projektimit” citohet: Konkursi i projektimit është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 104, të LPP-së, nëpërmjet së cilës, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh një studim ose projekt, që ka kryesisht natyrë estetike, duke i mundësuar autoritetit/entit kontraktor që të blejë, kryesisht, në fushat e planifikimit urban dhe rural, arkitekturës dhe inxhinierisë ose përpunimit të të dhënave, një plan ose projekt. Pika 5. Hapat e procedurës së konkursit të projektimit.... a) Titullari i autoritetit/entit kontraktor apo personi i autorizuar nxjerr urdhrin e prokurimit, sipas parashikimeve të nenit 77 të këtyre rregullave. Për këtë lloj procedure prokurimi, *urdhri i prokurimit nuk përmban fondin limit.* Me procesverbalin e KVO datë 30.03.2023, dhe me shkresën nr. 260/7 datë 30.03.2023, s’kualifikohet BOE ”D.” shpk & ”N.G.” shpk për shkak se oferta e tyre është me vlerë më të ulët se minimumi i lejuar i shërbimit sipas VKM 354. Pra konstatohet qartë se kjo procedurë është trajtuar si shërbim mbikëqyrje me vlera fikse dhe jo projekt duke s’kualifikuar padrejtësisht operatorë me vlera më të

	ulëta. Referuar bazës ligjore të shërbimit konsulencës dhe konkursit të projektimit ky operator nuk duhet të s’kualifikohej, pasi tarifata nuk janë përfundimtare.
<b>Kriteri:</b>	- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. - Termat e referencës procedurës “Projekteve” dhe dokumentet e tenderit - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Shmangje të propozime teknike sipas LPP, të cilat do të sillnin oferta më të ulëta se vlera e kontraktuar.
<b>Shkaku:</b>	Përzgjedhja e procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” është në kundërshtim me nenin 104 “Konkursi i Projektimit” të ligjit Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe neni 57 të VKM 285 datë 19.05.2021 “Konkursi projektimit”.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë në procedurat e prokurimit të projekteve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që të përgjedh projekte me propozime teknike (apo vlerësime me pike), në funksion të kërkesave të AK, duke propozuar oferta me kosto më të ulëta.

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 B/OE, për të cilët, referuar procesverbalit të hapjes së ofertave datë 23.03.2023. KVO-ja ka kryer në SPE nga data 30.03.2023, vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	S’kualifikuar/ Kualifikuar
1	D. & N. G.	4,634,408	S’Kualifikuar si vlera më ulët se vlera Minimale
2	I. D.-A..	4,756,057	Kualifikuar fituesi

OE “I. D.-A.” shpk i kërkohet dorëzimi i dokumentacionit sipas nenit 83 të RrPP. Formulari i njoftimit të fituesit realizohet me nr. 265/9 prot. Datë 12.04.2023 dhe raporti përmbledhës miratohet nga titullari me nr. 265/10 prot. Datë 20.04.2023. Kontrata nënshkruhet me AK IGJIU dhe OE fitues me nr. 265/15 prot. Datë 04.05.2023 me vlerën 4,756,057 lekë pa TVSH, ku nuk është përcaktuar asnjë kalendar pagesash në faza si më poshtë:

1. % e vlerës së kontratës me marrjen në dorëzim të projekt idesë përfundimtare, 2. % e vlerës me dorëzimin e projektit për miratimin e lejes së ndërtimit, 3. % e vlerës me dorëzimin e projektit të zbatimit draft (*koordinimi midis komponentëve*), 4. % e vlerës me dorëzimin e projektit të zbatimit (final), 5. % e vlerës me dorëzimin e preventivit përfundimtar. Me urdhrin e titullarit IGJIU nr. 12/1 datë 24.05.2023, ngrihet grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga B. P., E. M. dhe E. T.. Me shkresën e operatorit ekonomik “I.D.-A.” shpk nr. 269/19 prot., datë 02.06.2023, dorëzohet projekti i zbatimit i plotë. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim nr. 265/20 prot., datë 30.06.2023 nga grupi i marrjes në dorëzim, konstaton se janë realizuar shërbimet: Analiza e detyrës projektimit dhe termat e referencës; Projekt Idea paraprake; Projekt Idea Përfundimtare; Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; Projekt Zbatimi; Preventivi përfundimtar; Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi. Auditim energjistik, Raport projekt të sistemit fotovoltaiik.

*Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (Ministria e Mbrojtjes) është paraqitur observacioni me nr. 334/1 prot., datë 24.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 555/20 prot., datë 30.04.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:*

**Pretendimi i Subjektit:** Lidhur me rekomandimet dhe vlerësimet e KLSH, IGJIU ka vlerësuar dhe çmon të theksojë se rekomandimet kanë vlerë për tu konsideruar në një pjesë të tyre dhe në vijim IGJIU angazhohet që ti marrë në konsideratë. Për një pjesë të gjetjeve dhe rekomandimeve ka paraqitur kundërshtime. IGJIU përvec se është organ kërkimi-shkencor është edhe organ blerës, për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore të cilat nuk mbulohen plotësisht. Në bazë të projekteve të realizuar nga IGJIU, rezulton se 2023 janë blerë vetëm 3 projekte në raport me 31 projekte të realizuar nga IGJIU, ku faktor i rëndësishëm është edhe koha e kërkuar nga MM për realizimin e projekteve. Lidhur me konkursin e projektimit sqarohet përdorimi i procedurës për afatin e shpejtë të kohës, cka vendos IGJIU-në në kushte të pafavorshme dhe pamundësinë për ti zbatuar. Në projektin e prokuruar “Hartim projekt ide paraprake për kampusin e fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë AFA” nga IGJIU objekt trajtimi dhe analizë nga ana e KLSH, janë kryer aplikimet përkatëse dhe ky projekt është pranuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 9 datë 08.03.2023. Projekti është dorëzuar sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim nr 200/23 prot., datë 13.10.2022 (Analiza detyrës projektimit dhe projekt idea paraprake). Në observacion komentohet lidhur me vlerën e kontratave të shërbimeve, ku do të gjendeshin në kushtet e “nxitjes” së projektuesve për përpilim të projekteve me vlerë më të lartë për arsye të rritjes së cmimit. Ndryshimi i cmimit referuar projektit “Hartim projekt preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në bazën ajrore Kuçovë” duhet të analizohet në rritje.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet dhe sqarimet e kryera nga IGJIU, merren pjesërisht në konsideratë për faktin e korrigjimeve të mënyrës prokuroese në të ardhmen dhe mungesa e stafit teknik. Në lidhje me projektin e prokuruar “Hartim projekt ide paraprake për kampusin e fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë AFA” nga IGJIU objekt trajtimi dhe analizë nga ana e KLSH, janë kryer aplikimet përkatëse dhe ky projekt është pranuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me Vendimin nr. 9 datë 08.03.2023, sqarojmë se në momentin e pagesës së këtij shërbimi projekti nuk ka qenë i plotë dhe i marrë në dorëzim i pa plotësuar referuar edhe procesverbalit të marrjes në dorëzim nr. 200/23 datë 13.10.2022.

Në lidhje me zbatimin e VKM 354 të tarifave të shërbimit, grupi i auditimit sqaron se duhet qëndruar rigorozisht tarifave përkatëse të shërbimeve edhe në rastet kur shërbimi i projektimit rezulton në rritje si në rastin e projektit “Hartim projekt preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në bazën ajrore Kuçovë”, pasi janë të mirëpërcaktuar në nenet përkatëse të VKM 354, rrjedhimisht për këtë pjesë komentet nuk merren në konsideratë.

**Prokurimet e realizuara nga Ministria e Mbrojtjes mbi blerjet Ushtarake**

Procedurat e prokurimit objekt auditimi përjashtohen nga aplikimi i ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Këto procedura prokurimi zhvillohen sipas VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Veçantë të Klasifikimit të këtyre kontratave)”.

Prokurimet sipas VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e

kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Veçantë të Klasifikimit të këtyre kontratave).

Procedurat e prokurimit objekt auditimi, periudha e zhvillimit të të cilave është nga viti 2018 deri në Dhjetor të vitit 2020, janë të përjashtuara nga prokurimi publik, bazuar në pikën 2/b të nenit 5 dhe nenin 6 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, të ndryshuar. Këto procedura janë zhvilluar bazuar në:

Vendimin e KM nr. 521, datë datë 08.08.2007 “Për procedurat që përdoren nga Ministria e Mbrojtjes për prokurimin e disa mallrave dhe shërbimeve të përjashtuara nga rregullat e përgjithshme të prokurimit publik”, të ndryshuar me VKM nr. 1403, datë 27.10.2008.

Mbi Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zhvilluar sipas Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimrt në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Procedurat e prokurimit objekt auditimi zhvillohen bazuar në ligjin 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.

Nga shqyrtimi i bazës ligjore me të cilën janë zhvilluar këto procedura vërehen disa mospërputhje mes Ligjit 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020, konkretisht;

Referuarv ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, në nenin 53, pika 2 dhe 3 parashikohet:

2. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 15 ditëve**, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
3. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 15 ditëve**, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

Ndërsa në VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, në nenin 62, pika 4 dhe 5 parashikohet:

4. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve**, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.
5. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 (dhjetë) ditëve**, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

Për sa më sipër, vërehet një mospërputhje e afateve të ankimit mes parashikimeve të ligjit 36/2020 dhe VKM nr.1170, datë 24.12.2020. Duke qenë se ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit shqiptar me legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC, rekomandojmë që Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim korigjimin dhe ndryshimin e afateve në dispozicion të operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ankesave, në përputhje dhe përafrim të Direktivës 2009/81/EC.

Një tjetër mangësi që konstatohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) është edhe mos parashikimi i afateve të ankimit pas përzgjedhjes së kandidatëve në fazën e parë të procedurës së kufizuar. Konkretisht në kushtet kur dispozitat

ligjore nuk e rregullojnë këtë fazë të procedurës (lidhur me afatet e ankimit dhe kohën e fillimit të tyre), rekomandojmë që Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim përmbushjen e kësaj mangësie dhe parashikimin e një afati për paraqitjen e ankesave nga operatorët ekonomikë pas përfundimit të fazës së parë të procedurës së kufizuar.

Referuar VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, neni 5 “Kufijtë monetarë”, në nenin 1/a) parashikohet:

*1. Në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së, kufijtë monetarë janë:*

*a) kufiri për procedurat ndërkombëtare:*

*i. për kontratat e furnizimit dhe shërbimit me vlerë jo më të ulët se **50,964,400 lekë**;*

*ii. për kontratat e punëve me vlerë jo më të ulët se **6,371,787 lekë**.*

Duke pasur parasysh që ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit Shqiptar me Legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC, rezulton se vlera e përcaktuar e kufirit për procedurat ndërkombëtare për kontratat e punëve (me vlerë jo më të ulët se **6,371,787 lekë**), është një lapsus (**gabim**) në përkthimin e vlerës së Direktivës 2009/81/EC, ku parashikohet se për kontratat e punëve kufiri i përcaktuar është 5,150,000 Euro.

Për sa më sipër, rekomandojmë që Ministria e Mbrojtjes të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim korigjimin dhe ndryshimin e vlerës së përcaktuar në përputhje dhe përafrim të Direktivës 2009/81/EC.

Referuar VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, hapat për zhvillimin e procedurave të prokurimit janë përkatësisht si më poshtë:

- Gjenerimi i kërkesës operacionale (nuk ka afate të përcaktuar), bëhet nga struktura ushtarake e cila ka nevojën për furnizimin me mall apo shërbime, në mbështetje të plotësimit të misionit dhe detyrave të tyre funksionale (neni 5).
- Klasifikimi i kërkesave operacionale bëhet nga Komisioni i Veçantë i Klasifikimit (neni 6, nuk ka afate të përcaktuar). *Komisioni i Veçantë i Klasifikimit është strukturë e ngritur pranë Ministrisë së Mbrojtjes, i cili ka për qëllim klasifikimin ose jo të kërkesave operacionale, të hartuara nga strukturat gjeneruese, si kërkesa për kontrata për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake...., ndërsa miratimi i vendimit të KVK dhe vijimi i procedurave të mëtejshme bëhet nga Ministri i Mbrojtjes (neni 37/11, nuk ka afate të përcaktuar).*
- Ngritja e grupit për hartimin e projektit (nuk ka afate të përcaktuar) bëhet me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor, përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona dhe ka në përbërje ekspertë të fushës, përfaqësues të strukturës përkatëse për modernizimin dhe të strukturës gjeneruese të kërkesës operacionale. (neni 8). Grupi i punës është e vetmja strukturë përgjegjëse për përzgjedhjen e operatorëve që do të ftohen dhe përcaktimin e numrit të tyre.
- Pas miratimit nga Titullari i Autoritetit Kontraktor projekti dërgohet pranë strukturës përkatëse të prokurimit për vijimin e procedurave (Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve).
- Kur sigurohen fondet dhe ka nevojë për mallra dhe shërbime, titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar prej tij, miraton urdhrin e prokurimit, i cili duhet të përmbajë të paktën: (neni 25/5)
  - a) objektin e prokurimit;
  - b) përbërjen e njësisë së prokurimit;
  - c) vlerën limit të kontratës;
  - ç) llojin e procedurës së prokurimit dhe arsyet e përdorimit të saj”.

- Në vijim, pas miratimit të urdhrimit të prokurimit njësia e prokurimit harton dokumentet e tenderit, sipas llojit të procedurës së prokurimit (neni 15/1).
- Pas hartimit të dokumenteve të tenderit, titullari i autoritetit kontraktor apo personi i autorizuar, në përshtatshmëri me tipin e procedurës së prokurimit, miraton njoftimin e kontratës dhe ftesat për ofertë të cilat i dërgohen operatorëve ekonomikë të përzgjedhur (neni 26).
- Pas dërgimit të njoftimit të kontratës dhe ftesave për ofertë, ofertat dorëzohen në adresën e përcaktuar në dokumentet e tenderit brenda afatit kohor të përcaktuar në këto dokumente si afati i fundit për dorëzimin e ofertave. Çdo ofertë, e dorëzuar pas afatit të përcaktuar në njoftimin e autoritetit kontraktor, nuk shqyrtohet nga komisioni dhe i kthehet e pahapur kandidatit/ofertuesit (neni 27).
- Hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhen nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ngritur me urdher të titullarit të AK, brenda 20 ditëve nga afati i caktuar për dorëzimin e ofertave (neni 28).
- Klasifikimi përfundimtar i hartuar nga KVO u komunikohet komunikohet ofertuesve me shkrim ose në rrugë elektronike (neni 16).
- Çdo operator ekonomik, pjesëmarrës në një procedurë prokurimi që rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, mund ta kundërshtojë këtë vendim, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga data kur ankimesi është vënë në dijeni të dokumenteve ose vendimmarrjes që konteston (neni 31).
- Komisioni i vlerësimit të ofertave, pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, përgatit një raport përmbledhës dhe i propozon fituesin titullarit të autoritetit kontraktor (neni 28).
- Me përfundimin e afateve/procedurave të ankimit autoritetit kontraktor bën shpalljen e fituesit (neni 28).
- Pas miratimit të fituesit, titullari i autoritetit kontraktor urdhëron krijimin e Komisionit të Negocimit të Kontratës për negocimin e kushteve të saj. Nënshkrimi i kontratës brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, me kusht që të jetë bërë sigurimi i saj.
- Zbatimi dhe mbikëqyrja e kontratës realizohet nga struktura përgjegjëse për modernizimin, e cila vlerëson realizimin e detyrimeve kontraktuale, sipas fazave të realizimit të kontratës dhe përgatit raportin përkatës për fazën në të cilën është zbatimi i kontratës.  
Në përfundim të kontratës, struktura përgjegjëse për modernizimin përgatit një raport përmbledhës për titullarin e autoritetit kontraktor për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit, me kërkesë të tij (neni 33).

Në Ministrinë e Mbrojtjes gjatë periudhës të programit të auditimit nr. 555/1, datë 17.07.2023, bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Veçantë të Klasifikimit të këtyre kontratave”, janë zhvilluar procedurat e prokurimit përkatësisht si më poshtë:

#### **Gjatë vitit 2021:**

1. Procedura e prokurimit “Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë”, me objekt “Blerje shërbim mirëmbajtje (extra works) për helikopterin tip AS-350B, me shenjë anësore ZA-HTD”, me fond limit 159,376 Euro pa T.V.SH.
2. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Vlerësimi (survey) i gjendjes teknike të anijeve të Forcës Detare”, me fond limit 36,000 Euro pa T.V.SH.



### Gjatë vitit 2022:

1. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Blerje Sistem Identifikimi Automatik Ushtarak (Warship – Automatic Identification System) për anijet e klasit “Iliria”, me fond limit 155.000 Euro pa T.V.SH.
2. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese” me objekt, “Blerje pajisje dhe armatim individual dhe kolektiv jo-vrasës”, me fond limit 819.906 Euro pa T.V.SH.
3. Procedura e prokurimit “Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë”, me objekt “Përditësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të kodifikimit BULCOD të Qendrës së Menaxhimit të Materialeve të FA-së”, me fond limit 125.000 Euro pa T.V.SH.
4. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Kompletim me shtimje 20 mm x 102 për topat e anijeve të klasit Iliria”, me fond limit 1,112,850 Euro pa T.V.SH.
5. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Kompletimi me aksesore dhe pjesë këmbimi për gjithë tipet e armatimit të lehtë të këmbësores në FT”, me fond limit 20,624,897 EURO pa T.V.SH., e ndarë në dy lote.
6. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Kompletim me armatim individual dhe aksesore për Forcen Tokesore”, me fond limit 12,884,987 EURO pa T.V.SH.
7. Procedura e prokurimit “Procedurë konkurruese”, me objekt “Kompletimi me pajisje dhe pajime individuale/kolektive speciale luftimi dhe për kushte ekstreme moti e terreni për b2k/ROS”, me fond limit total 20,923,346 EURO pa T.V.SH., e ndarë në dy lote.
8. Procedura “Shtet me shtet”, me objekt “Kompletimi me avionë pa pilot (Unmanned Aerial Vehicles) të armatosur.

**Gjatë vitit 2023**, për periudhën objekt auditimi, **nuk janë zhvilluar procedura prokurimi** sipas VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operationale, përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Veçantë të Klasifikimit të këtyre kontratave)”. Për sa i përket procedurave të prokurimit si më sipër, të zhvilluara në periudhën 2021-2023, vërehet se në total janë zhvilluar 10 (dhjetë) procedura prokurimi, prej të cilave 2 (dy) janë “Procedurë me negociim të drejtpërdrejtë”, të zhvilluara sipas nenit 20, të VKM nr. 1085, datë 24.12.2020, 7 (shtatë) janë “Procedurë konkurruese”, të zhvilluara sipas nenit 19, të VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 dhe 1 është procedurë “Shtet me shtet” e zhvilluar sipas nenit 21, të VKM nr. 1085, datë 24.12.2020.

- Në vitin 2021 janë zhvilluar 2 procedura me fond limit total në vlerën 195,376 Euro dhe janë lidhur 2 kontrata në vlerën 194,876 Euro. Janë kursyer 500 Euro fonde buxhetore, **ose 99.7 %**.
- Në vitin 2022 janë zhvilluar 7 procedura me fond limit në vlerën 56,645,986 Euro dhe janë lidhur 7 kontrata në vlerën 52,213,796 Euro. Janë kursyer 4,432,190 Euro fonde buxhetore, **ose 92.1%**.

Siç vërehet efektiviteti i këtyre procedurave prokurimi është ***pothuajse minimal***, nëse krahasohet me procedurat e prokurimit publik ku si efekt i pjesëmarrjes dhe konkurrencës më të lartë vërehet një ulje në vlerën e ofertave të paraqitura dhe fituese dhe si rrjedhojë një kursimmë i lartë i fondeve buxhetore.

- Gjithashtu, edhe moszhvillimi i asnjë procedure prokurimi në vitin **2023**, bazuar në VKM nr. 1085, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për lidhjen e kontratave për blerjen e pajisjeve/mjeteve të projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake, si dhe

armët, municionet apo materialet luftarake për qëllime operacionale, përfshirë teknologjinë dhe softëare-t e lidhura me këto mallra, si dhe për përbërjen, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komisionit të Veçantë të Klasifikimit të këtyre kontratave”, në kushtet kur ka disa kërkesa operacionale të miratuara nga KVK, është një mangësi e theksuar në organizimin dhe funksionimin e sektorit të projekteve dhe pajisjeve ushtarake.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mospërputhje të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në ligjin 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.
<b>Situata:</b>	<p>Mbi Prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, zhvilluar sipas Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimrt në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020“Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Nga shqyrtimi i bazës ligjore me të cilën janë zhvilluar këto procedura vërehen disa mospërputhje mes Ligjit 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020, konkretisht;</p> <p>Referuarv ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, në nenin 53, pika 2 dhe 3 parashikohet:</p> <p>2. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen <b>brenda 15 ditëve</b>, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>3. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen <b>brenda 15 ditëve</b>, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p><b>Ndërsa</b> në VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, në nenin 62, pika 4 dhe 5 parashikohet:</p> <p>4. Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen <b>brenda 10 ditëve</b>, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>5. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen <b>brenda 10 (dhjetë) ditëve</b>, nga dita e nesërme e marrjes dijeni të njoftimit të fituesit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.</p> <p>Për sa më sipër, vërehet një mospërputhje e afateve të ankimit mes parashikimeve të ligjit 36/2020 dhe VKM nr.1170, datë 24.12.2020. Duke qenë se ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit shqiptar me legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC.</p> <p>- Një tjetër mangësi që konstatohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) është edhe mos parashikimi i afateve të ankimit pas përzgjedhjes së kandidatëve në fazën e parë të procedurës së kufizuar. Konkretisht në kushtet kur dispozitat ligjore nuk e rregullojnë këtë fazë të procedurës (lidhur me afatet e ankimit dhe kohën e fillimit të tyre).</p> <p>- Referuar VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, neni 5 “Kufijtë</p>

	<p>monetarë”, në nenin 1/a) parashikohet:  <i>1. Në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së, kufijtë monetarë janë:</i>  <i>a) kufiri për procedurat ndërkombëtare:</i>  <i>i. për kontratat e furnizimit dhe shërbimit me vlerë jo më të ulët se 50,964,400 lekë;</i>  <i>ii. për kontratat e punëve me vlerë jo më të ulët se 6,371,787 lekë.</i>  - Duke pasur parasysh që ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit Shqiptar me Legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC, rezulton se vlera e përcaktuar e kufirit për procedurat ndërkombëtare për kontratat e punëve (me vlerë jo më të ulët se <b>6,371,787 lekë</b>), është një lapsus (<b>Lapsus</b>) në përkthimin e vlerës së Direktivës 2009/81/EC, ku parashikohet se për kontratat e punëve kufiri i përcaktuar është 5,150,000 Euro.</p>
<b>Kriteri:</b>	- Ligji 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” - VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Paqartësi në procedurat e prokurimit Ushtarake.
<b>Shkaku:</b>	Mospërputhje ligjore.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim korigjimin dhe ndryshimin e vlerës së kufijtë monetarë sipas përcaktimeve të Direktivës 2009/81/EC.</li> <li>2. Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërmarrë masat e nevojshme për rregullimet e mospërputhshmërinë ligjore të afateve të ankesave për dokumentet e procedurave prokuruese.</li> <li>3. Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim përmbushjen e parashikimit të afatit të paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomikë pas përfundimit të fazës së parë të procedurës së kufizuar.</li> </ol>

## **ZBATIMI I KONTRATAVE**

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratë me objekt: “**Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë**”, konstatohet:

Projekti parashikon ndërtimin e 2 godinave, një godinë dy katëshe dhe një godinë një katëshe të ndara mes tyre me një fugë 5 cm. Njëra nga godinat e reja është organizuar në 2 kate me strukturë beton arme (tra – kollonë –plintë) dhe godina tjetër është një katëshe me strukturë metalike dhe me kapriadë metalike. Projekti është realizuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU). Objekti i kontratës “**Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë**” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 5937/2 prot. datë 10.10.2022, të lidhur midis Autoritetit Komandës Mbështetëse, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade I. Xh. dhe OE "E. K." shpk, përfaqësuar nga

administratori C. S.. Vlera e kontratës është 106,799,999 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar *5 muaj ose 150 ditë* nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 5938/2 prot. datë 10.10.2022, të lidhur midis Autoritetit Autoritetit Komandës Mbështetëse, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade I. Xh. dhe OE “D.” shpk, përfaqësuar nga administratori V. T. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 28.10.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët më datë 28.10.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 12.12.2022. Me kërkesën e sipërmarrësit nr. 1706 prot., datë 16.03.2023 drejtuar Autoritetit Kontraktor dhe mbikëqyrësit të punimeve, amendim kontrate për zgjatje të punimeve, për shkak të kushteve atmosferike dhe zgjatja e kërkuar është deri më datë 15.05.2023. Me amendimin e kontratës nr. 2014/2. Datë 29.03.2023, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve 190 ditë. Sipas procesverbalit të përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi, punimet deklarohen se janë përfunduar më datë 22.04.2023. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 3279/2 prot. datë 01.06.2023, të lidhur midis Autoritetit Komandës Mbështetëse, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade F. D. dhe OE "G.K." shpk, përfaqësuar nga administratori L.H. me Licensë M..... Akti i kolaudimit nuk përmban datë dhe nuk është nënshkruar nga Investitori. Me urdhrin e Gjeneral Brigade F. D. nr. 587 datë 06.07.2023, ngrihet grupi i punës i marrjes në dorëzim i përbërë nga Kolonel H. G., N/kolonel A. H., Major B. M., Kolonel L. Xh., anëtarë nga IGJIU dhe përfaqësues të PU. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim nuk është realizuar nga grupi të punës. Referuar pagesave pjesore konstatohet mospërputhje midis realizimit të punimeve me pagesat pjesore dhe faturave të lëshuara nga operatori ekonomik, pasi punimet janë deklaruar të përfunduar më datë 22.04.2023. Në fazën e auditimit konstatohet se operatori ekonomik ka realizuar situacion përfundimtar i cili nuk është likuiduar nga Autoriteti Kontraktor.

<b>1. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë ”, nga zbatuesi i punimeve OE “E. K.” Shpk.
<b>Situata:</b>	<p><i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p><b>1.</b> Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion i dosjes teknike, konstatohet se librezat e masave nuk përshkruajnë apo përcaktojnë saktë dimensionet e cdo zëri punimi, duke mos argumentuar asnjë përmasë me akse dhe vendodhjen e përmasës. Rrjedhimisht ato nuk justifikojnë apo argumentojnë saktë volumet e punimeve të likuiduara apo të pretenduara nga sipërmarrësi i punimeve, në kundërshtim me legjislacionin mbi kontrollin dhe disiplinimin e punimeve, c’ka ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve për miratimin e tyre në kundërshtim me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzim Nr.3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. <b>2.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli C "Klasat + Zyrat", zëri nr. 4, “Transport dheu me auto deri 5 km”, librezat e masave pasqyrojnë sasinë prej 2,007 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 2,007 m<sup>3</sup>,</p>

	<p>si produkt i shumave të gërmimit dhe mbushjes dheut. Konkretisht:</p> <p>- Zëri nr. 1 “Gërmim themele e plinta me eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>, shkarkim” në sasinë 1,215 m<sup>3</sup>, Zëri nr. 2 “Gërmim dheu me krah e transport karrocë” në sasinë 2.96 m<sup>3</sup>, Zëri nr. 3 “Mbushje, ngjeshje dheu” në sasinë 789.82 m<sup>3</sup>. Total transporti = 1,215 m<sup>3</sup> + 2.96 m<sup>3</sup> + 789.82 m<sup>3</sup> = 2,007m<sup>3</sup>. Referuar faktit, projektit dhe kushteve teknike të zbatimit, konstatohet qartazi se zëri nr. 3 “Mbushje, ngjeshje dheu” në sasinë 789.82 m<sup>3</sup>, është zë punimi i cili nuk është transportuar por zë punimi i përdorur dhe vendosur në kantier. Rrjedhimisht sasia prej 789.82 m<sup>3</sup> e situacionuar për transport dheu, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 900 lekë /m<sup>3</sup>, rezuton vlera prej <u>710,838 lekë pa TVSH. 3.</u> Në situacionin përfundimtar, kapitulli D “Depo Magazinimi”, zëri nr. 3, “Transport dheu me auto deri 5 km”, situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 1,372.8 m<sup>3</sup>, si produkt i gërmimit dhe mbushjes dheut. Konkretisht: - Zëri nr. 1 “Gërmim themele e plinta me eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>, shkarkim” në sasinë 1,226.54 m<sup>3</sup>, - Zëri nr. 2 “Mbushje, ngjeshje dheu” në sasinë 169.92 m<sup>3</sup>. Total transporti = 1,226.54 m<sup>3</sup> + 169.92 m<sup>3</sup> = 1,396.46 m<sup>3</sup>. Referuar faktit, projektit dhe kushteve teknike të zbatimit, konstatohet qartazi se zëri nr. 3 “Mbushje, ngjeshje dheu” në sasinë 169.92 m<sup>3</sup>, është zë punimi i cili nuk është transportuar por zë punimi i përdorur dhe vendosur në kantier. Rrjedhimisht sasia prej 169.92 m<sup>3</sup> e situacionuar për transport dheu, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 900 lekë /m<sup>3</sup>, rezuton vlera prej <u>152,928 lekë pa TVSH. 4.</u> Në situacionin përfundimtar, kapitulli C II “Klasat + Zyrat, Punime Murature”, zëri nr. 1, “Mur me tulla të lehtësuara t = 20 cm me ll.p.M25 (Muret perimetrale dhe parapet i tarracës)”, librezave e masave pasqyron sasinë prej 103.7 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 103.7 m<sup>3</sup>. Nga auditimi i librezave të masave dhe projektit konstatohet se në zërin “Brez b/a C20/25 në mure” është situacionuar një sasi e paargumentuar prej 45.86 m<sup>3</sup> brez betoni për mure dhe ky volum punimi nuk është zbritur në volumin e mureve perimetrale. Rrjedhimisht sasia prej 45.86 m<sup>3</sup> e situacionuar për Mur tulle, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 11,000 lekë /m<sup>3</sup>, rezuton vlera prej <u>504,460 lekë pa TVSH. 5.</u> Në situacionin përfundimtar, kapitulli C XIII “Kabina Elektrike”, zëri nr. 1, “FV Tabela paralajmëruese”, zëri nr. 2 “FV përcjellës shiurit bakri 30x3”, zëri nr. 4 “FV përcjellës bakri i zhveshur”, zëri nr. 5 “FV Morseteri tokëzim”, në vlerë totale i gjithë kapitulli i kabinës elektrike rezulton në <u>71,000</u> lekë. Nga verifikimi në objekt konstatohet se nuk ishte realizuar asnjë zë pune, e situacionuar padrejtësisht nga sipërmarrësi. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 1,439,226 lekë pa TVSH (710,838 + 152,928 + 504,460 + 71,000)</b>, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>
--	--

<b>Kriteri:</b>	- Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>1,727,071 lekë me TVSH</b> nga kontraktori OE “E. K.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

***Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga mbikëqyrësi i punimeve “D.” është paraqitur observacioni me nr. 18 prot., datë 15.04.2024, protokolluar në KLSH me nr. 555/16 prot., datë 15.04.2024 dhe me nr. 555/17 prot., datë 22.04.2024 , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:***

**Pretendimi i Subjektit:** Në objektin “Ndërtim Grup-Depo për pajisjet e kërkim-shpëtimit dhe akomodimi i Kompanisë së Kërkim - Shpëtimit në Repartin Ushtarak Nr.4036 (Ferraj, Tiranë)”, lidhur midis Komandës Mbështetëse (Rep. Ush. Nr. 4001) dhe shoqërisë sipërmarrëse "E.-K." sh.p.k, pretendohet se diferencat në volume nuk qëndrojnë.

- Gërmimi i dheut është realizuar me eskavator konform kushteve teknike, më pas e gjithë sasia e dheut të gërmuar është ngarkuar në mjet vetëshkarkues, për tu transportuar në vendin e paracaktuar nga Autoriteti Kontraktor për depozitimin e tyre. Mbase janë kryer proceset e tjera të punës, si betonimi i themeleve, është kryer procesi i mbushjes dhe ngjeshjes se dheut në vepër i cili është ngarkuar dhe transportuar nga vendi i depozitimit në objekt.

- Zëri i punës "Brez b/a C20/25 në mure", i përket brezit të murit në objektin Depo + Magazina i realizuar në të gjithë perimetrin e tij në kuotën  $\pm 0.00$  të magazinës (bashkëlidhur projekti dhe librezat e masave të cilat ndodhen edhe në dosjen e dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor). Duke qënë se Për objektin e magazines në preventiv nuk ishte parashikuar ky zë pune, kjo sasi e realizuar në këtë objekt është pasyruar në objektin Klasa+Zyra, duke ju shtuar volumit të tij pasi jemi brenda të njëjtit objekt. Brezi është realizuar me dimensione 05x03 sipas akseve të mureve të objektit Depo+Magazina. në total 45.86 m<sup>3</sup>. Volumi 6.25 m<sup>3</sup> brez b/a (me dimensione 02x01 në të gjithë perimetrin e murit të tullës) në murin e tullës në objektin Klasa+Zyra, është volumi i cili është zbritur nga volumi i murit të tullës, i cili në fakt ishte 111 m<sup>3</sup>, ndërsa në Situacionin Përfundimtar është pasqyruar 103.7 m<sup>3</sup>, pra është zbritur volumi i brezit b/a.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Pretendimi i subjektit në lidhje me zërin transportimit të mbushjeve të dheut nga vendepozitimi dhe në objekt, nuk disponon asnjë dokumentim të faktit të pretenduar, të transportit 2 herë, vendepozitimi përcaktuar nga AK etj., dhe për rrjedhojë nuk merret në konsideratë. Në lidhje me zërin e punës "Brez b/a C20/25 në mure", ju sqarojmë se edhe vetë librezat e masave të bashkëlidhura në observacion, kundërshtojnë pretendimin e mbikëqyrësit në përlllogaritjen e brezave të përdorura në muret e objektit, për rrjedhojë pretendimi nuk merret në konsideratë.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion rruge në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr, Tiranë”**, konstatohet: Projekti parashikon rikonstruksionin e një segmenti rrugor në zonën e Repartin Ushtarak 1001, Zall-Herr, Tiranë. Projekti është realizuar nga studioja “T.” shpk, me administrator Inxh. E. C. me nr. License nr. K..... Referuar gjendjes ekzistuese të rrugës, konstatohet se kjo rrugë është vetëm pa shtresë asfalti, por tabani i saj dhe shtresat e bazës janë të qëndrueshme dhe solide ku kalojnë vazhdimisht mjetet e rënda ushtarake. Projekti parashikon ndërtimin e kanalit anësor të rrugës në të djathtë dhe krahu tjetër me trotuar me pllaka. Nga auditimi i projekt – preventivit konstatohen disa pasaktësi duke mos u përputhur profilet tip me preventivin e parashikuar. Projekti parashikon zëra si skarifikim rruge (10cm), shtresë me cakëll (15 cm), shtresë binder (8cm), shtresë asfaltobeton (8cm), *ndërsa* preventivi parashikon shtresë çakëlli (t=2 x 20cm), shtresë stabilizant (t=15cm), shtresë binderi (8cm) dhe asfaltobeton (5cm). Objekti i kontratës **“Rikonstruksion rruge në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr, Tiranë”** është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 772/3 prot. datë 23.03.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe Operatorit Ekonomik "D." shpk, përfaqësuar nga administratori H. U.. Vlera e kontratës është 20,226,860 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 4 muaj nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 1456/4 prot. datë 06.05.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe personit fizik "M.K.", me Licensë M..... Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 3013/6 prot. datë 02.09.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe BOE "B. P." shpk & “H.-E.” shpk, me përfaqësues OE "B. P." shpk Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 06.05.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 1456/5 datë 06.05.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 06.05.2022. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi është realizuar me nr. 3137 prot. Datë 21.07.2022. Akti i kolaudimit është realizuar më 15.09.2022 dhe certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar më datë 23.09.2022. Me relacionin teknik të sipërmarrësit datë 14.07.2022 drejtuar mbikëqyrësit dhe AK, kërkohet miratimi i preventivit të ndryshuar të kontratës. Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 3018 prot. Datë 15.07.2022, konstatohet se gjatë zbatimit të punimeve janë kryer matjet topografike në objekt dhe azhurnimi i projektit bazë, ku janë konstatuar ndryshime të volumeve dhe kërkohet miratimi i ndryshimeve të volumeve brenda vlerës së kontratës. Me procesverbalin e datës 14.07.2022, miratohet nga palët përdorimi i fondit rezervë 3 % në masën 490,943 lekë pa TVSH.

<b>2. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <b>“Rikonstruksion rruge në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr, Tiranë”</b> , nga zbatuesi i punimeve OE "D." Shpk.
<b>Situata:</b>	Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon: <b>1.</b> Në preventivin e ripunuar, kapitulli "Punime Dherash dhe shtresash", zëri nr. 3, nr. 3.211 “Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=2x20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”. Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Autoritetin Kontraktor, janë përshkruar sipërfaqet e

	<p>profileve tërthore të piketave të rrugës. Nga verifikimet e gjendjes ekzistuese fillestare konstatohet se tabani i rrugës dhe shtresat e bazës kanë qenë të qëndrueshëme dhe solide ku kalojnë vazhdimisht mjetet e rënda ushtarake dhe nevoja për 2 herë shtresë cakulli përbën risk për përfitime të padrejta të kontraktorit. Gjithashtu në rrugë nuk janë realizuar karrotazhe apo teste të cilat mund të vërtetojnë hedhjen e cakullit në të gjithë rrugën me trashësi totale 40 cm. Situacioni përfundimtar përmban sasinë prej 8,745.6 m<sup>3</sup> dhe librezja e masave përmban sasinë prej 8,745.88 m<sup>3</sup>. Referuar profilit gjatësorë dhe tërthorë të projektit të azhurnuar dhe llogaritjeve në librezën e masave u konstatuan disa pasaktësi në rrugët dalëse me sipërfaqe të matura me pajisje topografike GPS. konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve në sipërfaqet dalëse të rrugës. Volumi i përfituar më tepër rezulton 421.2 m<sup>3</sup> (8,746.12 m<sup>3</sup> - 8,324.62 m<sup>3</sup>), me çmimin përkatës prej 390 lekë/m<sup>3</sup>, rezulton se sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën prej 164,385 lekë pa TVSH. <b>2.</b> Në preventivin e ripunuar, kapitulli "Punime Dherash dhe shtresash", zëri nr. 8, nr. 3.244 "Struktura monolite betony C20/25". Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Autoritetin Kontraktor, konstatohet se situacioni përfundimtar përmban sasinë prej 137 m<sup>3</sup> dhe librezja e masave përmban sasinë prej 137.14 m<sup>3</sup>. Në llogaritjet e librezës së masave konstatohet pasaktësi në llogaritje pasi është përcaktuar sipërfaqja e një seksioni të kanalit në sip. = 0.316 m<sup>2</sup>. Në fakt gjatësia në seksion të kanalit është L=2.7 ml dhe trashësia e betonit H= 0.1ml dhe rezulton sasia e sipërfaqes prej sip. 0.27 m<sup>2</sup> (2.7 ml x 0.1ml). Sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumin e betonit me 19 m<sup>3</sup> (137.14 m<sup>3</sup>-118.09 m<sup>3</sup>) dhe me çmimin përkatës 9,500 lekë/m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 180,500 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej <b>344,855 lekë pa TVSH</b> (164,385 + 180,500), për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>- Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	<p>Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.</p>
<b>Shkaku:</b>	<p>Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.</p>
<b>Rëndësia:</b>	<p>E lartë.</p>
<b>Rekomandime:</b>	<p>Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>413,862 lekë me TVSH</b> nga kontraktori OE "D." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.</p>



3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstruksion objekte ndërtimore në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau-Dejës, Shkodër”**, konstatohet:

Projekti parashikon rikonstruksionin e disa objekteve tek Reparti Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër. Objektet të cilat janë parashikuar për rikonstruksion janë “Objekti nr. 25, Godinë shumë funksionale”, “Objekti nr. 4, Komanda”, “Objekti nr. 13, 27, Truproja”, “Objekti nr. 14, 15, 16 Godina në formë U”. Projekti i rikonstruksionit është realizuar nga person fizik Ing. R. G.. Rikonstruksionet e godinave parashikojnë vetëm ndërhyrje sipërfaqësore, në punime tarrace, punime suvatimi, punime trotuari, bojatisje dhe elektrike. Objekti i kontratës **“Rikonstruksion objekte ndërtimore në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau-Dejës, Shkodër”** është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 4030/2 prot. datë 07.11.2022, të lidhur midis Autoritetit të Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade F. D. dhe BOE “B.” shpk & “M.” shpk, përfaqësuar nga administratorët N. B. dhe E. B.. Përfaqësues i BOE është operatori ekonomik “B.” shpk. Vlera e kontratës është 31,605,128 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 13 javë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 4566/3 prot. datë 16.11.2022, të lidhur midis Autoritetit të Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade F. D. dhe Operatorit Ekonomik “M.” shpk, përfaqësuar nga administratori T. S. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 18.11.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 1011/3 datë 18.11.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 18.11.2022. Me relacionin teknik të mbikëqyrësit nr. 01/26 prot., datë 17.02.2022 drejtuar Autoritetit Kontraktor, kërkohet miratimi i preventivit të ndryshuar të kontratës, për shkak të korigjimeve të sasive dhe nevoja për disa zëra të rinj punimesh, duke bashkëlidhur ndryshimet e volumeve, relacionet teknike, analizat e çmimeve të reja sipas manualit të çmimeve në fuqi dhe preventivin e ripunuar. Me procesverbalin e datës 17.02.2023, palët miratojnë ndryshimet e projekt-preventivit. Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 01/25 prot., datë 17.02.2022 drejtuar Autoritetit Kontraktor, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve, referuar kërkesës së sipërmarrësit datë 16.02.2023, për shkak të kushteve atmosferike dhe rishikimit të projektit. Nga sipërmarrësi kërkohet shtyrja e afatit të punimeve me 46 ditë kalendarike, duke propozuar datën e përfundimit të punimeve më 10.04.2023. Me amendimin e kontratës nr. 01/25 prot. Datë 17.02.2023, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve deri më datë 10.04.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi është realizuar me nr. 1743/1 prot. Datë 11.04.2023, ku deklarohet se punimet kanë përfunduar më datë 10.04.2023. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 3475/4 prot. datë 08.08.2023, të lidhur midis Autoritetit të Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade I. Xh. dhe Operatori Ekonomik “2.H.S.” shpk, përfaqësuar nga administratori H. Ll. me Licensë M..... Procesverbali i përfundimit të punimeve realizuar nga palët është më datë 10.04.2023. Akti i kolaudimit është përcjellë nga kolaudatori me nr. 4205 prot. Datë 18.08.2023 dhe është realizuar më 17.08.2023. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar me nr. 4219/1 prot. Datë 07.09.2023. Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk dokumentohet arsyeja e zgjatjes apo vonesës e realizimit të kolaudimit të punimeve prej 4 muajsh nga AK.

<b>3. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <b>“Rikonstruksion objekte ndërtimore në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau-Dejës, Shkodër”</b> , nga zbatuesi i punimeve BOE "B." shpk &
------------------------------	---

	"M." Shpk.
<b>Situata:</b>	<p><i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p><b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, objekti 13, 27 "Truproja", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>", librezë e masave pasqyron sasinë prej <math>19 m^3</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>19 m^3</math>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës <math>380 m^2 \times 0.05 m = 19 m^3</math>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej <math>355 m^2</math>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>", duhej të llogaritej <math>355 m^2 \times 0.05 m = 17,75 m^3</math>. Pra sipërmsrresi ka përfitur padrejtësisht sipërfaqen prej <math>19 m^3 - 17,75 m^3 = 1,25 m^3</math> dhe me cmimin përkatës prej <math>10,000 lek/m^3</math> rezulton vlera prej <u>12,500 lekë</u>.</p> <p><b>2.</b> Në situacionin përfundimtar, objekti 13, 27 "Truproja", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 3, "Shtresë llustër cemento 1:2", librezë e masave pasqyron sasinë prej <math>380 m^2</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>380 m^2</math>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës <math>380 m^2</math>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej <math>355 m^2</math>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë llustër cemento 1:2", duhej të llogaritej <math>355 m^2</math>. Pra sipërmsrresi ka përfitur padrejtësisht sipërfaqen prej <math>380 m^2 - 355 m^2 = 25 m^2</math> dhe me cmimin përkatës prej <math>500 lek/m^2</math> rezulton vlera prej <u>12,500 lekë</u>.</p> <p><b>3.</b> Në situacionin përfundimtar, objekti 25, "Godinë shumë funksionale", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>", librezë e masave pasqyron sasinë prej <math>41 m^3</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>41 m^3</math>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës <math>820 m^2 \times 0.05 m = 41 m^3</math>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej <math>780 m^2</math>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>", duhej të llogaritej <math>780 m^2 \times 0.05 m = 39 m^3</math>. Pra sipërmsrresi ka përfitur padrejtësisht sipërfaqen prej <math>41 m^3 - 39 m^3 = 2 m^3</math> dhe me cmimin përkatës prej <math>10,000 lek/m^3</math> rezulton vlera prej <u>20,000 lekë</u>.</p> <p><b>4.</b> Në situacionin përfundimtar, objekti 14, 15 dhe 16, "Godinë në formë U", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>", librezë e masave pasqyron sasinë prej <math>41 m^3</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>76 m^3</math>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës <math>525 m^2 \times 0.05 m = 26 m^3</math>, <math>625 m^2 \times 0.05 m = 31 m^3</math>, <math>365 m^2 \times 0.05 m = 18 m^3</math>, në total <math>76 m^3</math>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej <math>360 m^2 \times 0.05 m = 18 m^3</math>, <math>615 m^2 \times 0.05 m = 30.8 m^3</math>, <math>515 m^2 \times 0.05 m = 25.8 m^3</math>, në total <math>74.6 m^3</math>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren <math>t=5cm</math>". Pra sipërmsrresi ka përfitur padrejtësisht sipërfaqen prej <math>76 m^3 - 74.6 m^3 = 1.4 m^3</math> dhe me cmimin përkatës prej <math>10,000 lek/m^3</math></p>

	rezulton vlere prej <u>14,000 lekë</u> . <b>5.</b> Në situacionin përfundimtar, objekti 14, 15 dhe 16, “Godinë në formë U”, kapitulli “ <i>Punime Tarrace</i> ”, zëri nr. 3, “ <i>Shtresë llustër cimento 1:2</i> ”, librezat e masave pasqyrojnë sasinë prej 1,515 m <sup>2</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 380 m <sup>2</sup> , duke llogaritur sipërfaqen e tarracës 380 m <sup>2</sup> . Në fakt referuar librezës së masave, zëri “ <i>Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama</i> ” dhe projektin të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës 360 m <sup>2</sup> + 615 m <sup>2</sup> + 515 m <sup>2</sup> = 1,490 m <sup>2</sup> . Pra sipërmsrësi ka përfutur padrejtësisht sipërfaqen prej 1,515 m <sup>2</sup> – 1,490 m <sup>2</sup> = 25 m <sup>2</sup> dhe me cmimin përkatës prej 500 lek/m <sup>2</sup> rezulton vlere prej <u>12,500 lekë</u> . Për këtë investim rezultoi se <b>është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi vlere prej 71,500 lekë pa TVSH</b> (12,500 + 12,500 + 20,000 + 14,000 + 12,500), për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej <b>85,800 lekë me TVSH</b> nga kontraktori BOE “B.” shpk & “M.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër”, konstatohet:**

Projekti parashikon ndërtimin e magazine në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër. Projekti i ndërtimit të magazinës është realizuar nga shoqëria “A.” shpk. Ndërtimi i magazinës është parashikuar me konstruksion metalik dhe cati me panele sanduiç. Objekti i kontratës “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 4667/3 prot. datë 16.11.2022, të lidhur midis Autoritetit të Repartit Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade F. D. dhe BOE “S.U.” shpk & “B.” shpk, përfaqësuar nga administratorët M. Sh. dhe B. U.. Përfaqësues i BOE është operatori ekonomik “S.U.” shpk. Vlertat e kontratës është 35,867,475 lekë me TVSH. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar 23 javë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 5214/4 prot. datë 12.12.2022, të lidhur midis Autoritetit të Repartit Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade F. D. dhe Operatorit Ekonomik “G.C.” shpk, përfaqësuar nga administratori L. H. me Licensë M... Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar

nga palët më datë 12.12.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 4667/6 datë 12.12.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 12.12.2022. Me kërkesën e sipërmarrësit nr. 2198/1 prot., datë 08.05.2023 drejtuar Autoritetit Kontraktor dhe mbikëqyrësit të punimeve, kërkohet përdorimi i fondit rezervë dhe miratim i preventivit të ripunuar, për shkak të korigjimeve të sasive dhe nevoja për disa zëra të rinj punimesh, duke bashkëlidhur ndryshimet e volumeve, relacionet teknike. Me procesverbalin e datës 08.05.2023, palët miratojnë ndryshimet e projekt-preventivit. Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 2373 prot., datë 12.05.2023 drejtuar Autoritetit Kontraktor, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve, për shkak të kushteve atmosferike, ku kërkohet shtyrja e afatit të punimeve me 1 muaj. Me amendimin e kontratës nr. 2373/2 prot. Datë 05.06.2023, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve deri më datë 22.06.2023. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi është realizuar me nr. 3268 prot. Datë 27.06.2023, ku deklarohet se punimet kanë përfunduar më datë 23.06.2023. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 3505/4 prot. datë 02.08.2023, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade I. Xh. dhe BOE "B. P." shpk & "H.-E.C. përfaqësuar nga "B. P." shpk, me administrator A. A. me Licensë M..... Akti i kolaudimit është realizuar më 10.08.2023. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar me nr. 3268/2 prot. datë 12.09.2023.

<b>4. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër", nga zbatuesi i punimeve BOE "S.U." shpk & "B." shpk.
<b>Situata:</b>	<p><i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p><b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime gjërmimi", zëri nr. 1, "Gërmim themele e plinta <math>b &gt; 2m</math>, eskavator me goma, kova <math>0.25 m^3</math> shkarkim tokë", dhe zëri nr. 2 "Transport material ndërtimi, dheu me auto deri 5 km", librezja e masave pasqyron sasinë prej <math>1,567 m^3</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>1,567 m^3</math>. Sasia e llogaritur në librezën e masave mbi gjërmimin dhe transportit pasqyrohet mbi plintin, bazamentit dhe profilet e rrugës me gjatësi 52.7 m nga 0 + 000 deri në 0 + 052.74. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në dosjen e punimeve nuk janë të paqyruara profilet tërthore e gjatësore të kësaj rruge, ku të pasqyrohen kuotat përkatëse të projektit në mënyrë që të argumentohet volumi i plotë i gjërmimit, transportit dhe zëri "Mbushje me cakëll e gur gurore në traupin e rrugës, përgapur e ngjeshur me makineri", në kapitullin e sistemimeve të jashtme. <b>2.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime shtresash", zëri nr. 1, "Beton për nivelim <math>h = 7-10 cm</math>", librezja e masave pasqyron sasinë prej <math>72 m^3</math> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë <math>72 m^3</math>. Sasia e llogaritur në librezën e masave është për dyshemenë e magazinës <math>40.5 m \times 12.5 m \times 0.07 m = 35.94 m^3</math>. Ndërkohë nga sipërmarrësi dhe miratuar nga mbikëqyrësi është llogaritur edhe një shtresë tjetër niveluese (Dora 2) e cila është e pajustificuar dhe paargumentuar për tu realizuar edhe për tu likuiduar. Rrjedhimisht sasia e llogaritur e dytë është e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi në sasinë <math>35.94 m^3</math> me çmimin prej 7,500 lekë /<math>m^3</math>, rezulton vlera prej <u>269,550 lekë pa TVSH</u>. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 269,550 lekë pa TVSH</b>, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të</p>

	cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.
<b>Kriteri:</b>	Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>323,460 lekë me TVSH</b> nga kontraktori BOE "S.U." shpk & "B." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall – Herr”, Tiranë”, konstatohet:**

Projekti parashikon ndërtimin e magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall Herr, Tiranë. Projekti i ndërtimit të magazinës është realizuar nga shoqëria “D.” shpk me licensë M..... Ndërtimi i magazinës është parashikuar me konstruksion metalik dhe cati me panele sanduiç. Objekti i kontratës “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall – Herr”, Tiranë” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 773/7 prot. datë 14.04.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe OE "2." shpk, përfaqësuar nga administratori N. S.. Vlera e kontratës është 21,267,027 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 16 javë ose 112 ditë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 1457/4 prot. datë 09.05.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe Operatorit Ekonomik "D." shpk, përfaqësuar nga administratori V. T. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 17.05.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 1037/1 datë 17.05.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 17.05.2022. Me shkresën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 1037/2 prot., datë 18.05.2022, njoftohet Komanda e forcave tokësore se në objekt janë konstatuar municione të pashpërthyer. Për të shmangur incidente nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi janë pezulluar punimet deri në momentin e pastrimit të municioneve. Me procesverbalin e ndryshimit të volumeve datë 08.08.2022 midis palëve janë miratuar ndryshimet e sasive të volumeve për preventivin fillestar duke realizuar preventivin e rishikuar, tabelën e lëvizjeve të volumeve dhe preventivin e fondit rezervë. Me shkresën e mbikëqyrësit nr. 1039/2 datë 20.06.2022, njoftohet rifillimi i punimeve. Me kërkesën e mbikëqyrësit nr. 26 prot., datë 21.09.2022 drejtuar Autoritetit Kontraktor me nr. 1039/3 prot., datë 21.09.2022, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve, për shkak të kushteve atmosferike, ku kërkohet shtyrja e afatit të punimeve me 85 ditë. Me amendimin e kontratës nr. 1039/4 prot. Datë 23.09.2022, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve me 85 ditë. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi datë 23.12.2022 është realizuar me nr. 5708 prot. Datë

28.12.2022, ku deklarohet se punimet kanë përfunduar më datë 23.12.2022. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 23.12.2022. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, me person fizik "M.K.". Akti i kolaudimit është realizuar më 27.03.2023. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar me nr. 1539/3 prot. Datë 26.03.2023.

<b>5. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall – Herr”, Tiranë”, nga zbatuesi i punimeve OE “2.” shpk.
<b>Situata:</b>	<i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i> <b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli “Sistemime të jashtme për rrugë dhe trotur”, zëri nr. 2, “Shtresë betonë C 12/15”, librezë e masave pasqyron sasinë prej 115 m <sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 115 m <sup>3</sup> . Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas prerjes tërthore të detajit të shtresave për rrugën dhe trotuarin. Nga verifikimi projektit të azhornuar dhe trashësisë së shtresës së betonit të miratuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, konstatohet se kjo shtresë është 20 cm. Ndërkohë në llogaritjet e librezave të masave kjo shtresë është llogaritur me trashësi 30 cm dhe konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 42 m <sup>3</sup> = 115 m <sup>3</sup> - 73 m <sup>3</sup> , me çmimin përkatës prej 6,500 lekë/m <sup>3</sup> = <u>273,000 lekë pa TVSH</u> . Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 273,000 lekë pa TVSH</b> , për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.
<b>Kriteri:</b>	- Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>327,600 lekë me TVSH</b> nga kontraktori OE “2.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Për sa është trajtuar në projekt raportin e auditimit, nga sipërmarrësi i punimeve “2.”shpk është paraqitur observacioni me nr. 194 prot., datë 09.03.2024, protokolluar në KLSH me nr. 555/14 prot., datë 18.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:**

**Pretendimi i Subjektit:** Në objektin “Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall – Herr”, Tiranë”, pretendohet se rritja e trashësisë nga 20 cm (sipas detajit të projektit të rishikuar), në 30 cm (sipas detajit të realizuar) është kryer pasi në pjesën e trotuarit të magazinës janë vendosur depozitat e ujit të sistemimit të mbrojtjes ndaj zjarrit të cilat kanë një peshë relativisht të madhe (5000 lt) secila dhe nëpër të kalojnë dhe të gjithë linjat e tubacioneve të

sistemit të mbrojtjes nga zjarri dhe linja kryesore e furnizimit me ujë të objektit. Për të shmangur plasaritjet e mundshme në shtresën e betonit dhe garantimin e sigurisë së linjave të sipërpërmendura, në komunikim dhe me mbikëqyrësin e punimeve është bërë rritja e trashësisë së shtresës së betonit me 10 cm nga projekti i rishikuar. Gjithashtu llogaritja e volumeve përfundimtare për situacionin përfundimtar është kryer gjatë momentit përfundimit të punimeve dhe përgatitjes së dosjes teknike të objektit dhe ku projekti i rishikuar ka qenë i miratuar më parë.

Sa më sipër, referuar faktit, nga ana e shoqërisë sonë nuk është përfituar në mënyrë artificiale sasia prej 42 m<sup>3</sup>, pasi ajo është vendosur në objekt për të përmirësuar destinacionin e shfrytëzimit të objektit.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në lidhje me pretendimin e sipërmarrësit sqarojmë se grupi i auditimit i është referuar projektit të azhornuar. Gjithashtu nuk janë realizuar verifikime të trashësisë së shtresës që të vërtetohet trashësia prej 30 cm pasi është punim i maskuar dhe për këto arsye pretendimi nuk mund të merret në konsideratë.

**6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “*Rrethim i jashtëm i Repartit Ushtarak nr. 1060*”, Babrru, Tiranë, konstatohet:**

Projekti parashikon ndërtimin e rrethimit me rrjetë teli dhe profile metalik në Repartin Ushtarak nr. 1060, Babrru, Tiranë. Projekti i ndërtimit të magazinës është realizuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake. Objekti i kontratës “*Rrethim i jashtëm i Repartit Ushtarak nr. 1060*”, Babrru, Tiranë, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 2053/4 prot. datë 30.07.2021, të lidhur midis Autoritetit të Repartit Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe OE "I." shpk, përfaqësuar nga administratori F. Ç.. Vlera e kontratës është 31,456,772 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 6 muaj ose 180 ditë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 2664/3 prot. datë 18.08.2021, të lidhur midis Autoritetit të Repartit Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe Operatorit Ekonomik "D." shpk, përfaqësuar nga administratori V. T. me Licensë M..... Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 2487/4 prot., datë 30.06.2022, të lidhur midis Autoritetit të Repartit Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe Operatorit Ekonomik "R." shpk, përfaqësuar nga administratori R. N. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 07.09.2021. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 2053/10 datë 07.09.2021. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 07.09.2021. Me kërkesën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 534/1 prot., datë 01.02.2022, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve për shkak të kushteve atmosferike, ku kërkohet shtyrja e afatit të punimeve me 60 ditë. Me amendimin e kontratës nr. 534/3 prot. Datë 07.02.2022, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve me 60 ditë, pra në total afati i kontratës shkon në 240 ditë. Me shkresën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit nr. 2013 prot., datë 11.05.2022, kërkohet nga Komanda e Forcave Tokësore miratimi i preventivit të përmirësuar dhe përdorimi i fondit rezervë, për shkak se preventivi dhe projekti i kontratës krahasuar me faktin ka rezultuar se ka zëra punimesh që zbriten dhe zëra që shtohen. Ndryshimet e volumeve kanë marrë miratimet përkatëse edhe nga Investitori. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi me nr. 2013/2 prot., datë 31.05.2022, ku deklarohet përfundimi i punimeve sipas kontratës dhe amendimit të saj. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 31.05.2022. Akti i kolaudimit është realizuar më 09.08.2022. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar ne datë 01.09.2022.

<b>6. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rrethim i jashtëm i Repartit Ushtarak nr. 1060”, Babrru, Tiranë, nga zbatuesi i punimeve OE “I.” Shpk.
<b>Situata:</b>	<p>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</p> <p><b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli “Punime hekuri betoni”, zëri nr. 3, “Konstrksione metalike të thjeshta”, librezave e masave pasqyron sasinë prej 78,429.78 kg dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 78,429.78 kg Total. Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas profileve metalikë të përdorur në rrethim. Nga verifikimi projektit të azhornuar dhe trashësisë së konstruksioneve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, konstatohet se disa nga profilet metalike kanë diferenca në peshat specifike të tyre (profili 50x30x4mm). Nga rillogaritjet e librezave të masave profili i cili ndikon më shumë në zërin përkatës është 50x30x4 mm, i cili në librezën e masave është llogaritur me peshën specifike 4.89 kg/ml, ndërkohë nga verifikimet e peshës së këtij profili rezulton pesha specifike prej 4.30 - 4.65 kg/ml, në varësi të prodhuesve dhe të prodhimit specifik të metaleve. Nga rillogaritjet sipas peshës specifike reale, rezulton se konstatohet që sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 1,741.34 kg, me çmimin përkatës prej 132 lekë/kg = <u>229,856 lekë pa TVSH</u>. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 229,856 lekë pa TVSH</b>, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të parealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës prej <b>275,827 lekë me TVSH</b> nga kontraktori “I.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i Magazinës Nr. 5 Agjencia Mbroje, DPRMSH Korçë”, konstatohet: Projekti parashikon rikonstruksionin e magazinës në DRRMSH Korçë, me Investitor Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materialeve të Shtetit. Rikonstruksioni i magazinës përfshin punime shtresash, suvatimi, elektrike dhe mekanike. Projekti është hartuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU). Objekti i kontratës “Rikonstruksioni i Magazinës Nr. 5 Agjencia Mbroje, DRRMSH Korçë” është kryer sipas



kontratës për punë publike nr. 155/27 prot. datë 18.11.2022, të lidhur midis Autoritetit DPRMSh, përfaqësuar nga S. Z. dhe OE "P.G." shpk, përfaqësuar nga administratori L. P.. Vlera e kontratës është 9,687,333 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 35 ditë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 155/25 prot. datë 18.11.2022, të lidhur midis DPRMSh dhe Operatorit Ekonomik "S.S." shpk, përfaqësuar nga administratori A. M. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 25.11.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me datë 25.11.2022. Me shkresën e sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit datë 14.12.2022, kërkohet nga Investitori përdorimi i fondit rezervë në masën 5% në vlerën 450,872 lekë me TVSH, për shkak të ndryshimeve ndërmjet projektit dhe gjendjes faktike në terren u konstatuan lëvizje të volumeve dhe me procesverbalin datë 14.12.2022, miratohen ndryshimet e preventivit nga palët. Njoftimi dhe Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 19.12.2022. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim të lidhur midis DPRRMSH, me operatorin ekonomik "F.S." shpk, me administrator S. B.. Akti i kolaudimit është realizuar më 21.12.2022, dërguar me shkresë nr. 155/55 prot., datë 21.12.2022. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim është realizuar ne datë 21.12.2022.

<b>7. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Rikonstruksioni i Magazinës Nr. 5 Agjencia Mbroje, DPRMSh Korçë”, nga zbatuesi i punimeve OE “P.G.” shpk.
<b>Situata:</b>	<p><i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p><b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime shtresash", zëri nr. 2, “Shtresë betonë C 25/30, t=8 cm (dysHEMEJA E DEPOS)”, librezja e masave pasqyron sasinë prej 62.9 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 62.9 m<sup>3</sup>. Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas gjatësisë dhe gjerësisë së magazinës. Nga verifikimi projektit të fillestar dhe të azhornuar, konstatohet se përmasat e brendshme të magazinë janë 10.68 m gjerësi dhe 58.93 m gjatësi. Pra sipërfaqja e shtresës së brendshme është (10.68 m x 58.93 m = 629.37 m<sup>2</sup>) dhe trashësisë së shtresës së betonit t = 8 cm, rezulton volumi prej 629.37 m<sup>2</sup> x 0.08 m = 50.34 m<sup>3</sup>. Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 12.6 m<sup>3</sup> = 62.9 m<sup>3</sup> – 50.3 m<sup>3</sup>, me çmimin përkatës prej 14,200 lekë/m<sup>3</sup> = <u>178,920 lekë pa TVSH</u>. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 178,920 lekë pa TVSH</b>, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li> </ul>

<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e vlerës prej <b>214,704 lekë me TVSH</b> nga kontraktori OE "P.G." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**8.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt: *“Ndërtim magazine nr.1 dhe nr.2 në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr”, Tiranë*”, konstatohet: Projekti parashikon ndërtimin e dy magazinave në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall Herr, Tiranë. Projekti i ndërtimit të magazinës është realizuar nga shoqëria “D.” shpk me licensë M..... Ndërtimi i magazinës është parashikuar me beton/arme, muraturë dhe cati me panele sanduiç. Objekti i kontratës *“Ndërtim magazine nr.1 dhe nr.2 në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr”, Tiranë*” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 774/3 prot. datë 23.03.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe BOE "I." shpk & “Z.” shpk, përfaqësuar nga administratorët F. M. dhe D. S.. Vlera e kontratës për ndërtimin e dy magazinave është 45,914,362 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 16 javë ose 112 ditë nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur cmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit, është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 773/6 prot. datë 29.03.2022, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe Operatorit Ekonomik "L.C." shpk & “A.-S.”, përfaqësuar nga administratorët A. K. dhe A. N. me Licensë M..... dhe M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 02.11.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët me nr. 4724 prot., datë 04.11.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 02.11.2022. Me procesverbalin e ndryshimit të volumeve midis palëve janë miratuar ndryshimet e sasive të volumeve për preventivin fillestar duke realizuar preventivin e rishikuar, tabelën e lëvizjeve të volumeve dhe preventivin e fondit rezervë. Me kërkesën e mbikëqyrësit drejtuar Autoritetit Kontraktor, kërkohet shtyrje e afatit të punimeve, për shkak të kushteve atmosferike, ku kërkohet shtyrja e afatit të punimeve me 90 ditë, ku palët miratojnë shtyrjen me amendim kontrate, me objekt ndryshimin të afatit të punimeve me 90 ditë. Njoftimi i përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi datë 23.05.2023 është realizuar me nr. 2551 prot. Datë 23.05.2022. Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur më datë 23.05.2022. Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 764/4 prot., datë 28.02.2023, të lidhur midis Autoritetit Reparti Ushtarak nr. 1001, me person fizik "M.K.". Akti i kolaudimit është realizuar më 19.06.2023.

<b>8. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin <i>“Ndërtim magazine nr.1 dhe nr.2 në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr”, Tiranë</i> ”, nga zbatuesi i punimeve BOE "I." shpk & “Z.” Shpk.
<b>Situata:</b>	<i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i> <b>1.</b> Në situacionin përfundimtar, kapitulli <i>"Punime Murature"</i> , zëri nr. 1, <i>“Mur me tulla të lehtësuara dopio deri në 8m, ll.p.M25”</i> , librezja e masave pasqyron sasinë prej 90.9 m <sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar

	<p>pasqyron sasinë 90.9 m<sup>3</sup>. Llogaritjet janë realizuar me perimetrin e magazines, me mbylljen me tulla të hapsirës së kapriadës, duke zbritur dritaret, derën dhe brezin. Llogaritja e zbritjes për brezin e batonit është në sasinë 2.63 m<sup>3</sup>. Ndërkohë, nga auditimi i librezave të masave dhe projektit konstatohet se në zërin “Brez b/a C 16/20, h= 8m” është situacionuar një sasi e paargumentuar prej 12.3 m<sup>3</sup> brez betoni për mure dhe ky volum punimi nuk është zbritur i plotë në volumin e mureve perimetral por vetëm 2.63 m<sup>3</sup>. Rrjedhimisht sasia prej (12.3 m<sup>3</sup> – 2.63 m<sup>3</sup>) = 9.67 m<sup>3</sup> e situacionuar për Mur tulle, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 8,400 lekë /m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 81,228 lekë pa TVSH për 1 magazinë ose 19.34 m<sup>3</sup> (për 2 magazinat) dhe rezulton vlera prej <u>162,456 lekë pa TVSH</u> për të dyja magazinat.</p> <p>Në total, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë në total prej 19.34 m<sup>3</sup>, me çmimin përkatës prej 8,400 lekë/m<sup>3</sup> = <u>162,456 lekë pa TVSH</u>. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 162,456 lekë pa TVSH</b>, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.</li> <li>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>194,947 lekë me TVSH</b> nga kontraktori BOE "I." shpk & “Z.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**9. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e kontratës me objekt: “Ndërtimi i parkut të mbyllur për mjetet e blinduara (HMMWV) në Repartin Ushtarak nr. 1001 Zall-Herr”,**

Projekti parashikon ndërtimin e parkingut të mbyllur për mjetet e blinduara, duke krijuar hapsira parkimi, asfaltimi, mbyllimin e mbjeteve me panele sanduiç, punime elektrike dhe hidraulike. Projekti është realizuar nga Instituti i Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU). Objekti i kontratës “Ndërtimi i parkut të mbyllur për mjetet e blinduara (HMMWV) në Repartin Ushtarak nr. 1001 Zall-Herr” është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3210/2 prot., datë 22.09.2021, të lidhur midis Autoritetit Komandës së Forcës Tokësore, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe BOE "M. I.G." shpk & “I.G.” shpk & “B.” shpk, përfaqësuar nga administratorët P. K., E. Z. dhe B. D.. Vlera e kontratës është 104,003,702 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 8 muaj nga fillimi i punimeve. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku preventivi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës, ku kontraktori do të paguhet për sasinë e punës së realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Mbikëqyrja e kontratës së zbatimit,

është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 3212/2 prot., datë 22.09.2021, të lidhur midis Autoritetit Komandës së Forcës Tokësore, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade A. K. dhe OE “C.” shpk, përfaqësuar nga administratori V. M. me Licensë M..... Kolaudimi i punimeve është realizuar sipas kontratës për shërbim nr. 2930/7 prot. datë 10.07.2023, të lidhur midis Autoritetit Komandës së Forcës Tokësore, përfaqësuar nga Gjeneral Brigade I. Xh. dhe OE “D.” shpk, përfaqësuar nga administratori B. D. me Licensë M..... Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët më datë 28.10.2022. Procesverbali i fillimit të punimeve dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë mbajtur nga palët më datë 28.10.2022. Procesverbali i piketimit gjithashtu realizuar më 12.12.2022. Me kërkesën e mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit nr. 3458/3 prot., datë 19.10.2021 drejtuar Autoritetit Kontraktor kërkohet miratimi i ndryshimeve ose përmirësimeve të projektit, ku nuk ndryshohet vlera e kontratës por mbulohet me fondin rezervë. Relacioni teknik dhe projekti i ndryshimeve të propozuara përshkruan mangësitë e projektit dhe ndryshimet e propozuara në tipin e themeleve, planimetrinë e parkingjeve, propozimin e një rruge me cakëll, propozimin e një kanali ujrave të larta, ndryshimin e dimensioneve të profileve metalik dhe ndryshimin e tipit të panelit sanduiç. Me procesverbalin datë 20.11.2021, miratohen nga palët ndryshimet e projektit, lëvizjet e volumeve të punimeve dhe miratimi i fondit rezerve. Me amendimin e kontratës nr. 1099/6. Datë 05.09.2022, me objekt ndryshimin e afatit të punimeve 20 muaj referuar Aktit Normativ 10 datë 18.05.2022 “Për kompesim financiar të çmimit për disa materiale ndërtimi si pasojë e situatës së vecantë të krijuar në treg në vitin 2022. Sipas procesverbalit të përfundimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi, punimet deklarohen se janë përfunduar më datë 22.05.2023.

<b>9. Titulli i gjetjes:</b>	Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Ndërtimi i parkut të mbyllur për mjetet e blinduara (HMMWV) në Repartin Ushtarak nr. 1001 Zall-Herr” nga zbatuesi i punimeve BOE “M.I.G.” shpk & “I.G.” shpk & “B.” Shpk.
<b>Situata:</b>	<p><i>Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatua pasaktësi si më poshtë vijon:</i></p> <p><b>1.</b> Referuar pagesave pjesore konstatohet mospërputhje midis realizimit të punimeve me pagesat pjesore dhe situacionit përfundimtar nga operatori ekonomik, duke realizuar punime shtesë, duke referuar edhe tabelës së lëvizjes së volumeve. Referuar shkresës nr. 3458/3 prot., datë 19.10.2021, nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve deklarohet se mangësia e projektit ekziston në ndërtesat e parashikuara për tu prishur pasi ato ishin të prishura. Në situacionet pjesore dhe tabelën e lëvizjes së volumeve, punimet e prishjes kanë qenë 0 lekë (janë likuiduar vetëm në Sit. Nr.2), ndërsa në situacionin përfundimtar shtohet një sasi “Prishje shtresa betoni” dhe transporti i tyre në vlerën prej <u>323,400 lekë pa TVSH</u>, e cila është e paargumentuar dhe justifikuar bazuar librezës së masave dhe ecurisë së zbatimit të punimeve, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, c’ka ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve për miratimin e tyre në kundërshtim me Udhëzim Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe Udhëzim Nr.3, datë 15.2.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”. Për këtë investim rezultoi se <b>është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej 323,400 lekë pa TVSH</b>, për punime të përfunduara, të cilat mund të ishin korrigjuar në hartimin e preventivit të rishikuar apo situacionit përfundimtar.</p>

<b>Kriteri:</b>	- Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me: - Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12. - Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
<b>Shkaku:</b>	Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandime:</b>	Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej <b>388,080 lekë me TVSH</b> nga kontraktori BOE “M.I.G.” shpk & “I.G.” shpk & “B.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

## 2.6 Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në Ministrinë e Mbrojtjes u realizua bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Menaxhimi financiar dhe kontrolli përcaktojnë përgjegjshmërinë menaxheriale për planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë për të arritur objektivat dhe për të shmangur shpërdorimin, keqpërdorimin dhe vjedhjen e pasurisë.

Ministria e Mbrojtjes me anë të shkresës nr. 19100/1 prot., datë 08.11.2021 ka caktuar z. A. K. (Sekretar i Përgjithshëm) si Nëpunës Autorizues dhe me anë të shkresës nr. 3252/1 prot., datë 17.06.2022 znj. G. P.. Sa më sipër, në përmbushje të kërkesave të pikës të nenit 18/1, neni 19, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, “Nëpunësi autorizues i çdo njësie të qeverisjes së përgjithshme, në bazë të vetëvlerësimit depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues deklaratën dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt aktual”.

Ministria e Mbrojtjes, në bazë të nenit 19 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me ligjin nr.110/2015, ka hartuar dhe dërguar pyetësorin vjetor të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm me shkresën nr. 1313/1 datë 28.02.2023 drejtuar strukturës përgjegjëse për Harmonizimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me anë të shkresave të cituara, MM ka dërguar deklaratat për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe raportet për funksionimin e kontrollit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Struktura e raportimit respekton përcaktimet e Udhëzimit nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e Deklaratës dhe Raportit Vjetor për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njësitë Publike”.

Referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e kryer nga institucioni i MM-së, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët e kontrollit të brendshëm në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij. Aktivitetet e planifikuara për tu ndërmarrë me qëllim zgjidhjen e mangësive të zbuluara gjatë përgatitjes së raporteve vjetore

mbi funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit janë si më poshtë:  
Nga auditimi u konstatua se MM ka ngritur Ekipin e Menaxhimit të Programit në zbatim të udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA-së” paragrafi 2.5 pika 1/a në njësitë e qeverisjes qendrore që zbatojnë më shumë se një program buxhetor.

Drejtuuesi i programit si rregull është respektivisht nëpunësi autorizues i njësisë publike. Paragrafi 2.5 pika 2 citon se “Drejtuuesit e programit janë përgjegjës për të garantuar që janë duke u realizuar siç duhet përgjegjësitë e ekipit të menaxhimit të programit, si një komponent kyç i organizimit institucional për përgatitjen e kërkesave buxhetore”.

Sipas Manualit të MFK, në kreun III, “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, neni 19 citohet: *Titullarët e njësive të sektorit publik, zbatojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri-tjetrin:*

1. Mjedisi i kontrollit.
2. Menaxhimi i riskut.
3. Veprimtaritë e kontrollit.
4. Informacioni dhe komunikimi.
5. Monitorimi.

### **1. Mjedisi i kontrollit**

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Mjedisi i kontrollit përmban: Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike; politikat menaxheriale dhe stilin e punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; Politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aftësitë profesionale të punonjësve.

**a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të kësaj njësie publike.**

Në referencë të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, nevojitet që punonjësit të respektojnë normat etike dhe profesionale të bashkëpunimit e të ndihmës së ndërsjellë, mbështetur në krijimin e një Kodi të Brendshëm Etik. Nga auditimi u konstatua se, institucioni ka hartuar dhe zbaton një kod etike, i cili është miratuar me Urdhrin e Ministrit të MM me nr.359 datë 28.03.2022.

**b. Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.**

Ministria e Mbrojtjes funksionon në bazë të strukturës së miratuar me anë të urdhrin me nr. 94 datë 30.04.2010 të Kryeministrit, i ndryshuar me urdhrin nr. 167 datë 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 94 datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i ndryshuar me urdhrin nr. 47 date 09.03.2018 të Kryeministrit “Për disa ndryshime ne urdhrin e sipër përmendur.”

Krahas tij janë edhe Urdhret e Ministrit të MM, të cilat përcaktojnë organikën e institucioneve në varësi. MM ushtron veprimtarinë e vet mbi bazën e Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Brendshëm, miratuar me Urdhrin e Ministrit të MM me 2159 datë 16.11.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e MM dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.”. Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet se Rregulloja e Brendshme e MM nuk ka reflektuar ndryshimet e strukturës organizative, pasi nuk është bërë rishikimi i saj; duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësi dhe linjën e raportimit të punonjësve. Në strukturë janë shtuar disa drejtori si Drejtoria e Përgjithshme e

Emergjencave Civile, Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Drejtoria Operacionale e Drejtimit, për të cilat nuk janë reflektuar përkrahjet përkatëse të detyrave.

**c. Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit.**

Në Ministrinë e Mbrojtjes marrëdhëniet e punës rregullohen me anë të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar si dhe të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se në MM ka një rregullore të brendshme në të cilën janë evidentuar delegimi i detyrave dhe mënyra e dokumentimit të tyre veprime këto në përputhje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 15 “Rregulla të përgjithshme për delegimin e detyrave”, si dhe Kapitulli III “Delegimi i detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

**d. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.**

Në MM, burimet njerëzore menaxhohen nga Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, në varësi të së cilës është Sektori i Menaxhimit të personelit ushtarak/civil. Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë kryer dhe janë përfshirë në dosje vlerësimet e punonjësve për vitet 2021-2023.

**e. Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve gjatë viteve objekt auditimi, u konstatua se nga ana e Sektorit të Menaxhimit të personelit ushtarak/civil në MM nuk janë paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, veprime në kundërshtim me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1 “Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)”, paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Punonjësit e institucionit kanë kryer trajnime të ndryshme gjithëpërfshirëse, kryesisht të organizuara nga ASPA, për të cilat ka qenë e pamundur sigurimi i informacionit mbi trajnimet dhe ndjekjen e tyre nga ana e stafit të MM-së.**

## **2. Menaxhimi i riskut**

Risku dhe menaxhimi i riskut përcaktohet në Nenin 21 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative i veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes. Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut. MM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut në funksion të plotësisë të ciklit të menaxhimit të riskut, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2, neni 21 “Menaxhimi i Riskut”, ku citohet:...“*Titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të risku. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.*”, si dhe me udhëzimin e MFE nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3.2.1 ku citohet:... “*Titullari i njësisë publike është përgjegjës për përcaktimin e objektivave dhe strategjisë. Kjo përfshin: Menaxhimin efektiv të riskut*”.3.2.2 “*Nëpunësi autorizues/koordinatori i riskut ka përgjegjësi për: Ngritjen dhe funksionimin e sistemit të MR, përcaktimin e nivelit të oreksit të riskut; Vlerësimin e sistemit të MR (...)*”. Mbështetur në nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i

ndryshuar, me shkresën nr. 1313/1 prot., datë 28.02.2023, Sekretari i Përgjithshëm në MM ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në MFE, Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm; Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të MM, i cili është përmbledhje e raportit vjetor për menaxhimin financiar dhe kontrollin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm në MM; Pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e MFK-së nëpërmjet të cilit synohet ndërgjegjësim i mëtejshëm mbi rëndësinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe Planin e veprimit. **Nga auditimi i regjistrit të riskut për vitin 2022**, i cili përmbledh regjistrat e risqeve dhe planet e veprimit së të gjithë strukturave të MM-së, u konstatua se nuk janë përgatitur dhe dërguar te NA, regjistri i riskut nga secila drejtori përkatëse, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar pika neni 11, ku citohet... “Menaxherët e tjerë të strukturave të të gjitha niveleve të njësisë publike janë përgjegjës dhe raportojnë dhe i japin llogari eprorit, sipas shkallës hierarkike, për:

2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë”.

Nga ana e Grupit të Auditimit konstatohet me Urdhrin e Ministrit me nr. 963, datë 22.07.2014 është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), i cili nuk është rishikuar për çdo vit për të përcaktuar personat përgjegjës, por janë të përcaktuara vetëm funksionet. Sipas këtij urdhri, përbërja përcaktohet:

- Ministri i Mbrojtjes, Kryetar;
- Zv. Ministri i Mbrojtjes, Nën Kryetar;
- Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Anëtar;
- Drejtuesit e ekipeve të Menaxhimit të Programeve, Anëtarë;
- Drejtuesit e Njësive Shpenzuese të MM, Anëtarë;
- Drejtuesit e Drejtorive të Shtabit të Përgjithshëm, Anëtarë;
- Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Financave, Sekretar teknik.

### 3. Aktivitetet e kontrollit

Nga auditimi u konstatua se MM nuk ka të miratuar një rregullore të përditësuar me ndryshimet ligjore në fuqi, duke përfshirë dhe ndryshimet në organikën e institucionit të MM-së dhe njësive të varësisë, duke përcaktuar qartë detyrat. Nga ana e MM, është miratuar Gjurmën e Auditimit, si një dokument të unifikuar për të gjitha proceset e MM-së, në përputhje me përcaktimet e pikave nr. 2 dhe 3, të nenit 16, “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit”, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, pika 2.

Nga ana e Grupit të Auditimit u konstatua se, MM nuk disponon një regjistër kontabël të plotë aktiveve, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Kreu III “Regjistri i aktiveve të njësive të sektorit publik”, paragrafi 26, përcakton se: “Çdo njësi publike duhet të krijojë dhe të përditësojë një regjistër kontabël të të gjitha aktiveve që zotëron apo ka në administrim, përfshi dhe pronat publike nga të cilat siguron të ardhura. Regjistri mbahet në formën e kartelave ose në formë të sintetizuar”.

### 4. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi u konstatua se, përgjithësisht komunikimi me titullarin dhe nëpunësit e tjerë është bërë në formën dhe kohën e duhur, për ti ndihmuar ata në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësisë. Titullari është informuar nga drejtuesit me anë të mbledhjeve, nëpërmjet relacioneve dhe raporteve rreth këtyre mbledhjeve. Drejtuesit e programeve kanë raportuar tek nëpunësi autorizues për ecurinë e veprimtarisë, planeve të punës dhe objektivave të vendosur për realizimin e politikave, duke hartuar raporte monitorimi periodike në varësi të punës.



Punonjësit brenda institucionit komunikojnë me postë elektronike dhe në mënyrë verbale, ndërsa jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet e tjera, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Ministria e Mbrojtjes ka faqen e saj zyrtare në internet dhe nëpërmjet kësaj të fundit të gjithë të interesuarit mund të informohen rreth veprimtarisë së institucionit.

## 5. Monitorimi

Nga auditimi konstatohet se në vijim të përcaktimit në pikën 23/1 të nenit 4 të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin: “Nëpunës autorizues i nivelit të dytë”, dhe /ose të niveleve të tjera, janë nëpunës të administratës publike në secilën nga njësitë e vartëse, me buxhet më vete të njësisë së qeverisjes së përgjithshme, përgjegjës për përgatitjen, zbatimin, kontrollin e brendshëm financiar, monitorimin, raportimin, kontabilitetin dhe auditimin e brendshëm të buxhetit të tyre, që përgjigjet përpara nëpunësit autorizues...”, për periudhën objekt auditimi janë hartuar raportet e monitorimit 4-8-12 mujore të konsoliduara të buxhetit të Ministrisë së Mbrojtjes, por institucionet e varësisë, dhe Ministria e Mbrojtjes si institucion buxhetor më vete, nuk kanë hartuar raportet 4 mujore të monitorimit të buxhetit, veprime në kundërshtim me pikën 42 kapitulli III të 41.2 kapitulli III, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mos implementimi i një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MM, rezultoi se nuk janë implementuar si duhet kërkesat e ligjit 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, për arsye se: Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MM, rezultoi se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rregulloja e Brendshme e MM nuk ka reflektuar ndryshimet e strukturës organizative, pasi nuk është bërë rishikimi i saj; duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësive dhe linjën e raportimit të punonjësve. Në strukturë janë shtuar disa drejtori si Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Drejtoria Operacionale e Drejtimit, për të cilat nuk janë reflektuar përshkrimet përkatëse të detyrave.</li> <li>- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MM nuk ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës;</li> <li>- Nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe MM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut;</li> <li>- Nuk janë përgatitur dhe nuk janë dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse, të cilët përmbliidhen në regjistrin e riskut të vitit 2022 të MM-së;</li> <li>- MM nuk disponon një regjistër kontabël të plotë aktiveve.</li> </ul> <p>Veprimet e mësipërme janë kryer jo në përputhje me me pikën 2 të nenit 21, me pikën 2 të nenit 11, me pikën 1 të nenit 27, pikave nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe me Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1.</p>

<b>Kriteri:</b>	Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike” të Ministrisë të Financave. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mangësi në implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar si dhe në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.
<b>Shkaku:</b>	Moszbatimi i bazës ligjore në fuqi, e cila rregullon proceset e punës në fushën e MFK-së.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Strukturat përgjegjëse të MM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

## 2.7 Vlerësimi i komponentëve të Auditit të brendshëm.

Për këtë u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- ✓ Plani Auditimit dhe realizimit për vitin 2021-2022-2023.
- ✓ Raporti vjetor për vitin 2021-2022-2023.
- ✓ Plani strategjik 2021-2022-2023.
- ✓ Plani strategjik i auditimit dhe ai vjetor 2021-2022-2023.

**-Për vitin 2021** është miratuar plani strategjik 2021-2023 si dhe plani vjetor për auditim e brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, me urdhërin nr.1262 Prot., datë 20.10. 2020.

**-Për vitin 2022** është miratuar plani strategjik 2022-2024 si dhe plani vjetor për auditim e brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr.4293/2, datë 19.10.2021.

**-Për vitin 2023** është miratuar plani strategjik 2023-2025 si dhe plani vjetor për auditim e brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes, me shkresën nr.5190/1 Prot., datë 14.10.2022.

### **-Viti 2021:**

Me urdhër të titullarit nr. 1262, datë 20.10.2020, është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, Me shkresën nr. 1612/2 prot., datë 20.10.2020 DAB ka miratuar plani vjetor për vitin 2021 dhe planin strategjik për vitin 2021-2023. Me shkresën nr.187/3 prot., datë 11.04.2022 DAB ka miratuar planin vjetor për vitin 2021.Me shkresën nr.4293/3 prot., datë 19.10.2021 është dërguar në MFE ndryshimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2021.

Sipas planit strategjik dhe vjetor të dërguar, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MM, për vitin 2021 është programuar realizimi i 23 angazhimeve të auditimit, prej të cilave 11 (njëmbëdhjetë) auditime të kombinuara (të plota) dhe 8 (tetë) auditime përputhshmërisë si dhe 4 (katër) auditime financiare. Planifikimi i auditimeve është hartuar bazuar mbi numrin e plotë organik të njësisë së auditimit (Si njësi e plotësuar organike për vitin 2021, me vendimin nr.3 datë 15.10.2021 të Komiteti i Auditimit në planin vjetor 2021 ka pasur ndryshime:

Janë realizuar 8 angazhime të plota, nga 10 të planifikuara me ndryshime, (2 auditime në process pune në terren të cilat përfundojnë gjatë muajit Janar-Shkurt 2022). Është në proces pune audituse në terren “Për vlersimin e veprimtarisë ekonomike financiare në Komandën e Forcës Toksore (Reaorti 1001 Zall Herr Tiranë)”. Është në process pune audituse në terren sipas programit të miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm “Auditimi i aktivitetit ekonomiko-financiar në SHQU FA Tiranë”.

**-Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2021** është miratuar nga Titullari me shkresën nr. 187/3 Prot, datë 11.04.2022 dhe është dërguar në Drejtorisë së Harmonizimit të Adutimitit të Brëndshëm në MFE me shkresën nr. 4293/3 prot, datë 19.10.2021. Në këtë raportim është përshkruar koncretisht:

-Auditime të kryera me program të veçantë të miratuara me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

**1.** Auditim përputhshmërie dhe financiar “Për auditimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Modernizimit në MM dhe Komandës së Forcës Ajrore, Rinas, për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës nr.5844, datë 2.10.2017, me objekt: “Për blerjen e sistemit të integruar të vëzhgimit të hapësirës ajrore-Faza I”. Auditimi i përfunduar.

**2.** Auditim përputhshmërie dhe financiar “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratave të shitjes së skrapit të vitit 2019, në Komandën Mbështetëse (Rep.4001), Tiranë dhe repartet e FA-së. Përfunduar projekt raporti i auditimit, në proces përgatitja e raportit përfundimtar.

Në zbatim të gërmës “ç”, neni 6, të Ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” ndryshuar, gjatë vitit 2021, D/AB ka ndjekur, monitoruar dhe ka kërkuar zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve të dhëna në raportet përfundimtar të auditimeve të realizuara, e ka rezultuar se masa e zbatimit të tyre nga Titullarët, degët dhe sektorët e financës, personelit dhe logjistikës, të strukturave të audituara, janë në nivele jo të kënaqshme, megjithëse disa rekomandime shtrihen në një afat kohor më shumë se një vit.

**-Rekomandimet e propozuara.** Nga auditimet e përfunduara në vitin 2021 ndër të tjera ka specifikuar si një nga prioritetet e saj ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara me qëllim që ato të shërbejnë për ndreqjen e parregullësive e gabimeve, dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Drejtimi ka planifikuar punën për ndjekjen e rekomandimeve të auditimit me angazhime auditimi specifike, për t'u siguruar se njësitë shpenzuese kanë ndërmarrë të gjitha masat korrigjuese ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve dhe këshillave të auditimit. Bazuar në standartet e auditimit të brendshëm, si dhe materializimit të tyre në udhërrëfyesin e auditimit të brendshëm të sistemit financiar publik, zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi do të ndiqet me prioritet si dhe në respekt të afatit nga adresimi i tyre për njësitë e audituara.

Duke e vlerësuar të rëndësishme dhe qëllim final të auditimit, zbatimin e rekomandimeve, drejtorja e auditimit është fokusohet në përmirësimin e cilësisë së tyre dhe të bashkëpunimit me njësitë e audituara, me qëllim:

**Konkretisht,** nga 226 rekomandime të dhëna janë zbatuar 74 rekomandime ose 32.7% prej tyre, kjo e lidhur edhe me kohën e kufizuar deri në fund të vitit, si dhe 152 rekomandime janë vlerësuar në proces zbatimi që ndiqen në vazhdimësi. (në këtë material janë përfshirë edhe rekomandimet e lëna nga auditimi i kryer në Policinë Ushtarake përfunduar në Janar 2021). Duke bërë një krahasim me vitin 2020, kemi një nivel jo të mirë të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve me gjithë kohën e shkurtër të realizimit të auditimeve dhe situatën e pandemisë Covid -19.

Gjithashtu, për të gjitha-gjetjet (mungesat, dëmtimet shkeljet e disiplinës financiare me dhe pa dem ekonomik) të konstatuara nga auditimet e kryera, janë rekomanduar nxjerrjen e përgjegjësive dhe marrjen e masave, brenda kuadrit ligjor, për personat përgjegjës.

- **Gjetjet kryesore sipas sistemeve**

Gjetjet sipas fushës ose sistemit gjatë vitit 2021", rezulton se nga njësia e auditimit janë konstatua ose zbuluar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi të shoqëruar me efekte financiare për buxhetin e shtetit në shumën 12,345 mijë lekë, i ndarë në:

• prokurime, blerje dhe investime rreth:	1,343 mijë lekë.
• paga, shpërblime udhëtime dhe dieta rreth	1,548 mijë lekë.
• administrimin e pronave dhe pasurisë së FA-së, rreth	431 mijë lekë.
• Privatizim, shitje, pasurie...	1,005 mijë lekë.
• Të tjera.....	8,018 mijë lekë
<hr/>	
• Totali i gjetjeve sipas fushave ose sistemeve:	12,345 mijë lekë

**Organizimi i kapaciteteve audituese në MM**

Për periudhën 2021 në MM kanë qenë në fuqi struktura organizative e Ministrisë së Mbrojtjes ka funksionuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar. Ministria e Mbrojtjes e ka ndryshuar strukturën organike të saj, me urdhrin e Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”.

Titullari i Institucionit me Urdhrin nr. 2159, datë 16.11.2017, ka miratuar Rregulloren e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, ku njësia e auditimit të brendshëm është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njësive audituese dhe 1 (një) drejtusi kësaj njësie. Në bazë të strukturës dhe numrit të punonjësve, nivelit të riskut për çdo sistem, është bërë dhe përcaktimi i numrit të ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuara për këtë periudhë.

**-Për vitin 2021, Drejtori e Auditimit të Brendshëm, nuk ka funksionuar me numër të plotë sipas organizimit, pasi nuk është bërë zëvendësimi i 4 punonjësve, përkatësisht të një auditusi që ka dalë në pension në muajin Korrik 2019, dhe dy të larguar gjatë muajit mars 2020 si dhe largimit të ish drejtorit. Aktualisht Drejtori i Auditimit të Brendshëm funksionon me 4 punonjës më pak se struktura e miratuar.**

**- Organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, niveli i kualifikimit.**

Për vitin 2021 auditimi i brendshëm në MM ka funksionuar në bazë të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.201 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", si dhe manualit të auditimit i miratuar me urdhër të MF- nr.100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik" ndryshime. Përveç këtyre akteve, në punën audituese, kanë shërbyer edhe manuale e metodika të tjera specifike të miratuara nga MM.

-Sipas organizimit të miratuar, Drejtoira e Auditimit përbëhet nga 9 (nëntë) punonjës: Drejtori i drejtorisë së auditimit të brendshëm 1 (një), sektori i auditimit të njësive shpenzuese me 5 (pesë) punonjës, dhe sektori i auditimit të ndërmarrjeve me 3 (tre) punonjës. Në fakt, rezultoni e pa plotësuar edhe për 2 (dy) punonjës.

-Në sektorin e auditimit të ndërmarrjeve mungon 1 (një) punonjës (auditues), për shkak të daljes në pension në muajin korrik 2019 dhe 2 (dy) punonjës në sektorin e auditimit të njësive shpenzuese gjatë muajit Mars 2020, që ende nuk janë zëvendësuar (plotësuar organika). Nga muaji shtator i vitit 2019 në detyrën e drejtorit të auditimit, është caktuar dhe ngarkuar për kryerje e kësaj detyre, shefi i sektorit të auditimit të ndërmarrjeve.

**- Struktura e miratuar është si vijon:**

- Drejtor, 1 (një)
- Sektori i Auditimit të njësive shpenzuese, 5 punonjës, nga ku:
  - Përgjegjës sektori me kategorinë III-a, 1 (një)
  - Specialist me kategorinë III-b, 4 (katër)
- Sektori i auditimit të ndërmarrjeve, 3 punonjës, nga ku:
  - Përgjegjës sektori me kategorinë III-a, 1 (një)
  - Ispektor me kategorinë III-b, 2 (dy)

**Pranë Ministrisë së Mbrojtjes është ngritur struktura e Komitetit të Auditimit të Brendshëm** Me urdhërin nr. 1502, datë 05.10.2021 dhe ka vijuar veprimtarinë e tij si një strukturë mbështetëse për Drejtorinë e Auditimit, duke dhënë garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike. Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 4 mbledhje me Komitetin e Auditimit të Brendshëm, ku janë diskutuar problematikat e Drejtorisë së Auditimit, ecuria e planit vjetor 2021, gjetjet dhe rekomandimet sipas rastit.

**-Analiza e kapaciteteve të audituesve.**

Në realizimin e misioneve të parashikuara, Njësia e Auditimit të Brendshëm është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njësisë së auditimit në nivel drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes, i përbërë nga 8 (tete) auditues dhe 1 (një) drejtuesi i kësaj njësie.

Në bazë të strukturës dhe numrit të punonjësve, nivelit të riskut për çdo sistem, është bërë edhe përcaktimi numrin të ditëve të punës të nevojshme për auditimin e sistemeve të identifikuara për këtë periudhë.

**Për vitin 2021**, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, nuk ka funksionuar me numër të plotë sipas organikes, pasi nuk është bërë zëvendësimi i 4 (katër) punonjësve, përkatësisht të një audituesi që ka dalë në pension në muajin korrik 2019, dhe dy të larguar gjatë muajit mars 2020 si dhe të largimit të ish drejtorit. Aktualisht Drejtoria e Auditimit të Brendshëm funksionin me 4 (katër) punonjës me pak se struktura e miratuar.

**Kostatim:** Gjatë auditimi u kostatu se për vitin 2021 struktura në DAB është e paplotësuar me 4 (katër) punonjës më pak.

**Gjatë vitit 2021**, i gjithë stafi i DAB ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vijueshëm të edukimit të përditësuar të organizuar dhe zhvilluar nga NJQH/AB. Nga ana e stafit të cilët kanë qënë të certifikuar janë ndjekur trajnimet e detyrueshme 40 orë në vit të organizuara nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, këto trajnime janë ndjekur me interes nga audituesit e drejtorisë.

**Viti 2022:**

Me vendimit nr. 3, datë 15.10.2021 të KAB ka miratuar vlersimin e planit strategjike 2022-2024 dhe vjetor 2022, dhe me urdhër të titullarit nr. 4293/2 prot., datë 19.10.2021 ka dërguar MFE planin strategjike për vitin 2022-2024 dhe vjetor 2022, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”. Me shkresën nr. 4293/2 prot., datë 19.10.2021 titullari ka dërguar planin strategjik 2022-2024 dhe vjetor për vitet 2022. Me shkresën nr.1663, prot datë 07.02.2023 nga ministri i MM-së është miratuar raporti vjetor për vitin 2022.

Sipas planit strategjik dhe vjetor të dërguar, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MM, për vitin 2022 ka planifikuar gjithsej 14 auditime, prej te cilave 8 auditime te kombinuara dhe 6 auditime përputhshmërie (referuar planit strategjikë 2022-2024 dhe vjetor 2022 miratuar nga MM, me shkresën nr. 4293/2 prot., datë 19.10.2021.

Me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes janë kryer 2 auditime përputhshmërie të paparashikuara në planin vjetor 2022 në strukturat e Forcës Ajrore mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe procedurat e

ndjekura për zbatimin e kontratave të mirëmbajtjes së helikopterëve tip Cougar AS532A1 dhe tip EC-145. 1

Aktualisht, janë realizuar (përfunduar) 2 auditime të kombinuara në Forcën Tokësore dhe Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë (të filluara në fund të vitit 2021 dhe të përfunduara në vitin 2022). Në proces auditimi, janë 2 auditime të kombinuara (në AKSHE dhe Komandën Mbështetëse) dhe 2 auditime përputhshmërie (në Batalionin e Furnizimit dhe në Forcën Ajrore).

Referuar planit vjetor, për periudhën e mbetur (5 mujore), duhet të kryhen 11 auditime (6 të kombinuara dhe 5 përputhshmërie). Nënvizohet faktin që, ky plan do të realizohej me staf të plotë prej 9 punonjësish. Aktualisht, jemi në kushtet e një stafi të reduktuar, (mungojnë 2 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë).

-Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2022 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditimit të Brëndshëm në MFE me shkresën nr. 166/3 prot, datë 07.02.2023.

Në këtë raportim është përshkruar ecuria e 14 angazhimeve, nga të cilat , 8 auditime të kombinuara në bazë sistemi dhe 6 auditime përputhshmërie.

-Me shkresën nr. 1588, datë 01.08.2022, Ministri i Mbrojtjes miratoi disa ndryshime në planin vjetor të vitit 2022. Këto ndryshime, u bazuan në kërkesën e Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm, e cila u miratua nga Komuniteti i Auditimit të MM-së me vendimin nr. 1341/1, datë 29.07.2022. Argumenti bazë ishte mungesa e theksuar e stafit të Drejtorisë së auditit (54% e strukturës funksionale).

-Komiteti i Auditit të MM-së (me vendimin nr.1341/4, datë 29.07.2022) dhe Ministri i Mbrojtjes me shkresën nr. 15588, datë 01.08.2022, miratuan ndryshimet (pakësim të auditimeve) në planin vjetor të auditit 2022, konkretisht auditim i kombinuar në: Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MM, Komandën e Forcës Ajrore, Akademinë e FA dhe në Qendrën e KMBM. Ndryshimet e bërë me kërkesën të Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm.

-Sipas programit të miratuar për vitin 2022 (me ndryshimet), janë programuar për t'u kryer 12 misione auditimi, prej të cilave, 5 auditime të plota (të kombinuara) dhe 7 misione auditimi të llojeve të tjera (të përputhshmërisë, përformancës, financiare).

-Ne fakt janë përfunduar 5 auditime të plota (të kombinuara), ndërkohë që një objekt auditimi është në proces (AISM-është dërguar draft raportit). Ndërsa janë përfunduar të gjitha fazat e auditimit për 7 angazhime auditimi për përputhshmërie dhe atë financiare si dhe është në proces auditimi mbi kontrollin dhe vlerësimin e sistemeve në përdorimin e fondeve për veprimtari specifike operative në Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (fazë pune ne teren).

#### **- Analiza e programeve të Drejtorisë së Auditimit për periudhën raportuese.**

-Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm në Ministrinë e Mbrojtjes rezultoi se:

Kjo njësi auditimi referuar strukturës organizative janë miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me shkresën me nr. 4293/2 Prot., datë 19.10.2021 është e organizuar në nivel drejtorie dhe na varsi direkt të Ministrisë së Mbrojtjes, përbërja e drejtorisë, sipas strukturës së miratuar është si më poshtë:

-Drejtoria e Auditimit të Brëndshëm me 9 punonjës:

Drejtori (1)

-Sektori i auditimit të njësive shpenzuese, 5 punonjës

-Përgjegjës Sektori (1) Kategoria III-a

-Inspektor 4-kategoria III-b

-Sektori i Auditimit të ndërmarrjeve, 3 punonjës.

-Përgjegjës Sektori (1)- kategoria III-a

-Inspektor (2)-kategoria III-b

Për vitin 2022, struktura organike e auditimit të brendshëm në Forcat e Armatosura (*Ministrinë e Mbrojtjes*) ka qenë e plotësuar në masën 60%, pra me 5.4 punonjës në fakt (*mesatare*).

**-Rekomandimet e propozuara.** Për vitin 2022, të gjitha rekomandimet e dhëna nga Auditimi në raportet e tij, janë pranuar nga njësitë e audituara dhe nga menaxhimi i lartë i MM-së, mbi bazën e të cilave janë hartuar edhe plan veprimet përkatëse. Shkalla e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, do të përcaktohet brenda tre mujorit të parë të vitit 2023, bazuar në një angazhim specifik të auditimit në të gjitha njësitë e audituara gjatë vitit 2022.

**-Referuar gjetjeve kryesore për vitin 2022, gjetjet sipas fushave ose sistemit,** rezulton se nga njësia e auditimit të brendshëm, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të shoqëruara me efekte ekonomike për buxhetin e shtetit, në total në shumën prej 7,261,600 lekë, konkretisht:

-prokurime, blerje, investime.... 1,330,470 lekë

-paga e shpërblime.... 3,323,200 lekë

-administrim aktive.....

-privatizim, shitje, qiradhënie... 855,440 lekë

-të tjera..... 1,345,330 lekë 407,160 lekë

-Ndërsa gjetjet e shprehura në numër janë; në total 677 gjetje, që lidhen kryesisht me shkelje në fushën e blerjeve dhe prokurimeve me 96 gjetje, në fushën e pagesave me 185 gjetje, në fushën e administrimit 294 gjetje, në fushën e qiradhënies 14 gjetje dhe të tjera me 88 gjetje.

#### **- Organizimi i kapaciteteve audituese në MM:**

**Për periudhën 2022,** MM kanë qenë në fuqi struktura organizative e Ministrisë së Mbrojtjes ka funksionuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 "*Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura*", i ndryshuar. Ministria e Mbrojtjes e ka ndryshuar strukturën organike të saj, me urdhrin e Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 "*Për disa ndryshime në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit 63 të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura"* ku njësia e auditimit të brendshëm është organizuar në Drejtori Auditimi.

Titullari i Institucionit me Urdhrin nr. 2159, datë 16.11.2017, ka miratuar Rregulloren e Brendshme "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura*."

Në realizimin e misionëve të parashikuara, Njësia e Auditimit të Brendshëm është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njësisë së auditimit në nivel drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes përbërë nga 8 auditues dhe (1) drejtuesi i kësaj njësie.

#### **- Organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, niveli i kualifikimit.**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Mbrojtjes*", njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në nivel drejtorie në varësi të Ministrit të Mbrojtjes. Struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MM është miratuar me 9 (nëntë) punonjës: Drejtor i drejtorisë së auditimit të brendshëm 1 (një), sektori II auditimit të njësive shpenzuese me 5 (pesë) punonjës, sektori i auditimit të ndërmarrjeve me 3 (tre) punonjës.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm zhvillon veprimtarinë audituese në mënyrë të planifikuar duke zgjedhur dhe planifikuar për auditim efektivitetin dhe vlerësimin e sistemeve e fushave me risk tek njësitë brenda Ministrisë së Mbrojtjes dhe në Institucionet e varësisë të saj.

Veprimtaria audituese është e strukturuar në bazë të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", është zhvilluar bazuar në Planin Vjetor të Auditimit për Vitin 2022; është zhvilluar bazuar në Programin e Angazhimit të Auditimit, të hartuar për çdo njësi shpenzuese, me qëllim për të vlerësuar sistemin e kontrollit të brendshëm,

menaxhimin me efektivitet të fondeve publike dhe performancën e njësisë që auditohet. Auditorët i raportojnë në mënyrë të drejtpërdrejt Titullarit Institucionit/Ministrit të Mbrojtjes, nga i cili ka varësinë organizative dhe funksionale.

-Specialistët janë me arsim të lartë, 3 me shkenca juridike dhe 3 me shkenca ekonomike.

#### **-Struktura e miratuar është si vijon:**

Aktualishte struktura e drejtorisë është e pa plotësuar për 3 (tre) punonjës

-1 (një) punonjës në sektorin e auditimit të ndërmarrjeve

-2 (dy) punonjës në sektorin e auditimit të njësive shpenzuese

-Në vijim struktura është në proces plotësimi sipas procedurave të Departamentit të Administratës Publike.

**Kostatim:** Gjatë auditimi u konstatua se për vitin 2022 struktura në DAB është e paplotësuar me 3 (tre) punonjës më pak.

-Aktivitete të tjera të funksionit të AB. Struktura e Auditimit të Brendshëm e MM-së nuk ka kryer aktivitete të tjera, përveç kryerjes së angazhimeve të auditimit brenda sistemit të Ministrisë dhe ndjekjes së trajnimit të vijueshëm. -Pranë Ministrisë së Mbrojtjes është ngritur struktura e **Komitetit të Auditimit të Brendshëm** me urdhrin nr. 1502, datë 05.10.2021 dhe ka vijuar veprimtarinë e tij si një strukturë mbështetëse për Drejtorinë e Auditimit, duke dhënë garanci të arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike. Gjatë vitit 2021 janë zhvilluar 4 mbledhje me Komitetin e Auditimit të Brendshëm, ku janë diskutuar problematikat e Drejtorisë së Auditimit, ecuria e planit vjetor 2022, gjetjet dhe rekomandimet sipas rastit.

#### **-Analiza e Kapaciteteve të Audituesve.**

Në realizimin e misionëve të parashikuara, NJAB është mbështetur në organizimin aktual të strukturës së njësisë së auditimit në nivel drejtorie në Ministrinë e Mbrojtjes, përbërë nga 5 (tetë) auditues dhe 1 (një) drejtues i kësaj njësisë.

**-Për vitin 2022,** Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, nuk ka funksionuar me kapacitete të plota sipas organikës. Në periudhën Janar-Maj 2022, drejtoria ka funksionuar pa drejtues dhe me tre auditues me pak se struktura e miratuar. Aktualisht Drejtoria e Auditimit funksionon me një drejtues dhe 5 auditues. DAB është në proces rekrutimi për plotësimin e strukturës edhe me tre auditues të rinj.

**-Gjatë vitit 2022,** i gjithë stafi i DAB ka ndjekur trajnimin e detyrueshëm të vijueshëm të edukimit të përditësuar të organizuar dhe zhvilluar nga NJQH/AB. Nga ana e stafit të cilët kanë qënë të certifikuar janë ndjekur trajnimet e detyrueshme 80 orë në dy vjet të organizuara nga ana e Drejtorisë së Harmonizimit, këto trajnime janë zhvilluar dhe janë ndjek me interes nga audituesit e drejtorisë.

#### **Viti 2023:**

Me memo nr. 5190 prot., datë 11.10.2022 të DAB, ka miratuar planin strategjik si dhe planin vjetor për vitin 2023-2025, me shkresën nr. 5190/1 prot., datë 14.10.2022 është miratuar plani strategjik dhe ai vjetor për vitin 2023-2025, në përputhje me afatet ligjore të përcaktuara në "Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik". Me shkresën nr. 5190/3 prot., datë 17.10.2022 ka dërguar në MFE planin strategjik dhe planin vjetor për vitet 2023 – 2025.

-Lista e subjekteve dhe sistemeve për t'u audituar. Janw planifikuar, për t'u audituar 12 subjekte

-Raporti vjetor i veprimtarisë së DAB për vitin 2023 është miratuar nga Titullari me shkresën nr.5190/1 Prot., datë 14.10.2022 dhe është dërguar në Drejtorisë së Harmonizimit e Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 5190/3 prot, datë 17.10.2022. Në këtë raportim është përshkruar ecuria e 19 auditime, prej te cilave 16 të evaduar dhe 3 auditime ne proces.



**- Organizimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, niveli i kualifikimit.**

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 94, datë 30.04.2010 “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, i ndryshuar. Ministria e Mbrojtjes e ka ndryshuar strukturën organike të saj, me urdhrin e Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr.94, datë 30.04.2010 të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organizimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, Njësia e auditimit të brendshëm në MM është organizuar në nivel drejtorie në varësi të Ministrit të Mbrojtjes.

Struktura organizative e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MM është miratuar me 9 (nëntë) punonjës: Drejtor i drejtorisë së auditimit të brendshëm 1 (një), sektori i auditimit të njësive shpenzuese me 5 (pese) punonjës, sektori i auditimit të ndërmarrjeve me 3 (tre) punonjës.

Aktualisht struktura e drejtorisë është e paplotësuar për 3 (tre) punonjës:

- 2 (dy) përgjegjës sektori, (sektori i auditimit të njësive shpenzuese/sektori i auditimit të ndërmarrjeve).

1 (një) auditues në sektorin e auditimit të ndërmarrjeve.

**-Kostatim:** Gjatë auditimi u kostatu se për vitin 2023 struktura në DAB është e paplotësuar me 3 (tre) punonjës më pak.

**-Karta e Auditimit,** të brendshëm, miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm me Vendim dhe nga Ministri i MM-së me nr.413/1 prot, datë 09.02.2018. Kodi i Etikës për audituesit e brendshëm i miratuar nga Ministri i Financave me Urdhër nr. 86 datë 10.12.2015

**Për vitin 2023,** punonjësit e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MM kanë marrë pjesë në trajnimin organizuar nga NJHAB sipas programeve dhe afateve të përcaktuara nga Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, sipas kërkesave të pikës 1 të nenit 20 të Ligjit nr.114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

**-Zbatimi i procedurave në dokumentimin e punës, evadimi, ruajtja dhe arkivimi i tyre.**

-Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, dosje me zgjedhje të rastësishme të angazhimeve të kryera nga DAB për periudhën objekt auditimi. Dosje të subjekteve:

- Qendra e Menaxhimit Materialeve (Rep.6604);

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MM, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve në MM;

- Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (Rep.6002) Tiranë;

Nga auditimi u konstatua se për çdo angazhim, grupet e punës kanë krijuar një dosje të veçantë, kanë grumbulluar informacionet e nevojshme për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit i kanë analizuar informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit u gjendën të administruara e të firmosura, të gjitha dokumentet sipas modelit të Fomatit Standard nr. 1, në Kapitullin VI, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar, janë kryer vlerësimet e riskut për mjedisin e përgjithshëm të kontrollit, janë organizuar takimet fillestare me subjektet, janë bërë ndarjet e detyrave për çdo auditues, si dhe pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar. Gjithashtu, u konstatua se janë respektuar afatet për dërgimin e projektraportit dhe raportit përfundimtar të auditimit, në përputhje me kërkesat e Manualit për Auditin e Brendshëm, i ndryshuar; si dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. Grupet e auditimit pas angazhimeve në terren, në zbatim të pikës 4.1.12. Hapi 11: “Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimt nga njësia e audituar”, Kapitulli IV, i Manualit të Auditimit të Brendshëm, i ndryshuar; kanë përcjellë në subjektet e audituara, së bashku me raportin përfundimtar edhe plan veprimt e sugjeruar për realizimin e

rekomandimeve. Në zbatim të standardeve të Kapitullit VII “Sigurimi i cilësisë së punës të auditimit të brendshëm”, 4.1.10. Hapi 9: “Rishikimi i punës së Auditimit” në Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, i ndryshuar; i cili citon: Sigurimi i cilësisë ka rëndësi të veçantë, pasi nëpërmjet rishikimit duhet të sigurohet nëse puna e AB është kryer në përputhje me Standarde. Në vlerësim të përputhshmërisë me këtë standard, nga auditimi u konstatua se dokumenti “Rishikimi i Cilësisë së Punës” për dosjet e përzgjedhura, ishte në përputhshmëri të plotë. Në përfundim të çdo angazhimi auditues, drejtori i DAB ka përcjellë tek Titullari i Institucionit, Memo të nënshkruar (përmbledhje e shkurtër e raportit përfundimtar). Në zbatim të kërkesave të parashikuara në “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, një kopje e dokumenteve të dosjeve të auditimeve (shkresa dhe/ose dokumente që lidhen me të), duhet të protokollohen e të dorëzohen në arkivën e Institucionit. Në vlerësim me përputhshmërinë e zbatimit të këtij ligji, nga auditimi u konstatua se dosjet e angazhimeve për vitin 2021, janë protokolluar e arkivuar.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Mosplotësimi i strukturës së Auditimit të Brendshëm.
<b>Situata:</b>	- Struktura e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes është e organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 9 punonjës, sipas Urdhrit të Kryeministrit me Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 94, datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”. Nga auditimi u konstatua se, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, ku struktura është e paplotësuar për tre punonjës nga të cilët: 2 përgjegjës sektori dhe një auditues.
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, neni 12 germa b.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mungesa e garancisë së arsyeshme për mënyrën e funksionimit të njësisë publike dhe monitorimit të çështjeve që lidhen me funksionimin e kontrollit të brendshëm.
<b>Shkaku:</b>	Mosplotësim i strukturave.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	-Ministria e Mbrojtjes të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e strukturës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel me qëllim mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.

## 2.8 Probleme të ndryshme që mund të dalim gjatë auditimit.

**2.8.1** Auditimi në lidhje me projektin “TO BE READY - The flOod and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, Programi Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”)

Grupi i auditimit është iniciuar për të audituar këtë projekt për faktin se të gjithë pagesat e realizuara për projektin në vitin 2022 janë paguar nga buxheti i shtetit, nga fondi i planifikuar nga MM për shpenzimeve korrente në llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime”, në shumën prej 53,165 mijë lekë.

Nga MM në realizimin e fondeve buxhetore për grupin e shpenzimeve korrente ka deklaruar realizimin në masën 99%, përqindje e cila nuk është e saktë pasi nga MM është përfshirë vlera prej 53,165 mijë lekë si realizim shpenzimeve korrente të periudhës ushtrimore vlera e cila ka

të bëjnë me shpenzime në lidhje me bashkëfinancimin e projektit “TO BE READY - The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, Programi Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020”, Grupit të auditimit nuk i është dhënë informacion se si janë alokuar këto fonde, dhe kush nga zërat e shpenzimeve korrente të planifikuara për vitin 2022 nuk janë realizuar, pasi fondi i tyre ka kaluar për likuidimin e detyrimeve të projektin.

Grupi i auditimit, për të realizuar qëllimin dhe objektin e auditimit të përputhshmërisë dhe financiar, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore, të Ligji nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)”; të Ligji nr. 138/2016, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin Interreg IPA të bashkëpunimit ndërkuftar Itali-Shqipëri-Mali i Zi, 2014-2020”.

**Synimi i projektit “TO BE READY”** është përbashkimi me sfidën e përbashkët të ndarë midis rajoneve italiane, shqiptare dhe malazeze të Adriatikut të cilat, në vitet e fundit, janë goditur nga katastrofa të ndryshme natyrore dhe të tjera, kryesisht zjarre dhe përmbytje që kanë shkaktuar humbje të dukshme njerëzore, dëmtime në mjedis dhe infrastrukturë.

Objektivi i projektit është rritja e kushteve për rritjen e sigurisë së rajonit midis Italisë, Shqipërisë dhe Malit të Zi nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësi të ndryshme duke zbatuar iniciativa ndërkuftare për të krijuar një urë lidhëse midis rajoneve pjesëmarrëse në mënyrë që të miratohen strategji të përbashkëta ndërhyrjeje në rast zjarresh dhe përmbytjesh.

Buxheti total i projektit për Shqipërinë ku përfshihen institucionet si Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Ministria e Brendshme është **1,479,049.95** euro nga të cilat **1,257,192.45** euro janë financim nga IPA dhe **221,857.50** euro janë bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total).

Gjatë periudhës së implementimit, me miratimin e Sekretariatit të Përbashkët (JS) ka pasur rialokime të brendshme në buxhetin e projektit por pa prekur vlerën totale të tij.

Ndërkohë ndryshim i rëndësishëm ka ndodhur gjatë vitit 2021, për shkak të një rreziku të “decommitment” që mund të merrte pala shqiptare për shkak të vonësës në realizimin e aktiviteteve të projektit. Kryesisht shkurtimi i buxhetit për shkak të mosrealizimit u bë në zërin e shpenzimeve **staff costs** dhe **travel dhe accomodation**, në vlerën prej **11,131.42 euro**.

Marrja pjesë në këtë projekt, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion grupit të auditimit, ka filluar me një shkresë të dërguar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme me nr. 7622 prot., datë 9.5.2018 dhe është miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me memon me nr. 4051 prot., datë 25.05.2018. Dërgimi i projektit dhe buxhetit tek partneret si dhe fisha finale e aplikimit është bërë me e-mailin e datës 3 dhjetor 2018, nga ish Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (në zbatim të ligjit nr. 45/2019 transferuar në AKMC). Projekti është shkruar në bashkëpunim midis ish-DPEC dhe Drejtorisë së Politikave NATO dhe BE në Ministrinë e Mbrojtjes. Me e-mailin e datës 19 korrik 2019, ish - Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile i’a ka dërguar Drejtorisë së Politikave NATO dhe BE gjithë fishën e aplikimit.

Për implementimin e projekti, përfaqësues ligjor i tij është caktuar Sekretari i Përgjithshëm në MM, duke qenë se ky projekt ka filluar në momentin që emergjencat civile kanë qenë në nivel drejtorie dhe në varësi të drejtpërdrejtë nga MM.

Ish DPEC (aktualisht AKMC) ishte pjesë e organikës së Ministrisë së Mbrojtjes, edhe përfaqësimi ligjor për këtë drejtori mbulohej nga Sekretari i Përgjithshëm, jo vetëm për këtë projekt, por për çdo detyrë apo aktivitet tjetër që lidhej me veprimtarinë e emergjencave civile.

Fillimisht, përfaqësues ligjor ka qenë ish Sekretarja e Përgjithshme, znj. A. Th. e cila është larguar nga detyra dhe me pas ish Sekretari i Përgjithshëm i komanduar në MM Z. F. K., me detyre Drejtor i Përgjithshëm i Politikave të Mbrojtjes.

Partnerët në këtë projekt janë:

- Rajoni Molise (Departamenti i Mbrojtjes Civile) në Itali - Lideri i Projektit;
- Rajoni Puglia (Njësia e Mbrojtjes Civile) në Itali;
- Ministria e Mbrojtjes (AKMC) e Shqipërisë;
- Ministria e Brendshme (Departamenti i Emergjencave Civile) e Malit të Zi;
- Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë –Partner i Asociuar.

Projekti ka filluar implementimin në shtator 2019.

Projekti është shtyrë nga vete Sekretariati i Përbashkët njëherë në gusht 2023 dhe me pas deri në dhjetor 2023.

Me urdhrin nr. 1984 prot., 2669/3 datë 31.12.2019 të MM znj. O. Xh. “Për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës” urdhëron marrjen e masave

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të ndryshuar; të germës "f" dhe të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; ligjit nr. 37/2015 "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të marrëveshjes financiare të BE-se për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IA II)", ligjit nr. 138/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për programin INTERREG IPA CBC të bashkëpunimit ndërkufitar Itali - Shqipëri - Mali i Zi, 2014 -2020", në Marrëveshjen e Partneritetit Itali - Shqipëri - Mali i Zi, nënshkruar me datën 20/08/2019, si dhe të Termave të Referencës (TOR) - Menaxher i Projektit miratuar nga Komiteti i Vlerësimit, me datën 05/12/2019,

#### **Urdhëron:**

Marrjen e masave për zbatimin e Kontratës së Shërbimit për "Menaxheri Projektit" i projektit tematik "TO BE READY - The flood and Big fire forest, prediction, forecAst and emergency management - 355", bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", si me poshtë:

a) Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, të marre masat për kryerjen e pagesës së shërbimit dhe të detyrimeve që burojnë nga kontrata;

b) Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile të vendosë në dispozicion ambientet përkatëse të punës për ofrimin e shërbimit, si dhe të bashkëpunojë me Menaxherin e Projektit për zbatim të projektit;

c) ***Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të administrojë dokumentet e nevojshme të dosës së Menaxherit të Projektit;***

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile të kontrollojë ofrimin e shërbimit dhe të firmosë Raportin Kohor (Time-Sheet) përkatës që plotësohet çdo muaj nga ofruesi, sikurse parashikohen në Rregullat e Programit "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020" dhe legjislacionin në fuqi.

3. Përgjigjet për zbatimin e këtij urdhri: Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Politikave NATO dhe BE, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Mbrojtjes, në Ministrinë në Mbrojtjes, si dhe Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen Civile.

4. Ndjek zbatimin e urdhrin Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes.

Me urdhrin e Ministres së MM znj. O. Xh. me nr. 1991, prot., 2152/1, datë 31.12.2019 "Përngritjen e grupit të punës në ministrinë e Mbrojtjes për menaxhimin dhe Koordinimin e projektit "TO BE READY" në kuadër të programit interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020", urdhëron: Ngritjen e Grupit të Punës i cili do të zbatojë aktivitetet e parashikuara në kuadër të Projektit Tematik "TO BE READY - The flood and Big fire forest, prediction, forecast and emergency management - 355", i cili bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian nën instrumentin Para-Aderimit (IPA), Programi Trilateral "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", me përbërje prej shtatë anëtare.

3. Punonjësit do të angazhohen në aktivitetet e Projektit në Paketën e punës WPM, WP TI-T2 dhe WPC dhe do të punojnë për projektin deri në 40% të kohës së punës në baze të nevojave konkrete që do të përcaktohen rast pas rasti nga ana e Menaxherit të Projektit dhe do të paraqiten në Raportet Kohore (Time-Sheet) përkatëse që do të plotësohen dhe firmosen si parashikuar nga Rregullat e Programit.

4. Kontributi financiar i secilit punonjës, i llogaritur mbi pagën bruto në përputhje me kohën e përfshirë në projekt, do të llogaritet si pjesë e bashkëfinancimit të Ministrisë së Mbrojtjes për projektin "TO BE READY".

5. Menaxheri i Komunikimit të Projektit dhe asistentet e projektit, autorizohen të përfaqësojnë institucionin në takimet që zhvillohen në kuadër të projektit në fjale.

6. Ngarkohen anëtarët e Grupit të Punës dhe Menaxheri i Projektit "TO BE READY" për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri.

**Me urdhrin nr. 266 prot., 483/1 datë 27.02.2020** të Sekretarit të Përgjithshëm në mungesë porosi të z. F. K. është urdhëruar:

Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në kuadër të bashkëfinancimit të Ministrisë së Mbrojtjes për projektin "TO BE READY", të llogarisë kontributin financiar për punonjësit e angazhuar në Grupin e Punës për zbatimin e aktivitetëve të Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të muajit shkurt 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Menaxheri i Projektit "TO BE READY" dhe Drejtorja e Politikave NATO de BE, për komunikimin dhe zbatimin e këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrin janë (Time-Sheet) për K. Sh. në shumën 537.44 euro, A. A. në shumën 887.84 euro, B. C. në shumën 663.04 euro, F. Xh. në shumën 537.44 euro, T. S. në shumën prej 537.44 euro, E. H. në shumën 403.08 euro E. Sh. në shumën 537.44 euro mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Me urdhrin nr. 266/1 prot., 483/3 datë 30.03.2020** të Sekretarit të Përgjithshëm në mungesë porosi të Z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar në Grupin e Punës për zbatimin e aktivitetëve të Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të muajit mars 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrin janë (Time-Sheet) për K. Sh. në shumën 501.78 euro, A. A. në shumën 827.8 euro, B. C. në shumën 187.6 euro, F. Xh. në shumën 501.76 euro, T. S. në shumën prej 501.76 euro, E. H. në shumën 501.76 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Me urdhrin nr. 466 prot., 752/1 datë 30.04.2020** të Sekretarit të Përgjithshëm në mungesë porosi të z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar në Grupin e Punës për zbatimin e aktivitetëve të Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të muajit prill 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrin janë (Time-Sheet) për K. Sh. në shumën 531.68 euro, A. A. në shumën 878.40 euro, B. C. në shumën 656 euro, F. Xh. në shumën 531.68 euro, T. S. në shumën prej 531.68 euro, E. H. në shumën 531.68 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Me urdhrin nr. 570 prot., 280/1 datë 29.05.2020** të Sekretarit të Përgjithshëm në mungesë porosi të z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar

ne Grupin e Punës per zbatimin e aktiviteteve te Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të muajit prill 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrit janë (Time-Sheet) për K. Sh. ne shumën 502.07 euro, A. A. ne shumën 829.46 euro, B. C. në shumën 619.32 euro, F. Xh. në shumën 502.07 euro, T. S. në shumën prej 502.07 euro, E. H. në shumën 502.07 euro, E. Sh. në shumën 502.07 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Me urdhrin nr. 746 prot., 280/2, datë 30.06.2020** të Sekretarit të përgjithshëm ne mungese porosi të Z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar ne Grupin e Punës per zbatimin e aktiviteteve te Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) perkates të tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrit janë (Time-Sheet) për K. Sh. në shumën 585.34 euro, A. A. ne shumën 966.65 euro, B. C. në shumën 121.99 euro, F. Xh. në shumën 529.12 euro, T. S. në shumën prej 585.34 euro, E. Sh. në shumën 585.34 euro; E. H. në shumën 585.34 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Me urdhrin nr. 1140 prot., 1047/1, datë 30.09.2020** të Sekretarit të përgjithshëm në mungesë porosi të Z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar ne Grupin e Punës për zbatimin e aktiviteteve te Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të tetor, nëntor dhe dhjetor 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

#### **Korrik 2020**

Bashkëlidhur urdhrit janë (Time-Sheet) për F. Xh. në shumën 425.85 euro, E. H. në shumën 586.58 euro, K. Sh. ne shumën 586.58 euro, B. C. në shumën 723.58 euro, A. A. ne shumën 969.08 euro.

#### **Gushti 2020**

Bashkëlidhur urdhrit janë (Time-Sheet) për F. Xh. në shumën 558.41 euro, E. H. në shumën 349.63 euro, K. Sh. ne shumën 293.29 euro, B. C. në shumën 525.31 euro, T. S. në shumën prej 377.3 euro, A. A. ne shumën 922.54 euro.

#### **Shtator 2020**

Bashkëlidhur urdhrit janë (Time-Sheet) për F. Xh. në shumën 558.41 euro, K. Sh. ne shumën 428.85 euro, B. C. në shumën 561.7 euro.

**Me urdhrin nr. 1712 prot., 1633/1 datë 31.12.2020** të Sekretarit të përgjithshëm ne mungese porosi të Z. F. K. është urdhëruar llogaritja e kontributit financiar për punonjësit e angazhuar ne Grupin e Punës per zbatimin e aktiviteteve te Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës të Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, bashkëlidhur këtij urdhri.

Bashkëlidhur urdhrit janë të firmosura në një datë me 29.12.2020 (Time-Sheet) për periudhën tetor, Nëntor dhe Dhjetor.

**Tetor:** F. Xh. në shumën 569.39 euro, T. S. në shumën prej 569.39 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri.

**Nëntor:** B. C. në shumën 755.08 euro, F. Xh. në shumën 494.34 euro, T. S. në shumën prej 494.34 euro, mbi të cilët është bërë pagesa sipas këtij urdhri

**Dhjetor:** B. C. në shumën 852.26 euro, F. Xh. në shumën 557.97 euro, T. S. në shumën prej 557.97 euro.

Me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1034, datë 28.7.2021 është bërë një –ndryshim Urdhrit nr. 1996, datë 21.12.2012 “Për ngritjen e grupit të punës në ministrinë e Mbrojtjes për menaxhimin dhe Koordinimin e projektit “TO BE READY” në kuadër të programit interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020” me përbërje prej dhjetë anëtare.

Me shkresën me nr. 66/2 prot, datë 14.01.2022, ka dal urdhri i MM nr. 33, datë 14.01.2022,

“Për ngritjen e grupit të punës në Ministrinë e Mbrojtës për Menaxhimin dhe Koordinimin e Projektit Tematik “To Be Ready” në kuadër të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali Zi 2014-2020 me përbërje prej shtatë anëtare.

2. Grupi i Punës të angazhohet në kryerjen e aktiviteteve të projektit, krahas detyrave funksionale sipas përshkrimit korrespondues të punës, në kohë të pjesshme dhe sipas një përqindje të caktuar angazhimi.

3. Grupi i Punës të aktivizohet në të gjitha aktivitetet (paketat e punës) e planifikuara në projekt dhe të punojnë sipas nevojave të projektit.

4. Kontributi financiar i secilit punonjës, do të llogaritet sipas "Manualit të programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali Zi".

6. Ndjek zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe anëtarët e grupit të punës.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Ngritja e grupeve të punës për ndjekjen dhe realizimin projekti “To be ready”.
<b>Situata:</b>	<p>Me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1991, prot., 2152/1, datë 31.12.2019 dhe me nr. 33, datë 14.01.2022 “Për ngritjen e grupit të punës në ministrinë e Mbrojtjes për menaxhimin dhe Koordinimin e projektit “TO BE READY” në kuadër të programit interreg IPA CBC Italia-Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020” është ngritur grupi i punës, i cili do të zbatojë aktivitetet e parashikuara në kuadër të Projektit Tematik.</p> <p>Si anëtare të grupit të punës është caktuar Këshilltari për Median i Ministrit të Mbrojtjes, si asistent komunikimi i projektit për vitin 2019-2021 dhe si menaxher projekti për vitin 2022. Zgjedhja e një këshilltari si anëtar grupi pune është në kundërshtim me ligjin nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” neni 11, pika 4 “Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. <u>Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror</u>”</p> <p>Për vitin 2020 <i>me urdhrin nr. 266 prot., 483/1 datë 27.02.2020</i> të Sekretarit të përgjithshëm është urdhëruar, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në kuadër të bashkëfinancimit të Ministrisë së Mbrojtjes për projektin "TO BE READY", të llogarisë kontributin financiar për punonjësit e angazhuar në Grupin e Punës për zbatimin e aktiviteteve të Projektit Tematik "TO BE READY", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës çdo muaj. Nga grupi i punës i ngarkuar me urdhër të Ministrit nuk është bërë asnjë raport mbi realizimin e projektit dhe hapat që janë realizuar gjatë kësaj periudhe në lidhje me këtë projekt, duke ndikuar dhe në mosrealizimin në kohë të projektit. Në FLC janë dërguar për miratim deklaratat e pagesës dhe kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të personave të përfshirë në grupin e punës në vlerë totale, për 8 orë pune në ditë si të angazhuar për projektin dhe jo e ndarë në orë pune sipas Time-Sheet që janë 2 orë në ditë.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Ligji nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore”</p> <p>Urdhër i Ministrit të Mbrojtjes përkatësisht me nr. 1991, prot., 2152/1, datë 31.12.2019 dhe me nr. 33, datë 14.01.2022.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Mosrealizimi në kohë i projektit sipas fazave të përcaktuara në marrëveshje.

<b>Shkaku:</b>	Mungesë e monitorimit dhe mos raportim mbi realizimin e projektit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin dhe dokumentimin e punës së realizuar nga personat e ngarkuar për projektin “To Be Ready” bazuar në urdhrat e Titullarit të institucionit. Të ndaj përgjegjësit dhe të definojë qartë personat përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e projektit, bazës së të dhënave për marrëveshjet e bashkëfinancimit, në mënyrë që të kemi një raportim mbi gjendjen e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëfinancimit të përfutur nga institucioni.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Kontraktimi i eksperteve të projektit “To be ready”.
<b>Situata:</b>	<p>- Me memon me nr. 883 Prot, datë 04.09.2020 të Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve, kërkon miratimin për vijimin e procedurave të përzgjedhjes së dy ekspertëve për projektin “To Be Ready”.</p> <p>Në zbatimin të Urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 860 prot., date 24.07.2020, grupi i punës ka hartuar Termat e Referencës (TOR), ku ka përcaktuar formën e angazhimit, procedurën që duhet të ndiqet, si dhe fondin e nevojshëm për përzgjedhjen e Financierit dhe Menaxherit të Komunikimit në projektin "TO BE READY-The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergency management - 355", Programi Trilateral "Interreg IPA CBC Itali- Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020".</p> <p>Pas shqyrtimit të aplikatëve për financiere projekti nga Komiteti i Vlerësimit, me procesverbalin e mbajtur me nr.2107 prot, datë 28.12.2020 është përzgjedhur si fituese L. A. Dh..</p> <p>Me znj. Dh. dhe MM është lidhur kontrata me nr. 2107/3, datë 31.12.2020. Në nenin 6 është përcaktuar paga mujore 850 euro/muaj</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantja znj. L. A. Dh., në CV e paraqitur ka deklaruar se që nga Dhjetor 2014-vazhdim është këshilltare në Komisionin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.</p> <p>Kontraktimi i L. Dh. si financiere e projektit është në kundërshtim me Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionarit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” miratuar me Vendimin nr. 11, datë 29.01.2016, neni 15 “Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private” pika 2:</p> <p>Zyrtarët e KMSHC-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarim të interesave private periodike janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Komisioneri;</li> <li>Këshilltari;</li> <li>Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ; etj....</li> </ol> <p>Neni 16 “Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të interesit Zyrtarët e KMSHC-së” pika <b>b) nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies;</b></p> <p>2. Nga auditimi i dosjes së kontraktimit të "Menaxher Projekti"; “Financier Projekti” dhe “Menaxherit të Komunikimit” mungon baza mbi të cilën është bërë <b>përlllogaritja vlerës së shërbimit.</b></p>



	<p>- Së dyti kontrata tip e lidhur me menaxherin e projektit, financierin e projektit dhe menaxherin e komunikimit të projektit janë lidhur nga Burimet Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, si kontrata <b><i>pune individuale (staff cost)</i></b>, sipas ligjit shqiptar, dhe jo si kontratë shërbimi të përcaktuar në Ligji nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)”; Rregullave PRAG dhe Udhëzimeve të BE-së, si dhe Manuali i Programit të projektit Interreg IPA CBC Italy-Albania – Montenegro”, ashtu siç është vepruar me kontratat e tjera të lidhura nga MM, për realizimin e projektit.</p> <p>3. Me shkresën 07.02.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të MM, është shpallur në websitin e Ministrisë së Mbrojtjes, vend vakant par financier dhe menaxher projekti, ku aktualisht MM kishte të kontraktuar menaxher projekti dhe financier projekti, duke mos argumentuar nevojën për ndryshim.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se MM nuk kishte të dokumentuar përlllogaritjen e përcaktimit të vlerës së shërbimit, po vetëm shprehet se nga fondi i mbetur në dispozicion për ofrimin e këtyre shërbimeve nga projekti është vlera 73,000 euro dhe 41,000 euro. Pra konstatohet se nuk është realizuar studimi i tregut, bazuar në kostot e këtyre shërbimeve, termave të referencës që duhet të mbulojnë për realizimin e shërbimit por janë marrë vlerat e mbetura nga projekti për këto shërbime.</p>
<b>Kriteri:</b>	<p>Vendimin nr. 11, datë 29.01.2016, neni 15 “Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave private” pika 2: Ligji nr. 37/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)”.</p>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Përzgjedhja e kandidateve ne kushtet e konfliktit të interesit.
<b>Shkaku:</b>	Mangësi në shqyrtimin e dokumentacionit nga anëtarët Komisionit të Vlerësimit.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin dhe analizimin e përzgjedhjes së ekspertëve të projektit, si dhe mënyrën se si është përlllogaritur fondi limit për ekspertët e kontraktuara nga Ministria me kontratë <b><i>pune individuale (staff cost)</i></b>.</p> <p>- Grupi i punës të verifikojë nëse personi i kontraktuar në kushtet e konfliktit të interesit ka të dokumentuar ndonjë deklaratë që ndodhet në këto kushte dhe më pas të merren hapat e mëtejshëm për raportimin e rasteve pranë organeve kompetente.</p>

MM ka bërë pagesat mujore sipas kontratës së lidhur me znj. R. D., znj. L. Dh. dhe znj. F. H., sipas ***Aneksi nr. 3/I: “Pagesat mujore ndaj ekspertëve të projektit”*** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### **Procedura e Kontraktimit të menaxherëve:**

**Pozicioni vakant Menaxher Projekti** për zbatimin Projektit Tematik "TO BE READY" The flood and Big fire forest, prediction, forecast and emergency management - 355", bashkëfinancim nga BE nën IPA, Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi 2014/2020", është shpallur në websitin e Ministrisë së Mbrojtjes, me shkresën 07.02.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të MM, dhe afati i dorëzimit të dokumentacionit ishte data 21 shkurt 2022, ku aktualisht MM kishte kontraktuar menaxher projekti të cituar sa më sipër, ku në observimet e dërguar është konfirmuar se kontraktimi i ekspertëve të rinjë ka lindur si nevojë e mosrealizimit të projektit nga ekspertët e mëparshme, ku e konfirmuar dhe nga grupi i auditimit gjatë punës në terren bazuar në dokumentacionet e dorëzuara.

Me shkresën me nr. 959/1 prot, datë 17.03.2022, ka dalë urdhri me nr. 325, datë 17.03.2022 "Për ngritjen e Komisionit të vlerësimit të ofertave të paraqitura për prokurimet me objekt "Për prokurorimet e Ekspertizës së Jashtme për Shërbimet e Menaxhimit (Work Package M Management), IPA CBC Itali- Shqipëri-Mali i Zi".

### **Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezultoi se MM nuk disponon dokumentacion në lidhje me:**

- Dokumentimin i Përlllogaritjes së përcaktimit të vlerës së shërbimit, po vetëm shprehet se nga fondi i mbetur në dispozicion për ofrimin e këtyre shërbimeve nga projekti është vlerën 73,000 euro dhe 41,000 euro. Pra konstatohet se nuk është realizuar studimi i tregut, bazuar në kostot e këtyre shërbimeve, termave të referencës që duhet të mbulojnë për realizimin e shërbimit por janë marrë vlerat e mbetura nga projekti për këto shërbime.

Nga termat e referencës së vënë në lidhje me Financierën e projektit, rezultoi se fituesja I. M., bazuar në CV e dorëzuar nuk ka profilin dhe eksperiencën për të qenë në rolin e financieres së projektit, e cila duhet të bëjë raportimet financiare duke bërë raporte për buxhetimin e aktivitetit, raporte financiare, pasqyrat financiare, rishpërndarjen e buxhetit sipas/nëse kërkohet nga AK raportet e FCL dhe në fund raportin financiar të projektit.

**Gjithashtu kontrata e lidhur mes palëve nuk është e protokullar dhe ska datë të lidhjes të saj.** Ku në kontratën e lidhur në kushtet special në **artikullin 19** "Zbatimi i detyrave dhe vonesat" Pika 1 përcaktohet se "Data e fillimit të zbatimit do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga pala e fundit. Data mund të ricaktohet për arsye objektive", pra kjo datë nuk është e përcaktuar. **Pika 2** "Periudha për zbatimin e detyrave do të jetë data e nënshkrimit të kontratës nga pala e fundit, deri më 30 qershor 2022 (data zyrtare e mbylljes së projektit) dhe deri në finalizimin e mbylljes së projektit. Nëse një zgjatje e periudhës së zbatimit të projektit do të jepet nga autoritetet përgjegjëse, eksperti do të vazhdojë të përmbushë detyrat në përputhje me afatin e ri kohor".

**Artikullin 27** "Aprovimi i raporteve dhe dokumenteve":

Pika 5 "Miratimi i raporteve dhe dokumenteve Autoriteti kontraktor, brenda 45 ditëve nga marrja, do të njoftojë kontraktuesin për vendimin e tij në lidhje me dokumentet ose raportet e marra prej tij, duke dhënë arsyet nëse ai refuzon raportet ose dokumentet, ose kërkon ndryshime. Nëse autoriteti kontraktor nuk jep asnjë koment për dokumentet ose raportet brenda afatit kohor, kontraktuesi mund të kërkojë pranimin me shkrim të tyre. Dokumentet ose raportet do të konsiderohen të miratuara nga autoriteti kontraktor nëse ai nuk e informon shprehimisht kontraktuesin për ndonjë koment brenda 45 ditëve nga marrja e raportit. Pas miratimit të produktit përfundimtar nga Autoriteti Kontaktues, pagesa e mbetur (përfundimtare) do të ekzekutohet".

**Sa më sipër nga grupi i auditimit** bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion rezultoi se:

Financierja e projektit **I. M.**, bazuar në kontratën e lidhur ka pasur si detyrë të bëjë raportimet financiare, raporte për buxhetimin e aktivitetit, raporte financiare, pasqyrat financiare,

rishpërndarjen e buxhetit sipas/nëse kërkohet nga AK raportet e FCL dhe në fund raportin financiar të projektit, ku grupit nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për realizimin e shërbimit sipas kushteve kontraktuale.

Me memon nr. 2911/1, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP -M “Managment”, ku në kërkesë është propozuar hapja e procedurës për shërbimi Auditimi, *me qëllim të sigurojë verifikimet e shpenzimeve të projektit TO BE READY në lidhje me arritjet e afateve, të gjitha dokumentet e kërkuara për procedurat e kryera që nga fillimi i projektit dhe në vazhdim, si dhe të mbulojë verifikimin e shpenzimeve të bëra në kuadër të projektit të financiar.* kontratat ndërmjet operatorit (kontraktorit) të përzgjedhur dhe Autoritetit Kontraktor (Ministrisë së Mbrojtjes).

Sa më sipër rezulton se financierja e projektit të kontraktuar nuk ka realizuar detyrat e saj funksionale.

### **Procesi i likuidimit:**

- Nga MM me urdhrin e shpenzimit me nr. 268, datë 12.05.2022 është bërë likuidimi i znj. V. K. në vlerën 2,866,180 lekë, ku është mbajte tatim burim 505,796 lekë dhe znj. I. M. në vlerën 1,619,658 lekë, ku është mbajttë tatim burim 285,822 lekë bazuar në një urdhër të SP, z. A. K. me nr. 709, prot., 2486/2, datë 12.05.2022, i cili urdhëron shlyerjen e detyrimeve kontraktuale ndaj znj. V. K., si menaxhere e projektit dhe znj. I. M. për shërbimet financiere të projektit.

- Me urdhrin e shpenzimit me nr. 376, datë 16.06.2022 është bërë likuidimi i znj. V. K. në vlerën 2,849,068.08 lekë ku është mbajte tatim burim 502,777 lekë dhe znj. I. M. në vlerën 1,609,988.4 lekë, ku është mbajttë tatim burim 284,116 lekë bazuar në një urdhër të SP z. A. K. me nr. 927, prot., 3114/1, datë 16.06.2022, i cili urdhëron shlyerjen e detyrimeve kontaktuale ndaj znj. V. K., si menaxhere e projektit dhe znj. I. M. për shërbimet financiere të projektit.

- Me urdhrin e shpenzimit me nr. 23, datë 23.01.2023 është bërë likuidimi i znj. V. K. në vlerën 1,379,735 lekë, ku është mbajte tatim burim 243,483 lekë dhe znj. I. M. në vlerën 779,679 lekë, ku është mbajte tatim burim 137,590 lekë bazuar në një urdhër të SP z. A. K. me nr. 63, prot., 104/1, datë 20.01.2022, i cili urdhëron shlyerjen e detyrimeve kontaktuale ndaj znj. V. K., si menaxhere e projektit dhe znj. I. M. për shërbimet financiere të projektit.

Në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me projektin, ku të vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit, si dhe urdhër-shpenzimet e pagesës së kontraktuesve të shërbimit u konstatua mungesa e raporteve të realizimit të projektit dhe të shërbimit të realizuar nga kontraktuesja bazuar në kontratat e lidhura dhe *angazhimet specifike që duhet të realizojë financieri i projektit, pasi shuma është paguar 100% nga buxheti i shtetit nga llogaria 602.*

Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimit”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.”

Likuidimi i detyrimeve ndaj menaxheres së projektit dhe financieres së projektit është bërë vlera e plotë nga **fondet buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes.**

Ministria e Mbrojtjes në kuadër “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet këshillit të ministrave të republikës së Shqipërisë dhe komisionit europian për programin interreg ipa të bashkëpunimit ndërkufitar Itali–Shqipëri–Mali i Zi, 2014–2020” projektit "TO BE READY" kishte si detyrim të paguante vetëm 15% nga buxheti i shtetit dhe 85% nga fondet e projektit. MM duhet të paguante për vitin 2022 vetëm shumën 1,578,511 lekë dhe për vitin 2023 shumën prej 383,073 lekë.

Shuma prej 8,944,894 lekë e paguar në vitin 2022 dhe shuma prej 2,159,414 lekë e paguar për vitin 2023 janë veprime në kundërshtim me ligjin e buxhetit dhe me marrëveshjen, e cila është vlera 85%, që duhet të ishte paguar nga fondet e bashkëfinancimit dhe jo nga llogaria 602 “Të tjera material dhe shërbime special”, të cilat janë marrë nga buxheti i planifikimit të shpenzimeve korrente.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Shërbimi i realizuar nga ekspertet e projektit “To be ready”, si dhe pagesa e realizuar kundrejt tyre nga MM.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi rezultoi se për "Menaxher Projekti", "Financier Projektit" dhe "Menaxher Komunikimit" për periudhën 2021-2022 janë paguar çdo muaj bazuar në një kartele “Fletë kohore për stafin e personelit që punon me një numër fleksibël orësh në muaj ose në bazë mujore”.</p> <p>Në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me projektin, <b>ku të vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit, si dhe urdhër-shpenzimet e pagesës së kontraktuesve të shërbimit u konstatua:</b></p> <p>Mungesa e raporteve të realizimit të projektit dhe të shërbimit të realizuar nga kontraktuesit sipas përcaktimeve të nenit 3, të kontratës, ku janë të përcaktuara dhe <i>angazhimet specifike që duhet të realizojë menaxheri i projektit, financieri i projektit dhe menaxheri i komunikimit të projektit</i>, siç janë raportimet dhe informimet periodike sipas specifikimeve kontraktuale të projektit, raporte mbi realizimin e aktiviteteve që lidhen me vizibilitetin e projektit, si dhe përgatitja dhe përditësimi i dosjeve fizike dhe digjitale "TO BE READY".</p> <p>- Financierja e projektit I. M. është paguar vetëm bazuar në kontratën e lidhur me MM, dhe nuk ka të bashkëlidhur dhe të dokumentuar asnjë raport mbi realizimin e shërbimit të përcaktuar në kontratën saç janë raportimet financiare, raporte për buxhetimin e aktivitetit, raporte financiare, pasqyrat financiare, rishpërndarjen e buxhetit sipas/nëse kërkohet nga AK raportet e FCL dhe në fund raportin financiar të projektit.</p> <p>Nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K., me memon nr. 2911/1, datë 06.06.2022 kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP -M “Managment”, ku është propozuar hapja e procedurës për shërbimi Auditimi, <i>me qëllim të sigurojë verifikimet e shpenzimeve të projektit “TO BE READY” në lidhje me arritjet e afateve, të gjitha dokumentet e kërkuara për procedurat e kryera që nga fillimi i projektit dhe në vazhdim, si dhe të mbulojë verifikimin e shpenzimeve të bëra në kuadër të projektit të financuar.</i></p> <p>Sa më sipër rezulton se financieret e projektit të kontraktuar nuk kanë realizuar detyrat e tyre funksionale, duke sjellë mbivendosje shërbimesh pasi WP -M “Managment, do verifikoje të gjithë shpenzimet nga fillimi i projektit deri në përfundim të tij, ku për këtë shërbim janë paguar dy financierë projekti.</p>

	<p>Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nenin 4, pika 26 të ku citohet se “Dokument financiar është çdo informacion origjinal, plotësues, si dhe të dhënat kontabël të regjistruara në çdo lloj forme, të krijuara, të marra apo të mbajtura nga njësitë publike. Dokumenti financiar duhet të përshkruajë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, që ka për objekt të përmbajë të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore e ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin, e të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative”, nenin 2, pika 16 “Gjurma e auditimi”, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre...”, si dhe pikën 35, germa b “Dokumente vërtetues”, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.”</p> <p>2. Nga MM janë realizuar pagesa ndaj menaxherit të projektit znj. R. D. edhe për periudhën e 6- mujorit të parë të vitit 2020, periudhë pandemie Covid -19, vlerë e cila është e pajustificuar, bazuar dhe në detyrat të përcaktuara në nenin 3 të kontratës. Gjithashtu nga analiza e raportimeve në FLC kjo periudhë nuk është raportuar për tu rimbursuar.</p> <p>Nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15% rezulton se pagesa prej 1,006,442 lekë nuk është kërkuar për rimbursim, si rrjedhojë kjo vlerë e paguar <b><i>përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara padrejtësisht dhe të paguar 100% nga buxheti i shtetit.</i></b></p> <p>- <b>Gjithashtu</b> nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM, pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15%, për financieren L. Dh. rezulton se në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në shumën 830,275 lekë, ku pasi i hiqet tatimi në burim vlera është në shumën prej 705,734 lekë. <b><i>Nga MM është paguar vlera prej 941,861 lekë me një diferencë më shumë në vlerën 236,127 lekë, pas zbritjes së tatimit në burim.</i></b></p> <p>- Ndërsa për F. H., si menaxhere komunikimi nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15%, rezulton se në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në shumën 989,887 lekë, ku pasi i hiqet tatimi në burim vlera është në shumën prej 841,404 lekë. Nga MM është paguar vlera prej 941,861 lekë me një diferencë më shumë në vlerën 100,457 lekë, pas zbritjes së tatimit në burim.</p> <p><b><i>Si rrjedhojë vlera e paguar në shumën prej 100,457 lekë përbën Dëm ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara padrejtësisht.</i></b></p>
<b>Kriteri:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 4, pika 26.</li> <li>- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik.”.</li> <li>- Kontratat e lidhur me ekspertët.</li> </ul>
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Përftime të padrejta nga ekspertët, duke shkaktuar dëme ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara

	padrejtësisht.
<b>Shkaku:</b>	Pagesa të pa mbështetur në dokumentacioni, raporte dhe analiza mbi shërbimin e realizuar.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune, që të vlerësojnë e të analizojnë vlerën e shërbimit të likuiduar në vlerën <b>9,509 mijë lekë</b> , e cila rezulton e paguar në kushte e mungesës së raporteve të realizimit të projektit dhe të shërbimit të realizuar nga kontraktuesit sipas përcaktimeve të kontratës së lidhur, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga përfituesit.

### **Realizimi i procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të udhëzimit të ePRAG BE;**

#### **1. Procedurën “T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit “TO Be ready”**

Me memon nr. 2018, datë 19.04.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP-T1-T.1.6.1 dhe T.1.6.2 studimi dhe krijimi i fjalorit të shtypur dhe elektronik për rrezikun ndaj zjarreve dhe përmbetjeve.

2. WP T2- sipas aktiviteteve T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit TO Be ready” studimi dhe krijimi i hartës teknike me informacion mbi menaxhimin e rasteve të zjarreve dhe vështirësive të fluturimit mbi këto zona.

Me urdhërin nr. 525 datë 20.04.2022 te SP A. K. ‘Nisja e procedurave të tenderimit për prokurimin e aktiviteteve sipas paketës së punës WP T2- sipas aktiviteteve T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit TO Be ready”

Me urdhërin nr. 539, datë 22.04.2022 te SP A. K. ‘Nisja e procedurave të tenderimit për prokurimin e aktiviteteve sipas paketës së punës WP T2- sipas **aktiviteteve T.2.3.1 “External Expertise and sevice”** në kuadër të projektit TO Be ready” urdhëron znj. A. Z., përgjegjës Sektori të hartografisë në IGJIU dhe znj. J. M. specialiste në sektorin GIS për përgatitjen e termave të referencës për prokurimin e studimit dhe krijimin e hartës teknike me informacion mbi menaxhimin e rasteve të zjarrit dhe vështirësive të fluturimit mbi këto zona të parashikuar në Work Package WP-T2- T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit TO Be ready”.

Me datën 04.06.2022 është bërë njoftimi në faqen e MM për shprehje interesi për pjesëmarrje në tender për studimin dhe krijimin e hartës teknike me informacion mbi menaxhimin e rasteve të zjarreve dhe vështirësive të fluturimit mbi këto zona.

Me urdhrin nr. 857, prot., 2018/3, datë 03.06.2022 nga SP A. K. ka “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje N. L., K. N., F. Xh., R. X. dhe D. M..

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 2018/5, datë 08.06.2022 informon SP se me datën 06.06.2022 në mjediset e MM është bërë mbledhja e komitetit të vlerësimit për përzgjedhjen e aplikantit fitues për shërbimin e WP T2- sipas aktiviteteve T.2.3.1.

***Nga komisioni i vlerësimit thuhet se është bërë vlerësimi për hartimin dhe përkthimin e fjalorit multilingual, e cila ska lidhje me procedurën që po vlerësohet, dhe jo për procedurën objekt prokurimi.***

Më poshtë shprehen se kanë shpreh interesin 3 Aplikantë, ku pas vlerësimit administrativ, teknik dhe financiar të paraqitur nga secili aplikantë rezultoi se oferta më e ulët financiare ishte paraqitur nga G.-P. në vlerën 34,870 euro. Në përputhje me termat e referencës dhe kriteret e vendosura, përzgjedhja u realizua në bazë të ofertës financiare të paraqitur të kombinuar me vlerësimin teknik.

*Nga auditimi i dosjes së vënë në dispozicion rezulton se:*

**Nga AK është kërkuar në dokumentin “Service Contract Notice” që subjekti:**

Si përmbledhje, kriteret e mëposhtme të përzgjedhjes do të zbatohen për tenderuesit.

• *Së paku 5 vjet përvojë profesionale në fushën e çështjeve të zjarreve në pyje për rilevim dhe analiza teknike për hartimin e dokumenteve teknike/Hartës;*

• Eksperiencë e mëparshme në terren dhe përvojë pune të ngjashme

**Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të subjektit në QKB:**

- Fituesi nuk e ka objekt të veprimtarisë për studimin dhe hartimin e hartave teknike me informacion mbi menaxhimin e rasteve të zjarrit dhe vështirësive të fluturimit mbi këto zona të parashikuara

- Fituesi për periudhën 2019-2020 nga pasqyrat financiare të shkarkuar në QKB rezulton se subjekti është me humbje.

Gjithashtu referuar ligjit nr. 8907, datë 06.06.2002 “Për Funkcionimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë” neni 7 përcakton se:

***Detyrat në fushën e hartografisë***

Në fushën hartografike IGJUSH-i përgjigjet për:

a) studimin, grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave hapësinore për krijimin dhe botimin e hartave topografike në hapësirën tokësore, ajrore dhe detare të Republikës së Shqipërisë në shkallët 1: 10 000 - 1: 1 000 000 dhe i prodhon, përtërin e shpërndan në të gjithë strukturën e Forcave të Armatosura, në ndihmë të institucioneve studimore e projektuese shtetërore të administratës civile, biznesit dhe sistemit të edukimit;

b) krijimin e bazës së të dhënave të domosdoshme për hartimin numerik (dixhital) dhe konvencional të prodhimeve hartografike;

c) studimin, përzgjedhjen dhe kryerjen e fotografimeve ajrore, si dhe grumbullimin, përpunimin e të dhënave të pamjeve satelitore e remote-sensing, për qëllime topografike dhe tematike;

ç) rivlerësimin dhe hartimin e planeve topografike në shkallë të mëdha të hapësirave infrastrukturore të njësisive dhe reparteve ushtarake, të pasurive të paluajtshme të ushtrisë, për studimin dhe projektimin inxhinierik të veprave ushtarake.

Nga sa më sipër rezulton se nga AK kontraktimi i një pale të tretë për realizimin e këtij shërbimi është në shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore, pasi objekti i kësaj procedure është objekt i veprimtarisë së IGJU-se për të gjithë territorin e vendit.

*Për shkeljet e konstatuara sa më sipër mbajnë përgjegjësi personat e sipërcituar në material.*

MM me urdhër pagesën nr. 620, datë 28.10.2022 në vlerën 1,472,364.89 lekë, bazuar në faturat me nr. 50, të datës 14.07.2022, me urdhër pagesën nr. 25, datë 27.01.2023 bazuar në faturat me nr. 79, të datës 19.12.2022 në vlerën 718,345 lekë dhe me urdhër pagesën nr. 62, datë 09.02.2023 bazuar në faturat me nr. 73, të datës 24.11.2022 në vlerën 2,688,288.7 lekë

***Vlera është paguar 100 % nga Buxheti i shtetit, ku duhet të ishte ndarë 85% nga rimburimet e realizuara nga projekti dhe 15 % nga buxheti i shtetit.***

## **2. Procedurën “WP-T1-T.1.6.1 dhe T.1.6.2 “Studimi dhe krijimi i fjalorit të shtypur dhe elektronik për rrezikun ndaj zjarreve dhe përmbytjeve”.**

Me memon nr. 2018, datë 19.04.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP-T1-T.1.6.1 dhe T.1.6.2 studimi dhe krijimi i fjalorit të shtypur dhe elektronik për rrezikun ndaj zjarreve dhe përmbytjeve.

Me urdhrin nr. 526,prot., 2018/1, datë 20.04.2022 te SP A. K. ‘Nisja e procedurave të tenderimit për prokurimin e studimit dhe krijimit të fjalorit sipas aktiviteteve WP-T1-T.1.6.1 dhe T.1.6.2

Me memon nr. 2113, datë 21.01.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon nevojën e hartimit të termave të referencës.

Me urdhrin nr.538, prot., 2113/1 datë 22.04.2022 te SP A. K. “Për hartimin e termave të referencës për prokurimin e studimit dhe krijimit të fjalorit sipas aktivitetit WP-T1-T.1.6.1 dhe T.1.6.2, urdhëron Znj A. K., Përgjegjëse e sektorit të Mbështetjes dhe z. L. H., specialistë në sektorin e Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun në AKMC, për përgatitjen e termave te referencës

Me urdhërin nr. 858, prot., 2018/3, datë 03.06.2022 nga SP A. K. ka “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje N. L., K. N., F. Xh., R. X. dhe D. M..

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 2018/4, datë 08.06.2022 informon SP se me datën 07.06.2022 në mjediset e MM është bërë mbledhja e komitetit të vlerësimit për përzgjedhjen e aplikantit fitues për shërbimin e studimi dhe krijimi i fjalorit të shtypur dhe elektronik për rrezikun ndaj zjarreve dhe përmytjeve.

Nga Komiteti i vlerësimit thuhet se vetëm një aplikant nga thirrja e hapur ka dorëzuar në MM zarfin me dokumentacionin dhe ofertën financiare.

Në përputhje me termat e referencës dhe kriteret e vendosura, përzgjedhja u realizua në bazë të ofertës financiare të paraqitur të kombinuar me vlerësimin teknik, ku nga komiteti është shpallur fituesi “L.S.” SHPK me vlerën 9,850 euro.

Nga Komiteti i vlerësimit është mbajtur raporti i vlerësimit të ofertës me datë 07.06.2022 ku është vlerësuar në total 93.28 pike OE/ L.S. SHPK.

#### **Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të subjektit në QKB:**

- Fituesi nuk e ka objekt të veprimtarisë studim, si dhe krijimin e materialeve për fjalorë.

Subjekti bën editimin korrektimin përkthimin dhe faqosjen e materialeve.

Komiteti i vlerësimit i ka dhënë vlerësim me 91.6 pikë për vlerësimin teknik ndaj subjektit pa argumentuar me dokumentacione vërtetuese bashkëlidhur.

Nga dosja e vënë në dispozicion nga menaxherja e projektit znj. V.K., OE shpallur fitues ka dorëzuar vetëm “deklarata e ekskluzivitetit dhe disponueshmërisë” së stafit, formularë të tenderit të shërbimit.

Në dosje nuk ka asnjë dokument që vërteton Kriteret për personat juridikë:

1- Te ketë certifikate profesionale te përshtatshme me ketë kontrate, si përkthyes te certifikuar

2 - ka burime dhe ekspertizë të mjaftueshme të vazhdueshme (të paktën 1 përkthyes për gjuhë) për të qenë në gjendje të trajtojë kontratën e propozuar.

***Pra në dosje mungojnë kontrata e pune ose kontratë shërbimi mes OE dhe përkthyesve.***

Në dosje nuk ka bashkëlidhur dokumentacioni vërtetues për plotësimin e kriterit

“Ofertuesi ka ofruar shërbime përkthimi në gjuhët përkatëse (**anglisht, shqip, italisht, malazez**) dhe **korporatën e terminologjisë** të paktën 5 vjet përpara afatit të dorëzimit”.

Sa më sipër OE fitues nuk vërteton me dokumentacione justifikues se ka pune të ngjashme si dhe ka eksperiencë në krijimin dhe përkthimin e materialeve të cilat kanë pasur **terminologjinë e procedurës objekt prokurimi. Sa më sipër OE nuk duhet të ishte kualifikuar dhe shpallur fitues.**

Mes OE dhe AK MM është lidhur kontrata me datën 14.06.2022 nga ku 7,800 euro janë për hartimin dhe përkthimin e fjalorit në Anglisht, Shqip, Italisht dhe Malazeze.

Ndërsa vlera prej 1,970 euro është për printimin e 200 kopjeve.

Nga AKMC është mbajtur procesverbali nr. 1, datë 07.10.2022 me nr. prot., 1602/5, ku citon se nga OE është bërë dorëzimi i një cope fjalor shumëgjuhësh në 4 gjuhë.

Komisioni citon se termat e referencës së produktit të dorëzuar janë në përputhje me termat e referencës se procedurës së realizuar nga MM sipas PRAG (rregullat e BE).



Nga AKMC është mbajtur procesverbali nr. 2, datë 10.10.2021, me nr. prot., 1602/8 për marrjen në dorëzim të 200 kopjeve të fjalorit multilanguage, sipas kushteve të kontratës së lidhur mes MM dhe OE.

Në procesverbal citohet se administrimi i 200 kopjeve do të bëhet nga Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë dhe të Parandalimit në AKMC.

Nga MM është bërë likuidimi i PE me urdhër shpenzimin nr. 621 datë 28.10.2022 në vlerën 1,363,735.68 lekë ose në vlerën 11,820 euro me TVSH.

*Në njoftimin e kontratës dhe kushtet e veçanta të kontratës neni 19 është përcaktuar se OE fitues duhet të realizojë shërbimin brenda dy javëve nga data e lidhjes së kontratës. Lidhja e kontratës është bërë me datën 14.06.2022 dhe shërbimi sipas kontratës duhet të ishte realizuar brenda datës 30.06.2022.*

*Sa më sipër realizimi i shërbimit është bërë tre muaj me vonesë, duke mosrespektuar afatet e kontratës nga palët.*

MM me urdhër pagesën nr. 621, datë 28.10.2022 ka likuiduar OE, bazuar në faturat me nr. 340 dhe 337 të datës 07.10.2022.

*Vlera është paguar 100 % nga Buxheti i shtetit, ku sipas projektit vlera 9,850 euro pa TVSH, duhet të ishte ndarë 85% nga rimbursimet e realizuara nga projekti dhe 15 % nga buxheti i shtetit.*

### **3. Procedurën “WP -T.1.4.1 “Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve”.**

Me memon nr. 2911, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP -T.1.4.1 “Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve”.

Në memo sqarohet se buxheti do të mbulohet nga projekti “To be ready”, ku është dhënë dhe miratimi nga partneret Lider mbi kërkesën e MM për realizimin e kësaj blerje.

Me urdhër nr. 866 prot., 2981/2 datë 06.06.2022 të SP z. A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen **Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve**” në kuadër të projektit tematik “**To be ready**”, ku zhvillimi i procedurës do realizohet sipas përcaktimeve të udhëzuesit –Prag BE.

Me memon nr.2918, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon nevojën e hartimit të termave të referencës/specifikimet teknike të pajisjeve.

Me urdhërin nr. 866/1, prot., 2918/2 datë 06.06.2022 te SP A. K. “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike “**Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve**” ngarkon grupin e punës Gj. H.; E. C. dhe N. H..

Me urdhërin nr. 866/2, prot., 2918/2 datë 06.06.2022 i ndryshuar me urdhrin nr. 201, datë 08.09.2022 nga SP A. K. ka “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje O. D., F. Xh., E. F., B. M. dhe A. K..

Publikimi i tenderit në një gazetë kombëtare është bërë me datën 01.07.2022 (Panoram Jurnal). Afati i fundit për dorëzimin e ofertave datë 30.07.2022. Hapja e tenderit me datën 09.09.2022. Në hapjen e tenderit nga Komiteti i vlerësimit janë shprehur se kanë marrë pjesë dy operatorë ku ofertën financiare të A.M. ShPK nuk është hapur pasi sipas Komitetit të vlerësimit nuk plotëson kushtet teknike, të përcaktuar në “SERVICE CONTRACT NOTICE” siç janë pasqyrat e pa dorëzuara të vitit 2021, numri i punonjësve prej 50, si dhe nuk plotëson kriteret e pajisjeve të prokuruar.

Nga Komiteti i Vlerësimit është shpallur fitues “M.M.” me ofertën 238,050 euro nga 240,000 euro fondi i përcaktuar.

Mes OE/M.M.dhe AKMC është lidhur kontrata me datën 22.09.2022.

Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 254,014 euro e konvertuar në lekë në vlerën 27,687,596 lekë pa TVSh. ***Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC.***

Nga AKMC është paguar nga llogaria “Credins” për “To Be Ready” shuma prej 23,534,454 lekë, me përshkrimin likuidim i faturës 126/2023; 127/2023 dhe 128/2023, date 06.01.2023.

#### **4. Procedurën “WP -T.1.4.2 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” dhe WP -T.1.7.1 “Blerje e pajisjeve për dhomën e monitorimit”.**

Me memon nr. 2811, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në “WP -T.1.4.2 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” dhe WP -T.1.7.1 “*Blerje e pajisjeve për dhomën e monitorimit*”, ku në kërkesë është propozuar ndarja e tyre në dy lote.

Në kërkesë sqarohet se buxheti do të mbulohet nga projekti “To be ready”, ku është dhënë dhe miratimi nga partneret Lider mbi kërkesën e MM për realizimin e kësaj blerje.

Me urdhër nr. 865 prot., 2911/3 datë 06.06.2022 të SP z, A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen **“Blerje pajisje për video sensor kamera dhe pajisjen për dhomën e monitorimit” sipas formës së aplikimit WP -T.1.4.2 dhe ËP -T.1.7.1 në kuadër të projektit tematik “TO BE READY”.**

Me memon nr.2911/4, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon nevojën e hartimit të termave të referencës/specifikimet teknike të pajisjeve.

Me urdhrin nr. 865/1, prot., 2911/5 datë 06.06.2022 nga SP A. K. ka ngritur komisionin “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike “Blerje pajisje për video sensor kamera dhe pajisjen për dhomën e monitorimit”, ku ngarkon grupin e punës R. X. specialiste e Infrastrukturës dhe Administrator Rrjeti; A. R., specialist i sektorit GIS, IT dhe publikimit në Drejtorinë e Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit.

Grupi i punës me shkresën nr. 2911/6, datë 18.06.2022 ka dërguar një memo për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike. *Bashkëlidhur është aneksi i termave të referencës, e cila është firmosur dhe bërë deklaratë për objektivitetin dhe konfidencialitetin vetëm nga znj R. X., z. A. R. nuk ka firmosur dhe ska as deklaratë pavarësisht që sipas urdhrin është pjesë e grupit të hartimit të referencave.*

Me urdhrin nr. 865/2, prot., 2911/2 datë 06.06.2022 nga SP A. K. ka “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje O. D., D. M., H. D., L. Q. dhe A. C..

Mes OE/A.C. dhe AKMC është lidhur kontrata me datën 15.09.2022 prot., 1507/1, për të dy lotët, ku lot 1 është në vlerën 245,500 euro dhe lot 2 në vlerën 19,100 euro pa TVSH në total 264,600 Euro pa TVSH.

Nga Grupi i marrjes në dorëzim i ngritur me urdhrin e Titullarit të AKMC me nr. 31, datë 14.02.2023 është mbajtur procesverbali i marrjes në dorëzim me nr. 314/2, datë 08.03.2023, ku citon verifikimin e mallrave në ambientet e OE, të cilat janë në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në tender. Grupi citon se faza e dytë është vijimi i instalimit të këtyre pajisjeve në bashkinë Vlorë si përfitues i projektit, të cilat janë instaluar me datën 15-16 shkurt të 2023.

Mallrat e sistemit janë bërë hyrje në AKMC me fletë hyrjen me nr. 2, datë 08.03.2023 për vlerën 36,711,662.4 lekë.

Nga informacioni i dërguar në FLC u konstatua se në “*procedura e plotë për dhomën e monitorimit dhe video sensor kamera*” Inv No; 251/229, datë 02.08.2023 në vlerën 42,100.52 euro pa TVSh e konvertuar në 4,588,957 lekë pa TVSh. Në FLC është hedhur vlera “Vat” 6,118,610 lekë, vlerë e cila paguhet nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë e reflektuar në FLC është gabim pasi shuma e TVSH duhet të ishte në vlerën 917,791 lekë.

*Sa më sipër* vlera e reflektuar më shumë në shumën prej 5,200,819 lekë është e pajustificuar dhe argumentuar duke rritur fondin që duhet të paguajë buxheti i shtetit me efekt negative në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore.

Nga AKMC është likuiduar OE me urdhër shpenzimin me nr. 411, datë 12.12.2023 në vlerën prej 10,000,000 lekë, urdhër shpenzimin me datë 25.07.2023 në vlerën 4,588,957 lekë dhe nga

llogaria Credins “to be ready” me datë 14.11.2023 në vlerën 16,004,095 lekë, bazuar në faturën me nr. 25, datë 17.02.2023, me vlerë totale 30,593,052 lekë.

*Sipas bashkëfinancimit AK duhet të kishte paguar 85% nga llogaria Credins pra vlerën 21,670,079 lekë dhe 3,824,132 lekë plus TVSH nga llogaria 231 “Investime” nga Buxheti i AKMC.*

*Nga dokumentacioni i dërguar në FLC, nuk është regjistruar vlerën e plotë e kontratës prej 264,600 Euro pa TVSH, por vetëm vlera prej 42,100.52 euro pa TVSh.*

*Diferenca 222,499.48 euro nuk është deklaruar në FLC për tu rimbursuar nga projekti, si rrjedhojë e gjithë vlera do jetë detyrim i buxhetit të shtetit.*

## **5. Procedurën “WP -T.1.4.2 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” dhe WP -T.1.4.1 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile”.**

Me memon nr. 2074, datë 20.04.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në “WP -T.1.4.2 dhe WP -T.1.4.1, ku në kërkesë është propozuar të bëhet në dy procedura prokurimi sipas edhe specifikimeve të tyre.

*Në kërkesë citohet se kërkesa për rialokimin e buxhetit **drejtuar Partnerit Lider të projektit nuk përfshin zbatimin e këtyre aktiviteteve, ndaj procedura e prokurimit për këto aktivitete mund të vazhdojë sipas parashikimeve në Formën e Aplikimit.***

Me urdhër nr. 533 prot., 2074/1 datë 21.04.2022 të SP z, A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen **“Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” sipas formës së aplikimit WP -T.1.4.1** në kuadër të projektit tematik “TO BE READY”.

Me urdhër nr. 534 prot., 2074/1 datë 21.04.2022 të SP z, A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen **“Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” sipas formës së aplikimit WP -T.1.4.2** në kuadër të projektit tematik “TO BE READY”.

Me memon nr.2162, datë 26.04.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon nevojën e hartimit të termave të referencës/specifikimet teknike për këtë aktivitet/prokurimi..

Me urdhrin nr. 557, prot., 2162/1, datë 27.04.2022 nga SP A. K. është ngritur komisionin “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike WP -T.1.4.1 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile”, ku ngarkon grupin e punës Gj. H., E. C. dhe N. H..

Me urdhrin nr. 558, prot., 2162/1, datë 27.04.2022 nga SP A. K. është ngritur komisionin “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike WP -T.1.4.1 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile”, ku ngarkon grupin e punës Gj. H., E. C. dhe N. H..

Grupi i punës me shkresën nr. 2162/2 dhe 2161/3, datë 13.05.2022 ka dërguar memo për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike.

Me urdhrin nr. 872, prot., 3015/1, datë 10.06.2022 nga SP A. K. është “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje K. N., N. L., A. K., S. O. dhe R. H..

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 3156, datë 16.06.2022 drejtuar SP Z, A. K. informon se pavarësisht thirrjes së hapur në gazetën panorama dhe në faqen web të MM është dorëzuar vetëm një aplikant për këtë procedurë.

Komisioni vlerësoj dokumentacionin e paraqitur nga ana e tenderuesit OE/ **A.S. ShPK** dhe u konstatua se nga ana e tij ishte dorëzuar i plotë dosja e prokurimit në përputhje me termat e referencës/specifikimet dhe kriteret e vendosura. Gjithashtu oferta financiare ishte nën buxhetin maksimal të përcaktuar për këtë procedurë.

Publikimi i tenderit në një gazetë kombëtare është bërë me datën 17.05.2022 (Panoram Jurnal), dhe afati i fundit për dorëzimin e ofertave datë 15.06.2022. Hapja e tenderit me datën 16.06.2022.

Me datën 16.06.2022 është dërguar njoftimi OE i shpallur fitues.

Mes OE/A.S. ShPK dhe MM, për **Tenderi IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/01** është lidhur kontrata me datën **16.06.2022 prot., 1507/1**, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02 “*Blerje*

*e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile”* Portabel ëater pump 2 copë në vlerën 79,000; Trush pump for Flooding terrain 2 copë në vlerën 9,600 euro, total në vlerën 88,600 euro.

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 3126, datë 16.06.2022 drejtuar SP, z. A. K. se me datën 16.06.2022 në mjediset e MM është bërë mbledhja e komitetit të vlerësimit për përzgjedhjen e aplikantit fitues për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02, ku pavarësisht thirrjes së hapur në gazetën panorama dhe në faqen web të MM është dorëzuar vetëm një aplikant për këtë procedurë.

Komisioni vlerësoj dokumentacionin e paraqitur nga ana e tenderuesit OE/ A.S. ShPK, dhe u konstatua se nga ana e tij ishte dorëzuar i plotë dosja e prokurimit në përputhje me termat e referencës/specifikimet dhe kriteret e vendosura. Gjithashtu oferta financiare ishte nën buxhetin maksimal të përcaktuar për këtë procedurë.

**Me datën 16.06.2022 është dërguar njoftimi OE i shpallur fitues.**

Mes OE/A.S. ShPK dhe MM, për **Tenderi IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02** është lidhur kontrata me datën **16.06.2022**, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” *Plastic motor boat; Inflatable Boats Drysuits në vlerën 75,350 euro.*

Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 81,025 euro e konvertuar në lekë në vlerën 8,831,773.5 lekë pa TVSh. ***Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC, pasi vlera e kontraktuar është në shumën 75,350 euro.*** Nga AKMC është lidhur me OE/A.S. “Portabel water pump 2 copë në vlerën 79,000; Trush pump for Flooding terrain 2 copë në vlerën 9,600 euro”, total në vlerën **88,600 euro.**

Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 89,277.9 euro e konvertuar në lekë në vlerën 10,384,806 lekë pa TVSh. ***Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC, pasi vlera e kontraktuar është në shumën 88,600 euro.*** MM me urdhër pagesën nr. 628, datë 24.10.2022 ka likuiduar OE, bazuar në faturat me nr. 50 dhe datës 07.10.2022 në vlerën 12,461,767.2 lekë dhe me urdhër pagesën nr. 24, datë 27.01.2022 bazuar në faturat me nr. 49 dhe datës 07.10.2022 në vlerën 10,598,128 lekë.

***Vlera është paguar 100 % nga Buxheti i shtetit, ku sipas projektit duhet të ishte ndarë 85% nga rimbursimet e realizuara nga projekti dhe 15 % nga buxheti i shtetit.***

## **6. Procedurën “WP -M “Managment”.**

Me memon nr. 2911/1, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në WP -M “Managment”, ku në kërkesë është propozuar hapja e procedurës për shërbimi Auditimi, *me qëllim të sigurojë verifikimet e shpenzimeve të projektit TO BE READY në lidhje me arritjet e afateve, të gjitha dokumentet e kërkuara për procedurat e kryera që nga fillimi i projektit dhe në vazhdim, si dhe të mbulojë verifikimin e shpenzimeve të bëra në kuadër të projektit të financiar. kontratat ndërmjet operatorit (kontraktorit) të përzgjedhur dhe Autoritetit Kontraktor (Ministrisë së Mbrojtjes).*

Me urdhër nr. 864 prot., 2911/3, datë 06.06.2022 të SP z, A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen “Shërbime Auditimi”.

Me kërkesën nr. 2918/3, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon nevojën e hartimit të termave të referencës/specifikimet teknike për këtë aktivitet/prokurimi.

Me urdhrin nr. 864/1, prot., 2918/4, datë 06.06.2022 nga SP A. K. është ngritur komisionin “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike”, ku ngarkon grupin e punës R. R. dhe K. B..

Grupi i punës me shkresën nr. 3058, datë 18.06.2022 ka dërguar memo për miratimin e termave të referencës dhe specifikimeve teknike të përgatitura nga grupi i punës.

Me urdhrin nr. 864/2, prot., 2918/4, datë 06.06.2022 nga SP A. K. është “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” i ndryshuar me urdhërin nr. 200, prot., 1391/4, datë 08.09.2022 në përbërje N. L., D. M., E. S., K. N. dhe M. M..

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 1392/6, datë 12.09.2022 drejtuar SP Z, A. K., informon se me datën 09.09.2022 në mjediset e MM është bërë mbledhja e komitetit të vlerësimit për përzgjedhjen e aplikantit fitues për prokurimin e shërbimit të auditimit, ku është dorëzuar vetëm një aplikant për këtë procedurë.

Komisioni vlerësoj dokumentacionin e paraqitur nga ana e tenderuesit OE/ K. A. ShPK.

Me vlerë 59,850 euro pa TVSH dhe u konstatua se nga ana e tij ishte dorëzuar i plotë dosja e prokurimit në përputhje me termat e referencës/specifikimet dhe kriteret e vendosura. Gjithashtu oferta financiare ishte nën buxhetin maksimal të përcaktuar për këtë procedurë.

**Me datën 15.09.2022 është dërguar njoftimi OE i shpallur fitues.**

Mes OE/ K. A. ShPK dhe AKMC, është lidhur kontrata me nr. 1507/2, datën **15.09.2022**, për “Blerje Shërbime Auditimi”.

Periodha e zbatimit të kontratës është përcaktuar nga nënshkrimi i kontratës deri në mbylljen e projektit.

*Në raportin e dërguar nga FLC “Expenditure verification / Audit IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SRV06” first payment and second payment, në FLC në komente është vënë “Missing Documents. To be verified next reporting period”, dhe nuk është raportuar “Amount Certified Flc”. Shuma e deklaruar në Euro është në shumën 63,909 euro, ndërsa kontrata e lidhur është në shumën 59,850 euro pa TVSH.*

Nga AKMC me urdhër shpenzimin nr. 247, datë 05.12.2022 është likuiduar OE në vlerën 5,034,007 lekë bazuar në faturën nr. 219, datë 01.12.2022, bazuar në procesverbalin e marrjes në dorëzim me nr. 1507/19, datë 21.11.2022 nga grupi i punës së vlerësimit për fazën e parë, e cila përmban një raport auditimi dhe desk revieë e kryer nga OE sipas kontratës i përmbledhur në një Excel.

## **7. Procedurën “Work Package Communication”.**

Me memon nr. 2917, datë 06.06.2022 nga menaxheri i projektit V. K. drejtuar z. A. K. kërkon miratimin e nisjes së procedurës në “Work Package Communication”.

Në kërkesë sqarohet se buxheti do të mbulohet nga projekti “TO BE READY”, ku është dhënë dhe miratimi nga partneret Lider mbi kërkesën e MM për realizimin e kësaj blerje.

Me urdhër nr. 868 prot., 2917/1, datë 06.06.2022 të SP z, A. K. urdhërohet “Nisja e procedurës për blerjen “**Work Package Communication**”. Qëllimi i kontratës është të rregullojë përgjegjësitë, shpërblimin financiar, afatet dhe kushtet e shërbimeve ndërmjet operatorit të përzgjedhur (kontraktorit) në lidhje **me strategjinë e komunikimit** për të rritur ndërgjegjësimin, mirëkuptimin dhe njohuritë se si të reduktohet rreziku dhe të parandalohet zjarri në raste emergjente. dhe Autoriteti Kontraktues (Ministria e Mbrojtjes). **Metodat e propozuara duhet të jenë të qarta dhe të komunikojnë në mënyrë efektive mesazhet kryesore për palët e interesuara.**

Me urdhër nr. 868/1 prot., 2917/3 datë 06.06.2022 të SP z, A. K. është ngitur komisionin “Për hartimin e termave të referencës/specifikimeve teknike”, ku ngarkon grupin e punës L. H., specialist në Sektorin e Shtypit, Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun, A. M., përgjegjës në Sektorin e QKMBMFA.

Me Memon nr. 3058/2, datë 13.06.2022 përcillen për miratim termat e referencës nga grupi i punës.

Me urdhrin nr. 868/2 prot., 2917/3 datë 06.06.2022 nga SP A. K. është “Ngritur komisionin e vlerësimit të prokurimit” në përbërje E. H., O. D., F. M., E. H. dhe K. N..

Publikimi i tenderit në një gazetë kombëtare është bërë me datën 04.07.2022 (Panoram Jurnal), dhe afati i fundit për dorëzimin e ofertave datë 02.08.2022. Afati i fundit i dorëzimit të ofertave ka qenë datë 02.08.2022.

Komiteti i vlerësimit me memon nr. 1392/7, datë 12.09.2022 drejtuar SP Z, A. K. informon se me datën 23.08.2022 në mjediset e MM është bërë mbledhja e komitetit të vlerësimit për përzgjedhjen e aplikantit fitues për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/05, ku janë dorëzuar dy aplikant për këtë procedurë.

Komisioni vlerësoj dokumentacionin e paraqitur nga ana e tenderuesve, ku citon se njëri nga ofertuesit nuk kishte dorëzuar dosjen e plotë të prokurimit në përputhje me termat e referencës. Komisioni ka vlerësuar si ofertë të suksesshme OE/O.C. 48,500 euro.

Mes OE/O. C. SHPK dhe AKMC është lidhur kontrata me nr. 1507/3, datën 15.09.2022, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/05 “*Work Package Communication*” në vlerën në vlerën 48,500 euro.

Bazuar në nenin 19 të kontratës “Zbatimi i detyrave dhe vonesave është përcaktuar që kontrata fillon me datën e lidhjes së kontratës

Afati për zbatimin e detyrave është 90 ditë nga data e fillimit të kontratës, por mund të zgjasë në rastet e arsyeshme nga kontraktori.

Nga AKMC është likuiduar OE me urdhër shpenzimin nr. 238, datë 30.11.2022 në vlerën 4,765,356 lekë mbështetur në faturën me nr. 388, datë 16.11.2022, dhe kushteve të kontratës neni 29, ku citon pagesë 70% te vlerës së kontratës (32,950) euro për dorëzimin;

- Strategjisë së fushatës informuese dhe ndërgjegjësimit në lidhje me fatkeqësitë natyrore dhe nga zjarri.

- Konsultimi me palët përkatëse të interesit për të identifikuar nevojën për komunikim të rrezikut.

- Shpërndarjen e aktiviteteve konsultuese.

- Hartimin e strategjisë së komunikimit për të inkurajuar ndryshime të qëndrueshme sociale të sjelljes.

Nga grupi i marrjes në dorëzim është mbajtur procesverbali me nr. 1507/18, datë 21.11.2022 mbi marrjen e produktit të parë në lidhje me “Raportin e analizës së informacionit dhe ndërgjegjësimit” dhe “Strategjisë së fushatës ndërgjegjësuese dhe plani i veprimtimit”.

Në dosjen e vënë në dispozicion janë materiale të përcjella nga OE, të cilat kanë të bëjnë me raportin e parë në lidhje me “*ndërgjegjësimi për rrezikun dhe plani i zbatimit të strategjisë*” dhe raportin e dytë “*Raporti i analizës së informacionit dhe ndërgjegjësimit*”.

Pagesa e dytë prej 30% të vlerës së kontratës në shumën prej 14,550 euro do të realizohet pas dorëzimit të 5 mini videove, një pllakatë me rregullim të artë, 5 fletëpalosje dhe 5 infografic dhe versionin final të strategjisë së komunikimit.

Me urdhër shpenzimin me nr. 103, datë 11.04.2023, bazuar në faturën me nr. 29, datë 29.03.2023 në vlerën 1,963,630 lekë. Marrja në dorëzim është realizuar me datën 29.03.2023.

Sa më sipër fatura e fundit e lëshuar nga OE është me datë 29.03.2023, ditë që është bërë dhe marrja në dorëzim e produkteve, ku bazuar në kontratën e lidhur në nenin 19 të saj afati për përfundimin e realizimit të kontratës është 90 ditë, ose 16.12.2022.

Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 51,598 euro e konvertuar në lekë në vlerën 5,624,157 lekë pa TVSh. ***Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC, pasi vlera e kontraktuar është në shumën 48,500 euro.***

#### **8. T.1.1 “Analiza e territorit dhe fushatë semantike për përcaktimin e raportit të alarmit”**

Me memon nr. 650 prot., datë 27.07.2020 drejtuar ministrit të mbrojtjes, me lëndë “*Mbi miratimin e fillimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimin e aktiviteteve në kuadër të Projektit*

“TO BE READY”, thuhet se në zbatimim të projektit nga ana e programit të interreg ka mbërritur fondi i parë financimit dhe duhet të filloj zbatimin e aktiviteteve në një afat të ngushtë kohor duke e konsideruar emergjente finalizimin e tyre në afatet kohore të parashikuara brenda datës 15.10.2020 duke listuar dhe aktivitetet e parashikuara si më poshtë:

Paketa e Punës Menaxhim (PPM):

1. Aktiviteti me zë M.2 “Menaxhimi i riskut dhe cilësisë”, me vlerën e parashikuar në buxhetin e projektit 2500 Euro

2. Aktiviteti me zë M.2 “Plani i Qëndrueshmërisë së Projektit” me vlerën e parashikuar në buxhetin e projektit 3000 Euro.

Paketa e Punës T1 (PP-T1):

1. Aktiviteti me zë T.1.1 “Analiza e territorit dhe fushatë semantike për përcaktimin e raportit të alarmit” me vlerë të parashikuar në buxhetin e projektit 10,000 Euro.

Me urdhrin e ministrit me nr. 650/2 Prot., datë 20.10.2020 “Për ngritjen e grupit të punës dhe hartimin e termave të referencës, specifikimeve teknike, përcaktimin e vlerës së fondit të nevojshëm dhe propozimin e procedurës së përzgjedhjes për aktivitetin sipas paketës së punës T1 (PP-T1), të parashikuar në formatin e aplikimit të projektit tematik “TO BE READY”, është ngritur grupi i punës me 6 anëtar.

Me memon nr. 1047/8 Prot., datë 20.01.2021, drejtuar ministrit i bëhet me dije se grupi i punës në zbatim të urdhrin për ngritjen e grupit të punës, kanë kryer të gjitha detyrat e kërkuara dhe kanë hartuar termat e referencës, specifikimet teknike, studimin e tregut dhe kanë nxjerrë si fond limit shumë prej 10.000 Euro.

Me kërkesën nr. 298/3 Prot., datë 10.05.2021, drejtuar z. A. C., Titullar i Autoritetit Kontraktor, Agjencia Kombëtare e Mbrojtës Civile i kërkon vijimin e procedurave përkatëse për prokurimin e këtij aktiviteti.

Me procesverbalin nr. 1325 Prot., datë 15.06.2021 janë rishikuar termat e referencës dhe është bërë dhe një përlllogaritje tjetër e fondit që ka rezultuar në vlerën 9,826,66.67 lekë pa TVSH dhe është kërkuar të prokurohet sipas procedurës me blerje të vogël.

Me shkresën nr. 1325/1 Prot., datë 16.06.2021, drejtuar Drejtorisë së përgjithshme ekonomike dhe shërbimeve mbështetëse dhe Drejtorisë së prokurimeve dhe ankandëve, i janë dërguar procesverbali dhe termat e referencës të rishikuara për vazhdimin e prokurimit.

Me shkresën nr. 2873/3 Prot., datë 30.06.2021, drejtuar Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandëve i dërgon dokumentacionin e sjellë nga AKMC dhe ju kërkon realizimin e procedurës së prokurimit.

Me urdhrin e prokurimit nr. 72, Prot., Datë 07.07.2021 për “Blerje projekt analiza e territorit dhe fushat semantike, për përcaktimin e raportit të alarmit” me fond limit 982,666.67 lekë pa TVSH, referuar shkresës së AKMC me nr. 2873/2 datë 18.06.2021 “Rishikimi i termave të referencës për aktivitetin, analizë territorit dhe fusha semantike për përcaktimin e raportit të alarmit”.

Sipas Proces-Verbalit nr. 1 datë 09.07.2021 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, kanë ardhur dy ofertave dhe është shpallur fitues OE “E.P.A.” me ofertën ekonomike 890.000 lekë pa TVSH.

Mes MM dhe OE është lidhur kontrata me nr. 2873/7, datë 02.08.2021 me afat 45 ditë nga lidhja e kontratës.

Me shkresën nr. 3775 Prot., datë 03.08.2021, i dërgohet AKMC kontrata dhe urdhri për zbatimin e kontratës me objekt “Blerje projekt analiza e territorit dhe fushat semantike, për përcaktimin e raportit të alarmit”.

Me urdhrin nr. 1639/5 Prot., datë 21.10.2021 të titullarit të AKMC për “Ngritjen e grupit të punës për vlerësimin dhe marrjen në dorëzim të raportit studimor “Analiza e territorit dhe fushat semantike, për përcaktimin e raportit të alarmit”, është ngritur grupi i punës i ngarkuar me detyrë për të marrë në shqyrtim materialin e dorëzuar nga OE, rishikimin e materialit në

lidhje me përputhshmërinë e tij me termat e referencës, specififikimet teknike dhe plotësimin e kushteve të tjera kontraktore për marrjen e tij në dorëzim.

Nga grupi i punës është mbajtur procesverbali me nr. 1639/7, datë 01.11.2021, mbi vlerësimin dhe marrjen në dorëzim të raportit të studimor mbi “Analiza e territorit dhe fushat semantike, për përcaktimin e raportit të alarmit”, ku citon përputhjen e materialit të dorëzuar me termat e referencës, specififikimet teknike dhe plotësimin e kushteve të tjera të kontratës.

Nga MM është paguar OE me urdhër shpenzimit me nr. 647, datë 31.12.2021 në shumën 1,068,000 lekë, të financuar 100% nga Buxheti i Shtetit.

*Në shkresat për nisjen e procedurës është cituar se vlera do të paguhet 85% nga projekti dhe 15 % nga Buxheti i shtetit.*

*Institucioni disponon gjendje për këtë projekt vlerën 150,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër do të financohet nga rimbursimet e projektit të cilat janë dsiponibël në bankën Credins.*

*Sa më sipër likuidimi është bërë 100% me financim buxhetor pa dhënë argumentime se nga kush është alokuar pjesa tjetër e shumës.*

Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 7,651.31 euro. Në komentin në sistemin e FLC është cituar se procedura nuk është e plote Mungon njoftimi ku është publikuar dhe procedura që është ndjekur, mungojnë dokumentet e subjekteve konkurruese dhe vlerësimi i tyre. Mungon produkti etj. Në diferencë në FLC është ulur vlera prej 1,171 euro. Grupit nuk i është dhënë asnjë koment në lidhje me këtë komente dhe rimbursime të vlerës nga projekti.

#### **9. T.1.4. “Modeli i funksionimit për rrezikun hidrik dhe zjarret pyjore”; “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore”**

- Me urdhrin e prokurimit, nr. 1541, prot. 2588/4, datë 12.10.2021, të z. A. C., Sekretar i Përgjithshëm urdhërohet të kryhet prokurimi i fondit prej 11,06,318 lekë pa TVSH, me objekt “Blerje materiale për mbrojtjen nga zjarret pyjore”.

Kërkesa për blerjen e materialeve është bërë nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me nr. 298/2, datë 02.04.2021, në të cilën citon nevojat për realizimin e kësaj procedurë, në zbatim të urdhrin të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1336, datë 04.11.2021 dhe Ministrit të Brendshëm me nr. 420, datë 24.11.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe studimin e tregut për aktivitetet e parashikuar në formatin e aplikimit të Projektit "TO BE READY", sipas paketës së Punës T.1.4. “Modeli i funksionimit për rrezikun hidrik dhe zjarret pyjore” përkatësisht blerje të disa prej pajisjeve të parashikuar në projekt.

#### **Konstatim:**

Sipas plani veprimit të projektit “TO BE READY” të përcjellë nga menaxherja e projektit dhe të raportuar si të realizuar tek projekti është vetëm për vlerën me fond të parashikuar prej 75,000 euro pa TVSH e cila ka si përshkrim “Çanta ergonomike e ujit Vallfirest për shuarjen e zjarreve në pyje është një hap përpara në pajisjet profesionale dhe ergonomike. Kjo pajisje ofron performancë më të lartë dhe kapacitet më të madh operacional për ekipet e zjarrfikësve, të cilët punojnë me çanta shpine dhe mjete dore në të njëjtën kohë”, e cila e njësuar me procedurën e prokurimit të hapur është “Pompa Portative shpinore të ujit, me kapacitet mbajtës 20 litra”.

***Vlera e prokuruar “Rezervuar uji të lëvizshëm me karrel” me fondi limit prej 14,619 euro pa TVSH nuk është parashikuar në planin e veprimit dhe nuk është përllogaritur si vlerë e realizuar për projektin.***

Mes AK/AKMC dhe OE/ “V.” ShPK është lidhur kontrata me nr. 154/2, datë 07.02.2022

MM e ka likuiduar OE me urdhër pagesën me nr. 530, datë 07.09.2022, në vlerën 11,500,440 lekë me TVSh dhe është paguar 100% nga buxheti i shtetit.



### **10. WP-C “Public Event”**

Me urdhrin nr. 124, prot., 931/1, datë 16.05.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për miratimin e referencave, specifikimeve teknike përcaktimin e vlerës së fondit të nevojshëm dhe propozimin e procedurës **WP-C “Public Event” të parashikuar në programin e projektit “To be ready”** me anëtar; L. H., N. H. dhe A. P..

Me memon nr. 931/2, datë 14.07.2023 drejtuar z. H. C. grupi i punës informon se ka arritur në një rezultat përsa i përket specifikime teknike mbi eventin final që do të mbahet me datën 26.10.2023, ku është mbajtur dhe procesverbali me nr. 931/2, datë 14.07.2023.

Nga grupi i punës janë dërguar dhe kërkesë për ofertë 3 OE; “O.C.”; “P.” ShPK dhe “A.” ShPK. Nga OE janë kthyer përgjigje mbi ofertat e tyre përkatësisht:

“P.” ShPK dërgon ofertën me shkresën me nr. 931/4, datë 20.07.2023. në vlerën 11,775.2 euro:

“A.” ShPK dërgon ofertën me shkresën me nr. 931/5, datë 21.07.2023. në vlerën 11,775.2 euro:

“O.C.” dërgon ofertën me shkresën me nr. 931/5, datë 21.07.2023. në vlerën 12,074,04 euro:

Me memon nr. 931/7, datë 17.08.2023 grupi i punës informon se ka hartuar termat e referencës dhe ka përllogaritur fondin mbi eventin final që do të mbahet me datën 26.10.2023, ku është mbajtur dhe procesverbali me nr. 931/8, datë 17.08.2023.

Bazuar në ofertat ekonomike të ardhë nga OE, rezulton se mesatarja e tyre është në vlerën 11,875 euro dhe fondi i përllogaritur nga projekti ishte në vlerën 12,500 euro, ku unanimisht grupi vendosi si vlerë fondi vlerën 12,000 euro.

Nga AK me shkresat me nr. 931/9, datë 04.09.2023 janë dërguar ftesa për marrjen pjese në tender të tre OE “P.” ShPK; “A.” ShPK dhe “O.C.”.

Me urdhrin nr. 229, prot., 931/11, datë 18.09.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën **WP-C “Public Event” të parashikuar në programin e projektit “To be ready”** me anëtar; K. N., N. L., N. H., M. B. dhe V. L..

Grupi i punës me memon nr. 931/15, datë 09.10.2023 informon Titullarin në lidhje me vlerësimin e procedurës, ku citon që pas vlerësimit të ofertave është shpallur fitues OE “O. C.” pasi plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të përcaktuar, me ofertë 12,100 euro. Me AK/AKMC dhe OE “O.C.” është lidhur kontrata me nr. 931/18, datë 23.10.2023, në vlerën 12,100 euro.

Me urdhrin nr. 285, prot., 931/20, datë 30.10.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për marrjen në dorëzim të produkteve të prokurimit me objekt **WP-C “Public Event”** me anëtar; L. H., M. L. dhe A. P..

Grupi i punës ka dorëzuar memon me nr. 931/23, datë 31.10.2023 dërguar z. H. C. informon se me datën 30.10.2023 është dërguar pranë protokollit raporti përfundimtar në zbatim të kontratës me nr. 931/18, datë 23.10.2023.

Grupi ka mbajtur procesverbalin me nr. 931/22, datë 31.10.2023 ku citon se raporti i dërguar nga OE është në përputhje me normativat dhe fotot të skenarit të realizuar gjatë aktivitetit, realizimin e një dokumenti në CV mbi aktivitetet e kryera nga të gjithë partnerët, dhuratat e shpërndara për të gjithë pjesëmarrësit, marrja me qira e ambienteve ku është zhvilluar aktiviteti, si dhe organizimi i pritjes me coffe break dhe drekës.

Me memon me nr. 931/24, datë 06.11.2023 drejtuar z. H. C. kërkon likuidimin e OE, ku fondet disponibël janë në llogarinë “To Be Ready”.

Nga AKMC është likuiduar OE me datën 14.11.2023 nga llogaria Credins “To be ready”, bazuar në faturën e nr. 30, datë 30.10.2023 në vlerën 1,278,123 lekë me TVSH.

**Në FLC nuk është raportuar si procedurë.**

### **10. C1 “Educational products”**

Me urdhërin nr. 80, prot., 753/1, datë 06.04.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për miratimin e referencave, specifikimeve teknike përcaktimin e vlerës së fondit të

nevojshëm dhe propozimin e procedurës **CI “Educational products” të parashikuar në programin e projektit “To be ready”** me anëtar; K. N.; L. H. dhe V. L..

Me memon nr. 753/2, datë 08.05.2023 drejtuar z. H. C. grupi i punës, informon se me datën 08.05.2023 është mbledhur për të diskutuar në lidhje me termat e referencës, specifikime teknike dhe llogaritjen vlerës së fondit të tenderimit, ku është mbajtur dhe procesverbali me nr. 753/3, datë 08.05.2023.

Nga grupi i punës janë dërguar dhe kërkesë për ofertë 3 OE; “O.C.”; A.K. dhe Th. A. ShPK.

*Nga OE janë kthyer përgjigje mbi ofertat e tyre përkatësisht:*

A. K. dërgon ofertën me email. në vlerën 31,476 euro.

Th. A. ShPK dërgon ofertën me email. në vlerën 32,728 euro.

“O. C.” dërgon ofertën me email. në vlerën 33,295 euro.

Bazuar në ofertat ekonomike të ardhë nga OE, rezulton se mesatarja e tyre është në vlerën 32.500 euro, ku unanimisht grupi vendosi si vlerë fondi vlerën 32,500 euro, aq sa është planifikuar dhe në projekt.

Nga AK me shkresat me nr. 763/4, datë 08.05.2023 janë dërguar ftesa për marrjen pjese në tender të tre OE “A.P.” F.S.; “Th.A.” dhe “O. C.”.

“A.P.” F.S. nuk ka dhënë ofertë në fazën e parë që të dërgohet ftesë për marrjen pjesë në tender. Në procesverbalet e mbajtura nga grupi nuk është cituar dhe argumentuar arsyeja se pse i është dërguar këtij OE ftesa për pjesëmarrje dhe jo OE/A. K., i cili ka dhënë ofertë që në fazën e llogaritjes së fondit.

Me urdhrin nr. 146, prot., 763/9, datë 02.06.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën **CI “Educational products” të parashikuar në programin e projektit “To be ready”** me anëtar; D. A., A. P., K. P., N. H. dhe N. L.

Grupi i punës me memon 763/10, datë 08.06.2023 informon Titullarin në lidhje me vlerësimin e procedurës, ku citon që pas vlerësimit të ofertave është shpallur fitues OE “F.S.” pasi plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të përcaktuar, me ofertë 32,499,84 euro.

Grupit të auditimit nuk është vënë në dispozicion dokumentacionin e dorëzuar nga OE për të auditura nëse vlerësimi është bërë në përputhje me kriteret e kërkuara.

### ***Sa më sipër konstatohet se;***

Së pari dërgimi i ftesë për pjesëmarrje në tender në fazën e dytë të OE “F.S.”, i cili nuk ka ofertuar në fazën e parë, është e paargumentuar nga grupi se si është bërë përzgjedhja e këtij OE.

Së dyti skualifikimi i OE të tjerë nga tenderit, grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacionin e dorëzuar prej tyre, për të vërtetuar arsyet e skualifikimit, e cila ka sjellë mos hapjen e ofertave ekonomike nga këta OE.

Së treti nga AK me OE “O.C.”. janë lidhur kontrata, ku bazuar në procesverbalin e vlerësimit të grupit pikat për të cilat ky OE është skualifikuar në këtë tender, në procedurat e tjera si **“Work Package Communication” dhe WP-C “Public Event”**, nga grupi janë konfirmuar që i plotëson këto kriteret.

Nga Grupi i auditimit mbështetur ne QKB e OE/F.S. rezulton se kriteret e kërkuar nga AK nuk i plotëson, por duke qenë se grupi nuk disponon dokumentacionin e dorëzuar nga OE për të vërtetuar këto kriteret nuk shprehemi në lidhje me këtë fakt.

- Gjithashtu dhe termat e referencës së dërguar grupit të auditimit nuk janë dhënë të plota pasi mungojnë faqja ku është përcaktuar termat në nenit 6 dhe 7.

Me AK/AKMC dhe OE “F.S.” është lidhur kontrata me nr. 753/13, datë 23.06.2023, në vlerën 32,500 euro.

Me urdhrin nr. 85, prot., 1351/1, datë 28.07.2023 të Titullarit të AKMC ngrihet grupi i punës “Për marrjen në dorëzim të produkteve të prokurimit me objekt *CI “Educational products”* me anëtar; K. N., L. H. dhe M. B..

Grupi i punës ka dorëzuar memon me nr. 1351/2, datë 01.08.2023 dërguar z. H. C. informon se grupi vlerësoi materialin e dërguar nga OE/F.S., të cilat janë në përputhje.

Bashkëlidhur janë vënë në dispozicion dhe procesverbalet e marrjes në dorëzim të materialeve nga Prefekturat e Rretheve dhe Drejtorive Pyjore të Bashkive.

Nga AKMC është likuiduar OE me datën 14.09.2023 nga llogaria Credins “To be ready”, bazuar në faturën e nr. 13, datë 07.09.2023, në vlerën 4,198,350 lekë me TVSH.

***Në FLC nuk është raportuar si procedurë.***

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Realizimi i procedurave të prokurimit sipas përcaktimeve të udhëzimit të e PRAG BE.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i procedurave të realizuar u konstatua se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në disa raste bashkëlidhur dokumentacionit të procedurës së prokurimit të realizuar mungon dokumentacioni i termave të referencës dhe specifikimeve teknike, si dhe ne një procedurë aneksi i termave të referencës është firmosur dhe është bërë deklarata për objektivitetin dhe konfidencialitetin vetëm nga njëri nga anëtarët e grupit.</li> <li>- Përzgjedhja e OE fitues nuk plotësonin kriteret bazuar në termave të referencës të hartuara nga grupet e ngritura nga SP i AK “<i>Për hartimin e termave të referencës për prokurimin...</i>”</li> <li>- OE fitues nuk kishin realizuar shërbimin brenda afatit të përcaktuar në kushtet e veçanta të kontratës së lidhur mes palëve.</li> <li>- Në një procedurë, nga AK i është dërguar ftesa për pjesëmarrje në tender në fazën e dytë një OE, i cili nuk ka ofertuar në fazën e pare. Në dosje nuk ka asnjë dokumentacion, se si është bërë përzgjedhja e këtij OE nga grupi i punës.</li> </ul> <p>Grupi i punës “Për vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën...” ka përzgjedhur si ofertë të suksesshme pikërisht këtë OE të ftuar në fazën e dytë për marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, duke cituar se plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të përcaktuar, Në dosje mungon dokumentacioni i OE të s’kualifikuar nga tenderi, për të vërtetuar arsyet e skualifikimit, e cila ka sjellë mos hapjen e ofertave ekonomike nga këta OE.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Nga OE të skualifikuar rezulton se nga AK me një nga OE janë lidhur kontrata, ku bazuar në procesverbalin e vlerësimit të grupit pikat për të cilat ky OE është sklasifikuar në këtë tender, në procedurat e tjera, nga grupi janë konfirmuar që i plotëson këto kriteret, të cilat kanë qenë të njëjta në të gjitha këto tendera.</li> <li>- Në një procedurë të realizuar bazuar në planin e veprimit të projektit “TO BE READY” të përcjellë nga menaxherja e projektit dhe të raportuar si të realizuar tek projekti është bërë shtesë e një zëri në vlerën 14,619 euro pa TVSH, e cila nuk ka qenë parashikuar në planin e veprimit dhe nuk është përllogaritur si vlerë e realizuar për projektin.</li> <li>- Në lidhje me realizimin e Procedurën “T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit “TO Be ready” është kontraktuar një palë e tretë, ku referuar ligjit nr. 8907, datë 06.06.2002 “Për Funksonimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë” neni 7, rezulton se nga AK kontraktimi i një pale të tretë për realizimin e këtij shërbimi është në</li> </ul>

	shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore, pasi objekti i kësaj procedure është objekt i veprimtarisë së IGJU-se për të gjithë territorin e vendit.
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i ePRAG BE. Termet të referencës dhe specifikimeve teknike. Kontratat e lidhura mes palëve.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Përzgjedhja e OE, të cilët mund të cenojnë në realizimin e kontratës.
<b>Shkaku:</b>	Mos aplikimi i standardeve të njëjta në përzgjedhjen e OE që marrin pjesë.
<b>Rëndësia:</b>	E mesme.
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i Ministrisë e Mbrojtjes të marrë masa në vijimësi, që të sigurojë implementimin e projekteve bazuar në objektivat e programit dhe realizimin e tyre në kohë. Procedurat të realizohen mbi bazën e një vlerësimi të drejtë dhe të barabartë mes OE që marrin pjesë në tender, bazuar në procedura të hapura dhe transparente.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Raportimi i shpenzimeve në FLC.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i bashkëfinancimit të projektit “TO BE READY - The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst anD emergencY management – 355”, Programi Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020” rezultoi se:</p> <p><b>Për “Procedurën “WP -T.1.4.1 “Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve”</b> ku është lidhur kontrata në vlerën 238,050 euro. Nga AKMC në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 254,014 euro e konvertuar në lekë në vlerën 27,687,596 lekë pa TVSh. <i>Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC.</i></p> <p><b>Për “Procedurën “WP -T.1.4.2 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” dhe WP -T.1.7.1 “Blerje e pajisjeve për dhomën e monitorimit”</b>, ku është u lot1 është në vlerën 245,500 euro dhe lot 2 në vlerën 19,100 euro pa TVSH në total 264,600 Euro pa TVSH.</p> <p>Nga informacioni i dërguar në FLC u konstatua se në “<i>procedura e plotë për dhomën e monitorimit dhe video sensor camera</i>” Inv No; 251/229, datë 02.08.2023 në vlerën 42,100.52 euro pa TVSh e konvertuar në 4,588,957 lekë pa TVSh, rezultoi se; Në FLC është hedhur vlera “Vat” 6,118,610 lekë, vlerë e cila paguhet nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë e reflektuar në FLC është gabim pasi shumica e TVSH duhet të ishte në vlerën 917,791 lekë.</p> <p>Sa më sipër vlera e reflektuar më shumë në shumën prej 5,200,819 lekë është e pajustificuar dhe argumentuar duke rritur fondin, që duhet të paguajë buxheti i shtetit me efekt negative në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore. Gjithashtu rezultoi se në FLC nuk është regjistruar vlera e plotë e kontratës prej 264,600 Euro pa TVSH, por vetëm vlera prej 42,100.52 euro pa TVSh.</p> <p>Diferenca 222,499.48 euro nuk është deklaruar në FLC për tu rimbursuar nga projekti, si rrjedhojë e gjithë vlera do të jetë detyrim i buxhetit të shtetit.</p> <p><b>Për “Procedurën “WP -T.1.4.2 “Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile” dhe EP -T.1.4.1 “Blerje e pajisjeve për operatorët</b></p>

	<p><b>e emergjencës civile”</b> është lidhur kontrata me datën 16.06.2022 prot., 1507/1, për <i>“Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile”</i> Portabel ëater pump 2 copë në vlerën 79,000; Trush pump for Flooding terrain 2 copë në vlerën 9,600 euro, <b>total në vlerën 88,600 euro</b> dhe kontrata me datën 16.06.2022, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02 <i>“Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile ”Plastic motor boat; Inflatable Boats Drysuits”</i> në vlerën <b>75,350 euro</b>.</p> <p>Nga AKMC për kontratën <b>në vlerën 75,350 euro</b>, në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 81,025 euro e konvertuar në lekë në vlerën 8,831,773.5 lekë pa TVSh.</p> <p>Për kontratën <b>në vlerën 88,600 euro</b>, në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 89,277.9 euro e konvertuar në lekë në vlerën 10,384,806 lekë pa TVSh.</p> <p><b><i>Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC,</i></b></p> <p><b>Për “”Procedurën “WP -M “Managment”,</b> ku mes OE/ K.Al. ShPK dhe AKMC, është lidhur kontrata me nr. 1507/2, datën <b>15.09.2022</b>, për <i>“Blerje Shërbime Auditimi”</i> në vlerën <b>59,850 euro pa TVSH</b>.</p> <p>Në raportin e dërguar nga FLC <i>“Expenditure verification / Audit IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SRV06”</i> first payment and second payment, në FLC në komente është vënë <i>“Mungojnë dokumente, për t’u verifikuar në periudhën e ardhshme raportuese”,</i> dhe nuk është raportuar <i>“Shuma e Çertifikuar Flc”</i>. Shuma e deklaruar në Euro është në shumën 63,909 euro, ndërsa kontrata e lidhur është në shumën 59,850 euro pa TVSH.</p> <p><b>- Për “Procedurën “Work Package Comunication”</b> është lidhur kontrata me nr. 1507/3, datën 15.09.2022, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/05 <i>“Work Package Comunication”</i> në vlerën në vlerën 48,500 euro.</p> <p>Në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 51,598 euro e konvertuar në lekë në vlerën 5,624,157 lekë pa TVSh.</p> <p><b>-Për procedurën “T.1.1 “Analiza e territorit dhe fushatë semantike për përcaktimin e raportit të alarmit”</b> është lidhur kontrata me nr. 2873/7, datë 02.08.2021 në vlerën 890.000 lekë pa TVSH.</p> <p>Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 7,651.31 euro. Në komentin në sistemin e FLC është cituar se procedura nuk është e plote Mungon njoftimi ku është publikuar dhe procedura që është ndjekur, mungojnë dokumentet e subjekteve konkurruese dhe vlerësimi i tyre. Mungon produkti etj. Në FLC është ulur vlera prej 1,171 euro nga ky tender. Grupit nuk i është dhënë asnjë koment në lidhje me këtë komente dhe rimbursime të vlerës nga projekti.</p> <p><b>- Për procedurën WP-C “Public Event”</b> është lidhur kontrata me nr. 931/18, datë 23.10.2023, në vlerën 12,100 euro. <b>Nga AKMC nuk është raportuar si procedurë e realizuar dhe finalizuar në FLC.</b></p> <p><b>- Për procedurën “C1 “Educational products”</b> është lidhur kontrata me nr. 753/13, datë 23.06.2023, në vlerën 32,500 euro. Nga AKMC nuk është raportuar si procedurë e realizuar dhe finalizuar në FLC.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i ePRAG BE. Kontratat e lidhura mes palëve.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Vonesat e azhurnimit të të dhënave në FLC-së ngadalëson rrjedhën e certifikimit të programit, duke ndikuar në vonesat e rimbursimit të

	financimit, pasi pjesa me e madhe projektit është paguar nga fondet buxhetore.
<b>Shkaku:</b>	Neglizhencë e grupeve të punës, menaxhereve dhe financiereve të projekti, si rrjedhoja e një mungesë organizimi i brendshëm ose mungesën e njohurive dhe kompetencave specifike të përfituesit.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të marrin masa për vlerësimin e situatës aktuale, nxjerrjen e përgjegjësi, si dhe të bashkërendojnë veprimet për të siguruar implementimin në kohë të projekteve bazuar në objektivat e programit, si dhe raportimin në kohë të tyre në FLC, me qëllim shmangien e vonesave për certifikimin e programit dhe vonesave të rimbursimit të fondeve.

<b>Titulli i gjetjes:</b>	Rimbursimet e fondeve nga bashkëfinancimi.
<b>Situata:</b>	<p>Nga auditimi i llogarisë Credins “To be ready” rezultoi se nga projekti është rimbursuar vlerat si më poshtë:</p> <p>Me datën 18.06.2020 është transferuar vlera prej 188,504 euro, të konvertuara në 23,432,877.54 lekë.</p> <p>Me datën 12.01.2021 është transferuar vlera prej 17,539.17 euro, të konvertuara në 2,127,501.32 lekë.</p> <p>Me datën 31.07.2023 është transferuar vlera prej 195,083.26 euro, të konvertuara në 19,941,410,84 lekë. Në total është transferuar shuma prej 401,126 euro. Nga MM është paguar në total nga kjo llogari vlera prej 44,975,022 lekë.</p> <p>Nga informacioni I vënë në dispozicion nga AKMC citohet se: <b><u>Financimet ose rimbursimet e fondeve</u></b> (fillimisht në Bankën e Shqipërisë dhe pastaj në bankën e nivelit të dytë, banka Credins në këtë rast) janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ 188,503.56 €.</li> <li>➤ 3.155,28 €</li> <li>➤ 33,475.12 € (transferuar ne 22.5.2020)</li> <li>➤ 155,103.74 € (transferuar ne 22.5.2020)</li> <li>➤ 17,567.17 € (transferuar ne 5.1.2022)</li> </ul> <p>Sa më sipër, konstatohet një mospërputhje të vlerave të transaksioneve të bankës Credins, së vënë në dispozicion grupit të auditimit dhe informacionit të dhënë nga AKMC për “<i>Financimet ose rimbursimet e fondeve (fillimisht në Bankën e Shqipërisë dhe pastaj në bankën e nivelit të dytë, banka Credins në këtë rast</i>”.</p> <p>Gjithashtu citohet se “<b><i>Çertifikuar nga FLC dhe Komisioni Evropian</i></b>” janë shumat si mëposhtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 90,105.34 euro</li> <li>- 165.06 euro</li> <li>- 192,152 euro</li> <li>- 542,000.48 euro</li> </ul> <p><b>Në total = 806,422.88 euro</b></p> <p>Nga mbledhja e shumave të raportuara rezulton se në FLC duhet të ishte certifikuar shuma prej 824,422.88 euro.</p> <p>Nga AKMC është thënë që në total vlera është 806,422.88 euro me një diferencë më pak në shumën <b>prej 18,000 euro</b>, për të cilën nuk është dhënë sqarime dhe argumentime, se për cilën nga paketat nuk është bërë</p>

	<p>certifikimi i shumës. Gjithashtu thuhet se është në proces certifikimi shuma prej 45,565.82 euro.</p> <p>Buxheti total i projektit për Shqipërinë ku përfshihen institucionet si Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është <b>1,479,049.95</b> euro, ku nga informacioni i dhënë nga menaxherja e projektit dhe AKMC është cituar se, fondi ka pësuar shkurtime për shkak të situatës pandemike Covid 19 në vlerën 129,936.37 euro, nga ku rezulton se buxheti total i projektit është në vlerën 1,349,113.58 euro, nga të cilat 1,079,290.86 euro janë financim nga IPA dhe 269,822.7 euro janë bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total).</p> <p>Vlera e bashkëfinancimit nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total) ka një mospërputhje në llogaritje pasi në fazën e parë, pa u shkurtuar fondet vlera e bashkëfinancimit ka qenë në shumën <b>221,857.50 euro. Me shkurtime e fondeve edhe vlera e bashkëfinancimit ulet në mënyrë proporcionale dhe nuk mund të pësojë rritje me shumën 47,965.22 euro.</b></p> <p><b>Nga sa më sipër</b> buxheti total i projektit në vlerën 1,349,113.58 euro, ndahet në 1,146,746.5 euro financim nga IPA dhe 202,367 euro bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total).</p> <p>Në këto kushte shuma e ngarkuar më tepër, si detyrim i Buxhetit të Shtetit në vlerën <b>67,455.68 Euro (269,822.716 - 202,367)</b>, duke rënduar buxhetin e shtetit me vlera të pajustificuara.</p>
<b>Kriteri:</b>	Udhëzimi i ePRAG BE. Kontratat e lidhura mes palëve.
<b>Ndikimi/Efekti:</b>	Rritja e vlerës së bashkëfinancimit që duhet të mbulohet nga Ministria e Mbrojtjes është e pajustificuar dhe e paargumentuar, duke rënduar buxhetin e shtetit.
<b>Shkaku:</b>	Mos përlllogaritja e saktë të fondeve që i takon shtetit shqiptar për tu mbuluar në këtë marrëveshje bashkëfinancime, nga mungesën e njohurive dhe kompetencave specifike të personave që janë paguar dhe kontraktuar për asistencë në këtë projekt.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune, që të vlerësojnë e të analizojnë vlerën prej 67,455.68 Euro të përlllogaritur më tepër si detyrim për tu paguar nga shtetit Shqiptar dhe shumën e shpenzimeve prej 18,000 Euro e paargumentuar dhe justifikuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga përfituesit.

### 2.8.2 Për kryerjen e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes.

Mbi auditimin e ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes në bazë të Programit të Auditimit nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar, mbajtur në datë 10.01.2024. Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë” në Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky auditim është kryer në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit” dhe Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 “Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të

*rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*”.

**Objekti i këtij akt verifikimi është:**

Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën shkresën nr. 2622 prot., datë 19.05.2022 për Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi auditimin e përputhshmërisë” të ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes sipas programit të auditimit nr. 357/10 prot., datë 03.09.2021, për veprimtarinë nga data 01.09.2018 deri me datë 30.06.2021.

Nga grupi i auditimit u krye verifikimi mbi statusin e rekomandimeve në Ministrinë e Mbrojtjes, dërguar me shkresën nr. 2622 prot., datë 19.05.2022, ku është kërkuar zbatimi i rekomandimeve për 41 (dyzet e një) “Masa Organizative”, 5 (pesë) “masa për shpërblim dëmi” dhe 2 (dy) “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike.

Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 2622/2 prot., datë 30.08.2022 me lëndë “*Mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar të KLSH-së*” ka dërguar pranë KLSH, plan veprimin me nr. 2622/2, datë 30.08.2022, me të cilin ngarkon strukturat përgjegjëse të varësisë të marrin masa mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH.

**Sa mësipër rezulton se:** Plani veprimit nuk është paraqitur brenda afatit 20 ditë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 15, shkronja (j) të Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Ministria e Mbrojtjes bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nuk ka dërguar pranë KLSH informacion mbi zbatimin e rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Për sa më sipër auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve është bazuar në dokumentacionet e kërkuara për pikat e programit të auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar, dhe çdo koment është dhënë bazuar dokumentacionit të kërkuar nga auditimi në terren.

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë lënë 41 (dyzet e një) “Masa Organizative”, 5 (pesë) “masa për shpërblim dëmi” dhe 2 (dy) “Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

*Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:*

- a) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **41** Masa organizative nga ku **51** rekomandime, të cilat janë pranuar **51** dhe kanë statusin si më poshtë vijon:
  - a. **38** janë zbatuar, **1** janë në proces zbatimi, **2** janë zbatuar pjesërisht dhe **10** janë të pazbatuara.
- b) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **5** Masa shpërblim dëmi nga ku **5** rekomandime, cilat janë pranuar **5** dhe kanë statusin si më poshtë vijon:
  - a. **5** janë të pazbatuara.
- c) Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **2** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike nga ku **2** rekomandime, të cilat janë pranuar dhe kanë statusin e ecurisë së zbatimit si vijon,
  - a. **2** janë zbatuar.



**Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:**

## **A. MASA ORGANIZATIVE**

**4.1. Rekomandimi:** Nga Ministria e Mbrojtjes të merren masa që projektet e reja të propozuara për financim duhet të kenë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-ve, dhe duhet të jenë në përputhje me prioritetet sektoriale të propozuara nga njësitë e qeverisjes qendrore”.

**Në vijimësi**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi në terren sipas programit të auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar, u konstatua se ky rekomandim nuk është zbatuar dhe është trajtuar më hollësisht nga grupi i auditimit në pikën nr. 1 të programit të auditimit, ku është lënë rekomandim.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **pazbatuar** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimin numër 2 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**9.1. Rekomandimi:** Nga Ministri i Mbrojtjes ti kërkohet zyrtarisht AKMC, informacion zyrtar për zbatimin e kontratave për çdo lot dhe për çdo bashki i detajuar sa banesa janë 1+1, 2+1, 3+1, si dhe sipërfaqet respektive të ndërtimit për secilin tip banese dhe emër mbiemër të pronarit të banesave, në zbatim të dokumenteve të tenderit shtojca 12 “Projekti zbatimit dhe specifikimet teknike, ndarë sipas loteve”.

**Menjëherë**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Në lidhje me këtë rekomandim nuk na është vënë në dispozicion ndonjë dokumentacion mbi zbatimin e këtij rekomandimi nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës pranë MM. AKMC është Program buxhetor më vete i krijuar me ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **pazbatuar**.

**11.1. Rekomandimi:** Nëpunësi autorizues në Ministrinë e Mbrojtjes, në cilësinë e nëpunësit përgjegjës për sistemet e kontrollit të brendshëm, të ndërmarrë të gjitha iniciativat e nevojshme, brenda kompetencave të veta, me qëllim përafrimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në funksion aktualisht me atë çfarë kërkohet nga ligji dhe manuali për MFK, duke angazhuar edhe strukturat e tjera përkatëse në institucion për të korigjuar mangësitë e evidentuara nga auditimi.

**Menjëherë**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, ky rekomandim është zbatuar pjesërisht dhe është trajtuar më hollësisht në pikën nr. 6 të programit të auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **zbatuar pjesërisht** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**12.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes të marrë të gjitha masat e duhura me qëllim plotësimin e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel në përfitim të mbarëvajtjes së punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit shumë të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.

**Menjëherë dhe nëvijimësi**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe nga auditimi i pikes nr. 7 të programit të auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar, rezultoi se Drejtoria e Auditimit është e paplotësuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **pazbatuar** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimin numër 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masa që për të gjitha praktikatat e veprimeve të kryera me arkë dhe magazinë të sistemohet në mënyrë kronologjike dhe të bashkëlidhet i gjithë dokumentacioni i plotë justifikues dhe vërtetues në referencë të përcaktimeve ligjore në fuqi.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi i realizuar ne terren u konstatua problematika te përsëritura për sa i përket rekomandimitr “fletë-hyrjet në magazinën AQT për aktive të qarkulluara pa pagesë nga njësitë e tjera shpenzuese të vartësisë, nuk janë të shoqëruara me shkresën e njësisë për transferimin e aktiveve dhe autorizimin për tërheqje malli të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe “fletë-daljet me anë të të cilave janë bërë dalje njësisive të vartësisë aktive nuk janë shoqëruar me dokumentacionin e plotë shoqërues”, për te cilat janë trajtuar ne materialin e grupit te auditimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **pazbatuar** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**20.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes të shmanget detajimi i projekteve të reja të investimit publik me akte normative apo rishikimeve të tjera gjatë si dhe në përfundim të vitit buxhetor pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, për t’u dhënë prioritet projekteve të planifikuara në PBA, në respektim të disiplinës buxhetore me qëllim menaxhimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të fondeve publike.

#### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Gjatë auditimit në terren u konstatua se grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicionin dokumente dhe është trajtuar më hollësisht nga grupi në pikën nr. 1 të programit të auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **pazbatuar** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet 1-2 të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**22.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për përmirësimin e procesit të planifikimit dhe raportimit për efekt të hartimit dhe monitorimit të planit buxhetor, duke përfshirë të gjitha njësitë përgjegjëse për buxhetin e programeve të administruara nga aparati i institucionit.

#### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, për kërkesat buxhetore është realizuar ndërsa sa i takon raporteve të monitorimit 4 mujore, nga aparati i MM si njësi shpenzuese nuk është zbatuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i **zbatuar pjesërisht** dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet 1,2 dhe 3 të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**24.3. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, në vijimësi të krahasojë kërkesat buxhetore edhe me PBA-të e viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimit e tyre për të evituar ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe mos cënimin apo favorizimin e projekteve specifike.

#### **Brenda vitit 2022 dhe në vijimësi**

**Oëndrimi i audituesve shtetërorë:** Gjatë auditimit në terren u konstatua se kjo problematikë është e përsëritur dhe është trajtuar më hollësisht nga grupi në pikën nr. 1 të programit të

auditimit me nr. 555/1 prot., datë 17.07.2023, i ndryshuar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet 1,2 dhe 3 të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**27.1. Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të Ministrisë së Mbrojtjes të marrin masat për ngritjen e një grupi pune me qëllim verifikimin e aktiveve nën administrimin e institucionit dhe hartimin e një regjistri që në varësi të llojit të aktivitetit të përmbajë datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim të tij, vlerën e amortizimit të akumuluar ndër vite, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes së tyre, apo kërkesave të tjera përcaktuar në kuadrin rregullator në fuqi.

#### **Brenda vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi në terren u konstatua se Ministria e Mbrojtjes i mban aktivitetet e regjistruara në sistemin ALPHA WEB, në të cilën ka një informacion jo të plotë për aktivitetet të cilat janë marrë në dorëzim para vitit të implementimit të sistemit, për faktin se të gjitha janë regjistruar si hyrje në momentin që është implementuar sistemi. Nga MM janë duke përmirësuar sistemin me qëllim evidentimin e saktë të vlerës së aktiveve gjendje dhe amortizimit të akumuluar të secilit prej aktiveve të regjistruar.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet në proces dhe është rikërkuar nga grupi me rekomandimet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**32.1. Rekomandimi:** Strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes të marrin masat për trajtimin e kësaj problematike me qëllim verifikimin e heqjes së këtij mjeti nga kontabiliteti i aparatit duke e paraqitur atë në vlerën 1 lekë, nga 1,621 mijë lekë që është vlera neto e tij.

#### **Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2022**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Nga auditimi në terren u konstatua se ky mjet është i regjistruar dhe i pa sistemuar në kontabilitet, problematikë e cila është trajtuar në materialin e lënë nga grupi i auditimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**36.1. Rekomandimi:** Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi Vlorë, përfaqësuesit e saj, përfshi dhe një teknik të fushës ose specialist për impiantin e ujit, Kolaudatori dhe Mbikëqyrësi, duke bashkëpunuar në grup, të marrin masa për të njoftuar sipërmarrësin e punimeve me qëllim kryerjen nga ana e tij e riparimeve të nevojshme nëpër tarracat e godinave duke bërë njëkohësisht dhe testimet dhe vënien në punë dhe dorëzimin tek tekniku i fushës të impiantit të ujit. Në vazhdim, pasi të jenë kryer riparimet e nevojshme nga sipërmarrësi i punimeve, pa cënuar parametrat e objektit, të vijohet sipas procedurës duke marrë në konsideratë se operatorit ekonomik nuk i është çliruar garancia e punimeve e si rezultat, çdo lloj riparimi është i mundshëm për tu kryer duke përmbyllur në këtë mënyrë të gjitha fazat e nevojshme për kryerjen e punimeve dhe përfundimin e kontratës së lidhur.

Shënim: Rekomandimi i mësipërm, nuk do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit, nëse nga QAPU Bunavi Vlorë, do të vërtetohet me dokumente zyrtare se janë kryer riparimet e nevojshme nga sipërmarrësi i punimeve sipas këtij rekomandimi dhe se ato janë marrë në dorëzim nga përfaqësuesit e QAPU Bunavi Vlorë, duke përmbyllur të gjitha fazat e ekzekutimit të kontratës së lidhur.

#### **Menjëherë**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Gruipt të auditimi nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëse janë marrë masat në lidhje me këtë rekomandim.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

## B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1.1. Rekomandimi:** Nga Ministria e Mbrojtjes të merren masa që vlera **13,507,200** lekë për stacionimin dhe inspektimin në Itali të helikopterit Cougar AS532AL 631 deri më 30.11.2021, duke shtuar dhe vlerat deri në kthim, ti zbritet Kompanisë Franceze “A.” nga vlera kontraktuar, pasi për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.

**Me likuidimin e faturës**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Grupit të auditimi nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëse janë marrë masat administrative si dhe ligjore në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e **254,022** lekë nga BOE “E.” & “SH.” SHPK, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 12 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë dhe amendamentin e saj.

**Brenda datës 30.06.2022**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Grupit të auditimi nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëse janë marrë masat administrative si dhe ligjore në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**4.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e **163,065** lekë nga “E.” SHPK, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 10 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë.

**Brenda datës 30.06.2022**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Grupit të auditimi nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëse janë marrë masat administrative si dhe ligjore në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e 400,925 lekë nga “L.”, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 19 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë dhe amendamentin e saj.

**Brenda datës 30.06.2022**

**Qëndrimi i audituesve shtetërorë:** Grupit të auditimi nuk i është vënë në dispozicion asnjë dokumentacion për të vërtetuar nëse janë marrë masat administrative si dhe ligjore në lidhje me zbatimin e rekomandimit.

**Statusi:** Rekomandimi konsiderohet i pazbatuar.

<b>Titulli gjetjes:</b>	Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.
<b>Situata:</b>	Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, rezultoi se Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 2622/2, datë 30.08.2022, ka paraqitur planin e masave,

	<p>jashtë afatit 20 ditë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ministria e Mbrojtjes bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nuk ka dërguar pranë KLSH informacion mbi zbatimin e rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154 datë 27.1.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Rezulton se KLSH me shkresën nr. 2622 prot., datë 19.05.2022 ka lënë gjithsej 58 rekomandime: 41 masa organizative, nga të cilat 38 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezultojnë në proces zbatimi, 2 masa të zbatuara pjesërisht dhe 10 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 5 masa për shpërblim dëmi nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 4 masa janë të pazbatuara; 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike, 2 masa nuk janë zbatuar. Për masat organizative të cilat janë konstatuar dhe nga auditimi në terren janë trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit, për të cilat janë lënë rekomandime.</p>
<b>Kriteri:</b>	Ligji nr. 154.2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j” dhe “k” dhe pika 2 e nenit 30.
<b>Ndikimi/Efekti</b>	Neglizhenca e nëpunësit autorizues në marrjen e masave të duhura për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
<b>Shkaku:</b>	Nga mos zbatimi i rekomandimeve të lëna situata nuk ka përmirësim, problematikat vazhdojnë të jenë evidente.
<b>Rëndësia:</b>	E lartë.
<b>Rekomandimi:</b>	<p>Nëpunësi Autorizues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe <b>rikërkojmë</b> zbatimin e rekomandimeve që janë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale si më poshtë:</p> <p><b>A. MASA ORGANIZATIVE</b></p> <p><b>9.1. Rekomandimi:</b> Nga Ministri i Mbrojtjes ti kërkohet zyrtarisht AKMC, informacion zyrtar për zbatimin e kontratave për çdo lot dhe për çdo bashki i detajuar sa banesa janë 1+1, 2+1, 3+1, si dhe sipërfaqet respektive të ndërtimit për secilin tip banese dhe emër mbiemër të pronarit të banesave, në zbatim të dokumenteve të tenderit shtojca 12 “Projekti zbatimit dhe specifikimet teknike, ndarë sipas loteve”.</p> <p style="text-align: right;"><b>Menjëherë</b></p> <p><b>32.1. Rekomandimi:</b> Strukturat përkatëse të Ministrisë së Mbrojtjes të marrin masat për trajtimin e kësaj problematike me qëllim verifikimin e heqjes së këtij mjeti nga kontabiliteti i aparatit duke e paraqitur atë në vlerën 1 lekë, nga 1,621 mijë lekë që është vlera neto e tij.</p> <p style="text-align: right;"><b>Menjëherë</b></p> <p><b>36.1. Rekomandimi:</b> Qendra e Arsimimit Profesional të Ushtarëve, Bunavi Vlorë, përfaqësuesit e saj, përfshi dhe një teknik të fushës ose specialist për impiantin e ujit, Kolaudatori dhe Mbikëqyrësi, duke</p>

bashkëpunuar në grup, të marrin masa për të njoftuar sipërmarrësin e punimeve me qëllim kryerjen nga ana e tij e riparimeve të nevojshme nëpër tarracat e godinave duke bërë njëkohësisht dhe testimet dhe vënien në punë dhe dorëzimin tek tekniku i fushës të impiantit të ujit. Në vazhdim, pasi të jenë kryer riparimet e nevojshme nga sipërmarrësi i punimeve, pa cënuar parametrat e objektit, të vijohet sipas procedurës duke marrë në konsideratë se operatorit ekonomik nuk i është çliruar garancia e punimeve e si rezultat, çdo lloj riparimi është i mundshëm për tu kryer duke përmbyllur në këtë mënyrë të gjitha fazat e nevojshme për kryerjen e punimeve dhe përfundimin e kontratës së lidhur.

Shënim: Rekomandimi i mësipërm, nuk do të jetë pjesë e raportit përfundimtar të auditimit, nëse nga QAPU Bunavi Vlorë, do të vërtetohet me dokumente zyrtare se janë kryer riparimet e nevojshme nga sipërmarrësi i punimeve sipas këtij rekomandimi dhe se ato janë marrë në dorëzim nga përfaqësuesit e QAPU Bunavi Vlorë, duke përmbyllur të gjitha fazat e ekzekutimit të kontratës së lidhur.

**Menjëherë**

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Ministria e Mbrojtjes të merren masa që vlera **13,507,200** lekë për stacionimin dhe inspektimin në Itali të helikopterit Cougar AS532AL 631 deri më 30.11.2021, duke shtuar dhe vlerat deri në kthim, ti zbritet Kompanisë Franceze “A.” nga vlera kontraktuar, pasi për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Buxhetin e Shtetit përbën dëm ekonomik.

**Deri më datën 31.07.2024**

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e **254,022** lekë nga BOE “E.” & “Sh.” SHPK, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 12 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë dhe amendamentin e saj.

**Deri më datën 31.07.2024**

**4.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e **163,065** lekë nga “E.” SHPK, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 10 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë.

**Deri më datën 31.07.2024**

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrin masa për mbajtjen e penalitetit në vlerën e **400,925** lekë nga “L.”, si rezultat i ekzekutimit të punimeve me 19 ditë vonesë jashtë afateve të përcaktuara në kontratën bazë dhe amendamentin e saj.

**Deri më datën 31.07.2024**

## IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

### A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

**1. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i Prokurimeve Ushtarake, konstatohet se Ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 është miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit shqiptar me legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC. Prokurimet e fushës së mbrojtjes dhe sigurisë, janë zhvilluar sipas Ligjit nr. 36/2020 “Për prokurimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë” dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”. Nga shqyrtimi i bazës ligjore me të cilën janë zhvilluar procedurat ushtarake vërehen disa mospërputhje mes Ligjit 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020.

a) Referuar ligjit 36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë”, në nenin 53, pika 2 dhe 3 parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative. *Ndërsa* në VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, në nenin 62, pika 4 dhe 5 parashikohet se në rastin e ankesave për dokumentet e procedurës, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e marrjes së njoftimit të kontratës, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative.

b) Referuar VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”, neni 5 “Kufijtë monetarë”, në nenin 1/a) parashikohet: Në përputhje me nenin 20 të LPFMS-së, kufijtë monetarë janë: a) kufiri për procedurat ndërkombëtare: pika i. për kontratat e furnizimit dhe shërbimit me vlerë jo më të ulët se **50,964,400 lekë**; pika ii. për kontratat e punëve me vlerë jo më të ulët se **6,371,787 lekë**.

Duke pasur parasysh që ligji nr. 36/2020 dhe VKM nr. 1170, datë 24.12.2020 janë miratuar në kuadër të përafrimit të legjislacionit të shtetit Shqiptar me Legjislacionin e BE dhe konkretisht me Direktivën 2009/81/EC, rezulton se vlera e përcaktuar e kufirit për procedurat ndërkombëtare për kontratat e punëve (me vlerë jo më të ulët se 6,371,787 lekë), është një lapsus (Lapsus) në përkthimin e vlerës së Direktivës 2009/81/EC, ku parashikohet se për kontratat e punëve kufiri i përcaktuar është 5,150,000 Euro.

c) Një tjetër mangësi që konstatohet në ligjin dhe rregullat e prokurimit në Fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë (FMS) është edhe mos parashikimi i afateve të ankimit pas përzgjedhjes së kandidatëve në fazën e parë të procedurës së kufizuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë me qëllim korigjimin dhe ndryshimin e vlerës në kufijtë monetarë sipas përcaktimeve të Direktivës 2009/81/EC.

**Menjëherë**

**1.2 Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë masat e nevojshme për propozimin e miratimin e ndryshimeve të nevojshme, me qëllim që të shmanget kjo papajtueshmëri dhe mungesë koherence ligjore dhe korigjimin e mospërputhjes ligjore lidhur me afatet e ankesave për dokumentet e procedurave prokuruese.

**Menjëherë**

**1.3 Rekomandimi:** Autoriteti kontraktor Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, të ndërmarrë hapat e

nevojshëm ligjorë me qëllim përmbushjen e parashikimit të afatit të paraqitjes së ankesave nga operatorët ekonomikë pas përfundimit të fazës së parë të procedurës së kufizuar.

**Menjëherë**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2021-2022, janë planifikuar në PBA 2021-2023 si projekte të reja në vlerë më të ulët, duke ruajtur tavanet buxhetore të miratuara, dhe në PBA 2022-2024 dhe konkretisht:

Në PBA 2021-2023 janë parashikuar me një vlerë totale prej 18,571,645 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 janë parashikuar në vlerën totale prej 28,664,854 mijë lekë, me një diferencë prej 10,093,209 mijë lekë.

Nga auditimi i planifikimit për vitin 2022, u konstatua se 30 projekte investimi nuk reflektohen në PBA 2022-2024, ose reflektohen me vlera të konsiderueshme më të ulëta, me qëllim ruajtjen e tavanëve të miratuara dhe alokimin e fondeve për projekte të reja. Konkretisht, për vitin 2022 në 30 projekte investimi, në PBA 2021-2023 parashikohen në shumën 6,576,315 mijë lekë, ndërsa në PBA 2022-2024 parashikohen në shumën 1,700,000 mijë lekë, me një diferencë prej 4,876,315 mijë lekë, veprime në mospërputhje me *Ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim:** Nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes të merren masa në vijimësi për krahasimin e kërkesave buxhetore në vitin aktual me kërkesat buxhetore të PBA-ve të viteve të kaluara duke rakorduar ecurinë e investimeve kapitale me qëllim mirë menaxhimin e tyre për të evituar krijimin e detyrimeve të prapambetura, ndryshimet në prioritetet e projekteve, si dhe cenimin apo favorizimin e projekteve specifike.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2021-2022, janë realizuar projekte të paplanifikurara në PBA-të respektive dhe konkretisht: 10 projekte në shumën 1,089,925 mijë lekë gjatë vitit 2021; 13 projekte investimi në shumën 1,175,011 mijë lekë, gjatë vitit 2022. Sa më sipër, projektet e reja të propozuara për financim nuk kanë kaluar procedurat e miratimit në kuadër të PBA-së. Gjithashtu, nga ana e grupit të auditimit u konstatua se për vitin 2021 janë planifikuar në PBA 2021-2023, 21 projekte investimi në shumën 575,915 mijë lekë, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2021. Për vitin 2022, janë planifikuar në PBA 2022-2024, 14 projekte investimi në shumën 1,014,387 mijë lekë, por nuk janë çelur me buxhetin e vitit 2022.

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, neni nr.40, Udhëzimin nr.9, datë 20.03.2018, i MFE-së "*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*", pika nr.64; VKM 185, datë 29.03.2018 "*Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike*", Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Titullari i Institucionit në bashkëpunim me Grupin e Menaxhimit Strategjik, të marrin masat e nevojshme në mënyrë që në periudhat në vijim të eliminohen praktikatat e çeljes së projekteve të reja pa kaluar në procedurat e ciklit të menaxhimit të investimeve publike, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nga ana institucioneve të varësisë së Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe nga vetë aparati i Ministrisë së Mbrojtjes, si njësi shpenzuese, nuk janë hartuar raportet e monitorimit si dhe relacionet shpjeguese 4-8-12 mujore për të ndjekur realizimin e produkteve të buxhetit të secilës njësi shpenzuese më vete, për të garantuar



përmirësimin e procesit të planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit, ndjekjen dhe arritjen e qëllimit dhe objektivave të synuara, sipas deklaratës së politikës së programit, si dhe krahasimin e treguesve të planifikuar të performancës me treguesit faktik. Raportet e monitorimit janë hartuar në bazë të programeve buxhetore nga Ekipi i Menaxhimit të Programeve, ku monitorimi është kryer për të gjithë programet e MM pa hartuar raporte 4 mujore monitorimi sipas Udhëzimit nr.22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të Buxhetit në NJQQ” dhe Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 65. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqet nr. 19-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marrë masat, për hartimin e raporteve periodike të monitorimit të buxhetit 4-8-12 mujore për aparatën e MM dhe njësitë e varësisë si njësi shpenzuese për produktet e buxhetit të administruara, me qëllim përmirësimin e procesit të planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit.

Në vijimësi

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i funksionimit dhe strukturës së Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatorë, si dhe nisur nga fushat e përgjegjësisve shtetërore që aktualisht ka Ministria e Mbrojtjes, rezultoi se kjo strukturë nuk ishte e plotësuar me stafin e nevojshëm sipas organikës së miratuar.

- Në emërtimin e kësaj drejtorie është dhe Integrimi, por në funksionin e saj nuk e ka integrimin pasi detyrat kryesore lidhen vetëm me koordinim e marrëveshjeve, punë për të cilën ndiqet e gjithë praktika sipas marrëveshjeve përkatëse duke u përkthyer dhe duke u bashkërenduar me strukturat përkatëse dhe Institucionet e linjës sipas llojit dhe specifikës që ka marrëveshja. Nisur nga fakti që detyrat kryesore të cilat kërkojnë plotësimin e praktikave përkatëse për lidhjen e marrëveshjeve, ndër të tjera kërkojnë edhe negociimin e tyre përveç koordinimit, (pjesë që duhet ti përkiste Integritimit) rezultoi se këtë proces e kryen një nga sektorët e Drejtorisë së Politikave të NATO-BE (Sektori i Politikave me Jashtë), ku përpunimi dhe finalizimi i praktikave të marrëveshjes nga dy drejtori të ndryshme pa lidhje funksionale në strukturë me njëra tjetrën, mund të ndikojë në vonesa në përcjelljen e praktikave, rekomandimeve apo edhe raporteve dhe negociemeve gjatë grupeve të punës në fazën fillestare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 31-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të merren masa, që të kërkohet ristrukturim i kësaj drejtorie duke e ndarë në sektor, me funksionet organike “Përgjegjës sektori”, si dhe të plotësohet me numrin e nevojshëm të specialistëve për çdo sektor, duke bërë pasqyrimin e këtyre detyrave edhe në rregulloren e brendshme të funksionimit dhe organizimit të MM, bazuar në përgjegjësitë dhe funksionet, me qëllim realizimin në kohë të marrëveshjeve, si dhe ndryshimeve përkatëse të legjisllacionit në këtë fushë, duke qenë se angazhimet janë në nivel qeveritar dhe duhet të përafrohen me të gjitha normativat e Vendeve Aleate, por edhe me ato të Bashkimit Evropian.

Në vijimësi

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i disa urdhër-shpenzimeve për likuidimin e biletave të transportit ajror ndërkombëtar, si dhe në disa urdhër-pagesa të shërbimeve-dieta jashtë vendit të punonjësve, të likuiduara nëpërmjet arkës, në 15 praktika të audituara u konstatua *mungesa e boarding pass, e ftesës së vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve*. Me anë të këtij dokumentacioni, vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit si dhe pjesa e shpenzimeve që do të mbulojë organizatori dhe pjesa që do të mbulojë buxheti i shtetit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.22 të MFE datë 10.07.2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, date 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”,

pika 4 dhe me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 4, pika 26 nenin 2, pika 16, si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” pikën 35, germa b. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes të marrë masa, që në të gjitha praktikat për udhëtime dieta për jashtë vendi, dokumentit të pagesave t'i bashkëngjitet, autorizimi për pjesëmarrje nga titullari i institucionit, ftesa e vendit pritës dhe draft agjenda e punimeve.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i urdhër-shpenzimeve, u konstatua mosrespektim i afateve, sa i takon likuidimit të faturave, për 75 raste, nga 180 të testuara nga auditimi, duke tejkuluar afatin ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar në UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, pika 184 “Nëpunësit zbatues të njërive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik”, si dhe Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, afatet për autoritet publike, pika a), parashikon që kalimi i likuiditetit tek kreditori duhet të bëhet brenda 60 ditëve kalendarike, duke parashikuar dhe 30 ditë për procedurat e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit dhe procesimit të pagesës në degën e thesarit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues të marrë masat të paraqesë në strukturën e thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të OE, me qëllim respektimin e disiplinës buxhetore dhe shmangien e riskut për krijimin e detyrimeve të prapambetura.

## Në vijimësi

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të “Pasqyrës së Performancës” rezultuan mospërputhje të shpenzimeve të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare me rakordimin me degën e thesarit përkatësisht për:

- Llogarinë 602 “Blerje mallra e shërbime” për Llogarinë 6024 “Shpenzime udhëtimi”, ku në “Pasqyrën e Performancës” është pasqyruar në vlerën 52,095,925 lekë, ndërsa me rakordimin me degën e thesarit është vlera 50,095,925 lekë me një diferencë më shumë prej 2,000,000 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni.

- Llogarinë 605 “Transferime për Organizatat Ndërkombëtare” është pasqyruar në vlerën 418,649,981 lekë, ndërsa me rakordimin me degën e thesarit është vlera 365,999,981 lekë me një diferencë më shumë prej 52,650,000 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni.

- Llogarinë 606 “Transferta Paguara nga Institucione tjera e Org. Pushtetit Vendor” është pasqyruar në vlerën 62,070,197 lekë ndërsa me rakordimin me degën e thesarit është vlera 51,309,887 lekë me një diferencë më shumë prej 10,760,310 lekë, e cila është e paargumentuar nga institucioni. *Shuma e diferencave të konstatuara është në vlerën 65,410,310 lekë.*

Sa më sipër rezulton një diferencë me një vlerë prej **9,433,273 lekë**, mes shpenzimeve të pasqyruar në pasqyrën e performancës financiare me rakordimin me degën e thesarit, pasi i është zbritur vlera e kredituar në llogarinë 467 “Kreditore të ndryshëm”, për të cilën ska asnjë informacion në shënimet shpjeguese dhe asnjë informacion se si është bërë verpimet kontabël i mbylljes nga Institucioni. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare

vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, paragrafi 3.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të analizojë diferencat e konstatuara dhe në vijimësi të marrë masat për të argumentuar arsyet e mos rakordimit të shpenzimeve të realizuara në një vit ushtrimor me degën e thesarit, me qëllim reflektimin e drejtë të tyre në “Pasqyrën e Performancës”.

- Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marrë masa që për diferencat e konstatuara të nxjerrë përgjegjësitë për zyrtarët dhe të fillojë procedurat e marrjes së masave disiplinore për veprimet dhe mosveprimet e tyre.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që për detyrimet e krijuara të bëjë veprimin kontabël në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Alpha Web” rezultoi se në llogarinë 31 “Materiale”, rezultoi se janë regjistruar padrejtësisht si materiale zëra të aktiveve afatgjata në vlerë totale 780,229 leke.

Gjithashtu konstatohet se gjendja e materialeve në magazinë sipas të dhënave nga “Alpha Web” është në vlerën 11,266,591 lekë, ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 1,193,936 lekë me një diferencë prej 10,072,655 lekë.

Inventari i imët është në vlerën 16,515,515 lekë ndërsa në pasqyrën financiare janë pasqyruar në vlerën 3,876,403 lekë me një diferencë në vlerën prej 12,639,112 lekë.

Llogaria 35 “Mallra” është pasqyruar në kontabilitet në vlerën 13,129,191 lekë, ndërsa në “Alpha web” është zero. Diferenca totale “Gjendje inventari qarkullues” e pasqyruara në pasqyrën financiare të institucionit krahasuar me regjistrimin e tyre në programin “Alpha Web” është në vlerën 9,582,577 lekë, e cila është e paargumentuar në shënimet shpjeguese të institucionit. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin e vlerave të kontabilizuar në llogarinë 31 “Materiale”, duke kredituar këtë llogari për vlerat të cilat nuk i përkasin dhe debituar llogarinë 21 “Aktive Afatgjata”.

**Menjëherë**

**8.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që përpara mbylljes së pasqyrave financiare vjetore të bëhet një rakordim të vlerave të regjistruara në “Alpha Web” dhe atyre që do të raportohet në pasqyra financiare, duke mbajtur një procesverbal midis punonjësit të ngarkuar për kontabilizimin e hyrje daljeve të vlerave materiale dhe Përgjegjësit të Sektorit.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi vendimet e proceseve gjyqësore dhe njohjen e tyre në kontabilitet rezultoi se shuma e vendimeve gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë nuk janë njohur në kontabilitet si detyrime për t’u shlyer. Si rrjedhojë ky detyrim nuk është njohur në kontabilitet sipas parimit të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, por është njohur në momentin e likuidimit, në kundërshtim me nenin 61, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimit të MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat në përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 34 dhe 42. Kjo ka sjellë mospasqyrim të drejtë të llogarive në pasqyrën e “Pozicionit financiar”.

- Nga Pasqyrat financiare të printuar nga Sistemi i thesarit konstatohet se Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është në shumën prej 1,374,960 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën 170,916 lekë e paargumentuar në shënimet shpjeguese. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, të merren masa në vijimësi për ndjekjen me kujdes të proceseve gjyqësore dhe përcjelljen në kohë të informacionit të plotë dhe të saktë të vendimeve të gjykatës të formës së prerë, në njësinë përkatëse, përgjegjëse për financë/kontabilitetin.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që menjëherë pas marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të bëjë regjistrimin në kontabilitet të detyrimit të plotë të titullit ekzekutiv, bazuar në parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

### Në vijimësi

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kartelave të detyrimeve të Përfaqësuesve/Atasheve Ushtarak në 31.12.2022 për shpenzimet financiare të cilat mbulohen nga Ministria e Mbrojtjes rezultoi se: -Vlera e tyre ishte në shumën prej 915,753,741 lekë, ndërsa në llogarinë 437-438 “Organizma të tjera shtetërorë” ky detyrim paraqitet në vlerën 759,129,156 lekë, me një diferencë në shumën prej 156,624 mijë lekë.

-Kishte detyrime të pa mbyllura që nga viti 2020. Në disa raste rezultoi se mbyllja e shpenzimeve nga AU & PU ishte kryer pas 2 deri në 3 vjet.

- Në lidhje me dokumentacionin e mbylljes së shpenzimeve të rakorduar nga sektori i financës me Atashetë Ushtarak & Përfaqësuesit Ushtarak (AU & PU) u konstatua se, mbyllja e shpenzimeve bëhej sipas rastit, pa iu nënshtruar asnjë lloj rregulli apo kriteri. Nga Sektori i Financës pranë Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe në rastet kur janë mbajtur procesverbalet e mbylljes dhe dorëzimit të dokumentacionit të shpenzimeve me përfaqësuesit ushtarak nuk është bërë kontabilizimi i mbylljes së detyrimeve në kontabilitet dhe mbyllja e kartelave të detyrimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Titullari/ose Nëpunësi Autorizues i MM, të marrë masat të menjëhershme për nxjerrjen e një urdhri të brendshme në lidhje me mbylljen e shpenzimeve financiare të Përfaqësuesve/Atasheve Ushtarak, që çdo vit përpara mbylljes së pasqyrave financiare Atashetë Ushtarak & Përfaqësuesit Ushtarak duhet të paraqesin një deklaratë për shpenzimet e realizuara gjatë vitit ushtrimor të shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e skanuar të justifikimit të shpenzimeve, të cilat më pas të dërgohen në rrugë elektronike, Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar për të reflektuar të gjitha transaksionet dhe ngjarjet në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

### Menjëherë

**10.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për sistemimin e llogarisë 437-438 “Organizma të tjera shtetërorë” në pasqyrën e pozicionit financiar, me qëllim përfshirjen e gjendjes reale të detyrimeve të gjithë shpenzimeve financiare të kryera dhe të rakorduara mes përfaqësuesve/atasheve dhe përfaqësuesit të ministrisë.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zërave të pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është regjistruar vlera e plotë e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” prej 57,181,681 lekë, nga të cilat vlera prej 1,204,644 lekë përfaqëson “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila ka të bëjë me detyrime të dhjetorit që likuidohen nga “Financim i pritshëm nga buxheti”. Diferenca prej 55,977,037 lekë

e debituar në llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është veprim në kundërshtim me udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” paragrafi 3.2, vlerë e cila duhet të ishte debituar në llogarinë 4864 “Shpenzime te periudhave te ardhshme për detyrime të prapambetura”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa në vijimësi, që për detyrimet e krijuara të bëjë veprimin kontabël në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim paraqitjen e drejtë të pasqyrës së pozicionit financiar të institucionit.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aktiveve të regjistruara në programin “Alpha Web” rezultoi se:

- Llogari 215 “Mjete transporti” është në vlerën 26,413,260 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është në vlerën 29,910,461 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën prej **3,497,200 lekë**. Nga MM është bërë dalje të mjeteve të transportit për të cilën nuk figurojnë asnjë dokumentacion mbështetës.

- Llogari 218 “Inventar ekonomik” është në vlerën 274,356,666 lekë, ndërsa vlera bruto e pasqyruar në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” është në vlerën 279,091,542 lekë, me një diferencë më shumë në vlerën prej **4,734,876 lekë**.

- Nga auditimi i procesit të kalimit të aktiveve, nga një subjekt në tjetrin mbështetur në Urdhrat për “Kalim kapitali pa pagesë” u konstatua mungesë dokumentacioni si: kartela e llogaritjes së vlerës së amortizimit të akumuluar dhe të llogaritur nga subjekti deri në momentin e daljes nga pronësia, ku nga MM është regjistruar në kontabilitet vlera e koston historike të tyre; Akt konfirmimi i njësisë pritëse dhe fletë-hyrja e regjistrimit të aktivitetit. Mungesa e dokumentacioneve shoqëruese le të hapur ciklin e transferimit të kapitalit nga një institucion në tjetrin. Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30 të MFE, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa të menjëhershme, për verifikimin e diferencave të konstatuara nga rakordimi i të dhënëve të sistemit “Alpha web” dhe atyre të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe më pas të bëjnë korrigjimet dhe sistemimin e domosdoshme, duke bërë që llogaria e aktiveve afatgjata materiale të paraqitet vlera e drejtë dhe e rakorduar sipas kërkesave të teknikave kontabël.

**Menjëherë**

**12.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat, që përpara se të bëjë reflektimin e pakësimit ose të shtesës së aktive në kontabilitet nga lëvizjet kapitale pa pagesë brenda apo jashtë sistemit, të disponojë të gjithë dokumentacionin përkatës të kalimit kapital të aktiveve hyrëse ose dalje, me qëllim mbylljen e ciklit të transferimit si dhe verifikimin e reflektimit në kontabilitet të tyre.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i analitik i llogarive të “Investimeve”, si dhe nga rakordimi i zërit “Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)” në pasqyrën e flukseve monetare (cash flow) me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” rezultoi se:

Akordimi i fondeve buxhetore për llogarinë 231 “Investime” është në vlerën 11,345,000 lekë, vlerë e cila është debituar në llogarinë 231 “Për Aktive Afatgjata materiale”.

Ndërsa, vlera prej 1,015,992 lekë, e cila është debituar në llogarinë 218 “Inventar ekonomik” si blerje të krijuara gjatë vitit nuk përputhet me fondet e akorduara për shpenzime kapitale, për të cilën nga Institucioni nuk ka asnjë sqarim në shënimet shpjeguese se nga është marrë ky fond. Kjo vlerë e kontabilizuar ndikon në pasqyrimin jo të drejtë të “Pasqyrës së ndryshimeve ne aktivet neto/ fondet neto”. Veprimet në kundërshtim me Udhëzimin e MFE me nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të merren masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2022, u konstatua:

- Diferenca të vlerave të pasqyruara në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” nga blerjet e krijuara dhe me vlerat në llogarinë 231 “Investime” të pasqyruar në pasqyrën e “Pozicionit Financiar”.

- Zëri “Transferime në buxhet të Fondeve te pa përdorura(-)” në pasqyrën e “Flukseve monetare (cash flow)” nuk përputhet me shumën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit dhe të fondeve të akorduara.

- Në pasqyrën 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto neto)” për pakësimet e aktiveve si rezultat i transferimeve apo nxjerrjes jashtë përdorimi për disa njësi vartësie nuk është llogaritur amortizimi i akumuluar, por është pasqyruar zvogëlimi në vlerën e kostos historike, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit, me ndikim material në fondin neto të institucionit.

- Në pasqyrën e pozicionit financiar të institucionit, në rubrikën D “Fondet e konsoliduara nga Institucioni” është pasqyruar llogaria 106 “Teprica e Granteve kapitale të Huaja” në vlerën 1,091,730,717 lekë, përkatësisht në “Repartin 4001”. Nga analiza e zërave në pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/ fondet neto rezultoi se, nga institucioni kjo vlerë nuk është pasqyruar në llogarinë 23 “Investime”, por është pasqyruar si rritje aktiveve në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)”, si shtesa pa pagesë jashtë sistemi, për të cilat janë njohur në momentin fillestar në llogarinë 21, të aktiveve afatgjata dhe është bërë hyrje në institucion.

- Ndryshimi i Llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në pozicionin financiar nuk përputhet me të hyrat dhe likuidimet e pasqyruara në pasqyrën e “cash flow”, duke ndikuar në pasqyrimin jo të saktë dhe me gabime materiale të pozicionit financiar të institucionit.

- “Totali i Fondeve te veta” për disa njësi vartësie nuk është pasqyruar saktë, e cila ka gabime materiale, të cilat kane ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pozicionit financiar të institucionit.

- Nga lëvizja e aktiveve në institucionet e vartësisë në pasqyrën 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” përkatësisht në “Repartin 3001” rezultoi se është bërë reflektimi i nxjerrje jashtë përdorimi të zërit “Ndërtime e Konstrukione” të një prone të vlerësuar për jashtë përdorimi që nga viti 2011, ku në shënimet shpjeguese nuk ka asnjë sqarim në lidhje si është bërë vlerësimi dhe nxjerrja jashtë përdorimi i kësaj prone që nga viti 2011 dhe pasqyruar në kontabilitet në vitin 2022.

-Kalimi pa pagesë të aktiveve nga njëri institucion tek tjetri rezultoi mospërputhje të vlerave të pasqyruara, ku përkatësisht:

Për kalimin e “Ndërtime e Konstrukione” nga “Repartin 6630” në “Repartin 5001”, sipas urdhrorit të Ministrit të Mbrojtjes me nr. 194 datë 23.02.2022, u konstatua se në “Repartin 5001” është pasqyruar vlera prej 12,356,003 lekë, ndërsa në pasqyrën e “Repartit 6630” është pasqyruar vlera prej 13,455,987 lekë, me një diferencë në shumën **1,099,984 lekë të**

### **paargumentuar në shënimet shpjeguese.**

- Për daljet brenda sistemit të “Ndërtimit e Konstrukione” në vlerën 86,803,250 nga “Repartin 4001” dhe shtesë në “Repartin 6604” në vlerën 52,657,246 lekë, nga përthithja e aktivitetit, si dhe vlera 1,089,370 lekë shtesë në “Toka, troje, terrene” në total në vlerën 53,746,616 lekë bazuar në urdhrin e MM nr. 60 datë 18.11.2021 “Kalim pronësie të aktivitetit bazuar në ristrukturim” u konstatua, diferenca (86,803,250 - 53,746,616 = **33,056,634 lekë**) e transferimit, vlerë e cila nuk është sqaruar se nga cila njësi është përthithur.

Veprime sa më sipër në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 62, me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masa për analizimin e diferencave të konstatuara.

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të marrë masat që të gjitha transaksionet dhe ngjarjet të trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare. Sektori i Financës të marrë masa për të kryer sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve dhe korrigjimin e sistemit të tyre në pasqyrat financiare të viteve pasardhëse.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**14.2. Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marrë masa që për diferencat e konstatuara të nxjerrë përgjegjësitë për zyrtarët dhe të fillojë procedurat e marrjes së masave disiplinore për veprimet dhe mosveprimet e tyre.

### **Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga rakordimi i gjendjes së aktiveve të evidentuar nga Komisioni i inventarizimit me gjendjen e aktiveve të pasqyruara në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” ka rezultuar një diferencë në shumën prej 50,206,736.90 lekë, për të cilën nga subjekti i audituar nuk janë dhënë shpjegime mbi burimin e krijimit të kësaj difference.

- Nga rakordimi i lëvizjeve të aktiveve të realizuara gjatë vitit 2021 dhe pasqyrimi i tyre në formatin 7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” ka rezultuar se: Vlera e aktiveve të dala nga institucioni shoqëruar me dokumentacion është në shumën 17,493,024 lekë, si dhe vlera 6,830,594 lekë që janë aktiveve të dërguara në ASNI për asgjësimin e tyre, bazuar në urdhrin me nr. 1, datë 12.01.2017 “Për trajtimin e mbetjeve nga pajisjet elektronike, pas heqjes nga përdorimi të Forcave të Armatosura”, në total në shumën prej 24,323,618 lekë. Nga institucioni është pasqyruar vlera prej 85,231,318 lekë në kolonën “Pakësime të tjera”, me një diferencë më shumë në vlerën 60,907,700 lekë, vlerë për të cilën nga subjekti i audituar nuk janë dhënë shpjegime dhe nuk ka dokumentacion bashkëlidhur të daljes ose transferimit të këtyre aktiveve. Veprime në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqet nr. 56-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes të marrë masat të menjëhershme për ngritjen e një grupi punë, me qëllim verifikimin e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit dhe bazuar në rezultatet e dala të marrë masat rast pas rasti, për të analizuar diferencat dhe të nxjerre përgjegjësitë disiplinore, të marre masa të shpërblimit të dëmeve apo të drejtohet organeve të tjera shtetërore për diferencat e pa justifikuar, si dhe të kryhen sistemet e nevojshme dhe regjistrimet në kontabilitet në bazë të klasifikimit ekonomik kontabël, duke identifikuar

burimin e pasaktësive dhe mospërputhjeve.

- Ministria e Mbrojtjes të marrë masat në vijimësi, që çdo vit përpara mbylljes së pasqyrave financiare, Përfaqësuesit/Atashetë Ushtarak duhet të paraqesin inventarizimin e aktiveve nën administrim, duke e rakorduar me vlerat e pasqyruara në kontabilitetin e mbajtur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, me qëllim sigurimin e plotësisë, paanësisë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

## Menjëherë dhe në vijimësi

**16. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i 8 (tetë) procedurave të prokurimit “Punë Mallra dhe shërbime”, në Ministrinë e Mbrojtjes me objekt: “*Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)*”; “*Rikonstruksion i ambienteve magazinuese rezerve shteti (Vendodhje DRRMSH Pukë)*”, “*Ndërtim hangari për mirëmbajtje dhe strehim helikopterësh UH60 Black Hawk*”, “*Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë*”, “*Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike*”, “*Ndërtim depo A-M në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat*”, “*Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat*”, “*Rikonstruksion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër*”, janë konstatuar se nga ana e njërive të prokurimit, kriteret e pjesëmarrjes nuk janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter. Gjithashtu mungojnë licencat e lëshuara nga QKL dhe operatorët ekonomik që kanë të punësuar “Auditues energjie”, nuk i kanë të pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjetik në ndërtesa”, në kundërshtim nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, neni 39, pika 4. Kriteret kualifikuese kanë kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk është stimuluar pjesëmarrjen e tyre. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente.

### Në vijimësi

**16.2. Rekomandimi:** AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërish, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

### Në vijimësi

**17. Gjetja nga auditimi:** Nga auditimi i 6 (gjashtë) procedurave të prokurimit “Punë Mallra dhe shërbime”, në Ministrinë e Mbrojtjes nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit me objekt “*Ndërtim i godinave shumëfunktionale për Akademinë e Mbrojtjes dhe Sigurisë (Fakulteti dhe Menca)*”, BOE i shpallur fituese “P.G.” & “J.” shpk, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. OE “P.G.” shpk, nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit lidhur me disponimin në stafin e shoqërisë të punonjësit “Auditues energjie”, pajisur me “Çertifikatë për Auditues Energjetik në ndërtesa”, lëshuar nga Agjencia për Eficencën e Energjisë. Në lidhje me mangësitë në plotësimin e kriterëve nga BOE pjesëmarrës në garë dhe shpallur fitues, nga KVO-ja nuk rezulton të jetë kërkuar asnjë sqarim nga ofertuesi apo NJP për të motivuar apo argumentuar vendimin e tyre.



b. Në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë”; Ndërtim palestere e Regjimentit Operacional Special”, në Repartin Ushtarak nr. 1040”; “Ndërtim palestere në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë” nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se operatori fitues nuk përmbushin kërkesat për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”.

c. Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion ambientesh për zyra për njësinë ushtarake të sigurisë kibernetike”, nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se operatori fitues “A.” shpk nuk përmbush kërkesën për kualifikim që dëshmitë e kualifikimit profesional/certifikatë/diploma, të jenë të lëshuara nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Sipas Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8, operatori fitues “A.” shpk ka deklaruar se ka drejtues teknik zj. B. A., me profesion Inxhinierë Ndërtimi profil transport. Sipas shkresës e sigurimeve shoqërore nr. 3860/1 prot. Datë 08.06.2022, konstatohet se zj. B.A, është e dy punësuar pranë Fakultetit të Inxhinierisë së ndërtimit dhe nuk është përcaktuar koha apo pozicioni i punësimit pranë Fakultetit. Referuar listëpagesës së OE “A.” shpk, rezulton se kjo punonjëse është e punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë.

d. Në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i objekteve nr. 4, 8 dhe 15, në Repartin Ushtarak nr. 1030, Poshnje, Berat” dhe “Ndërtim palestere në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall-Herr, Tiranë”, nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se operatorët të shpallur nuk plotëson të gjitha kërkesat sipas dokumenteve të tenderit, pasi operatorë kanë paraqitur të njëjta dokumente me procedurat të cilat po realizohen në të njëjtën periudhë kohore.

e. Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për xhenion (elemente për ura Bailey)” OE i shpallur fituese konstatohet se nuk plotëson kërkesat e DST. OE fitues si BOE; 3. – P. rezulton se nuk është prodhues, ku në skedën teknike tek “Letër angazhimi e Prodhuesit/Distributorit të autorizuar” të paraqitur ka vënë emrin e tij. Nga auditimi i dokumentacioneve të dorëzuar nga OE “T.D.” ShPK shtojca 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, “Mbi Konfliktin e Interesit” ka bërë deklaram të rremë pasi një nga ortakët e kompanisë është Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, post të cilin e mban që nga muaji Nëntorit 2021, në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 1, Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1. Rekomandimi:** AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

**Në vijimësi**

**17.2. Rekomandimi:** AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave të marrë masa, që në rastet e konstatimit të OE në kushtet e konfliktit të interesit, të ndjekë hapat ligjore për raportimin e tyre në organet kompetente, me qëllim përdorimin me eficence dhe efektivitet e fondeve publike.

**Në vijimësi**

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 3 (tre) procedurave të prokurimit “Shërbime”, në Institutin e Gjeografisë dhe Infrastrukturës Ushtarake (IGJIU) nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në përzgjedhjen e procedurave të prokurimit dhe kritere kualifikuese me objekt: “*Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA*”; “*Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë*”; “*Hartim Projekt-preventivi për Rikonstruksion objekti “Shtëpia e Ushtarakëve, Kuçovë*”, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar është përzgjedhur lloji i procedurës së prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” dhe jo “*Konkurs Projektimi*” në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore të hartimit të projekteve. Janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësive të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë në përputhje me LPP. Afati i realizimit të projekteve është përcaktuar në kohë shumë të shkurtër, cka tregon veprime të paargumentuara në përcaktimin e afatit për hartimin e projekt preventivit, ku nuk mund të zbatohen as fazat e shërbimit apo dorëzimit të projektit sipas VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim*”. Afati shumë i shkurtër i dorëzimit të projekt- preventivit ngushton konkurrencën, duke mos stimuluar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik. Gjithashtu konstatohet se në DT, procedura është trajtuar si kontratë *shërbimi mbikëqyrje apo kolaudimi*, ku është përcaktuar se të gjitha ofertat në vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar, e përlllogaritur mbi bazën e parashikimeve të VKM 354, do të skualifikohen, duke moskrijuar mundësi operatorëve ekonomik për propozime teknike dhe ekonomike të Projektit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1.Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë në procedurat e prokurimit të projekteve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që të përzgjedh projekte me propozime teknike (apo vlerësime me pike), në funksion të kërkesave të AK, duke propozuar oferta me kosto më të ulëta.

**Në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje materiale për mirëmbajtjen e përgjithshme*” zhvilluar në Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2023 me fond limit në vlerën e 64,418,286 lekë pa TVSH e përlllogaritur nga Komanda Mbështetëse, u konstatuan parregullsi përsa i përket dokumentimit të mënyrës së përlllogaritjes së vlerës së fondit limit. Në procesverbalin e mbajtur për përcaktimin e vlerës së fondit limit nga Komanda Mbështetëse cilësohet se komisioni nga data 18 janar 2023 deri me datën 08.02.2023 ka bërë testimin e tregut dhe në vazhdim tek tabela e paraqitur me çmimet e marra, nuk jepen të dhëna për operatorët ekonomikë nga të cilët është marrë oferta por vetëm përcaktime gjeografike nga janë marrë çmimet pra zona Tiranë-Vorë, Kinostudio, 21 Dhjetor dhe Kombinati, të cilat nuk janë të dokumentuar. Asnjë e dhënë nuk jepet për operatorët ekonomikë që kanë dhënë oferta tek komisioni për përlllogaritjen e vlerës së fondit limit. Gjithashtu nga komisioni nuk janë marrë në konsideratë çmimet për rreth 20 artikuj të dërguar nga INSTAT, si dhe çmimet e kontratës identike me nr. 4012/6, datë 12.09.2022. Veprime në kundërshtim me VKM-së 285, datë 19.5.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” neni 76.

- Mungon një raport/relacion mbi nevojat për prokurimin e mallrave që do të prokurohet, pasi referuar dokumentacionin të sjellë nga repartet ushtarake nevojat e paraqitura nuk janë të analizuar dhe të argumentuar mbi dokumentacione si: gjendja e mallrave në magazinë bazuar në kontratën identike të ekzekutuara një viti më parë, situacione apo kartela shoqërues të lindjes së nevojave për blerje të këtyre mallrave, si dhe elementëve të tjerë, të cilët nuk janë përjashtues.

- Përsëritja e kërkesave, për e mallrat, veglat ndërtimore, hidraulike dhe elektrikë, të cilat shumë herë dublohen dhe nuk janë analizuar, studiuar në lidhje me konsumin e tyre, pasi ekzistojnë shumë mallrat të cilat kane jetëgjatësi dhe nuk janë produkte konsumi.

Veprime ne kundërshtim me Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 i ndryshuar, neni 21, pika 2 dhe neni 35 pika 1 dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 2, pika 1 dhe pika 2 germa “a”, neni 13 pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1.Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Prokurimeve dhe Ankandeve në bashkëpunim me Komandën Mbështetëse të marrin masat që në të ardhmen, për procedurat e tenderimit në lidhje me blerjen e mallrave për mirëmbajtjen e përgjithshme, të dokumentohet analiza mbi nevojat e njëjësive për mallra, si dhe në përlogaritjen e fondit limit të përdorin mënyrën më efektive të mundshme, me qëllim mirë menaxhimit e fondeve publike.

**Në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në MM, rezultoi se:

- Rregulloja e Brendshme e MM nuk ka reflektuar ndryshimet e strukturës organizative, pasi nuk është bërë rishikimi i saj; duke sjellë mangësi në ndarjen e detyrave, përgjegjësive dhe linjën e raportimit të punonjësve. Në strukturë janë shtuar disa drejtori si Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Drejtoria e Planifikimit dhe Koordinimit të Emergjencave Civile dhe Drejtoria Operacionale e Drejtimit, për të cilat nuk janë reflektuar përshkrimet përkatëse të detyrave.

- Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në MM nuk ka paraqitur programe specifike për trajnimin e punonjësve të administratës;

- Nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe MM nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimit të riskut;

- Nuk janë përgatitur dhe nuk janë dërguar te NA, regjistri i riskut nga drejtoritë përkatëse, të cilët përmbledhen në regjistrin e riskut të vitit 2022 të MM-së;

- MM nuk disponon një regjistër kontabël të plotë aktiveve.

Veprimet në kundërshtim me pikën 2 të nenit 21, me pikën 2 të nenit 11, me pikën 1 të nenit 27, pikave nr. 1, 2 dhe 3 të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, si dhe me Manualin për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin, Kap. II, pika 2.5.1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 6, faqet nr. 174-179 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1.Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse të MM-së, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara, si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

**Brenda vitit 2024 e në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes, u konstatua se përgjegjësi i sektorit të financës është anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 për nëpunësin civil, neni 37, pika 3 ku citon se: *“Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra”.* *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 31-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të marrë masa për informimin e nëpunësit, i cili ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të ndërmarre hapat e menjëhershme për shmangien e kushteve të konfliktit të interesave (nëpërmjet ndërprerjes së angazhimeve si Anëtare e KB ose si mbajtëse e pozicionit të PSF).

**22. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratave të qirasë për pronat me sipërfaqe mbi 200 m<sup>2</sup>, u konstatua se nga Drejtoria e Miradministrimit të Pronave dhe Njësitë Monitoruese në Ministrinë e Mbrojtjes të cilat kanë në administrim pasuritë shtetërore nuk janë marrë masat e nevojshme për krijimin e kartelave të veçanta për secilën pronë të dhënë me qira, e cila duhet të jetë e inventarizuar me të dhënat përkatëse që nga momenti i lidhjes së kontratës me ndryshimet e ndodhura gjatë periudhave. Gjithashtu, grupi i auditimit konstatoi mangësi në dokumentacionin përkatës në rend kronologjik, si akt-monitorimet, së bashku me raportet e hollësishme për ecurinë e tyre, procesverbalet përkatëse me dorëzimet e objekteve/pasurive shtetërore ku përshkruhet gjendja fizike e pronës, vlera kontabël përkatëse e raportuar në pasqyrat financiare, duke shkaktuar mungesë të gjurmës së auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM-së nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, kreu VI, pika “c” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqet nr. 44-56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**22.1.Rekomandimi:** Nga ana e Drejtorisë së Miradministrimit të Pronave në bashkëpunim me Strukturat Përgjegjëse, të merren masat e nevojshme për krijimin e kartelave të veçanta për secilën pronë ose aset të dhënë me qira, me qëllim krijimin e gjurmës së auditimit në funksion të rritjes së efektivitetit në monitorimin e tyre.

Në vijimësi

**23. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i funksionimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Mbrojtjes rezultoi se: Auditimi është i organizuar në rang Drejtorie dhe përmban në organikën e saj 9 punonjës, sipas Urdhrit të Kryeministrit me Kryeministrit nr. 167, date 05.10.2017 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 94, datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”. Nga auditimi u konstatua se, DAB ka funksionuar me strukturë të paplotësuar, ku struktura është e paplotësuar për tre punonjës nga të cilët: 2 përgjegjës sektori dhe një auditues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 7, faqet nr. 179-187 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**23.1.Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes të marrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim plotësimin e strukturës të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me personel me qëllim mbarëvajtjen e punës së kësaj drejtorie dhe të gjithë institucionit për shkak të rolit të rëndësishëm që kjo drejtori ka në evidentimin e problematikave të menaxhimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

**24. Gjetje nga auditimi:** Në kuadër të programit interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020”, me urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes me nr. 1991, prot., 2152/1, datë 31.12.2019 dhe me nr. 33, datë 14.01.2022 është ngritur grupi i punës në përbërje prej shtatë anëtar për menaxhimin dhe koordinimin e projektit “TO BE READY”, i cili do të zbatohet aktivitetet e parashikuara në kuadër të Projektit Tematik. Si anëtare të grupit të punës është caktuar Këshilltari për Median i Ministrit të Mbrojtjes, si asistent komunikimi i projektit për vitin 2019-2021 dhe si menaxher projekti për vitin 2022. Zgjedhja e një këshilltari si anëtar grupi pune është në kundërshtim me ligjin nr. 90/2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore” neni 11, pika 4.

- Me urdhrin e Sekretarit të Përgjithshëm me nr. 266, prot., 483/1, datë 27.02.2020 është urdhëruar, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, që në kuadër të bashkëfinancimit të Ministrisë së Mbrojtjes për projektin "TO BE READY", të llogarisë kontributin financiar për punonjësit e angazhuar në Grupin e Punës për zbatimin e aktivitetëve të Projektit Tematik "To

Be Ready", sipas Raportit Kohor (Time-Sheet) përkatës çdo muaj. Nga grupi i punës i ngarkuar me urdhër të Ministrit nuk është bërë asnjë raport mbi realizimin e projektit dhe hapat që janë realizuar gjatë kësaj periudhe në lidhje me këtë projekt, duke ndikuar dhe në mosrealizimin në kohë të projektit. Në FLC janë dërguar për miratim deklaratat e pagesës dhe kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të personave të përfshirë në grupin e punës në vlerë totale, për 8 orë pune në ditë si të angazhuar për projektin dhe jo e ndarë në orë pune sipas Time-Sheet që janë 2 orë në ditë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin dhe dokumentimin e punës së realizuar nga personat e ngarkuar për projektin "To Be Ready" bazuar në urdhrat e Titullarit të institucionit. Të nxjerrë përgjegjësit dhe të definojë qartë personat përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe administrimin e projektit, bazës së të dhënave për marrëveshjet e bashkëfinancimit, në mënyrë që të kemi një raportim mbi gjendjen e përgjithshme të marrëveshjeve të bashkëfinancimit të përfutur nga institucioni.

**Menjëherë**

**25. Gjetje nga auditimi:** Në kuadër të programit Trilateral interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020" nga Ministria e Mbrojtjes janë kontraktuar "Menaxher Projekti"; "Financier Projekti" dhe "Menaxherit të Komunikimit" për projektin në projektin "TO BE READY-The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergency management - 355", nga auditimi i dokumentacionit të kontraktimit të ekspertëve të projektit rezultoi se:

- Kandidati i përzgjedhur dhe kontraktuar si financier projekti znj. L. Dh. është në kundërshtim me Rregulloren "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionarit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil" miratuar me Vendimin nr. 11, datë 29.01.2016, neni 15 "Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklarim periodik të interesave private" pika 2 dhe neni 16 "Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të interesit Zyrtarët e KMSHC-së" pika b.

- Në dosje mungonte baza ose një analizë, mbi të cilën është bërë përlllogaritja vlerës së shërbimit.

- Kontrata tip e lidhur me menaxherin e projektit, financierin e projektit dhe menaxherin e komunikimit të projektit janë lidhur nga Burimet Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, si kontrata *pune individuale (staff cost)*, sipas ligjit Shqiptar, dhe jo si kontratë shërbimi të përcaktuar në Ligji nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Para anëtarësimit (IPA II)"; Rregullave PRAG dhe Udhëzimeve të BE-së, si dhe Manuali i Programit të projektit Interreg IPA CBC Italy-Albania – Montenegro". (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes, të marren masa për ngritjen e një grupi pune për verifikimin dhe analizimin e përzgjedhjes së ekspertëve të projektit, si dhe mënyrën se si është përlllogaritur fondi limit për ekspertët e kontraktuara nga Ministria me kontratë *pune individuale (staff cost)*.

- Grupi i punës të verifikojë nëse personi i kontraktuar në kushtet e konfliktit të interesit ka të dokumentuar deklaratën që ndodhet në këto kushte dhe më pas të merren hapat e mëtejshëm për raportimin e rasteve pranë organeve kompetente. Ministria e Mbrojtjes të marrë masa për informimin e nëpunësit të kontraktuar, i cili ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe të ndërmarre hapat e menjëhershme për shmangien e konfliktit të interesave.

**Menjëherë**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të realizuar për programin “Trilateral interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali I Zi 2014-2020” nga Ministria e Mbrojtjes për projektin në projektin "TO BE READY-The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergency management - 355" u konstatua se:

- Në disa raste bashkëlidhur dokumentacionit të procedurës së prokurimit të realizuar mungon dokumentacioni i termave të referencës dhe specifikimeve teknike, si dhe në një procedurë aneksi i termave të referencës është firmosur dhe është bërë deklarata për objektivitetin dhe konfidencialitetin vetëm nga njëri nga anëtarët e grupit.

- Përzgjedhja e OE fitues në lidhje me procedurën “*Studimi dhe krijimi i fjalorit të shtypur dhe elektronik për rrezikun ndaj zjarreve dhe përmbajtjeve*” shpallur fituesi “L.S.” shpk në vlerën 1,363,735.68 lekë; “*Studimi dhe krijimi i hartës teknike me informacion mbi menaxhimin e rasteve të zjarreve dhe vështirësive të fluturimit mbi këto zona*” shpallur fituesi G.-P. në vlerën 4,878,998.59 lekë; “*Educational products*” shpallur fituesi “F.S.” në vlerën 4,198,350 lekë, rezultoi mosplotësimi i kriterëve bazuar në termave të referencës të hartuara nga grupet e ngritura nga titullari i AK “*Për hartimin e termave të referencës për prokurimin...*”

- OE fitues nuk kishin realizuar shërbimin brenda afatit të përcaktuar në kushtet e veçanta të kontratës së lidhur mes palëve.

- Në një procedurë, nga AK i është dërguar ftesa për pjesëmarrje në tender në fazën e dytë një OE, i cili nuk ka ofertuar në fazën e parë. Në dosje nuk ka asnjë dokumentacion, se si është bërë përzgjedhja e këtij OE nga grupi i punës. Grupi i punës “Për vlerësimin e ofertave të paraqitura për procedurën...” ka përzgjedhur si ofertë të suksesshme pikërisht këtë OE të ftuar në fazën e dytë për marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, duke cituar se plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të përcaktuara. Në dosje mungon dokumentacioni i OE të s’kualifikuar nga tenderi, për të vërtetuar arsyet e s kualifikimit, e cila ka sjellë mos hapjen e ofertave ekonomike nga këta OE. Nga OE të s kualifikuar rezulton se nga AK me një nga OE janë lidhur kontrata, ku bazuar në procesverbalin e vlerësimit të grupit pikat për të cilat ky OE është s kualifikuar në këtë tender, në procedurat e tjera, nga grupi janë konfirmuar që i plotëson këto kriterë, të cilat kanë qenë të njëjta në të gjitha këto tendera.

- Në një procedurë të realizuar bazuar në planin e veprimit të projektit “TO BE READY” të përcjellë nga menaxherja e projektit dhe të raportuar si të realizuar tek projekti është bërë shtesë e një zëri në vlerën 14,619 euro pa TVSH, e cila nuk ka qenë parashikuar në planin e veprimit dhe nuk është përlllogaritur si vlerë e realizuar për projektin.

- Në lidhje me realizimin e Procedurës “T.2.3.1 External Expertise and sevice në kuadër të projektit “To be ready” është kontraktuar një palë e tretë, ku referuar ligjit nr. 8907, datë 06.06.2002 “*Për Funksonimin e Institutit Gjeografik Ushtarak të Shqipërisë*” neni 7, rezulton se nga AK kontraktimi i një pale të tretë për realizimin e këtij shërbimi është në shkelje të ligjeve dhe akteve nënligjore, pasi objekti i kësaj procedure është objekt i veprimtarisë së IGJU-se për të gjithë territorin e vendit. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**26.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë e Mbrojtjes të marrë masa në vijimësi, që të sigurojë implementimin e projekteve bazuar në objektivat e programit dhe realizimin e tyre në kohë. Procedurat të realizohen mbi bazën e një vlerësimi të drejtë dhe të barabartë mes OE që marrin pjesë në tender, bazuar në procedura të hapura dhe transparente.

**Menjëherë**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i raportimeve të shpenzimeve në FLC në lidhje me programin Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020” të projektit “TO BE READY” u konstatua se:

- Për “Procedurën “WP -T.1.4.1 “Automjeteve Pick Up 4x4 për përgjigjen ndaj zjarreve” ku është lidhur kontrata në vlerën 238,050 euro. Nga Agjencia Kombëtare Mbrojtjes Civile

(AKMC) në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 254,014 Euro e konvertuar në lekë në vlerën 27,687,596 lekë pa TVSh. *Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC.*

- Për "Procedurën "WP -T.1.4.2 "Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile" dhe WP -T.1.7.1 "Blerje e pajisjeve për dhomën e monitorimit", ku lot1 është në vlerën 245,500 Euro dhe lot 2 në vlerën 19,100 Euro pa TVSH në total 264,600 Euro pa TVSH. Nga informacioni i dërguar në FLC u konstatua se në "*procedura e plotë për dhomën e monitorimit dhe video sensor camera*", Inv No; 251/229, datë 02.08.2023 në vlerën 42,100.52 euro pa TVSh e konvertuar në 4,588,957 lekë pa TVSh, rezultoi se; Në FLC është hedhur vlera "Vat" 6,118,610 lekë, vlerë e cila paguhet nga buxheti i shtetit. Kjo vlerë e reflektuar në FLC është gabim pasi shumica e TVSH duhet të ishte në vlerën 917,791 lekë.

Sa më sipër vlera e reflektuar më shumë në shumën prej 5,200,819 lekë është e pajustificuar dhe argumentuar duke rritur fondin, që duhet të paguajë buxheti i shtetit me efekt negative në përdorimin dhe menaxhimin e fondeve buxhetore. Gjithashtu rezultoi se në FLC nuk është regjistruar vlera e plotë e kontratës prej 264,600 Euro pa TVSH, por vetëm vlera prej 42,100.52 euro pa TVSH. Diferenca 222,499.48 Euro nuk është deklaruar në FLC për tu rimbursuar nga projekti, si rrjedhojë e gjithë vlera do të jetë detyrim i buxhetit të shtetit.

- Për "Procedurën "WP -T.1.4.2 "Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile" dhe EP -T.1.4.1 "Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile" është lidhur kontrata me datën 16.06.2022 prot., 1507/1, për "*Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile*" Portabel water pump 2 copë në vlerën 79,000; Trush pump for Flooding terrain 2 copë në vlerën 9,600 euro, total në vlerën 88,600 euro dhe kontrata me datën 16.06.2022, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/02 "Blerje e pajisjeve për operatorët e emergjencës civile" "*Plastic motor boat; Inflatable Boats Drysuits*" në vlerën 75,350 euro.

Nga AKMC për kontratën në vlerën 75,350 euro, në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 81,025 euro e konvertuar në lekë në vlerën 8,831,773.5 lekë pa TVSh.

Për kontratën në vlerën 88,600 euro, në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 89,277.9 euro e konvertuar në lekë në vlerën 10,384,806 lekë pa TVSh.

*Pra siç shihet ka një mospërputhje mes vlerës së kontraktuar dhe të deklaruar në FLC.*

- Për "Procedurën "WP -M "Managment", ku mes OE/ K. A. shpk dhe AKMC, është lidhur kontrata me nr. 1507/2, datën 15.09.2022, për "*Blerje Shërbime Auditimi*" në vlerën 59,850 euro pa TVSH.

Në raportin e dërguar nga FLC "Expenditure verification / Audit IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SRV06" first payment and second payment, në FLC në komente është vënë "Mungojnë dokumente, për t'u verifikuar në periudhën e ardhshme raportuese", dhe nuk është raportuar "Shuma e Çertifikuar FLC". Shuma e deklaruar në Euro është në shumën 63,909 euro, ndërsa kontrata e lidhur është në shumën 59,850 euro pa TVSH.

- Për "Procedurën "Work Package Comunication" është lidhur kontrata me nr. 1507/3, datën 15.09.2022, për IPA ITMNEAL/TBR-MOD/SUP/05 "*Work Package Comunication*" në vlerën në vlerën 48,500 euro. Në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 51,598 euro e konvertuar në lekë në vlerën 5,624,157 lekë pa TVSh.

-Për procedurën "T.1.1 "Analiza e territorit dhe fushatë semantike për përcaktimin e raportit të alarmit" është lidhur kontrata me nr. 2873/7, datë 02.08.2021 në vlerën 890.000 lekë pa TVSH. Në FLC nga AKMC është deklaruar vlera për rimbursim në vlerën 7,651.31 Euro. Në komentin në sistemin e FLC është cituar se procedura nuk është e plotë. Mungon njoftimi ku është publikuar dhe procedura që është ndjekur, mungojnë dokumentet e subjekteve konkurruese dhe vlerësimi i tyre. Mungon produkti etj. Në FLC është ulur vlera prej 1,171 euro nga ky tender. Grupit nuk i është dhënë asnjë koment në lidhje me këtë komente dhe rimbursime të vlerës nga projekti.

- Për procedurën WP-C "*Public Event*" është lidhur kontrata me nr. 931/18, datë 23.10.2023,

në vlerën 12,100 Euro. Nga AKMC nuk është raportuar si procedurë e realizuar dhe finalizuar në FLC.

- Për procedurën “C1 “Educational products” është lidhur kontrata me nr. 753/13, datë 23.06.2023, në vlerën 32,500 euro. Nga AKMC nuk është raportuar si procedurë e realizuar dhe finalizuar në FLC. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**27.1.Rekomandimi:** Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes dhe i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të marrin masa për vlerësimin e situatës aktuale, nxjerrjen e përgjegjëseve, si dhe të bashkërendojnë veprimet për të siguruar implementimin në kohë të projekteve bazuar në objektivat e programit, si dhe raportimin në kohë të tyre në FLC, me qëllim shmangien e vonesave për certifikimin e programit dhe vonesave të rimbursimit të fondeve.

**Menjëherë**

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Mbrojtjes për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, rezulton se Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr. 2622/2, datë 30.08.2022, ka paraqitur planin e masave, jashtë afatit 20 ditë, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Ministria e Mbrojtjes bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion nuk ka dërguar pranë KLSH informacion mbi zbatimin e rekomandimeve brenda afatit 6 mujor, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 30, pika 2 e Ligjit nr.154 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Rezulton se KLSH me shkresën nr. 2622 prot., datë 19.05.2022 ka lënë gjithsej 58 rekomandime: 41 masa organizative, nga të cilat 38 masa rezultojnë të zbatuara plotësisht, 1 masë organizative rezultojnë në proces zbatimi, 2 masa të zbatuara pjesërisht dhe 10 masa organizative rezultojnë të pazbatuara; 5 masa për shpërblim dëmi nga të cilat 1 masë është zbatuar dhe 4 masa janë të pazbatuara; 2 masa për eliminimin e efekteve negative në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, 2 masa nuk janë zbatuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 217-224 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**28.1.Rekomandimi:** Nëpunësi Autorizues të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe **rikërkojmë** zbatimin e rekomandimeve që janë të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e zbatimit të atyre në proces zbatimi, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe forcimin e disiplinës buxhetore dhe fiskale.

**Menjëherë**

## **C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, germa b) dhe c) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e Titullarit të njësisë publike Ministrisë së Mbrojtjes, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **38,552,676 lekë** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Kontratës së shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “Hartim Projekt-preventivi ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për



*UAV në Bazën Ajrore Kuçovë*”, nuk janë përmbushur parashikimet ligjore të VKM-së me nr. 354, datë 11.05.2016 “*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”. Me raportin nr. 423/10 prot. Datë 25.05.2023, miratohet procedura e prokurimit nga titullari i IGJIU dhe kontrata nënshkruhet me OE fitues “A. E.” shpk me nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 me vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, ku nuk është përcaktuar asnjë kalendar pagesash e ndarë në faza. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim nr. 423/8 prot., datë 25.08.2023 nga grupi i marrjes në dorëzim, konstatohet se janë realizuar shërbimet: Analiza e detyrës projektimit dhe termat e referencës; Projekt Idea paraprake; Projekt Idea Përfundimtare; Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; Projekt Zbatimi; Preventivi përfundimtar; Përgatitja e dokumentacionit për procedurë tenderimi. Fatura tatimore e operatorit ekonomik mban nr. 38/2023 datë 04.09.2023, me vlerë total 15,884,200 pa TVSH ose 19,061,040 lekë me TVSH dhe kërkesa për likuidim nr. 423/19 prot., datë 04.09.2023, e cila është e likuiduar plotësisht gjithë vlera e kontratës nga financa e IGJIU. Në lidhje me dorëzimin e projektit konstatohet se në zbatim të VKM-së me nr. 354, datë 11.05.2016 “*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”, neni 7, “*Përcaktimi i Tarifave*” pika 5, dhe pika 8, nga AK, nuk është marrë asnjë masë për rilloaritjen e vlerave të projektimit. Referuar Projekt – Preventivit të dorëzuar nga projektuesi “A.E.” shpk, konstatohet se vlera e Investimit për objektin “*Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për UAV në Bazën Ajrore Kuçovë*”, rezulton në vlerën 345,647,428 lekë me TVSH. Pra kjo është kostoja përfundimtare e cila do të rilloaritjet vlera e shërbimit të projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudit. Në bazë të kostove të objektit, është llogaritur tarifa e projektimit, nga grupi i auditimit dhe specialistë të IGJIU, si më poshtë: I. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira shuma 258,106,339 lekë me TVSH, II. Rruga taxiway parkimet shuma 90,209,677 lekë me TVSH, III. Platforma me hangarin dhe objektet e përfshira + Rruga taxiway parkimet shuma 345,647,428 lekë me TVSH. Në bazë të vlerave sa më sipër rezultojnë tarifat e projektimit si më poshtë: Totali Min 7,393,174 lekë dhe Max 9,010,110 lekë. Mos llogaritja e kostove përfundimtare të ndërtimit dhe rrjedhimisht edhe kostove të shërbimit të projektimit, kanë sjellë përfitim të padrejtë në favor të projektuesit. Kontrata e shërbimit nr. 423/12 prot. Datë 08.06.2023 midis OE “A.E.”, dhe Titullarit të IGJIU, u nënshkrua me çmimin e ofertuar nga kontraktuesi dhe i miratuar nga AK, në vlerën 15,884,200 lekë pa TVSH, pra me diferencë  $(15,884,200 - 7,393,174) = 8,491,026$  lekë pa TVSH ose **10,189,231 lekë me TVSH**, e cila përbën Dëm Ekonomik për Buxhetin e Shtetit, e përfituar padrejtësisht nga projektuesi “A.E.” shpk. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Instituti Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrë masa të analizojë me grup pune të veçantë, shkaqet dhe arsyet e mos llogaritjeve të kostove përfundimtare të shërbimit të projektimit dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës prej **10,189,231 lekë me TVSH** e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “A. E.”.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Kontratës së shërbimit me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me objekt: “*Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë të AFA*”, nuk ka përmbushur parashikimet ligjore të VKM-së me nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*”. Me raportin përmbledhës nr. 200/8 prot., datë 27.06.2022, miratohet procedura e prokurimit nga titullari i IGJIU. Formulari i njoftimit të fituesit është realizuar me nr. 200/9 prot., datë 01.07.2022 dhe kontrata e shërbimit realizohet me nr. 200/11 prot., datë 22.07.2022 me vlerën 5,698,405 lekë me TVSH me OE fitues “I. D.-A.” shpk. Me shkresën e OE “I.D.-A.” shpk, nr. 468 prot., datë 20.09.2022, dorëzohet

dokumentacioni i kontratës së shërbimit që bashkëngjijt vetëm Analizën e Detyrës së projektimit dhe Projekt idenë paraprake. Inventari i dosjes përmban vetëm 13 relacione të godinave për gjendjen ekzistuese dhe një planimetri IDE të tyre. Me procesverbalin e marrjes në dorëzim të shërbimit nr. 200/23 prot., datë 13.10.2022 për objektin “*Hartim Projektide paraprake për kampusin e ri të Fakultetit të Mbrojtjes dhe sigurisë të AFA*”, konstatohet se është dorëzuar detyra e projektimit dhe termave të referencës dhe projekt ideja paraprake për kampusin. Sa më sipër nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga marrja në dorëzim e projekt idesë hartuar nga OE “I.D.-A.” shpk, Analiza e Detyrës së projektimit dhe Projekt idea paraprake, ka ngjashmëri me Detyrën e projektimit realizuar në Mars 2022 nga IGJIU, çka tregon mbivendosje të idesë apo shërbimit të projekt idesë. Projekt Idea e përgatitur nga OE “I.D.-A.” shpk nuk paraqet situatë të saktë dhe nevojat reale për ndërhyrje, pasi kryesisht përshkruan gjendjen ekzistuese të godinave dhe nevojën për rikonstruksion, gjë e cila është hartuar ose konstatuar nga vetë IGJIU dhe nuk ka hartuar asnjë kosto paraprake të Investimeve. Referuar VKM nr. 354 datë 11.05.2016 “*Miratimin e Manualit të tarifave për shërbime në Planifikim Territori, Projektim, Mbikëqyrje dhe Kolaudim*” Nenit 25 dhe Nenit 49 “*Shërbimet për planifikimin e strukturave mbajtëse*” nga operatori ekonomik fitues, nuk është përcaktuar asnjë kosto apo ide paraprake e investimeve apo variante të ndryshme të projekt idesë. Gjithashtu nuk është realizuar asnjë relacion statiko-konstruktive mbi problemet e qëndrueshmërisë së godinave dhe në përfundim projekti përfundimtar i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU. Projekti i zbatimit përfundimtar është zbatuar nga vetë IGJIU, fillimisht për 3 objekte më datë 26.06.2022 në vlerën e investimit prej 1,438,894,719 lekë me TVSH dhe në përfundim për 2 objekte (Akademia, Menza) datë 17.07.2022 në vlerën e Investimit prej 741,534,842 lekë me TVSH. Pra nuk ka argumentim se për çfarë shkak duhet të prokurohej shërbimi i hartimit të projekt idesë kur projekt - preventivi i zbatimit është realizuar nga vetë IGJIU, ç’ka tregon keqmenaxhim të fondeve publike në vlerën **5,698,405 lekë me TVSH**, e përfituar padrejtësisht nga OE “I.D.-A.” shpk. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, Institutit Gjeografik Ushtarak i Shqipërisë të marrin masa për ngritjen e një grupi pune, me specialist të fushës për vlerësimin e dokumentacionit shtesë të shërbimit të projektidesë në vlerën **5,698,405 lekë me TVSH**, e cila nga dokumentacioni i vënë në dispozicion grupit të auditimit rezulton si shërbim i papërfunduar sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nëse shërbimi projekt idesë pas vlerësimit të grupit me ekspertë rezulton i paplotësuar bazuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, të merren masa ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga operatori ekonomik “I.D.-A.” shpk.

### **Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: “*Ndërtim grup-depo për pajisjet e Kërkim-Shpëtimit, në Repartin Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë*” lidhur midis Autoritetin Komandës Mbështetëse dhe OE “E. K.” shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi:

- Në situacionin përfundimtar, kapitulli C “*Klasat + Zyrat*”, zëri nr. 4, “*Transport dheu me auto deri 5 km*”, librezja e masave pasqyron sasinë prej 2,007 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 2,007 m<sup>3</sup>, si produkt i shumave të gërmimit dhe mbushjes dheut. Konkretisht: Zëri nr. 1 “*Gërmim themele e plinta me eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>, shkarkim*” në sasinë 1,215 m<sup>3</sup>, Zëri nr. 2 “*Gërmim dheu me krahe e transport karrocë*” në sasinë 2.96 m<sup>3</sup>, Zëri nr. 3 “*Mbushje, ngjeshje dheu*” në sasinë 789.82 m<sup>3</sup>. Total transporti = 1,215 m<sup>3</sup> + 2.96 m<sup>3</sup> + 789.82 m<sup>3</sup> = 2,007 m<sup>3</sup>. Referuar faktit, projektit dhe kushteve teknike të zbatimit, konstatohet qartazi se zëri nr. 3 “*Mbushje, ngjeshje dheu*” në sasinë 789.82 m<sup>3</sup>, është zë punimi i cili nuk është transportuar por zë punimi i përdorur dhe vendosur në kantier. Rrjedhimisht sasia prej 789.82

m<sup>3</sup> e situacionuar për transport dheu, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 900 lekë /m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 710,838 lekë pa TVSH.

- Në situacionin përfundimtar, kapitulli D "Depo Magazinimi", zëri nr. 3, "Transport dheu me auto deri 5 km", situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 1,372.8 m<sup>3</sup>, si produkt i gërmimit dhe mbushjes dheut. Konkretisht: - Zëri nr. 1 "Gërmim themele e plinta me eskavator me goma 0.25 m<sup>3</sup>, shkarkim" në sasinë 1,226.54 m<sup>3</sup>, - Zëri nr. 2 "Mbushje, ngjeshje dheu" në sasinë 169.92 m<sup>3</sup>. Total transporti = 1,226.54 m<sup>3</sup> + 169.92 m<sup>3</sup> = 1,396.46 m<sup>3</sup>. Referuar faktit, projektit dhe kushteve teknike të zbatimit, konstatohet qartazi se zëri nr. 3 "Mbushje, ngjeshje dheu" në sasinë 169.92 m<sup>3</sup>, është zë punimi i cili nuk është transportuar por zë punimi i përdorur dhe vendosur në kantier. Rrjedhimisht sasia prej 169.92 m<sup>3</sup> e situacionuar për transport dheu, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 900 lekë /m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 152,928 lekë pa TVSH.

- Në situacionin përfundimtar, kapitulli C II "Klasat + Zyrat, Punime Murature", zëri nr. 1, "Mur me tulla të lehtësuara t = 20 cm me ll.p.M25 (Muret perimetrale dhe parapet i tarracës)", librezat e masave pasqyron sasinë prej 103.7 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 103.7 m<sup>3</sup>. Nga auditimi i librezave të masave dhe projektit konstatohet se në zërin "Brez b/a C20/25 në mure" është situacionuar një sasi e paargumentuar prej 45.86 m<sup>3</sup> brez betoni për mure dhe ky volum punimi nuk është zbritur në volumin e mureve perimetrale. Rrjedhimisht sasia prej 45.86 m<sup>3</sup> e situacionuar për Mur tulle, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej 11,000 lekë /m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 504,460 lekë pa TVSH. Në situacionin përfundimtar, kapitulli C XIII "Kabina Elektrike", zëri nr. 1, "FV Tabela paralajmëruese", zëri nr. 2 "FV përcjellës shirit bakri 30x3", zëri nr. 4 "FV përcjellës bakri i zhveshur", zëri nr. 5 "FV Morseteri tokëzim", në vlerë totale i gjithë kapitulli i kabinës elektrike rezulton në 71,000 lekë. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **1,727,071 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të parrealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **1,727,071 lekë me TVSH** nga kontraktori OE "E. K." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

#### Menjëherë

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "Rikonstruksion rruge në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr, Tiranë" lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe Operatorit Ekonomik "D." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatua disa pasaktësi. Në preventivin e ripunuar, kapitulli "Punime Dherash dhe shtresash", zëri nr. 3, nr. 3.211 "Shtresë cakëlli mbeturinë kave t=2x20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri". Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Autoritetin Kontraktor, janë përshkruar sipërfaqet e profileve tërthore të piketave të rrugës. Nga verifikimet e gjendjes ekzistuese fillestare konstatohet se tabani i rrugës dhe shtresat e bazës kanë qenë të qëndrueshme dhe solide ku kalojnë vazhdimisht mjetet e rënda ushtarake dhe nevoja për 2 herë shtresë çakulli përbën risk për përfitime të padrejta të kontraktorit. Gjithashtu në rrugë nuk janë realizuar karrotazhe apo teste të cilat mund të vërtetojnë hedhjen e çakullit në të gjithë rrugën me trashësi totale 40 cm. Situacioni përfundimtar përmban sasinë prej 8,745.6 m<sup>3</sup> dhe librezat e masave përmban sasinë prej 8,745.88 m<sup>3</sup>. Referuar profilit gjatësorë dhe tërthorë të projektit të azhurnuar dhe llogaritjeve në librezën e masave u konstatuan disa pasaktësi në rrugët dalëse me sipërfaqe të matura me pajisje topografike GPS. konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër volumin e punimeve në sipërfaqet dalëse të rrugës. Volumi i përfituar më tepër rezulton 421.2 m<sup>3</sup>

(8,746.12 m<sup>3</sup> - 8,324.62 m<sup>3</sup>), me çmimin përkatës prej 390 lekë/m<sup>3</sup>, rezulton se sipërmarrësi ka përfituar më tepër vlerën prej 164,385 lekë pa TVSH. Në preventivin e ripunuar, kapitulli "Punime Dherash dhe shtresash", zëri nr. 8, nr. 3.244 "Struktura monolite betoni C20/25". Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në Autoritetin Kontraktor, konstatohet se situacioni përfundimtar përmban sasinë prej 137 m<sup>3</sup> dhe librezat e masave përmban sasinë prej 137.14 m<sup>3</sup>. Në llogaritjet e librezës së masave konstatohet pasaktësi në llogaritje pasi është përcaktuar sipërfaqja e një seksioni të kanalit në sip. = 0.316 m<sup>2</sup>. Në fakt gjatësia në seksion të kanalit është L=2.7 ml dhe trashësia e betonit H= 0.1ml dhe rezulton sasia e sipërfaqes prej sip. 0.27 m<sup>2</sup> (2.7 ml x 0.1ml). Sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht volumnin e betonit me 19 m<sup>3</sup> (137.14 m<sup>3</sup>-118.09 m<sup>3</sup>) dhe me çmimin përkatës 9,500 lekë/m<sup>3</sup>, rezulton vlera prej 180,500 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **413,862 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **413,862 lekë me TVSH** nga kontraktori OE "D." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

#### Menjëherë

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "Rikonstruksion objekte ndërtimore në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau-Dejës, Shkodër" lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe BOE "B." shpk & "M." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi.

- Në situacionin përfundimtar, objekti 13, 27 "Truproja", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren t=5cm", librezat e masave pasqyrojnë sasinë prej 19 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 19 m<sup>3</sup>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës 380 m<sup>2</sup> x 0.05 m = 19 m<sup>3</sup>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej 355 m<sup>2</sup>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren t=5cm", duhej të llogaritej 355 m<sup>2</sup> x 0.05 m = 17,75 m<sup>3</sup>. Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej 19 m<sup>3</sup> - 17,75 m<sup>3</sup> = 1.25 m<sup>3</sup> dhe me çmimin përkatës prej 10,000 lekë/m<sup>3</sup> rezulton vlera prej 12,500 lekë.

- Në situacionin përfundimtar, objekti 13, 27 "Truproja", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 3, "Shtresë llustër çimento 1:2", librezat e masave pasqyrojnë sasinë prej 380 m<sup>2</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 380 m<sup>2</sup>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës 380 m<sup>2</sup>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqe e tarracës prej 355 m<sup>2</sup>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë llustër çimento 1:2", duhej të llogaritej 355 m<sup>2</sup>. Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej 380 m<sup>2</sup> - 355 m<sup>2</sup> = 25 m<sup>2</sup> dhe me çmimin përkatës prej 500 lekë/m<sup>2</sup> rezulton vlera prej 12,500 lekë pa TVSH.

- Në situacionin përfundimtar, objekti 25, "Godinë shumë funksionale", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren t=5cm", librezat e masave pasqyrojnë sasinë prej 41 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë sasinë 41 m<sup>3</sup>, duke llogaritur sipërfaqen e tarracës 820 m<sup>2</sup> x 0.05 m = 41 m<sup>3</sup>. Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës prej 780 m<sup>2</sup>. Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren t=5cm", duhej të llogaritej 780 m<sup>2</sup> x 0.05 m = 39 m<sup>3</sup>. Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej 41 m<sup>3</sup> - 39 m<sup>3</sup> = 2 m<sup>3</sup> dhe me çmimin përkatës prej 10,000 lekë/m<sup>3</sup> rezulton vlera prej 20,000 lekë pa TVSH.

- Në situacionin përfundimtar, objekti 14, 15 dhe 16, "Godinë në formë U", kapitulli "Punime

Tarrace", zëri nr. 1, "Shtresë termoizoluese me polistiren  $t=5\text{cm}$ ", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $41\text{ m}^3$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $76\text{ m}^3$ , duke llogaritur sipërfaqen e tarracës  $525\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 26\text{ m}^3$ ,  $625\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 31\text{ m}^3$ ,  $365\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 18\text{ m}^3$ , në total  $76\text{ m}^3$ . Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqe e tarracës prej  $360\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 18\text{ m}^3$ ,  $615\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 30.8\text{ m}^3$ ,  $515\text{ m}^2 \times 0.05\text{ m} = 25.8\text{ m}^3$ , në total  $74.6\text{ m}^3$ . Rrjedhimisht edhe zëri "Shtresë termoizoluese me polistiren  $t=5\text{cm}$ ". Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej  $76\text{ m}^3 - 74.6\text{ m}^3 = 1.4\text{ m}^3$  dhe me çmimin përkatës prej  $10,000\text{ lek}/\text{m}^3$  rezulton vlera prej 14,000 lekë pa TVSH.

- Në situacionin përfundimtar, objekti 14, 15 dhe 16, "Godinë në formë U", kapitulli "Punime Tarrace", zëri nr. 3, "Shtresë llustër çimento 1:2", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $1,515\text{ m}^2$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $380\text{ m}^2$ , duke llogaritur sipërfaqen e tarracës  $380\text{ m}^2$ . Në fakt referuar librezës së masave, zëri "Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresë katrama" dhe projektit të azhurnuar pasqyrohet sipërfaqja e tarracës  $360\text{ m}^2 + 615\text{ m}^2 + 515\text{ m}^2 = 1,490\text{ m}^2$ . Pra sipërmarrësi ka përfituar padrejtësisht sipërfaqen prej  $1,515\text{ m}^2 - 1,490\text{ m}^2 = 25\text{ m}^2$  dhe me çmimin përkatës prej  $500\text{ lek}/\text{m}^2$  rezulton vlera prej 12,500 lekë pa TVSH.

Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **85,800 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të porealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **85,800 lekë me TVSH** nga kontraktori BOE "B." shpk & "M." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

#### Menjëherë

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau Dejës, Shkodër" lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe BOE "S.U." shpk & "B." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi.

- Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime gjurmimi", zëri nr. 1, "Gërmim themele e plinta  $b>2\text{m}$ , eskavator me goma, kova  $0.25\text{ m}^3$  shkarkim tokë", dhe zëri nr. 2 "Transport material ndërtimi, dheu me auto deri  $5\text{ km}$ ", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $1,567\text{ m}^3$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $1,567\text{ m}^3$ . Sasia e llogaritur në librezën e masave mbi gërmimin dhe transportit pasqyrohet mbi plintin, bazamentit dhe profilet e rrugës me gjatësi  $52.7\text{ m}$  nga  $0 + 000$  deri në  $0 + 052.74$ . Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, konstatohet se në dosjen e punimeve nuk janë të pasqyruara profilet tërthore e gjatësore të kësaj rruge, ku të pasqyrohen kuotat përkatëse të projektit në mënyrë që të argumentohet volumi i plotë i gërmimit, transportit dhe zëri "Mbushje me cakëll e gur gurore në trupin e rrugës, përgapur e ngjeshur me makineri", në kapitullin e sistemimeve të jashtme. **2.** Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime shtresash", zëri nr. 1, "Beton për nivelim  $h=7-10\text{ cm}$ ", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $72\text{ m}^3$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $72\text{ m}^3$ . Sasia e llogaritur në librezën e masave është për dyshemenë e magazinës  $40.5\text{ m} \times 12.5\text{ m} \times 0.07\text{ m} = 35.94\text{ m}^3$ . Ndërkohë nga sipërmarrësi dhe miratuar nga mbikëqyrësi është llogaritur edhe një shtresë tjetër niveluese (Dora 2) e cila është e pajustificuar dhe paargumentuar për tu realizuar edhe për tu likuiduar. Rrjedhimisht sasia e llogaritur e dytë është e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi në sasinë  $35.94\text{ m}^3$  me çmimin prej  $7,500\text{ lek}/\text{m}^3$ , rezulton vlera prej 269,550 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **323,460 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime

të përealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **323,460 lekë me TVSH** nga kontraktori BOE "S.U." shpk & "B." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "Ndërtim magazine në Repartin Ushtarak nr. 1040, Zall – Herr", Tiranë" të lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe OE "2." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi. Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Sisteme të jashtme për rrugë dhe trotuar", zëri nr. 2, "Shtresë betoni C 12/15", librezë e masave pasqyron sasinë prej 115 m<sup>3</sup> dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 115 m<sup>3</sup>. Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas prerjes tërthore të detajit të shtresave për rrugën dhe trotuarin. Nga verifikimi projektit të azhornuar dhe trashësisë së shtresës së betonit të miratuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, konstatohet se kjo shtresë është 20 cm. Ndërkohë në llogaritjet e librezave të masave kjo shtresë është llogaritur me trashësi 30 cm dhe konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 42 m<sup>3</sup> = 115 m<sup>3</sup> - 73 m<sup>3</sup>, me çmimin përkatës prej 6,500 lekë/m<sup>3</sup> = 273,000 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **327,600 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të përealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **327,600 lekë me TVSH** nga kontraktori OE "2." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "Rrethim i jashtëm i Repartit Ushtarak nr. 1060", Babrru, Tiranë" të lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe OE "I." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi. Në situacionin përfundimtar, kapitulli "Punime hekuri betoni", zëri nr. 3, "Konstrksione metalike të thjeshta", librezë e masave pasqyron sasinë prej 78,429.78 kg dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë 78,429.78 kg Total. Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas profileve metalikë të përdorur në rrethim. Nga verifikimi projektit të azhornuar dhe trashësisë së konstrksioneve nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, konstatohet se disa nga profilet metalike kanë diferenca në peshat specifike të tyre (profili 50x30x4mm). Nga rillogaritjet e librezave të masave profili i cili ndikon më shumë në zërin përkatës është 50x30x4 mm, i cili në librezën e masave është llogaritur me peshën specifike 4.89 kg/ml, ndërkohë nga verifikimet e peshës së këtij profili rezulton pesha specifike prej 4.30 - 4.65 kg/ml, në varësi të prodhuesve dhe të prodhimit specifik të metaleve. Nga rillogaritjet sipas peshës specifike reale, rezulton se konstatohet që sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej 1,741.34 kg, me çmimin përkatës prej 132 lekë/kg = 229,856 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi **vlera prej 275,827 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të përealizuara. (Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha

procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **275,827 lekë me TVSH** nga kontraktori "I." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt: "*Rikonstruksioni i Magazinës Nr. 5 Agjencia Mbroje, DPRMSH Korçë*", lidhur midis Autoritetin DPRMSH, dhe OE "P.G." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi. Në situacionin përfundimtar, kapitulli "*Punime shtresash*", zëri nr. 2, "*Shtresë betoni C 25/30, t=8 cm (dysHEMEJA e depos)*", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $62.9 \text{ m}^3$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $62.9 \text{ m}^3$ . Sasia e llogaritur në librezën e masave është llogaritur sipas gjatësisë dhe gjerësisë së magazinës. Nga verifikimi projektit të fillestar dhe të azhornuar, konstatohet se përmasat e brendshme të magazinës janë  $10.68 \text{ m}$  gjerësi dhe  $58.93 \text{ m}$  gjatësi. Pra sipërfaqja e shtresës së brendshme është ( $10.68 \text{ m} \times 58.93 \text{ m} = 629.37 \text{ m}^2$ ) dhe trashësisë së shtresës së betonit  $t = 8 \text{ cm}$ , rezulton volumi prej  $629.37 \text{ m}^2 \times 0.08 \text{ m} = 50.34 \text{ m}^3$ . Pra konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë prej  $12.6 \text{ m}^3 = 62.9 \text{ m}^3 - 50.3 \text{ m}^3$ , me çmimin përkatës prej  $14,200 \text{ lekë/m}^3 = 178,920 \text{ lekë pa TVSH}$ . Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **214,704 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të parealizuara. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **214,704 lekë me TVSH** nga kontraktori OE "P.G." shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt "*Ndërtim magazine nr.1 dhe nr.2 në Repartin Ushtarak nr. 1001, Zall – Herr*", Tiranë", lidhur midis Autoritetin Reparti Ushtarak nr. 1001 dhe BOE "I." shpk & "Z." shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi. Në situacionin përfundimtar, kapitulli "*Punime Murature*", zëri nr. 1, "*Mur me tulla të lehtësuara dopio deri në 8m, ll.p.M25*", librezja e masave pasqyron sasinë prej  $90.9 \text{ m}^3$  dhe situacioni përfundimtar pasqyron sasinë  $90.9 \text{ m}^3$ . Llogaritjet janë realizuar me perimetrin e magazinës, me mbylljen me tulla të hapësirës së kapriadës, duke zbritur dritaret, derën dhe brezin. Llogaritja e zbritjes për brezin e batonit është në sasinë  $2.63 \text{ m}^3$ . Ndërkohë, nga auditimi i librezave të masave dhe projektit konstatohet se në zërin "*Brez b/a C 16/20, h= 8m*" është situacionuar një sasi e paargumentuar prej  $12.3 \text{ m}^3$  brez betoni për mure dhe ky volum punimi nuk është zbritur i plotë në volumin e mureve perimetral por vetëm  $2.63 \text{ m}^3$ . Rrjedhimisht sasia prej ( $12.3 \text{ m}^3 - 2.63 \text{ m}^3$ ) =  $9.67 \text{ m}^3$  e situacionuar për Mur tulle, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, me çmimin prej  $8,400 \text{ lekë /m}^3$ , rezulton vlera prej  $81,228 \text{ lekë pa TVSH}$  për 1 magazinë ose  $19.34 \text{ m}^3$  (për 2 magazinat) dhe rezulton vlera prej **162,456 lekë pa TVSH** për të dyja magazinat. Në total, konstatohet se sipërmarrësi ka përfituar më tepër sasinë në total prej  $19.34 \text{ m}^3$ , me çmimin përkatës prej  $8,400 \text{ lekë/m}^3 = 162,456 \text{ lekë pa TVSH}$ . Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **194,947 lekë me TVSH**, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar dhe punime të parealizuara. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **194,947 lekë me TVSH** nga kontraktori BOE "I." shpk & "Z." shpk, për punime të likuiduara

por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratë me objekt *“Ndërtimi i parkut të mbyllur për mjetet e blinduara (HMMWV) në Repartin Ushtarak nr. 1001 Zall-Herr”*, lidhur midis Autoritetin Komandës së Forcës Tokësore dhe BOE “M. I. G.” shpk & “I.G.” shpk & “B.” shpk, nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, verifikimeve në objekt dhe librezës së masave, u konstatuan disa pasaktësi. Referuar pagesave pjesore konstatohet mospërputhje midis realizimit të punimeve me pagesat pjesore dhe situacionit përfundimtar nga operatori ekonomik, duke realizuar punime shtesë, duke referuar edhe tabelës së lëvizjes së volumeve. Referuar shkresës nr. 3458/3 prot., datë 19.10.2021, nga mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve deklarohet se mangësia e projektit ekziston në ndërtesat e parashikuara për tu prishur pasi ato ishin të prishura. Në situacionet pjesore dhe tabelën e lëvizjes së volumeve, punimet e prishjes kanë qenë 0 lekë (janë likuiduar vetëm në Sit. Nr.2), ndërsa në situacionin përfundimtar shtohet një sasi “Prishje shtresa betoni” dhe transporti i tyre në vlerën prej 323,400 lekë pa TVSH, e cila është e paargumentuar dhe justifikuar bazuar librezës së masave dhe ecurisë së zbatimit të punimeve, e përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi, c’ka ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve për miratimin e tyre në kundërshtim me Udhëzim Nr. 2, datë 13.5.2005 *“Për Zbatimin e punimeve të ndërtimit”* dhe Udhëzim Nr.3, datë 15.2.2001 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*. Për këtë investim rezultoi se është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi vlera prej **388,080 lekë me TVSH**, për punime të parealizuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës prej **388,080 lekë me TVSH** nga kontraktori BOE “M.I.G.” shpk & “I.G.” shpk & “B.” shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar *“Rikonstrukcion objekti nr. 3, në Repartin Ushtarak nr. 1010, Vau i Dejës, Shkodër”* ka marrë pjesë 1 OE, ku KVO-ja ka kryer në SPE në datë 04.07.2022 vlerësimin e procedurës. Operatori ekonomik i shpallur fitues “A.” shpk, është tërhequr nga oferta më datë 13.06.2022, në procedurën e prokurimit. E drejta për tu tërhequr nga një procedurë administrative, parashikohet në nenin 64, të Ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, cituar: Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjore, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Me raportin përmbledhës të Drejtorit të DPA nr. 3498/2 prot. Datë 27.07.2022, drejtuar SP, njoftohet tërheqja e OE “A.” shpk, ku KVO refuzoi ofertën dhe kërkon konfiskimin e sigurimit të ofertës në vlerën prej 317,298 lekë dhe të raportojë pranë APP rastin e tërheqjes së ofertuesit. Me shkresën e titullarit të MM nr. 4065/1 prot. Datë 08.08.2022, kërkohet konfiskimi i ofertës nga shoqëria “A.” sh.a, lëshuar në emër të shoqërisë “A.” shpk, përfitues Ministria e Mbrojtjes në vlerën **317,298 lekë**, bazuar në nenin 83 të LPP, ku vlera e sigurimit të ofertës transferohet në llogarinë e MM sipas numrit të llogarisë dhe kodit të institucionit. Me shkresën nr. 4065/2 prot. Datë 08.08.2022, raportohet tek APP mbi tërheqjen e OE. Formulari i sigurimit të ofertës rezultoi me datë 13.06.2022 me nr. Serial; 220603613 me afat vlefshmërie 150 ditë. Nga auditimi i të ardhurave të arkëtuara në MM për periudhën 2022 deri në përfundim të auditimit në terren, rezultoi se kjo shumë nuk është arkëtuar nga subjekti si detyrim i lindur



nga konfiskimi i sigurimit të ofertës. Gjithashtu, nga MM kjo vlerë prej **317,298 lekë** nuk është pasqyruar as në pasqyrat financiare të institucionit si detyrim, duke ndikuar në pasqyrimin jo të drejte të llogarisë 468 “Debitorëve të ndryshëm të institucionit”, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 5, faqet nr. 79-174 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1.Rekomandimi:** Ministria e Mbrojtjes, sektori i prokurimeve të marrë masa të menjëhershme për dërgimin e njoftimit të konfiskimit të ofertës nga shoqëria “A.” sh.a, lëshuar në emër të shoqërisë “A.” shpk, përfitues Ministria e Mbrojtjes në vlerën prej **317,298 lekë**, ku vlera e sigurimit të ofertës transferohet në llogarinë e Ministrisë së Mbrojtjes sipas numrit të llogarisë dhe kodit të institucionit.

## Menjëherë

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për realizimin e projektit “TO BE READY” si dhe procedurës së likuidimit për “Menaxher Projekti”, “Financier Projektit” dhe “Menaxher Komunikimit” për periudhën 2021-2022 rezultoi se:

Në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në lidhje me projektin mungonin raporte të realizimit të projektit dhe të shërbimit të realizuar nga kontraktuesit, sipas përcaktimeve të nenit 3, të kontratës së lidhur, ku janë të përcaktuara dhe angazhimet specifike që duhet të realizojë menaxheri i projektit, financieri i projektit dhe menaxheri i komunikimit të projektit.

- Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, këta ekspertë janë paguar çdo muaj bazuar në kontratën e lidhur dhe një karteletë “Fletë kohore për stafin e personelit që punon me një numër fleksibël orësh në muaj ose në bazë mujore”, pa bashkëlidhur dokumentacion, ku të vërtetohet qëllimi dhe objekti i shërbimit.

- Financierja e projektit I. M. është paguar vetëm bazuar në kontratën e lidhur me MM, dhe nuk ka të bashkëlidhur dhe të dokumentuar asnjë raport mbi realizimin e shërbimit të përcaktuar në kontratën siç janë raportimet financiare, raporte për buxhetimin e aktivitetit, raporte financiare, pasqyrat financiare, rishpërndarjen e buxhetit sipas/nëse kërkohet nga AK raportet e FCL dhe në fund raportin financiar të projektit.

Pagesa totale prej 8,166 mijë lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara padrejtësisht dhe të paguar 100% nga buxheti i shtetit.

Veprimet në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar me nenin 4, pika 26, nenin 2, pika 16, si dhe të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorin publik” pika 35, germa b.

2. Nga MM janë realizuar pagesa ndaj menaxherit të projektit znj. R. D. edhe për periudhën e 6- mujorit të parë të vitit 2020, periudhë pandemie Covid -19, vlerë e cila është e pajustificuar, bazuar dhe në detyrat të përcaktuara në nenin 3 të kontratës. Gjithashtu nga analiza e raportimeve në FLC kjo periudhë nuk është raportuar për tu rimbursuar. Nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15% rezulton se pagesa prej 1,006,442 lekë nuk është kërkuar për rimbursim, si rrjedhojë kjo vlerë e paguar përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara padrejtësisht dhe të paguar 100% nga buxheti i shtetit.

- Gjithashtu nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM, pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15%, për financieren L. Dh. rezulton se në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në shumën 830,275 lekë, ku pasi i hiqet tatimi në burim vlera është në shumën prej 705,734 lekë. *Nga MM është paguar vlera prej 941,861 lekë me një diferencë më shumë në vlerën 236,127 lekë, pas zbritjes së tatimit në burim.*

- Ndërsa për F. H., si menaxhere komunikimi nga analiza e shumës së deklaruar në FLC për rimbursim, me atë të paguar nga MM pasi kemi zbritur vlerën e tatimit në burim prej 15%, rezulton se në FLC është deklaruar vlera për rimbursim në shumën 989,887 lekë, ku pasi i hiqet tatimi në burim vlera është në shumën prej 841,404 lekë. Nga MM është paguar vlera prej

941,861 lekë me një diferencë më shumë në vlerën 100,457 lekë, pas zbritjes së tatimit në burim. Si rrjedhojë vlera e paguar në shumën prej 100,457 lekë përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pasi janë fonde të përfituara padrejtësisht. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të merren masa për ngritjen e një grupi pune, që të vlerësojnë e të analizojnë vlerën e shërbimit të likuiduar në vlerën **9,509 mijë lekë**, e cila rezultoi e paguar në kushte e mungesës së raporteve të realizimit të projektit dhe të shërbimit të realizuar nga kontraktuesit sipas përcaktimeve të kontratës së lidhur, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga përfituesit.

**Menjëherë**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i rimbursimeve në lidhje me programin Trilateral “Interreg IPA CBC “Itali–Shqipëri–Mali i Zi 2014/2020” të projektit “TO BE READY” rezultoi se nga projekti është rimbursuar vlerat prej 401,126 Euro.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga AKMC citohet se është kërkuar për tu “*Certifikuar nga FLC dhe Komisioni Evropian*” shuma prej 824,422.88 Euro, por të miratuar për tu rimbursuar është vlera prej 806,422.88 Euro, me një diferencë më pak në shumën prej 18,000 euro, për të cilën nuk është dhënë sqarime dhe argumentime, se për cilën nga paketat nuk është bërë certifikimi i shumës.

- Buxheti total i projektit për Shqipërinë ku përfshihen institucionet si Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është 1,479,049.95 euro, ku nga informacioni i dhënë nga menaxherja e projektit dhe AKMC është cituar se, fondi ka pësuar shkurtime për shkak të situatës pandemike Covid 19 në vlerën 129,936.37 euro, nga ku rezultoi se buxheti total i projektit është në vlerën 1,349,113.58 euro, nga të cilat 1,079,290.86 euro janë financim nga IPA dhe 269,822.7 euro janë bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total). Vlera e bashkëfinancimit nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total) ka një mospërputhje në llogaritje pasi në fazën e parë, pa u shkurtuar fondet vlera e bashkëfinancimit ka qenë në shumën 221,857.50 euro. Me shkurtimet e fondeve edhe vlera e bashkëfinancimit ulet në mënyrë proporcionale dhe nuk mund të pësojë rritje me shumën 47,965.22 euro.

Nga sa më sipër buxheti total i projektit në vlerën 1,349,113.58 euro, ndahet në 1,146,746.5 euro financim nga IPA dhe 202,367 euro bashkëfinancim nga Ministria e Mbrojtjes (15% e vlerës në total). Në këto kushte shuma e ngarkuar më tepër, si detyrim i Buxhetit të Shtetit në vlerën 67,455.68 Euro (269,822.716 - 202,367), duke rënduar buxhetin e shtetit me vlera të pajustificuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 8, faqet nr. 187-217 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1.Rekomandimi:** Nga Titullari i Ministrisë së Mbrojtjes të marren masa për ngritjen e një grupi pune, që të vlerësojnë e të analizojnë vlerën prej **67,455.68 Euro** të përlogaritur më tepër si detyrim për tu paguar nga shteti Shqiptar dhe shumën e shpenzimeve prej **18,000 Euro** e paargumentuar dhe justifikuar, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore e financiare dhe të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e vlerës nga përfituesit.

**Menjëherë**

## **C.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Vendimeve gjyqësore, të cilat kanë marrë formë të prerë për punonjës /zyrtarë civil është konstatuar se:

- Për 6 mujorin e dytë të vitit 2021 është paguar shuma prej 4,568,760 lekë;
  - Për vitin 2022 është paguar shuma prej 9,137,520 lekë;
  - Për 6 mujorin e parë të vitit 2023 është paguar shuma prej 5,573,169 lekë, për ekzekutimin dhe pagesën e 7 vendimeve gjyqësore me detyrimin për “Pagesë page deri në kthim në punë” për ish punonjës të larguar padrejtësisht nga puna, për të cilët vijon pagesa dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi nuk rezulton të ketë komunikim me Departamentin e Administratës Publike për këta gjyq fituesit, ku të jetë kërkuar sistemimi i tyre në institucione të tjera të administratës publike.
  - Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbartimore dhe detyrimet ndaj gjyqfituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë risku e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyqëfituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbartimore. Nga grupi i auditimit bazuar në urdhër shpenzimet e audituara mbi likuidimin e gjyqëfituesve bëri ndarjen e detyrimeve që në detyrime ndaj gjyqëfituesve dhe shpenzimeve përmbartimore, nga ku rezultoi se shpenzimet përmbartimore janë si më poshtë:
    - Për 6 mujorin e vitit 2021 janë paguar shpenzime përmbartimore në shumën 681,670 lekë;
    - Për vitin 2022 janë paguar shpenzime përmbartimore në shumën 1,254,362 lekë;
    - Për 6 mujorin e vitit 2023 janë paguar shpenzime përmbartimore në shumën 226,879 lekë.
- Sa më sipër, vlerë prej 21,442 mijë lekë, konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për buxhetin e shtetit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqet nr. 31-44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Nga Strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Mbrojtjes, të merren masa në bashkëpunim me DAP, për rikthimin në punë të të gjithë punonjësve që kanë fituar këtë të drejtë sipas përcaktimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

**Menjëherë**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, pika 4, germa “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrit të Mbrojtjes**, në vlerësim të shkeljeve sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe nenit 57, pika 1, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për punonjësit sipas përgjegjësive të tyre, në lidhje me çështjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara, sipas nenit 58, germa “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil”.

#### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit që do të jepen masat disiplinore për shkeljet sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarë veprimet si më poshtë:

- a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.
- b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

## **F. NJOFTIMI I INSPEKTORATIT TË LARTË PËR DEKLARIMIN DHE KONTROLLIN E PASURIVE DHE KONFLIKTIT TE INTERESAVE.**

Për shkeljet sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Kreu VI, Neni 41, “Autoritetet përgjegjëse për parandalimin, kontrollin dhe zgjidhjen e gjendjeve të konfliktit të interesave” që ka përcaktuar se “Autoriteti qendror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe që përmendet në këtë ligj me shkurtimin “Inspektorati i Lartë. Inspektorati i Lartë, vihet në lëvizje me kërkesë të institucioneve publike, palëve të interesuara dhe kryesisht me nismën e tij”, si dhe Neni 42 “Kompetencat e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, germa “h” që sanksionin “vendosjen e masave administrative ndëshkuese në kompetencë të tij, sipas përcaktimeve në këtë ligj”, KLSH të informojë ILDKPKI mbi situatat e mundshme të konfliktit të interesit të rezultuara në Ministrinë e Mbrojtjes dhe strukturat e saj, me qëllim që të ndërmarrë veprimet e nevojshme ligjore, për sa më poshtë vijon:

### **a. Për znj. K. B., me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Financës, pasi:**

Nga auditimi i strukturës së Ministrisë së Mbrojtjes, u konstatua se përgjegjësi i Sektorit të Financës është i punësuar si anëtare e Këshillit Bashkiak të Tiranës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin Nr. 152/2013 për nëpunësin civil, neni 37, pika 3 ku citon se: “Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore. Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra”.

### **b. Për znj. L. A. Dh., me detyrë Këshilltar pranë KMSHC-së, pasi:**

Në kuadër të programit trilateral interreg IPA CBC Italia- Shqipëri-Mali i Zi 2014-2020” nga Ministria e Mbrojtjes janë kontraktuar “Menaxher Projekti”; “Financier Projekti” dhe “Menaxherit të Komunikimit” për projektin në projektin “*TO BE READY-The flood and Big fire foREst, prediction, forecAst and emergency management - 355*”.

Nga auditimi i dokumentacionit të kontraktimit të ekspertëve të projektit rezultoi se:

Me znj. L. Dh. dhe MM është lidhur kontrata me nr. 2107/3, datë 31.12.2020, ku në nenin 6 është përcaktuar paga mujore 850 euro/muaj. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga aplikantja znj. L. Dh., në CV e paraqitur ka deklaruar se që nga dhjetor 2014-vazhdim është këshilltar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Kontraktimi i L. Dh. si financiere e projektit është në kundërshtim me Rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Institucionin e Komisionarit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” miratuar me Vendimin nr. 11, datë 29.01.2016, neni 15 “Zyrtarët që mbartin detyrimin për deklaram periodik të interesave private” pika 2:

Zyrtarët e KMSHC-së, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklaram të interesave private periodike janë:

a). Komisioneri;

b). Këshilltari;

c). Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ; etj....

Neni 16 “Kufizimi i interesave privatë për parandalimin e konfliktit të interesit Zyrtarët e KMSHC-së” pika b) nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër fitimprurëse, me përjashtim të mësimdhënies.

### **c. Për znj. A. T. me detyrë Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit për periudhën e auditimit, pasi:**

Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale për xhenion (elemente për ura Bailey)” OE i shpallur fituese rezulton se nuk plotëson kërkesat e DST. OE fitues si BOE; 3. – P. rezulton se nuk është prodhues, ku në skedën teknike tek “Letër angazhimi e

Prodhuesit/Distributorit të autorizuar” të paraqitur ka vëne emrin e tij.  
Nga auditimi i dokumentacioneve të dorëzuar nga OE “T.D.” ShPK shtojca 8 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, “Mbi Konfliktin e Interesit” ka bërë deklaram të rremë pasi një nga ortakët e kompanisë është Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, post të cilin e mban që nga muaji Nëntorit 2021, në kundërshtim me nenin 21, paragrafi 1, Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 ”Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**